REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I LETËRSISË

DISERTACION

"LETËRSIA PËR FËMIJË"

(Nga Rilindja deri në kohët e sotme)

PËR MBROJTJEN E GRADËS "DOKTOR I SHKENCAVE" NË LETËRSI SHQIPE

Punoi:
Ma. Rudina ALIMERKO

Udhëheqës shkencor:
Prof. As. Dr. Astrit BISHQEMI

Tiranë, 2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I LETËRSISË

DISERTACION

I paraqitur nga Ma. RUDINA ALIMERKO
Në kërkim të gradës shkencore "Doktor"

Tema: **"LETËRSIA PËR FËMIJË"**

(Nga Rilindja deri në kohët e sotme)

Udhëheqës shkencor:
Prof. As. Dr. Astrit BISHQEMI

Mbrohet me datë_____

Komisioni i vlerësimit:

1. **Prof. Dr. Bashkim Kuçuku – kryetar jurie**
2. **Prof. Dr. Floresha Dado – oponent**
3. **Prof. Dr. Ali Xhiku – oponent**
4. **Prof. Dr.Klara Kodra– anëtar**
5. **Prof. Asoc. Dr. Kristaq Jorgo - anëtar**

PËRMBAJTJA

Parathënie ……..……..…..... v
Hyrje 7

KREU I

1.1 Burimet e letërsisë shqiptare për fëmijë, folklori për të vegjlit ……..... 12

KREU II
Tradita romantike e Rilindjes në letërsinë shqiptare për fëmijë

2.1 Tablo panoramike ……..... 25
2.2 Kristoforidhi i vjershës dhe i prozave të para për fëmijë ……..... 29
2.3 Naim Frashëri – themeluesi i letërsisë shqiptare për fëmijë 35
2.4 Sami Frashëri i abetares së Stambollit 45
2.5 Çajupi – përshtatësi më i talentuar i përrallave të La Fontenit 47
2.6 Papa Kristo Negovani – themeluesi i novelës për fëmijë 52

KREU III
Letërsia shqiptare për fëmijë në dy-tri dekadat e para të shekullit XX (para e pas shpalljes së Pavarësisë)

3.1 Tablo panoramike 63
3.2 Ndihmesa në letërsinë për fëmijë e Anton Xanonit 66
3.3 Ndre Mjeda – mjeshtër i vargut poetik 68
3.4 Asdreni – poeti i natyrës dhe i kushtrimit për liri 72
3.5 Luigj Gurakuqi – pionieri i qytetërimit perëndimor 77

KREU IV
Fillimet e letërsisë moderne shqiptare për fëmijë

4.1 Tablo panoramike 82
4.2 Revistat për fëmijë 85
4.3 Ilo Mitkë Qafëzezi – letrarizonjësi për fëmijë e të rinj 87
4.4 Dhimitër Pasko – Mitrushi i përrallave dhe i rikrijimeve 88

KREU V
Autorë të letërsisë bashkëkohore për fëmijë

5.1 Tablo panoramike 92
5.2 Bedri Dedja 101
5.3 Odhise Grillo 108

5.4 Petro Marko 112
5.4.1 *Shpella e piratëve* e Petro Markos dhe *Dy vjet pushime* e Zhyl Vernit 116
5.5 Adelina Mamaqi 122
5.6 Xhevat Beqaraj 132
5.7 Gaqo Bushaka 139
5.8 Ferhat Çakërri 144
5.9 Skënder Hasko 150
5.10 Bardhyl Xhama 154
5.11 Tasim Gjokutaj 161
5.12 Astrit Bishqemi 168
5.13 Xhahid Bushati 174
5.14 Ferit Lamaj 179
5.15 Viktor Canosinaj 185
5.16 Bardhosh Gaçe 190
5.17 Andrea Petromilo 195
5.18 Vilhelme Vranari 199
5.19 Përllumb Velo 201

PËRFUNDIME 204

BIBLIOGRAFI 209

Parathënie

*Në kuadër të studimeve në fushën e letërsisë për fëmijë, tema **"Letërsia për fëmijë"** (Nga Rilindja deri në kohët e sotme) synon të paraqesë atë krijimtari letrare që u dedikohet posaçërisht fëmijëve e të rinjve dhe që ndikon fuqishëm në formimin e shprehisë së leximit, si dhe zgjimin dhe thellimin e dashurisë së tyre për artin letrar.*

Janë bërë përpjekje të trajtohen shkrimtarë të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në gjini të ndryshme letrare për lexuesit e moshave të njoma, duke theksuar më shumë anën estetike të krijimeve letrare dhe njohjen e veçorive psikologjike të fëmijëve.

Studimi është një përpjekje modeste për t'u dhënë studentëve, mësuesve dhe lexuesve të tjerë një panoramë të lindjes dhe zhvillimit të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Luigi Santucci letërsinë për fëmijë e quan letërsi e magjisë dhe letërsi e mrekullisë, që nxit përfytyrimin, kënaqësinë, fisnikërinë dhe pasurimin shpirtëror. Në këtë kuadër, themi që edhe punimi ynë ka meritën se i kushtohet një dege të rëndësishme të letërsisë sonë, një dege disi të lënë pas dore dhe jo të vlerësuar siç duhet tek ne edhe në ditët e sotme.

Në renditjen e shkrimtarëve është patur parasysh kriteri kronologjik, pra mosha e tyre. Por ky kriter është gërshetuar, është thyer edhe nga pesha që ka ky apo ai autor me të cilët kanë qenë bashkëkohës. Pra, kemi patur parasysh edhe hierarkinë e vlerave. Madje, është vlerësuar edhe koha kur ata kanë debutuar e kanë kontribouar në letërsinë për fëmijë.
Bie fjala:
Vërtet Xanoni është i datëlindjes 1862, kurse Negovani -1875, por Negovani studiohet para Xanonit, sepse ai ka dalë me vëllim të veçantë për fëmijë më parë: "Vjershë shkresëtorja" e tij është botuar më 1899, kurse tri vëllimet e "Këndimeve për shkollat e para të Shqypnisë" të Xanonit (në bashkëpunim me Mjedën) kanë dalë në vitet 1904-1911).
Ose:
Vërtet Sotir Gurra është i datëlindjes 1884, kurse Vasil Xhaçka – i 1895-s, por Xhaçka studiohet përpara, sepse kontributi i tij në letërsinë për fëmijë është shumë më i hershëm. Revista e tij për fëmijë "Vatra e Rinisë" qarkulloi e militoi në vitet 1933-38, kurse "Mituria" e Gurrës në vitin 1944, vetëm disa muaj jetë.

Edhe te letërsia bashkëkohore e letërsisë për fëmijë është patur parasysh ky gërshetim kriteresh që parashtruam. Kështu, megjithëse Petro Marko është i datëlindjes 1913, ai studiohet pas B. Dedjes (lindur më 1930) dhe O. Grillos (l. 1933), sepse romani i tij i parë "Shpella e piratëve" e pa dritën e botimit më 1964, atëherë kur Dedja e Grilloja patën botuar secili nga disa libra për fëmijë dhe qenë bërë të njohur e të dashur si autorë për lexuesit e moshës së re. Po në të njëjtën mënyrë kemi arsyetuar për shkrimtarët e tjerë bashkëkohorë, duke vënë në plan të parë cilësinë, peshën e tyre artistike, vitin e publikimit të veprave artistike të tyre të shquara, si dhe datëlindjet e autorëve.

Gjithashtu, shtojmë se është patur parasysh karakteri rivlerësues për disa autorë e vepra të botuara në periudhën moniste.

Theksojmë që duhet patur parasysh se:

- Ky studim nuk është tekst i plotë e shterues i letërsisë për fëmijë; në të ardhmen do të plotësohet për t'u botuar si i tillë.

- Nuk janë përfshirë në këtë studim të gjithë shkrimtarët shqiptarë e letërsisë për fëmijë e të rinj. Madje, janë marrë vetëm shkrimtarë që kanë kontribuar dhe kryer aktivitetin letrar brenda kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë. Pra, në punimin tonë nuk janë përfaqësuar shkrimtarët shqiptarë të letërsisë për fëmijë që jetojnë e krijojnë në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në Diasporë, të tillë si: Agim Deva, Fejzi Bojku, Hajro Ulqinaku etj. etj., që janë pjesë integrale e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj. Teksti ynë me këta autorë do të plotësohet, siç thamë, në të ardhmen.

- Në studim nuk është ruajtur sa duhet përpjesëtimi i paraqitjes së shkrimtarëve sipas peshës së tyre (shkrimtarëve më të spikatur në fushën e letërsisë për fëmijë e të rinj t'u kushtohej vend më tepër, të trajtoheshin më gjerë). Ky përpjesëtim do të shikohet më vonë, kur punimi të plotësohet, të përgatitet e të redaktohet për botim si tekst letërsie.

Hyrje

Punimi synon për një karakter sa më integral dhe ka padyshim vlera njohëse. Gjithashtu synon të japë një panoramë gjithëpërfshirëse të krijimtarisë letrare, specifike për fëmijë, lëvruar gjatë periudhës së Rilindjes dhe prek pothuaj gjithë portretet e krijuesve që bënë emër, jo vetëm me veprimtarinë atdhetare dhe diturake, por edhe me veprën e tyre letrare për fëmijë.

Themi që ka meritën që i kushtohet një dege të letërsisë sonë, disi të lënë pas dore, akoma më shumë në ditët e sotme; për shkak të specifikave që ka për shembull: fazën e fëmijërisë në formimin e karakterit e të shijes estetike të njeriut të ardhshëm, gjuhën e veprës letrare për fëmijë që e veçon nga gjuha e veprës për të rriturit, stilin artistik, figurat stilistike që përdoren në krijimet për fëmijë, tematika e saj, nevojat, aftësitë e mundësitë perceptuese e receptuese të lexuesit të cilit i dedikohet.

Është kjo arsyeja e ndërmarrjes së kësaj teme dhe që më ka bërë t'i përkushtohem me pasion. Ndërsa Luigi Santucci e quan letërsinë për fëmijë, letërsi e magjisë dhe letërsi e mrekullisë duke nxitur përfytyrimin, kënaqësinë, fisnikërinë dhe pasurimin shpirtëror, mendoj me të drejtë se letërsia për fëmijë mund të përkufizohet si Hirushja e letërsisë sonë.

Gjatë punimit të disertacionit kam ndier kënaqësinë të zbuloj profile të ndryshme shkrimtarësh që me artin e tyre argëtojnë, edukojnë lehtësisht, ëmbëlsisht dhe me dashuri, të vegjël e të rinj.

Por njëkohësisht kam ndier përgjegjësinë se si çdo punë hulumtuese shkencore që ka vështirësitë e saj (pavarësisht modeleve në punën time), të jem e kujdesshme në argumentim të disa problematikave, në analiza të shkrimtarëve të marr në studim, etj..,duke mos rënë në përsëritje, por duke sjellë diçka të re në fushn e studimeve të letërsisë për fëmijë e të rinj.

Objekti i kësaj teme studimore është një përpjekje për të ravijëzuar në një sfond më të plotë të zhvillimit letrar shqiptar për fëmijë që nga zanafilla e tij dhe në vazhdim. Tema"Letërsia për fëmijë", ka karakter përshkrues dhe analizues, por sigurisht që nuk mungon ana informative.

Si është realizuar kjo punë?

Nga njëra anë kemi theksuar mendimin kritik mbi disa krijime që duhen kërkuar te mbledhësit e hershëm të kësaj letërsie përmendim këtu Thimi Mitkon etj, nga ana tjetër një pasqyrë të tipareve dhe veçorive që krijoi letërsia shqipe për fëmijë gjatë Rilindjes Kombëtare, kohë kur kjo pasuri letrare nisi të krijojë fytyrën e saj letrare e pastaj kategorizimin e autorëve dhe të veprave në autorë përfaqësues të tyre dhe në vepra të tjera të njohura.

Në trajtimin e kësaj teme, është patur parasysh që letërsia për fëmijë ka po ato karakteristika të përbashkëta të zhvillimit të letërsisë së të rriturve; por nga ana tjetër ajo përfiton edhe veçoritë e saj, mbart mjaft tipare specifike që lidhen drejtpërdrejt me lexuesin e vogël.

Metodat e kërkimit për këtë studim ka qenë një ndër pikësynimet kryesore për të bërë një trajtim hulumtues, kërkues dhe analizues në fushën e letërsisë për fëmijë.

- *Themi hulumtues, sepse çdo punë hulumtuese shkencore ka kërkesat dhe vështirësitë e saj. Edhe në këtë studim duke patur parasysh hapësirën e madhe të problemeve që i përkasin kësaj fushe, natyrisht jemi munduar të hulumtojmë në literaturat më të fundit për të sjellë profile shkrimtarësh dhe kontributin e tyre në këtë fushë.*
- *Themi kërkues, për shkak të specifikës që ka letërsia shqipe për fëmijë. Meriton vëmendje dhe kujdes duke u bazuar në kërkimin e vlerave më të mira. Kemi parasysh analizën e veprave të veçanta të autorëve të marrë në studim, duke nxjerrë në pah krijimin letrar që ka bërë autori dhe që i përgjigjet kërkesave që ka kjo fushë.*
- *Themi analizues, pasi ky punim vjen si studim në fushën e letërsisë për fëmijë, dhe, si e tillë, jemi munduar e përpjekur që të pasqyrojmë e të analizojmë rolin e padiskutueshëm të atyre figurave, personaliteteve që jo vetëm krijuan letërsi të mirëfilltë artistike për fëmijë, por dhanë edhe komente, interpretime apo vlerësime të pjesshme të kësaj letërsie, ashtu sikundër kjo parrullë apo moto do të shërbejë në platformën krijuese, që me përkushtim, pasion e dashuri e kthyen në art të mëvetsishëm duke sjellë perla në letërsinë tonë magjike.*

Lënda e punimit është shpërndarë, organizuar dhe strukturuar në pesë pjesë:

*Në kreun e parë të punimit me temë "***Burimet e letërsisë për fëmijë***", synon të pasqyrojë fillesat dhe burimet e letërsisë shqiptare, ku letërsia jonë për fëmijë gjenezën e saj e ka, si e gjithë letërsia e kultivuar, te folklori popullor, te folklori për të vegjël, sikundër janë përrallat fantastike, këngët popullore për të vegjëlit, këngët-lodra, ninullat shqiptare, këngët e motmotit, gjëegjëzat dhe këngët e ndryshme lirike.*

Krijuesit tanë nga foklori nuk kopjuan mekanikisht tema, fabula për krijime të tyre, nuk u ndikuan nga pasazhe të jashtme, por synuan shpirtin popullor të krijimtarisë, ndjeshmërinë artistike, mënyrën e këngëtimit, magjinë e rrëfimit.

Letërsia për fëmijë traditën e vet e formësoi si letërsi didaktike me frymë moralizuese. Megjithatë në këtë temë studimi kemi ngulmuar që hapësirat e letërsisë për fëmijë t'i ndriçojmë dhe për kohët më të hershme në ato të pakta gjurmë që gjënden në botimet kishtare dhe shërbesat e saj, ku nëpërmjet tyre pasqyrohet bota artistike shqiptare. Pjesët didaktiko-fetare për fëmijë, niset nga vepra "Doktrina e Krishterë" e Lekë Matrëngës (1592), të cilën ai e di për dokument të parë me të cilin zë fill letërsia e shkruar didaktike-fetare shqiptare për fëmijë. Të kësaj periudhe janë dhe veprat e Theodhor Kavaliotit, (1718-1797), Danil Haxhiut (1754-1825) dhe të Konstatin Beratit (1745 - 1825), kurse si një shkallë më të lartë të zhvillimit të kësj letërsie paraqet veprën e Naum Veqilharxhit (1797-1866).

Në kreun e dytë, ***"Tradita romantike e Rilindjes në letërsinë shqipe për fëmijë"*** *trajtohen dhe gjykohen disa veçori të zhvillimit të letërsisë shqipe për fëmijë gjatë Rilindjes Kombëtare.*

Ashtu si letërsia e të rriturve, edhe letërsia për fëmijë zë fill me një nga periudhat më të ndritura të jetës shqiptare, atë të Rilindjes Kombëtare ku mjaft autorë, personalitete të shquara, krijuan artin e tyre për të vegjël.

Kjo pasuri letrare për fëmijë bën pjesë në traditën romantike të letërsisë sonë, e cila ka tiparet e veta, ka porosinë e saj kryesisht për nevojat e zgjimit kombëtar dhe arsimit shqip. Pjesa më e madhe e krijimeve të kësaj letërsie, si: vjersha, tregime, fabula, përralla, copëza letrare-shkencore, janë shkruar posaçërisht për t'u përfshirë në tekste për shkollat e para shqipe. Të tilla janë pothuajse të gjitha krijimet për fëmijë të Kostandin Kristoforidhit, të Naim Frashërit, të Sami Frashërit, të Papa Kristo Negovani, etj.

Midis tyre ka patur mjaft krijime të tjera të shkruara posaçërisht për fëmijët, jashtë kuadrit të teksteve shkollore, që ata të edukohen artistikisht dhe moralisht. Në këtë këndvështrim përfshihen krijime të mirëfillta letrare dhe artistike siç është vëllimi "Vjersha për mësonjëtoret e para" i Naim Frashërit, si dhe dy përmbledhjet "E këndimit të çunave këndonjëtoreja" po të këtij autori, të cilat, megjithëse lidhen përsëri me shkollën, i konsiderojmë si librat e parë artistikë jashtëshkollorë. Në këtë periudhë kemi edhe përkthime e përshtatje të fabulave të Ezopit dhe fabulistëve të tjerë nga Anton Santori e më vonë nga Çajupi etj.; novela "I vogli Donat Argjendi" i P.K.Negovanit etj..

Letërsia për fëmijë e Rilindjes Kombëtare shënoi një hap cilësor; ajo u zhvillua si një letërsi artistike në gjini të shkurtra e, megjithatë, ajo nuk mundi të fitonte tiparet e një dege të pavarur në trungun e letërsisë së përgjithshme.

Kostandin Kristoforidhi zë vendin e parë në historinë e lëvrimit të gjuhës shqipe, po edhe të letërsisë artistike për fëmijë (me vjershën "Ylli i vogël lart në qiell", përrallëzën "Dy dhitë" apo tregimin e gjatë "Gjahu i malësorëve").

Një nga tiparet e tjera të kësaj tradite letrare për fëmijë është se rilindësit tanë treguan që kultivimi i letërsisë për fëmijë ishte një mision i madh e i rëndësishëm shoqëror, pedagogjik, artistik dhe kombëtar, letërsi e cila duhej lëvruar për të zhvilluar dhe qytetëruar brezin e ri të Shqipërisë.

Ndër ta ishin: Kostandin Kristoforidhi-babai i gjuhës shqipe, Naum Veqilharxhi-polemist dhe themelues i abetares shqipe; Naim Frashëri- poeti ynë Kombëtar i Rilindjes, Sami Frashëri me mendje enciklopedike, Çajupi – përshtatësi më i talentuar i fabulave të La Fontenit, fabula të cilat, si na thotë vetë me një vjershë origjinale në faqen e parë të librit në fjalë, ua adresoi fëmijëve, brezit të ri. Me të tillë kulturë ishin edhe autorë të tjerë pasues të letërsisë shqipe për fëmijë, si: Gjerasim Qiriazi, Papa Kristo Negovani, Anton Xanoni, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Asdreni etj.

Nga studimet që kanë bërë një varg autorësh shqiptarë si: Bedri Dedja, Astrit Bishqemi, Odhise Grillo, Agim Deva, Hamit Boriçi, Faik Shkodra, Tasim Gjokutaj etj., del në pah që kjo pasuri letrare për fëmijë bën pjesë në traditën romantike të letërsisë sonë e cila ka tiparet e veta, kryesisht për nevojat e zgjimit kombëtar dhe arsimit shqip. Pjesa më e madhe e autorëve të kësaj letërsie për fëmijë ishin mësues, mëmëdhetarë, poetë e shkrimtarë të cilët dhanë një ndihmesë të shquar në përhapjen e shkollës shqipe dhe, sidomos, në rrënjosjen e vetëdijes kombëtare.

Për hartimin e kësaj teme jemi mbështetur në mjaft artikuj e studime që kanë bërë autorët tanë të njohur, por edhe në vetë krijimtarinë e tyre letrare që vitet e fundit është botuar në ringjallje të kësaj kulture të veçantë artistike.

*Në kreun e tretë, "**Nga letërsia për fëmijë në gjysmën e parë të shekullit XX"** hulumtohet letërsia për fëmijë në fillim të shekullit XX me Xanonin, Mjedën, Gurakuqin, Asdrenin.*

I njëjti proçes vazhdon edhe pas shpalljes së Pavarësisë, pra, në gjysmën e parë të shekullit XX. Këtu shquan punën e mirë të abetareve e të këndimeve të Anton Xanonit e të Ndre Mjedës, Luigj Gurakuqit e Asdrenit dhe theksohet se jashtë këtyre teksteve, letërsia jonë për fëmijë nuk njohu botime te veçanta artistike.

*Në kreun e katërt, "**Në fillimet e letërsisë moderne shqiptare për fëmijë"** jepet një panoramë e zhvillimit të letërsisë për fëmijë në vitet '30, e cila nisi të lëvrohej më me gjallëri, duke dalë nga kuadri i ngushtë didaktik që siç citohet të ketë shkruar poeti dhe studiuesi Tasim Gjokutaj,"pati më tepër leximе për fëmijë sesa letërsi të mirëfilltë për fëmijë".*

Të kësaj periudhe theksohet si shumë të rëndësishme për zhvillimin e letërsisë sonë për fëmijë edhe disa vepra të përkthyera të letërsisë botërore për fëmijë, si romani "Zemër" të Edmondo De Amiçisit, romani "Njeriu i padukshëm", i Ralf Kolfordit, "Robinson Kruzo" i Daniel Defosë, "Princi i lumtur dhe përralla të tjera" i Oskar Uajlldit, "Liza në botën e çudirave" i Ljuis Kerollit etj.

Letërsia për fëmijë mori një shtysë të veçantë në këtë kohë me daljen në dritë të revistës së parë për të vegjëlit "Vatra e rinisë", e cila nisi botimin më 1933 dhe pati një jetë 6-vjeçare. Në faqet e saj u botuan krijime letrare për fëmijë të mjaft autorëve si: Milto Sotir Gurra, Vasil Xhaçka, Ilo Mitkë Qafëzezi, Spiro Çomora etj.

Një vend të rëndësishëm përbën dhe krijimtaria e mirëfilltë letrare për fëmijë e prozatorit Mitrush Kuteli. Asnjë autor tjetër shqiptar nuk është mbështetur kaq fort te proza e pasur gojore e popullit, te balada e rapsodia; fryt i përpunimit me mjeshtëri i materialeve folklorike është vëllimi "Tregime të moçme shqiptare". Kuteli ka marrë prej këtij thesari popullor epikën legjendare e historike, ciklin e Kreshnikëve, baladat e moçme arbëreshe, ngjarje nga Moti i madh i Skënderbeut, të cilat i ritregon me bukuri e mjeshtëri artistike.

*Kreu i pestë, "**Disa autorë të letërsisë bashkëkohore për fëmijë"** është i ndarë në sythe dhe nënsythe të cilat jepen në mënyrë të detajuar. Është bërë kategorizimi i autorëve dhe i veprave në autorë përfaqësues të tyre dhe në vepra të tjera të njohura, duke nxjerrë vlerat e qëndrueshme artistike letrare për fëmijë.*

Autorë përfaqësues të poezisë dhe prozës moderne shqipe për fëmijë prezantohen poetët: Bedri Dedja, Odhise Grillo, Petro Marko, Adelina Mamaqi, Xhevat Beqaraj, Gaqo Bushaka, Ferhat Çakërri, Skënder Hasko, Bardhyl Xhama, Tasim Gjokutaj, Astrit Bishqemi, Xhahid Bushati, Ferit Lamaj,Viktor Canosinaj, Bardhosh Gaçe etj. Kështu, mbështetur në metodën e seleksionimit dhe të rivlerësimit, prezantohen edhe përfaqësues e vepra të njohura edhe të shumë llojeve të tjera të shkrimit letrar si të letërsisë artistike - shkencore, të fabulës, të përrallës sonë të kultivuar, të përshtatjes dhe rikrijimit, etj.

Mirënjohje...

Gjatë punimit të disertacionit kam ndier kënaqësinë të zbuloj profile të ndryshme shkrimtarësh që me artin e tyre argëtojnë, edukojnë, lehtësisht, ëmbëlsisht dhe me dashuri, të vegjël e të rinj.

Por njëkohësisht kam ndier përgjegjësinë se si çdo punë hulumtuese shkencore që ka vështirësitë e saj (pavarësisht modeleve në punën time), të jem e kujdesshme në argumentim të disa problematikave, në analiza të shkrimtarëve të marr në studim, etj..,duke mos rënë në përsëritje, por duke sjellë diçka të re në fushen e studimeve të letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj.

Pa dyshim, një punim i tillë nuk është vetëm vepër personale e disertantes, por është fryt i kontributit dhe bashkëpunimit të disa personave që kam kënaqësinë t'i falenderoj në mënyrë të veçantë.

Së pari do doja të shpreh mirënjohjen time për udheheqësin shkencor Prof. Dr. Astrit Bishqemi, i cili ishte një udhëheqës vizionar, mendimtar ideal nga pikpamja strikte, profesional, të mendimit shkencor dhe autentik. E falenderoj për sugjerimet e tij të vazhdueshme dhe të vlefshme, disponueshmërinë, inkurajimin dhe përkrahjen gjatë punës për realizimin e disertacionit, sa më pranë interpretimit studimor e kërkimor.

Një falenderim i veçantë shkon për studentët e mi me të cilët kam shkëmbyer ide dhe mendime, e që me vullnetin që kanë treguar në diskutimet dhe analizat në lëndën e Letërsisë për fëmijë e të rinj, më kanë nxitur t'i përkushtohem kësaj fushe akoma më shumë gjatë gjithë periudhës time disa vjeçare si pedagoge e kësaj lënde.

Së fundmi, dëshiroj të shpreh një falenderim të veçantë për familjen time, ndaj bashkëshortit dhe mikut tim më të mirë, Kreshnikut, ndihma e së cilit në momente të vështira, ka qenë gjithnjë e madhe. Ka ditur të më kuptojë dhe të më përkrahë gjatë gjithë kohës së realizimit me sukses të punimit. Atij dhe dy fëmijve të mi të mrekullueshëm Hergert dhe Stela, unë ua kushtoj këtë punim.

KREU I

1.1.BURIMET E LETËRSISË SHQIPTARE PËR FËMIJË, FOLKLORI PËR TË VEGJLIT

Ashtu si popuj të tjerë të Europës, edhe shqiptarët, qysh në kohët e moçme e kanë përkundur botën fëminore në traditat e tyre të krijimtarisë gojore, e cila tek ne është edhe e pasur, edhe e larmishme. Kjo botë artistike me përralla, legjenda, ninulla,gjëegjëza, proverba dhe fabula ka ushqyer tek fëmijët, që prej vatrës familjare, ndjenja të fuqishme e emocione, kurse nga ana tjetër ka ndikuar tek ata edhe për edukimin artistik dhe moral.

Shoqëria jonë njerëzore në artin e vet popullor,duke sjellë këto përfytyrime mbi natyrën,botën dhe shoqërinë, ka shpalosur në botën e fëmijëve edhe tablo të mëdha të jetës,ëndrra dhe vizione të cilat kanë krijuar tek fëmijët një botë interesante duke nxitur fantazinë e tyre. Nëpërmjet përrallave, legjendave dhe këngëve fëmijët kanë mësuar gojë më gojë ndër breza, për luftërat dhe përpjekjet e shqiptareve për Atdheun dhe lirinë, për bukuritë e natyrës, Hënën, Diellin, zogjtë, por edhe për botën mitologjike aq të pasur me zana, dragonj, kuçedra e katallanë, të cilat përbëjnë një pasuri të pazëvëndësueshme të artit popullor. Nëpërmjet përrallave dhe fabulave ata kanë mësuar për jetën e kafshëve, zogjve dhe shpendëve, por në të njëjtën kohë arti popullor u ka mësuar atyre me alegorinë e vet, edhe veprime, ngjarje e dukuri të njëjta me ato të shoqërisë njerëzore.

Qysh në kohët e hershme në traditën gojore shqiptare ka qenë mjaft e zhvilluar proza tregimtare, mjaft e shumëllojshme. Në luftë për të drejtën dhe lirinë, bota shpirtërore dhe artistike shqiptare krijoi heronjtë e vet, përfaqësuesit e vet, që luftojnë për çlirimin shoqëror dhe mbrojtjen e dinjitetit të tyre.Vetë përrallat me personazhe dhe ngjarje të çuditshme, me aventurat dhe heronjtë e tyre i çojnë fëmijët në mjedise fantastike duke u dhënë atyre të kuptojnë mjaft dukuri të thella të jetës.

Në kulturën popullore shqiptare, ***përrallat popullore***, me të cilat janë rritur breza të tërë fëmijësh, përbëjnë një pasuri të madhe artistike të cilat ndikojnë tek fëmijët. *Përralla ndihmon në edukimin mendor të të vegjëlve. Fëmijët mësohen të njohin të bukurën në natyrë e shoqëri*[1].

Në motivet dhe tematikën e tyre janë të pranishme mjaft forca të natyrës: vërshimi i lumenjve, përmbytjet dhe sidomos fatkeqësitë natyrore në të cilat fantazia popullore ka personifikuar dhe krijuar qënie të mbinatyrshme me tipare dhe karakteristika të veçante[2].

---

[1] Pandora Dedja. Roli i perrallave ne edukimin moral dhe estetik te femijeve. – Shqiptarja e re, 1974, nr. 2, f. 25

[2] Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i gjuhësisë, "Histori e letërsisë shqiptare", vëllim i parë, Tiranë 1959, f. 56

Nëpërmjet kësaj pasurie artistike, fëmijët mësojnë se si njeriu ndeshet e fiton mbi forcat e errëta të natyrës, gjithmonë sipas parimit: e mira fiton mbi të keqen.

Në përrallat shqiptare ndeshjet midis dragoit dhe kuçedrës sjellin në përfytyrimet e fëmijëve shtrëngatat dhe furtunat, vrasja e kuçedrës nga dragoi pasqyron luftën kundër thatësirës.

Qysh në kohët e hershme, këto forca misterioze të natyrës kanë formuar karaktere dhe funksione të shumëfishta. Figura të tilla,si: Cikllopi,Gjigandi me një sy apo Katallani personifikojnë egërsine e detit. Gjithsesi, ngjarjet mbartin optimizëm, ku e drejta dhe e mira triumfojnë mbi të keqen dhe padrejtësinë, në artin poetik të këtyre përrallave.

Këto përralla mbështillen në një botë ëndërrimtare, ku heronjve u vijnë në ndihmë krahët e zogut, Pela Qylehane, kafshë e shpendë të tjera, të cilat nëpërmjet botës fantastike ndihmojnë njeriun për të shpëtuar nga e keqja. Nga ana tjetër, përrallat me forcën artistike realizojnë tek fëmijët, ndjenjën e guximit dhe të vetëmohimit për të luftuar në jetë për të drejtën, me besim të madh në vetvete.

Bota motivore e përrallave është e mbushur përherë me elementë të tillë ku realizohet fitorja e së mirës ndaj së keqes, e cila nxit tek fëmijët dashurinë për botën njerëzore dhe lumturinë e tyre. Pikërisht kjo luftë i ka ndarë personazhet në të mirë dhe të këqinj. E Bukura e Dheut përfaqëson lumturinë dhe gëzimin e jetës[3]. Por që të arrihet kjo lumturi, heroi përballet me vështirësi të mëdha. Shpesh këto figura si: E Bukura e Dheut ndeshet me përbindësha, kuçedra dhe qenie me shtatë kokë, me dredhi dhe dhelpëri, por kurdoherë fiton e mira, mençuria dhe trimëria.

Në traditën popullore shqiptare ka një pasuri të veçantë për të Bukurën e Dheut, ajo jeton në det, lumenj, liqene, kroje dhe herë quhet Floçkë e herë Gërzhetëz. Edhe kur martohet E bukura e Dheut, i dashuri i saj duhet të tregojë zgjuarsi dhe trimëri të madhe, dashuri dhe fisnikëri. Por edhe trimi nuk e ka të lehtë që të fitojë zemrën e saj, pasi ai pengohet nga vëllezërit dhe nga elementë të tjerë, megjithëse atij i vijnë në ndihmë disa qënie fantastike si: Dyrdyli (një lloj kali që fluturon në hapësirën shqiptare), Pela Qylehane, Miza e Dheut. Midis personazheve të përrallave shqiptare shfaqen Dedalia, Maro Përhitura, që me veprimet e me sjelljet e tyre, vlerat morale të virtyteve kundër veseve dhe shfaqjeve negative të jetës.

Mjaft interesante në përrallat shqiptare janë dhe personazhet negativë që fantazia popullore u ka dhënë cilësi dhe karakteristikë aq të dallueshme saqë në përfytyrimin e fëmijëve mishërojnë të keqen si: Kuçedra, Lubia, Divat, Katallani, Syqenëza, Shtatëpëllëmbëmjekra, Qosja, por, edhe përfytyrime të tilla si: njerka apo si motra e pasur. Duke lexuar disa nga përrallat popullore shqiptare vëmë re se mjaft prej atyre personazheve sjellin në perceptimin e fëmijëve botën mitologjike shqiptare.

[3] Po aty, f. 57

Në përmbledhjet tona folklorike si: ”*Bleta shqiptare*” e Thimi Mitkos, ”*Valët e detit*” e Spiro Dines apo përmbledhjet ”*Visaret e Kombit*”, personazhe të tilla si: orët, zanat, shtojzovallet, dragonjtë zënë një vend të rëndësishme në tablonë e ngjarjeve duke i dhënë përrallës gjallëri e dinamizëm. Personazhet shpeshherë veprojnë në kufi të një mbretërie, në mjediset fshatare, por edhe në qytete. Përralla të tilla si: “*Gjuetari e shejtani*”,”*Djali gjahtar e dervishi*”, ”*Miu,buburreci e maçorri*”,”*Qerosi që vrau kuçedrën*”,”*Trimi që u martua me të bijën e Stihisë*”, përbëjnë një thesar të kulturës sonë shpirtërore pasi ato simbolizojnë jetën, ëndrrat, luftërat dhe përpjekjet e shqiptarëve për përparimin dhe lumturinë e tyre. Ato ndikojnë drejtpërdrejt tek fëmijët edhe për faktin se kanë një botë të pasur artistike, ngjarje, bëma e histori, si dhe një gjuhë poetike që përthithet shpejt nga fëmijët. Përvetësimit të tyre prej fëmijëve u shërben dhe nga ndërtimi i thjeshtë i përrallave. Fëmijët qysh në hyrje të tyre, takohen me personazhet e tyre të dashur, më tej vazhdojnë aventurat dhe elementë të çuditshëm. Kështu fëmijët përftojnë vlera të mëdha edukative, etike dhe estetike duke u argëtuar..

Në përrallat shqiptare klishet e hyrjeve dhe mbylljeve, dialogët e shumtë, peizazhi, përshkrimi i figurave si dhe stili me fjali të shkurtëra, mbartin brenda tyre psikologjinë e fëmijëve. Gjenia e popullit pjesën më të madhe të përrallave e ka krijuar për të vegjëlit. Ato kanë vlera pedagogjike:

- Zhvillojnë aftësitë njohëse të fëmijës. Përralla i zgjeron horizontin mendor fëmijës, i mpreh shijet estetike, e edukon në pikëpamjen morale.
- Zhvillojnë imagjinatën e fëmijëve. Ato i përshtaten mirë të menduarit konkret dhe ende të pazhvilluar të fëmijëve.

xxx

Një vend të veçantë në pasurinë letrare popullore për fëmijë zënë ***fabulat***. Në qendër të tyre kanë personazhe kafshë, shpendë apo bimë,veprime të të cilave dhe përshkrimet e tyre nxisin fantazinë e fëmijëve. Ato janë të pëlqyeshme nga fëmijët edhe për faktin se nëpërmjet tyre njohin nga afër jetën e kafshëve. Në botën poetike të fabulave, në sytë e fëmijëve, shpalosen fenomene morale dhe shoqërore, por nga ana tjetër kjo botë poetike mjaft e larmishme brenda saj ka dhe zërin e protestës kundër veseve, ligësive dhe elementeve negative të jetës. E rëndësishme është të vëmë në dukje se fabulat shqiptare kane një përfundim proverbial me mendime filozofike dhe mjaft te kuptueshme nga fëmijët[4].

Vetë personazhet e këtyre fabulave, si: ujku, gomari, dhelpra, gjeli, pula, luani, tigri zbërthejnë ngjarje,bëma e veprime që marin një kuptim alegorik e përcjellin mesazhe të qarta. Në fabula kafshet personifikohen: qengji nenkupton njeriun e mire e te urte, dhelpra- njeriun dinak, ujku- njeriun e

[4] Bardhosh Gaçe, “Letërsia shqipe për fëmijë”, Vlorë, 2006, f. 25

keq dhe gjakatar etj. Pra, fabulat jane krijime te shkurtëra me karakter alegorik e simbolik. Si të tilla, fabulat kanë një synim të qartë moralizues me një qëllim të dukshëm didaktik, që gjen mishërimin më konçiz dhe konkretizohen sipas moralit në fundin e tyre. Shpeshherë në fund, moralizimi konkretizohet me një fjalë të urtë, që paraqitet si një përfundim logjik i gjithë veprimit që jep fabula. Midis fjalëve të urta vlen të përmendim si: *Bashkimi bën fuqinë; Mos u mëso të tjerëve gjëra që ti nuk i kupton; Më mirë të jetosh një ditë si luan, sesa nje jetë të pasur e si mi; Veprimet flasin më fort se fjalët etj.*

Fabulat si tregime alegorike, nëpërmjet bashkëbisedimit të kafshëve a bimëve, mbartin edhe psikologjinë dhe humorin e pasur shqiptar. Personazhet e tyre simbolizojnë krenarinë, madhështinë, guximin, forcën. Kështu, shqiponja simbolizon guximin dhe krenarinë, milingona-punën, dhelpra-dinakërinë, ndërsa ujku-egërsinë.

Në fabulën"*Shqiponja dhe penda e saj* " del ne pah personazhi i shqiponjës si simbol i forcës dhe guximit:

Një shqiponjë qendronte në majë një shkëmbit dhe priste çastin të sulej mbi një lepur që po vërtitej buzë pyllit.

Një gjahtar i fshehur në pyll qëlloi me shigjetë mbi shqiponjën dhe e plagosi për vdekje. Shqiponja hodhi një shikim mbi zemrën e saj dhe pa se maja e shigjetës ishte bërë prej pendësh shqiponje.

-Është një dhimbje e dyfishtë për mua sepse duhet të vdes nga pendët e mia, - tha shqiponja ndërsa ndjente fundin e saj.

Ndërsa në fabulën "*Qeni, gjeli dhe dhelpra* "shpaloset me mjeshtëri personazhi i dhelprës si simbol i dinakërisë.

Një qen dhe një gjel dolën bashkë për kismet dhe nata i zuri në pyll. Kështu gjeli kërceu në pemë dhe zuri vend në një degë të lartë, ndërsa qeni dremiti poshtë pemës. Kur, më në fund zbardhi dita e re, gjeli, si zakonisht, këndoi më zë të lartë dhe tërhoqi vëmendjen e një dhelpre, e cila mendoi ta kullufiste.

Kafsha dinake iu afrua pemës dhe i foli gjelit nga poshtë degëve:

- Sa zog i bukur dhe i dobishëm që je! Mes gjithë zogjve të tjerë nuk kam parë asnjë më të bukur se ti. Pse nuk zbret poshtë, miku im, që të këndojmë e të gëzojmë bashkë?

- Shko te trungu i pemës, mike e dashur, - ia ktheu gjeli, - dhe thuaji sakrestanit tim t'i bjerë këmbanës.

Po,kur dhelpra iu afrua trungut të pemës, qeni brofi në këmbë dhe e bëri copa-copa.

Në këtë fabul kaq të bukur përcillet dhe morali i saj: *Ai që ngre kurthe për të tjerët, bie vetë në lak.*

Interesante është dhe personazhi i milingonës në fabulën "*Milingona dhe gjinkalla*".

Një ditë të ftohtë dimri, milingonat po nxirrnin jashtë folesë ca kokrra gruri, që i kishin mbledhur gjatë verës, për t'i tharë nga lagështira. Aty pranë kaloi një karkalec gjysmë i vdekur nga të pangrënët dhe u kërkoi një kafshatë sa për të shuar pakëz urinë.

- Çfarë bëre verën që shkoi?- e pyetën milingonat.

- Oh,- ua ktheu gjinkalla. Këndova ditë e natë dhe nuk pata kohë të mbledh ushqim.

- Epo mirë, atëherë, - i thanë milingonat dhe ia përplasën derën e shtëpisë në fytyrë duke qeshur. Përderisa këndove gjithë verën, kërce tërë dimrin.

Pra, këtu personazhi i milingonës *simbolizon punëtoren,* ndërsa nëpërmjet gjinkallës përcillet idea se *Përtacia është nëna e urisë.*

Rrëfimi në fabul është më i kufizuar e më i përcaktuar se ai në përrallë. Nëpërmjet rrëfimit të kursyer, të gërshetuar sidomos me dialogë, shqiptohen aksione të ndryshme të kafsheve, nga dalin kuptime të qënësishme për jetën e njeriut.

Fabula është një krijim artistik polivalent në lidhje me lexuesin. Ka dy lexime, po të shpreheshim ndryshe. Është e pëlqyeshme nga lexuesit e rritur dhe nga moshat e njoma. Të rriturit i mbërthen në të nënkuptimi, kurse fëmijëve u intereson ngjarja konkrete, aksioni që bart.

Fabula ka po ato cilësi që zotëron përralla, veç është më e shkurtër, shkruhet me pak rreshta apo vargje.

Siç vënë në dukje mjaft studiues si: *Bedri Dede, Astrit Bishqemi, Faik Shkodra,* në fabula zhvillohet një bashkëbisedim i kafshëve dhe i bimëve në të cilat është ngjizur dhe një humor i pasur i mjedisit shqiptar, i psikologjisë së mentalitetit krahinor dhe i vendit, gjë që e bën komunikimin me të vegjëlit të jetë jo vetëm i drejtpërdrejt por krijon tek ata dhe një ambient të gëzuar.

Një pasuri të madhe në krijimtarinë letrare për fëmijë kanë luajtur edhe **anekdotat** që janë përcjellë si një art i fuqishëm gojë pas goje nga te riturit tek fëmijët.

Si tregime të shkurtëra me elementet e tyre humoristike dhe të papriturat e përfundimit të tyre, ato krijojnë tek fëmijët një botë të pasur artistike. Në mjaft tema e motive të anekdotave me pasurinë e madhe të dialogëve të tyre demaskohen aspekte të ndryshme të jetës dhe shoqërisë, kurdoherë me një humor të gjallë dhe argëtim të këndshëm per fëmijët.

Këtë art poetik e bëjnë të fuqishëm edhe vet personazhet groteske. Anekdotat shqiptare tashmë kanë krijuar një fytyrë të skalitur të personazheve të tillë si: Tosku e Mosku, Qerosi, Nastradini, Gishtoja, Gjysagjeli, Kacamisri etj. Aq të përhapura kanë qenë ato në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX saqë me elementët e tyre argëtues kanë gjetur përhapje në të gjithë trevat e vendit, duke kultivuar tek fëmijët një humor të papritur e të këndshëm.

Bukuria e anekdotës qëndron në çastin e kallëzimit të saj dhe në aftësinë e shprehjes së atij që kallëzon. Ajo mund të mbyllet me formulat e zakonshme me të cilat mbyllen dhe përrallat[5].

[5] Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i gjuhësisë, "Histori e letërsisë shqiptare", vëllim i parë, Tiranë 1959, f. 60

Në traditën tonë popullore fëmijët kanë përthithur mjaft moral dhe prej **legjendave** dhe **gojëdhënave**. Nëpërmjet tyre fëmijët janë ambjentuar me mjaft elemente të mbinatyrshëm të cilët edhe pse të trilluar apo imagjinar kanë krijuar një botë fantazie mjaft të pasur.

Megjithatë duhet vënë në dukje se në disa prej tyre ka dhe mbështetje reale, elemente realiste të cilët duke udhëtuar nëpër shekuj e gojë më gojë kanë përftuar të jashtëzakonshmen.

Në botën kulturore shqiptare **legjendat** ndahen në dy grupe:

a-*Legjenda mitologjike*
b-*Legjenda historike*

a-*Legjendat mitologjike* janë krijimet më të hershme në fushën e legjendave por edhe nga më të hershmet në tërësinë e folklorit shqiptar. Motivet, subjektet dhe personazhet mbartin elemente mitologjike, të prodhuar nga fantazia popullore. Në këto legjenda ka përshkrime të gjera me botë të thellë artistike, ku ndodh që njerëzit të shndërrohen në drurë, gurë, shpendë, male apo lumenj, në to ka përgjithësime të fuqishme artistike.

Brenda tyre gjallojnë orët, zanat, shtojzavallet, sutat, dragonjtë, floçkat, të cilat përshkruhen me hiperbolizime e personifikime. Në të gjitha këto legjenda, që paraqiten si trillime të karakterit fantastik shihet një bazë jetësore.

Kështu ilustrojmë legjendën mbi zënkën e Diellit me Hënën, që ishin motër e vëlla.

Zënka e tyre është e lidhur me faktin real se ato asnjëherë nuk janë bashkë, por gjithmonë të ndarë. Nëpërmjet subjektesh të thurrura rreth tyre, këto legjenda na sjellin përfytyrimin artistik si shpjegues të gjenezës, të forcës dhe të burimit të saj, si dhe të rolit që luajnë këto figura mitologjike të veshur me elemente të mbinatyrshëm.

b-*Legjendat historike* edhe pse ndërtohen mbi trillimin e fantazisë popullore, ato kanë dhe një bazë historike, reale. Në legjendat historike personazhet vepruese janë njerëz konkretë, të nxjerrë nga jeta reale e përditshme. Në to përgjithësisht mungojnë personazhet fantastike, karakteristikë të përrallave. Pra, në përgjithësi, në dallim nga legjendat mitologjike, legjendat historike kanë një karakter më realist. Këtë e dikton vetë lënda historike që trajtojnë, përcaktimi i vendit e i kohës së ngjarjes apo dhe disa detaje jetësore që ato ngërthejnë.

Legjendat historike flasin për figura të caktuara historike të popullit shqiptar. Por një vend të veçantë kanë zënë dhe luftëtarë të caktuar, trima dhe trimëresha, që mbi gjithçka vunë interesat e përbashkëta, për të cilat ata luftuan. Aktet e tyre historike nuk u shuan, por, përkundrazi, jehuan nga brezi në brez, nga një periudhë historike në tjetrën duke u legjendarizuar.Midis këtyre legjendave spikatin ato për figurën e Skënderbeut,Gjergj Arianiti, Moisi Golemi, Lekë Dukagjini apo të 90 vajzave krutane që u hodhën nga shkëmbi në lumin Dro për të mos rënë të gjalla në duart e armiqve, ashtu siç ndodh edhe në legjendën e vajzave të

Sulit, apo atë të trimëreshës Maro Kondi nga Kurveleshi. Kuptohet që këtej se, pavarësisht që në një legjendë flitet për një figurë historike, siç është p.sh.Skënderbeu, në të kemi bëma të pabesueshme.

Kështu në një legjendë tregohet se si Skënderbeu, me një të goditur të shpatës, çan malin për t'u dhënë ujë ushtarëve të tij per te shuar etjen. Në këto raste hiperbolizimi ndërtohet mbi bazën e një trillimi me përmasa të mëdha. Dhe në këto legjenda është e dukshme prania dhe roli i fantazisë, por duket qartë se ajo është vetëm një mjet artistik. Nga legjendat përftohen mjaft ndijime e perceptime si dhe vlera edukative, nëpërmjet argëtimit dhe mjedisit gazmor të fëmijëve.

Në krijimtarinë gojore gjendet një pasuri e thellë e mençurisë popullore psikologjike dhe botës shpirtërore të popullit. Por s'duhet të harrojmë, që edhe në këtë lloj të folklorit, fëmijët mëkohen prej imagjinatës së ndezur dhe fantazisë së pasur.

Në botën artistike e edukative të fëmijëve, një vend të rëndësishëm zënë edhe **këngët lodra**, ku qysh në moshën 3-4 vjeç, me fantazinë e tyre, të vegjëlit organizohen në lojra të ndryshme midis tyre, të cilat kanë *karakter lodrues, argëtues dhe edukativ.*

Në këto lodra imitohen shpendë, kafshë, njerëz, kukulla etj., duke u shoqëruar edhe me vargjet e këngëve që këndohen e lodrohen.

Në vargjet e këtyre këngëve, ka humor, satirë, por edhe një botë gazmore fëminore. Lojëra të tilla si "*Dhitë e egra*", "*Koxheli*", "*Vrasja e arushës*","*Gjuha e dhelprës","Bëz-bëz bën bleta","Ujku dhe delet*", kanë zhvilluar tek fëmijët shkathtësinë, guximin, vullnetin, zgjuarësinë dhe vënien në veprim të intuitës së tyre krijuese.

Duke qenë se këto lodrime organizohen në grupe fëmijësh, në hedhjen e shortit midis tyre, apo gjatë lojës, veprimet shoqërohen me vargje poetike si te kënga- lojë "*Shi,shi,lagashi*" :

Shi-shi
Lagashi
Shkoi plaka
Në mulli,
Bëri tre
Kulaçë në hi,
Një e poq,
Një e dogj,
Një e hëngri
Me gjithë zogj.

Një vëmendje të veçantë tërheqin *këngët* dhe *ritet* të cilat në jetën shqiptare, janë praktikuar edhe nga fëmijët. Në traditën shqiptare çdo stinë ka patur festat e veta,të cilat kanë dhe këngët dhe lodrat e tyre të organizuara prej fëmijëve, ceremoniale të tilla: *kalendrat* (25 dhjetor), *Shën Gjini* (24 qershor), *Shën Mitri* (Tetor), të cilat janë të lidhura ngushtë me një botë të pasur poetike të praktikuar.

Festat e motmotit nisin me Kalendrat e cila nënkupton ripërtëritjen dhe fuqinë e Diellit, festë kjo që kristianizmi e ktheu në ditën e lindjes së Krishtit.

Megjithatë në vendin tonë kremtohet si nga te krishteret dhe muslimanët.

Në Veri të vendit kjo festë quhet "*Kullana*" dhe kremtohet me rastin e dëborës së parë ku mjaft fëmijë organizojnë lodra të ndryshme. Duke kremtuar këtë festë, banorët e vendit me fëmijët e tyre në zjarrin e shtëpisë vënë një kërcu të madh, të cilin kanë emërtuar "*Buzëm*".

Tek të gjithë fëmijët është ngulitur urimi"*Të falem, Buzmi bujar*" dhe prej tyre këndohet kënga :

Po vjen Buzmi bujar
Me gjethe e bar,
Me hedha e shqerra,
Pas tyre vjen vera..

Pas këshëndellave vjen *festa e Vitit të Ri*, siç njihet nga ortodoksit *Shën Vasili*, i cili në mjaft këngë kristianizmi na shfaqet me ngjalljen e fatit për mbarësi të familjes dhe fëmijëve, për shëndetin e tyre dhe për gëzimet e jetës.

Mjaft e pasur bota poetike e fëmijëve është me ceremoninë e *Ditës së Verës*, një ditë e shënuar kjo që kremtohet pothuajse në tërë vendin. Ashtu si në Elbasan, Gjakovë e Labëri, edhe në Mokër e Zagori, fëmijët vendosin guguvere(verore) dhe këndojnë këngë për të ndjellë stinën e pranverës. Sipas traditës *veroret* që bëhen prej katër ngjyrave (e kuqe, jeshile, blu dhe e bardhë) vendosen në këtë ditë nga fëmijët në dorë e në gushë dhe pas një periudhe, ato lidhen mbi pemë (ftonj,shege,kumbulla) që t'i marrin dallëndyshet dhe zogjtë e tjerë duke kënduar vargjet e këngëve:

Dallëndyshe,dallëndyshe,
Na kët'verore të kuqe,
Të ma shpiesh anës detit,
Të m'i sjellësh bukë shëndetit.

Mjaft interesante paraqiten këngë dhe rituale për *Shën Gjergjin* (23 Prill), *Rusicat* (25 ditë pas Pashkëve), *Shën Gjini* (24 Qershor), *Shën Dhimitri;* ku në çastet e kremtimit të këtyre festave ndizen edhe zjarre nëpër kodra, pyje e sheshe të fshatrave.

Krahas lodrave e gostive në vargjet e këngëve përcillen edhe momente për të nderuar Tokën,Hënën,Diellin,Yjet.

Po keshtu paraqiten këngë dhe rituale për *Vangjelizmoin* (25Mars) ose, siç e thërrasin bektashinjtë, Novruzin. Atë ditë fëmijët, për të trembur gjarpërinjtë me rastin e ardhjes së pranverës, këndojnë e lodrojnë:

Ikni gjarpërinj,ikni shtërpinj,
ikni shtëza dhe ju minj,
Se vjen marsi e u përpin,
Arrin dhe Vangjelizmoi,

T'u presë e t'u shkrumbojë,
T'u hedhë në përrua,
T'u bëj qen edhe langua.....

Këngët, lodrat, me çeljen e pranverës, përcjellin një gëzim të veçantë tek fëmijët. Në larminë dhe pasurinë e vargjeve të këngëve, lodrave të stinëve e motmotit, ka edhe lutje e thirrje drejtuar fuqive të natyrës, shpendëve e kafshëve, me vargje *onomatopeike* (që imitojnë zërat e kafshëve e të shpendëve), me fjalor të pasur poetik.

Kjo pasuri e madhe poetike ka përcjellë edhe vetë jetën shqiptare. Nëpërmjet stinëve, ngjyrave, zërave, detit, malit, lumenjve, qiellit, zogjve, përjetimet marrin pamje të ndryshme në botën fëminore. Edhe veshja edhe lodrat e fëmijëve zhvillohen sipas stinëve, me anë të të cilave bota e tyre ndjek këtë shpirt poetik.

Një vend të rëndësishëm në edukimin artistik dhe moral të fëmijëve zënë fjalët e urta dhe gjëegjëzat. Në traditën e kulturës sonë popullore **fjalët e urta** ose, siç quhen ndryshe, *proverba*, shprehin një urtësi dhe një filozofi të thellë. Ato kanë ushqyer nëpër shekuj botën mendore të të vegjëlve por edhe të moshave të tjera.

Në vetvete, fjalët e urta janë thënie të shkurtëra, të mençura, me gjykime e mesazhe që mbartin një përvojë të madhe të jetës. Bota e tyre artistike është krijuar nga përvoja jetësore, duke shprehur stinët dhe motin si dhe interesin e bujkut dhe të blegtorit për prodhime bujqësore dhe blegtorale:"*Prilli mbjell farën, vjeshta mbush hambarët*" , "*Shiu i verës tek pragu i derës*","*Si kofini pas të vjeli*","*Ujku barì s'bëhet*".

Në këto ndërtime artistike vihet re edhe mendësia e fshatarëve si dhe mjediset blegtorale. Krahas tyre, një vend të dukshëm zënë fjalët e urta për punën, zanatet që janë praktikuar në jetën njerëzore: "*Në mos rrjedh,pikon*", "*Qari e zarari janë vëllezër","Ustai që rregullon çatitë e të tjerëve,çatia e tij pikon"*.

Disa prej fjalëve të urta shprehin ëndrrat e prindërve për shkollimin e fëmijëve të tyre ("*Shit kalin, mëso djalin*", "*Kush nuk mëson në djalëri, nuk gjen nder në pleqëri ", "Fëmijës mos i lër pasuri, por mësoi gramati"*; etj); shprehin vlerësimet për shkollën ("*Shkolla të hap sytë", "Libri është arma e të mençurit","Rob' i pamësuar, dru i papunuar"* etj.). Ato bëjnë fjalë për rolin e edukatës që në moshë të njomë ("*Druri ndreqet në të njomë", "Vërsi i djalërisë,kohë e diturisë*"), për vlerën e studimit ("*Dituria s'ka fund", "Sa rron, mëson", "Më mirë të dish, sesa të kesh"*) etj.

Tek fjalët e urta, fëmijët kanë përthithur mjaft vlera artistike-morale sidomos tek një cikël i tërë që kanë të bëjnë me moralin shoqëror, nderimin ndaj njeriut si dhe dashurine dhe respektin ndaj tij për punën dhe dituritë. Në pasurine e këtyre fjalëve të urta është ushqyer një mençuri e rrallë me botë të pasur shpirtërore e thënie lakonike.

Në to është fati i njeriut dhe drama e tij, por dhe nxitja që fëmijët të mësojnë të mirën, të virtytshmen, nderin dhe respektin për jetën.Në thënie të tilla të urta e të mençura, si: "*Nga i ndershmi mos ki frikë","Puna e ka*

*ballin të larë me flori","Mëndje e shëndoshë në trup të shëndoshë"*etj, shpaloset një përvojë e madhe e jetës me mesazhe të qarta. Këto mesazhe transmetojnë tek fëmijët ndjenjën e krenarisë dhe dinjitetin por dhe qëndrimin e prerë që duhet të mbajnë ndaj së keqes dhe fenomeneve negative.

Një cikël i tërë fjalësh të urta shprehin qëndrimin e shqiptarit kundër pushtuesit të huaj, trimërinë dhe lavdinë e tij si dhe ndjenjat e thella kombëtare "*Uji fle,hasmi s'fle","Ku shkel turku,nuk mbin bari","Ta duam Atdheun si shqiponja folenë*",etj.

Një cikël i veçantë i fjalëve të urta të mençura popullore është dhe ai që ka të bëjë me nderimin për virtyte të larta shqiptare. Ky cikël proverbash ka një përhapje të gjerë dhe një fantazi të pasur artistike si "*Shtëpia e shqiptarit-e mikut dhe e shtegtarit","Besa e shqiptarit si purteka e arit","Trimëria mban lirinë dhe mëmëdhenë" ,"Shqiptari është i besës dhe i nderit","Shqiptari, kur jep fjalën, ther djalën","Shqiptari është bujar me vatër dhe zjarr*". Duke përshkruar virtytet e shqiptarit, në mjaft proverba zbërthehen motive të ndryshme të shoqërisë.

Shqiptarët, për vlerat në traditën e tyre artistike, kanë ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi, fjalë të urta për njeriun dhe Atdheun: "*Njeriu është lulja e tokës","Trimi i mirë të vë kufinë", "Çfarë ia sheh syri ia bën dora","Fëmija e djalit-floriri i ballit", "Nusja e djalit-syri i ballit","Burrë e grua,mish e thua*".

Megjithatë, duhet të pranojmë se në psikologjinë shqiptare ka dhe mjaft fjalë të urta që e kanë origjinën e tyre tek besimet popullore, apo mendësitë e moçme.

Duke u nisur nga mendimi i mjaft studiuesve - që nga *Naimi e Çajupi* apo përmbledhjet folklorike të *Thimi Mitkos, Spiro.Dines , Zef Jubanit,* duhet të pranojmë se proverbat kanë një qarkullim të madh në jetën e popullit, por ndërthuren edhe me jetën e popujve të tjerë.

Krahas pasurisë së madhe burimore që ka tradita popullore shqiptare, në përmbledhjet tona dhe në botimet tona folklorike gjenden dhe mjaft fjalë të urta latine, arabe, franceze, ballkanike, që kanë ardhur nëpërmjet marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore të shqiptarëve me të huajt.

Ajo që duhet të vëmë në dukje, është se, fjalët e urta gjenden pothuajse në të gjitha tekstet e Abetareve dhe Këndimeve të hartuara në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare si dhe në tërë krijimtarinë e poetëve më të shquar, si *N.Frashëri, A.Z.Çajupi, K.Kristoforidhi, P.K.Negovani, N.Mjeda, A.S.Drenova,Gj.Qiriazi, J.Bageri* etj. Në botën poetike të fjalëve të urta vihet re rima dhe asonanca çift e çift, aliteracionet si dhe fjalët e zgjedhura me ngarkesa poetike që ndërtohen me anë të metaforave dhe sinekdokave. Një nga vlerat e veçanta të tyre është se ato mbahen mend lehtë prej fëmijëve dhe përdoren vazhdimisht prej tyre.

Në pasurinë e **gjëegjëzave** ushqehet përherë një mendim i fuqishëm artistik me formë metaforike, duke sjellë te fëmijët argëtimin e tyre në raste festash apo në vatrat familjare.

Në traditën popullore shqiptare gjëzat, që ndryshe emërtohen "*Kashelasha*", nëpërmjet pyetjeve shprehin zgjuarsinë e fëmijëve. Në kohët më të lashta gjëzat kanë pasur një karakter ritual dhe magjik me orakullin dhe perënditë.

Në mjaft gjëegjëza shprehet jeta e njeriut, bota bimore, shpendët dhe kafshët, natyra dhe fenomenet e saj: "Hidhet e përdridhet përmbi qeramidhe"(*breshëri*),"Bie në ujë e s'njomet, bie në gjemb e s'gjëmbohet"(*rrezja e diellit*), "Një lis me dymbëdhjetë dega, gjashtë të buta dhe gjashtë të egra"(*viti*).

Megjithatë, më të bukurat gjëegjëza janë ato që lidhen me jetën blegtorale dhe bujqësore; me mjetet e punës: tezgjahu, parmenda, plugu, por edhe mjetet e jetesës:

"Pesë trima thurin një gardh" (*shtizat*),"Sorrë e gjerë dhe bishtgjatë/Vërsulet e na bën darkë"(*tigani*),"Ditën ha mish, natën rri si dervish"(*hosteni*), "Njëherë në mot,/del e kullot"(*drapri*) apo "Rrumbullak, rrumbullak,/ka shtatë brima rreth e qark"(*koka*).

Në analizën që mund t'u bëjmë gjëegjëzave, vihet re se nëpërmjet antitezave të tyre nxitet imagjinata, pasi ato shprehin botën e thellë psikologjike, duke u bërë tërheqëse për fëmijët.

Gjëzat mund t'i ndajmë[6] :

a) Gjëza që paraqesin <u>tipare të jashtme</u> të një sendi dhe kërkojnë gjetjen e emrit të tij:

- duke dhënë ngjyrat e objektit:
  Rruqe- rruqe, paparuqe,
  Gjysmë e bardhë e gjysmë e kuqe. (veza)
- duke dhënë zhurmat që bën, tingujt që lëshon (gjëza onomatopeike):
  Vizh e fup mbas derës. (fshesa)
- duke dhënë tiparet dhe format e sendit:
  Hollë- hollë si byrek
  Trashë- trashë si cyrek. (libri)
  Gjëzat e këtij grupi janë të përshtatshëm sidomos për parashkollorë.

b) Në grupin e dytë futen gjëzat për moshën shkollore, sepse shprehin tipare më thelbësore, <u>tipare të brendshme</u> të sendit, si:

- funksionin e sendit:
  Haber bie, haber shpie. (telefoni)
- formën dhe funksionin e sendit:
  Një e hollë karkacule,
  Që të vesh e të bën lule. (gjilpëra)
- lëndën e sendit:
  Dru prej mali, bisht prej kali. (sita)
- sasinë e elementeve përbërës:
  Gjashtëdhjetë biba, dymbëdhjetë pata,
  Një bari u shkon nga mbrapa. (ora)
- kohën e veprimit:
  Një herë në mot
  Del e kullot. (drapëri)

[6] Miranda Dule: Roli i gjëagjëzave në zhvillimin mendor të fëmijëve – "Probleme të traditës dhe të aktualitetit në letërsinë për fëmijë", T. 1976

- mënyrën e veprimit:
  Kur flet, bërtet. (sëpata)

Në të gjitha këto gjëza proçesi i të menduarit, i cili ka karakter abstrakt, kalon në disa hallka, si: analizë, sintezë, krahasim etj.

c) Gjëza problemore, që jepen në formë tërheqëse dhe edukojnë te fëmijët durimin, këmbënguljen, shkathtësinë e të menduarit dhe arsyetimin etj. Këto janë për mosha më të rritura. Përbëhen nga tri- katër vargje, që ndërtohen më së shumti mbi bazën e antitezës:

Shkon tuj qesh e vjen tuj qa. (Kova)

Shpesh përsëritet një fjalë në fillim:

Bie n'ujë e s'laget,
bie n'ferrë e s'griset,
bie n'gur e s'thyhet. (rrezja e diellit)

Në analizën që mund t'u bëjmë gjëzave, vihet re se nëpërmjet antitezave të tyre nxitet imagjinata, pasi ato shprehin botën e thelle psikologjike, duke u bërë tërheqëse për fëmijët. Në to, si dhe në fjalët e urta, pasqyrohen mençuria dhe urtësia e popullit, që trashëgohet brez pas brez.

Nëna dhe gjyshja luajnë një rol kryesor në botën artistike të fëmijëve. Mendja artistike e gjyshes është shumë e pasur, ndërsa nëna, mes ledheve e pekuleve, nuk lodhet kurrë së krijuari për fëmijën e vet.

Prej tyre është thurur një pasuri e madhe e krijimtarisë poetike për fëmijë, midis ninullave, të cilat përfshihen si lloj më vete në lirikën popullore shqiptare.

Ninullat janë vargje spontane, ku shprehet dashuria e nënës për fëmijën; ajo e do fëmijën e vet të bukur, trim,të mençur, të shëndetshëm: "*U bafsh nderi kësaj shpie,/Punofsh ti,o për Shqipni-e!*". Nëna e krahason fëmijët e vet me zogjtë e qiellit, pëllumbat e pulëbardhat, me lulet e mollës e të ftoit, me botën natyrore e kozmike që e rrethon: "*Fli mori cucë,e mbylli sytë,/Kur t'm'i çelësh,i çelësh si yjtë.…"*

Mjaft interesant është personifikimi i gjumit të fëmijës, në vargjet e ninullave, gjumi e merr fëmijën në krahët e vet dhe e mbështjell me botën e ëndrrave. Ninullat (këngët e djepit), si vargje të improvizuara aty për aty,shprehin dëshirat e ëndërrimet e nënës për rritjen dhe të ardhmen e fëmijës së vet, ato përcjellin ndjenja e përjetime me vlera të veçanta artistike.

Është interesant të përmendim këtu vëzhgimin e studiuesit Prof. Gjergj Zheji për këto këngë: *Në ninullat nënat rrinë larg politikës, larg historisë, larg luftërave, larg*

ndeshjeve etj. Dhe është disi e vështirë të besosh se ajo uron fëmijën që të rritet e të bëhet si ky apo si ai hero. Kjo të bën të besosh se në mjaft këngë ninulle të mbledhura, jo vetëm këto vitet e fundit ku dhunimi është i qartë, por edhe në mbledhjet e mëparshme, ka pasur ndërhyrje e redaktime që

është vështirë të merren si origjinale, edhe kur si model për fëmijët sugjerohet Kastrioti[7].

Në traditën folklorike shqiptare janë përftuar vlera të rralla e brilante të shpirtit artistik popullor. Kjo pasuri e thellë artistike, me funksionet e saj njohës, komunikative, edukative dhe artistike, ka luajtur një rol të madh ndër shekuj, duke mëkuar tek fëmijët kulturën kombëtare dhe frymëzimin poetik popullor.

[7] Gjergj Zheji, "Hyrje në folklor" Tiranë, 1994, f.52.

KREU II

TRADITA ROMANTIKE E RILINDJES NË LETËRSINË SHQIPTARE PËR FËMIJË

2.1 Tablo panoramike
2.2 Kristoforidhi i vjershës dhe i prozave të para për fëmijë
2.3 Naim Frashëri – themeluesi i letërsisë shqiptare për fëmijë
2.4 Sami Frashëri i abetares së Stambollit
2.5 Çajupi – përshtatësi më i talentuar i përrallave të La Fontenit
2.6 Papa Kristo Negovani – themeluesi i novelës për fëmijë

2.1 Vështrim panoramik

Ashtu si romantikët evropianë edhe rilindësit tanë bënë kujdes të veçantë që të mbledhin e të botojnë traditën gojore të letërsisë aq të pasur e aq të çmuar në aspektin artistik dhe argëtuese për fëmijët.

Nën shembullin e prozatorëve anglezë e poetëve gjermanë dhe francezë; (anglezi *Xhejms Markferson* (1765), *Gëtja* në Gjermani, *Shatrobrijani dhe Lamartin* në Francë) edhe poetë, shkrimtarë rilindës gjetën në letërsinë popullore një pasuri të vyer të artit poetik. Pas romantikut të madh *Bajroni* një interesim të madh për traditën tonë folklorike pati anglezi *Sharl Didie* edhe më pas, gjermani *Herman Kester* të cilët tërhoqën vëmendjen e mendimit kritik dhe letrar në Europë për mjaft përralla, këngë e legjenda arbëreshe.

Një punë të thelluar bëri shkencëtari gjerman *Hahn,* në veprën e të cilit qysh në shek. XIX u përfshinë mjaft përralla, gjëegjëza, fjalë të urta e këngë, lodra të botës shqiptare. Më tej këtë punë e çoi albanologu tjetër gjerman *Rajnhald,* i cili, nëpërmjet këngëve të djepit, fjalëve të urta, përcjell natyrshëm një kulturë të thellë artistike, mençurinë popullore dhe lodrat e fëmijëve.

Interesimi i romantikëve evropianë në fund të shek.XIX bëhet gjithnjë e më i madh sidomos nga shkencëtari *August Dozon* i cili me botimin e këngëve, përrallave dhe proverbave dëshmonte interesimin e madh të vatrës familjare shqiptare për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve si dhe ushqimin artistik dhe estetik të tyre.

Këtë gjë e pohon me të drejtë edhe shkencëtari tjetër *Holger De Pedersen* i cili në vitin 1876 përmblodhi në botimin e vet fabula e anekdota si dhe krijime të tjera folklorike shqiptare duke vënë shënimin në disa prej tyre, se këndoheshin nga të vegjëlit,gratë apo pleqtë. Kjo botë e madhe poetike e letërsisë popullore tërhoqi, me të drejtë, vëmendjen e studiuesve dhe dijetarëve evropiane, pasi në to përfshihen tradita dhe zakone, rituale, këngë djepi e trimërie, gojëdhëna e legjenda, të cilat nëpër breza kishin ushqyer moralin dhe fantazinë e fëmijëve shqiptarë.

Një pasuri e madhe e kulturës sonë popullore për fëmijë dhe të rinj, gjëndej edhe në arbëreshët e Italisë. Mjaft prej poetëve dhe shkrimtarëve të njohur,në shembullin e romantizmit evropian, nisën të botojnë përmbledhjet e tyre. I tillë ishte *Viçens Dorsa.*Veçanërisht romantiku ynë i madh *Jeronim De Rada,* i cili, në përmbledhjen e vet "*Rapsodi të një poeme shqiptare*", na jep mjaft variante autentike,që tregojnë për kujdesin e arbëreshëve dhe për frymëzimin e fëmijëve të tyre nga bëmat, trimërite, por edhe nga jeta zakonore e stërgjyshërve të tyre të ikur nga dheu mëmë.

Në parathënien e kësaj përmbledhjeje *De Rada* pohon : "*Këto* këngë *për të gjithe ne janë monumenti më i vjetër i gjuhës sonë dhe një model i madh stili të thjeshtë,të kulluar dhe të fuqishëm*".

Të ndikuar nga romantizmi evropian, edhe mjaft autorë të tjerë të shquar shqiptarë, si: *Thimi Mitko, Spiro Dine, Zef Jubani,* bënë përpjekjet e tyre për ta mbledhur visarin popullor dhe për ta plotësuar me shënime për traditën e gjallë folklorike që ruhej ndër shqiptarë. Pikërisht kjo krijimtari e pasur popullore shërbeu edhe si frymëzim i shkrimtarëve dhe poetëve rilindës për të thurur artin e tyre.

Pasuria e artit poetik popullor për të vegjëlit dëshmohet edhe nga dy veprat monumentale të folkloristikës sonë:

"*Bleta shqiptare*" (1878) e *Thimi Mitkos*
"*Valët e detit*" (1908) e *Spiro Dines*.

Kjo pasuri folklorike dëshmon për një kulturë të lashtë të shqiptarëve ndër popuj e Ballkanit. Me nxjerrjen në dritë të këtyre veprave rilindësit tanë nisën të botojnë edhe artikuj në shtypin e kohës, si në gazetën "*Albania", "Drita", "Dituria*" etj., ku vihej në dukje lashtësia e krijimtarisë gojore dhe përcjellja e saj gojë më gojë ndër breza.

Vepra folklorike "*Bleta shqiptare*" e Thimi Mitkos[8] në një kapitull të veçantë të saj, nën titullin *Këngë të vegjëlish* jep dhe visare të tilla popullore si ato që këndoheshin nga të vegjëlit për Diellin dhe Hënën, shiun e dukuri të tjera të natyrës apo për festat tradicionale, siç ishin: Kërshëndellat, Ujët e bekuar, Ditën e Verës, Shën Gjergji, Shën Gjini apo mjaft vargje të tjera që kanë të bëjnë me rritjen e fëmijës,daljen e dhëmbëve dhe lodrat e tyre. Një pjesë të madhe të këtyre krijimeve i pati mbledhur në Korçë, Elbasan si dhe ndër shqiptarët e Egjiptit, Stambollit e Bukureshtit.

Qëllimi kryesor i *Thimi Mitkos* ishte që bashkatdhetarët e tij, të mëdhenj e të vegjël, të ringjallnin këtë pasuri artistike dhe popullore që permblidhte në

[8] Thimi Mitko – "Vepra", Tiranë 1981, f. 69-83

vetvete doket dhe zakonet, këngët dhe lodrat, dhe gjuhën e bukur shqipe, për edukimin kombëtar të tyre.Siç e vë në dukje vet autori në parathënien e "*Bletës shqiptare*", synimi i tij është që nëpërmjet kësaj pasurie folklorike"*t'u japë brezave që vijnë trashëgiminë kulturore popullore për edukimin kombëtar të tyre*".

Në këtë përmbledhje përfshihen 490 proverba, 80 gjëegjëza, 359 këngë, 12 përralla,të cilat në kohën më pas janë mbledhur edhe nga autorë te tjerë, në vise të ndryshme të Shqipërisë. Gjerësia dhe larmia e materialeve folklorike si dhe burimet e vjeljes tregojnë për përpjekjet vigane të Mitkos në gjurmimin e traditës folklorike shqiptare dhe vlerat e saj kombëtare.

Ndër mbledhësit e shquar të folklorit renditet dhe **Zef Jubani** (1818-1880) i cili, krahas prozës dhe vjershave të veta,më 1871 pati botuar një përmbledhje folklorike nën titullin *Këngë popullore dhe rapsodi poemash shqiptare* në të cilën gjëndet një pasuri e rrallë e traditës gojore të kohës.

Në një shënim të këtij rilindësi me të drejtë shtrohet kërkesa se "*Tradita folklorike, ky visar popullor, duhet me u nxanë në shkolla, për me mësue gjuhën tonë,në mos edhe për zakonet tona".*

Spiro Dine (1844-1922) - një tjetër folklorist, që edhe vet shkruante vjersha me frymë popullore; në veprën e tij *Valët e detit* (1908) përmblodhi mjaft këngë popullore, fjalë të urta, përralla duke ndjekur kështu shembullin e mësuesit të tij *Thimi Mitko*. Në këtë përmbledhje Spiro Dine përfshin mjaft fabula dhe këngë patriotike si dhe lodra e këngë të vegjëlish, që pasqyrojnë botën artistike të fëmijëve.

Studimet në këtë fushë na bëjnë me dije se, krahas subjekteve e motiveve, rilindësit tanë dhe autorët më pas kanë sjellë edhe frymën e përgjithshme,detajet poetike, fabulat, fjalët e mençura e urtësinë popullore, shprehjet filozofike por edhe ritmin dhe rimën, duke krijuar një muzikalitet të gjallë në përjetimet e fëmijëve. Në këtë këndvështrim edhe përvetësimi i përrallave dhe anekdotave,përshtatja dhe kultivimi i tyre është bërë me mjeshtëri të madhe, duke sjellë vlera të reja në letërsinë tonë.

Bota folklorike shërbeu jo vetëm për kultivimin e përrallave por edhe për të ndërtuar zhanre të mëdha si novela e romane, ku elementët përrallore dhe fantastikë zënë një vend të gjerë.

Përgjithësisht tradita jonë e pasur folklorike dëshmon për visare të çmuara të artit popullor që rilindësit tanë, të ndikuar dhe nga romantizmi europian, e përvetësuan dhe pasuruar atë duke krijuar përfytyrime të reja dhe një kulturë të re poetike- artistike në letërsinë shqipe për fëmijë. Këtë traditë, që ka të bëjë dhe me origjinalitetin kombëtar të letërsisë shqipe për fëmijë e thelluan, e çuan dhe më tej edhe mjaft autorë të letërsisë moderne për fëmijë që patën si shembull letërsinë romantike të Rilindjes sonë. Akademiku Bedri Dedja arsyeton se themelimi i letërsisë së shkruar artistike shqiptare për fëmijë nuk mund të jetë produkt i një viti. *Ai është një proçes i ndërlikuar zhvillimi gjatë shumë viteve, i një periudhe prej gati një shekulli, fundi i shekullit XVIII dhe fundi i shekullit XIX* [9].

[9] Bedri Dede, "Probleme të historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë" , MESUESI, 15.12.1999

Ndaj fillimet e kësaj letërsisë duhet t'i kërkojmë në disa dokumente: në shqipërimet e fabulave për fëmijë, në dy vjershat e Veqilharxhit që ndodhen në evëtarin e tij, në krijimet e Kristoforidhit, të Naimit, Samiut, Negovanit e të Çajupit etj.

Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare nis në vitin '30-40 të shekullit XIX dhe vazhdon deri në shpalljen e Pavarësisë. Është një lëvizje e tërë politike, ideologjike, kulturore dhe letrare e popullit tonë për çlirim nga zgjedha osmane.

Atdhetarët shqiptare zhvilluan një veprimtari të gjerë brenda e jashtë vendit tonë, dhe krijuan klube e shoqëri patriotike. E tillë qe *Shoqëria e Stambollit* më 1879, me kryetar Sami Frashërin. Degë të saj u ngritën në Bukuresht (*Drita* e pastaj *Dituria*), në Sofje (*Dëshira),* në Egjipt e në Amerikë etj. Edhe brenda në Shqipëri u formuan shoqëritë kulturore *Bashkimi, Agimi, Përparimi* etj. Ato botuan shumë gazeta, revista e libra shqip duke propaganduar idetë kombëtare.

Rëndësi të veçantë patriotët shqiptarë i kushtuan arsimit, shkollës dhe gjuhës shqipe. Më 1887 në Korçë u hap Mësonjëtorja e parë shqipe; më 1908 në Manastir u mblodh Kongresi që miratoi alfabetin e gjuhës shqipe, këtë që përdorimin edhe sot e kësajdite, kurse më 1909 në Elbasan hapi dyert shkolla e parë e mesme – Normalja, që do të përgatiste mësues për shkollat tona.

Rilindasit i dhanë rëndësi zgjimit të ndërgjegjes kombëtare, edukimit të dashurisë e të krenarisë për vendin e për kombin tonë.

Rilindasit i kënduan plot dashuri gjuhës amtare, historisë së lavdishme, veçanërisht kohës e bëmave të Skënderbeut, virtyteve të çmuara të popullit tonë, si: besës, trimërisë, shpirtit të pamposhtur liridashës, urrejtjes ndaj pushtuesve.

Veçoritë e letërsisë për fëmijë në këtë periudhe janë këto:

- Letërsia për fëmijë përgjithësisht nuk doli jashtë kuadrit të teksteve shkollore dhe, si pasojë, nuk mund të fitonte tiparet e një dege të pavarur në trungun e përgjithshëm të letërsisë së kësaj periudhe.
- Qe një letërsi romantike. Rilindasit u përpoqën t'i japin kësaj letërsie fryme të shëndoshë atdhetare, të dashurisë për gjuhën, për dijen etj.
- Letërsia për fëmijë dhe mësimi shkollor në gjuhën shqipe janë një proçes i njësuar, një proçes i vetëm. Pavarësisht nga kushtet e vështira, rilindasit patën një kuptim të drejtë për veçantitë e letërsisë për fëmijë, e cila duhej të shkrihej me parimet e mësimit e të edukatës së shkollës shqipe.
- *Veprimtarët e Rilindjes ishin të vetëdijshëm se duhej të sakrifikonin nga niveli artistik për hir të synimeve arsimore-pedagogjike. Kjo ishte arsyeja pse krijimtaria e kësaj periudhe, e cila pati për autorë shkrimtarë që krijuan vepra kulmore për*

të rriturit, as në rastin më të arrirë, si te Naimi ose te Mjeda, nuk arriti nivelin artistik të letërsisë për të rritur [10].

- Veçori tjetër specifike e kësaj periudhe shënon lëvrimi në gjini të shkurtra, si vjersha, fabula, përralla, tregimi, ku rilindasit dhanë modele të mrekullueshme duke përdorur humorin, frazat e shkurtra, stilin e thjeshtë tregimtar.
- Rilindasit me punën e tyre treguan se krijimi i letërsisë për fëmijë është detyrë e madhe dhe e rëndësishme shoqërore, se kjo letërsi luan rol të madh në edukimin e brezit te ri.

2.2 Kristoforidhi i vjershës dhe i prozave të para për fëmijë

Konstandin Kristoforidhi[11] (1827-1895), duke qenë patriot dhe lëvrues i shquar i gjuhës shqipe, mësues në Tunizi, në Tiranë e në Elbasan, punoi me pasion edhe libra për shkollat shqipe.

Si fillime të letërsisë artistike për fëmijë konsiderohen dy krijimet e Kostandin Kristoforidhit, vjersha "*Ylli i vogël lart në qiell*", që është një përshtatje nga letërsia e huaj të cilën autori e përfshiu në "*Alfavitarin shqip*" (1872) dhe proza origjinale "*Gjahu i malësorëve"* (1886).

Vjersha **"*Ylli i vogël lart në qiell*"** është e ndërtuar thjesht dhe tingëllon natyrshëm me mjeshtëri e frymëzim. Është një himn për hapësirën qiellore që, me bukurinë dhe harmoninë e saj zgjon te fëmija dëshirën dhe kërshërinë për të njohur dukuritë e botës së paanë dhe për të menduar mbi to.

---

[10] Ramazan Çadri, "Letërsia për fëmjë midis vlerës dhe antivlerës", LETERSIA SI E TILLE. Tiranë, 1996, f. 306

[11] Veprat e Kristoforidhit ndahen në:
Të botuara sa qe gjallë.
Katër kateqisma për çunat e vogjilë. Kostandinopol 1867
Dhiata e re. Punët e Apostujve dhe Sbulesa e Gjon Hy- ditunit, gegërisht 1869, e toskërisht 1870.
Katër katekizmat, gegërisht 1872.
Psaltiri, gegërisht 1868, e toskërisht 1872.
Te Bërëtë dhe të Dalëtë, toskërisht 1880, 1884, 1894.
Historia e Shënjtësë Shkronjë për dielmt përmbledhurë kah Dhiata e Vietër edhe kah historia e botës, Istambul gegërisht 1870, e toskërisht 1872.
Kristoforidhi u mor edhe me çështjen e të mësuarit dhe të gramatikës së shqipes, prandaj sa qe gjallë ai hartoi edhe dy abetare dhe një gramatikë për mësimin e shkrim-këndimit, të cilat si e thotë vetë, i hartoi për të mësuar gjuhën amtare fëmijët nëpër skolirat e Shqipërisë.
Abetar shqip, gegërisht Kostantinopol 1872.
Alfavitar shqip, pa vend e vit botimi [toskërisht, me shkronja greke].
Gramatika e gjuhës shqipe, toskërisht 1882.
Vepra të botuara pas vdekjes:
Fjalori shqip-greqisht, Athinë 1904.
Gjahu i malësorëve- Hieja e Tomorrit(1884); botimi i parë: "Albania", Londër, prill-nëntor 1902;
Jetëshkronja e njerëzve ndriçim (1885).
Systema e përgjithshme (pa vit se ku e ka botuar).
Këto dy veprat e fundit na tregojnë se Kristoforidhi nuk ka qenë vetëm një linguist, por edhe dijetar i interesuar për shkencat dhe historinë.

Në mendjen e fëmijes krijohet një peizazh i bukur romantik :

Ylli i vogël lart në qiell,
duket porsi zjarr në pyll.
Sipër dheut lart qëndron,
Xixa-xixa xixëllon.

Disku i diellit kur perëndon,
nata hijen e lëshon,
ylli veten e zbulon,
Xixa-xixa xixëllon[12].

Përsëritja e vargut me karakter onomatopeik *xixa-xixa-xixëllon*, si dhe krahasimi *porsi zjarr* krijojnë atmosferë duke nxitur përfytyrimin tonë për qiellin e qëndisur me yje.

Në dy strofat e tjera autori me mjeshtëri u tregon fëmijëve për dobinë praktike që ka ndriçimi i yjeve:

Dritë e yllit kur shkëlqen,
Udhëtarit ç'i pëlqen
Natën errët kur po shkon,
Udhën vetëm s'e harron.

Imazhi tani ndryshon. Nga qielli zbresim në tokë. Objekti i kamerës ulet në një pyll të errët, te një udhetar që çan nëpër natë nën ndriçimin e yjeve. Yjet përveç ndriçimit që bëjnë, janë shumë të dobishëm për t'u orientuar. Kështu, për shembull, Ylli polar i tregon udhëtarit drejtimin e Veriut....

Ndërsa në strofën e fundit autori kërkon të zgjojë te lexuesi kureshtjen për të njohur botën e paanë. Tani kamera e poetit fikson një fëmijë, një çun, që ka ngritur kokën lart, u gëzohet yjeve, bukurisë mahnitëse të tyre, por nga ana tjetër zhytet në mendime. Koka e tij e vogël mendon e mendon, habitet e çuditet për këtë dukuri të madhërishme:

Natën çuni kur shikon
Sipër botës, fort mendon,
Mendtë e tija ç'i habit,
Ylli i vogël se si ndrit.

Ndërkohë gjatë leximit të vjershës autori kërkon të ngacmojë edhe lexuesit e vegjël, të cilët pyesin: vallë, si qëndrojnë lart yjet, si xixëllojnë. Një mori pyetjesh të vijnë në mëndje duke bërë të mendohet jo vetëm të voglin kureshtar, po edhe të rriturin, edhe shkencëtarin me mjekër.

Kjo vjershë është shkruar në strofa katërvargëshe, me masën popullore tetërrokëshe, me rimë të puthur. Për rimat, ndonòse ato janò tò lehta, foljore, poeti ka zgjedhur fjalët më me peshë të ngjarjes; *shikon, mendon, habit, se se ndrit*. A nuk mbartin ato tërë përmbajtjen e strofës?

Vjersha është shkruar me një gjuhë të thjeshtë e të qartë, varg të rrjedhshëm e me rimë të saktë. Dhe, padyshim që kjo vjershë mësohet lehtë

[12] Kostandin Kristoforidhi, "Ylli i vogël lart në qiell", Tiranë, 2007, f. 5

dhe mbahet mendt gjatë në kujtesë ku me anë të figurave të thjeshta, në të jepen dukuri të caktuara të natyrës të cilat, me bukurinë e tyre magjike, ndezin imagjinatën duke përftuar një gjëndje të veçantë shpirtërore tek të vegjëlit. Gjithashtu, në këtë vjershë del në pah dhe puna e tij me gjuhën e pastër shqipe. Nuk gjen aty as edhe një fjalë të huaj. Gjithçka është thënë aq bukur me fjalët e gjuhës sonë.

Gjithashtu në Abetare përveç dy krijimeve, vjersha "*Ylli i vogël lart në qiell*" dhe përralla " Dy dhitë ", përfshihen edhe copa këndimi me karakter letrar, tregime fetare si: *Kurbani i Nojes* dhe *Ylberi* apo te rrëfimi *Të gjetunit e Moisiut, Jezusi ndërmjet mjeshtrave* etj. Këto janë të ilustruara me skica dhe me këshilla për fëmijët.

Në copat e këndimit Kristoforidhi na paraqitet si prozator për fëmijë. Ai shkroi copa leximi me karakter shkencor duke përcjellë tek të vegjëlit disa njohuri shkencore mbi kafshët dhe jetesën e tyre (*Qeni, Kali, Dhia, Shqiponja, Dallëndyshja, Peshku,Gamilja, Merimanga, Flutura, dhe* përralla *Dy dhitë*). Kristoforidhi kërkon që nëpërmjet copave letrare të përcjellë tek fëmijët dashurinë dhe përkujdesjen ndaj kafshëve, duke realizuar kështu synime edukative të caktuara.Përmendim shkrimin "Shqiponja", ku autori thekson idenë e krenarisë kombëtare: "*...Këta zogj trima dhe të fortë ndahen në shumë lloje dhe kanë shumë emra. Edhe ne na quajnë shqiptarë, sepse jemi trima, të fortë, porsi skifteri. Gjuhën tonë e quajnë shqipe, sepse ne flasim gjuhën e zogjve trima"*[13].

Apo në shkrimin tjetër "Dallëndyshja", ku autori përveç njohurive shkencore kërkon t'i edukojë artistikisht dhe t'u mësojë fjalët e bukura të gjuhës sonë shqipe: *...Djemtë e vegjël, kur shohin dallëndyshen për herë të parë, u këndojnë kështu:*

Moj dallëndyshe, gushëbardhushe,
Faqe kuqe, buzëburbuqe,
Sqepgjilpërë, bishtgërshërë,[14]

Ndërsa përralla ***Dy dhitë*** është ndërtuar mbi bazën e një subjekti të fabulistëve klasike. Subjekti i saj ka dy vija, që ndjekin njëra-tjetrën: I-historia e dy dhive që takohen në një udhë të ngushtë në mal e që i lirojnë rrugën njëra-tjetrës: *... Dy dhi, duke kullotur një herë në një mal të lartë, hasen në një udhë të ngushtë. Udha ishte aq e ngushtë sa mezi kalonte njëra prej tyre. Po edhe të kthehesh prapa ishte e pamundur. Nga ana e sipërme e udhës ndodhej një shkrep guri i lartë. Kurse nga ana e poshtme e udhës, ndodhej një rrëpirë e thellë.*

Ç'thoni ju, si vepruan dy dhitë?

Njëra prej tyre u ul në gjunjë ngadalë, duke u mbështetur mirë pas shkëmbit të gurit. ....kështu, të dy dhitë shpëtuan dhe morën udhën e vet, duke kullotur gjethe të egra nëpër ato kodra[15].

II- fati i keq i dy dhive të tjera kokëforta që takohen në një dru mbi përrua e nuk i lëshojnë rrugë shoqja-shoqes: *... Dhitë vështruan njëra-tjetrën*

[13] Po aty, f. 14
[14] Kostandin Kristoforidhi, "Ylli i vogël lart në qiell", Tiranë, 2007, f. 16
[15] Po aty, f. 12

në sy. Secila prej tyre dëshironte të kalonte para shoqes….Atëherë u nisën që të dyja gjer në mes të vigut të ngushtë dhe filluan të zihen e të shtyjnë me brirë njëra-tjetrën, gjersa rrëshqitën të dyja, ranë në përrua dhe u mbytën në ujë.

Nëpërmjet kësaj përralle, Kristoforidhi ngjarjet na i jep në mjedisin karakteristik shqiptar, duke përcjellë idenë edukative, që na e nxjerr tërthorazi.

Kristoforidhi është i pari punëtor i shqipes, që ka studiuar dhe që ka njohur me themel të dy dialektet. Këtë gjë e shohim në përkthimet e tij, të cilat i ka bërë në të dy dialektet, gegërisht dhe toskërisht. Se si ai ka punuar e shkruar në të dy dialektet duket më mirë në tregimin e tij origjinal, ***Gjahu i malësorëve (Hieja e Tomorrit).*** Madje këtë vepër[16] e ka shkruar më 1884, në tri versione gjuhësore: toskërisht, gegërisht dhe në të folmen e Elbasanit, por ajo s'u botua në asnjërin dialekt sa ishte gjallë autori. Kopja e dorëshkrimit të toskërishtes u botua në 1902, në revistën Albania të Konicës. Po ky edicion i toskërishtes u botua së voni nga Maximilian Lambertz në Albanisches Lesebuch, Leipizig, 1948.

Nga kjo vepër në dialektin e mesëm kemi edicionet e fletoreve të Elbasanit: *Tomorri* 1910, Nr. 10 dhe 11 dhe *Kopështi Letrar* 1918, Nr. 2,3,4,5,6,7,8. Vepra në dialektin e mesëm është botuar edhe në 1930, në broshurë të veçantë, në Korçe nga Peppo & Marko.

Kopja e dialektit të Veriut është botuar vetëm një herë më 1949 në faqet e revistës *Literatura jonë* Nr. 11-12. Kopja e dialektit të Veriut, në dorëshkrim të autorit gjëndet në Arkivën e Institutit të Shkencave.

Kallëzimi *Gjahu i malësorëve* është një tregim i shkurtër, i thjeshtë, shumë i gjallë me dialogë të bukur, shumë i këndshëm për shprehjet e zgjedhura e të rralla.

Subjekti i tregimit është i thjeshtë. Përshkruan një ditë gjahu që bëjnë malësorët në malin e Tomorrit. Në të nuk ka ngjarje, as konflikt, është i thurur me episode dhe situata tërheqëse. Vendin kryesor në të e zë zhvillimi i veprimit dhe dialogu i shkathët, me anën e të cilëve bëhet karakterizimi i personazheve. Studiuesi Rexhep Qosja vëren se Kristoforidhi në këtë prozë e bën *dialogun kryepersonazh, temë dhe motiv të kallëzimit për arsye se, sipas mendimit të tij, perms dialogut më së miri mund të shquajë mundësitë e gjuhës popullore*[17].

Në plan të parë me këtë del dhe ideja e dashurisë për atdheun, nëpërmjet figurës së malit të shenjtë, Tomor. Që në faqet e para të saj idealizoi malin e Tomorrit: - *Ashtu pra t'a dini të mos shkelni ndë malt të Tomorrit se është vent i mirë, është mal i shënjtëruar. Aty e ka të ndënjuritë Zot' i Shqipërisë që ruan Malësinë, ay na ka ruajturë neve Malësorëtë e s'kemi rënë në dorë t' arëmikutë gjer më sot, edhe na ka për të ruajturë kurdo sepse atë kanë pasë luturë pleqtë tanë të vjetëritë, e gjyshatë tanë e stërgjyshatë tanë e katrëgjyshatë tanë, e gjithë të parëtë tanë të moçëmit*[18]. Pra, Shqipëria, vend

[16] Kostandin Kristoforidhi, "Gjahu i malësorëve" (Hieja e Tomorrit), Tiranë, 1950, në shënimin hyrës nga Ziaudin Kodra, f. 3

[17] Rexhep Qose, "Historia e letërsisë shqip – Romantizmi II", Tiranë, 2000, f. 469

[18] Kostandin Kristoforidhi, "Gjahu i malësorëve" (Hieja e Tomorrit), Tiranë, 1950, f. 14

i vjetër trimash, me Tomorrin, nuk është shkelur kurrë nga këmba e armikut. Këtë idealizim të malit të Tomorrit, si ruajtës i fateve të Shqipërisë dhe si ai që u ka zbardhur armët shqiptarëve, Kristoforidhi e ka bërë me kohë, para Naimit, para Çajupit.

Autori, përveç qëllimeve të tij patriotike kur flitet për malin e Tomorrit, tregon dhe bukurinë e madhështinë e ndjenjës së dashurisë dhe të krenarisë për atdheun dhe për virtytet e larta të shqiptarit. Qëllimin patriotik, Kristoforidhi në trajtë të mbyllur, e shpreh edhe me dhelprën, edhe me shërbëtorët grekë. Dhelpra simbolizon armikun e djallëzuar që aso kohe donte ta gllabëronte Shqipërinë.... *Qëllon Toska që ta vrasë, po nuk e zë, qëllon edhe Gega, po këtij i shkon plumbi bosh; as pushka e Arbërit s'e godet dot dhelprën dredharake dhe djallëzore. Dhelpra është dinake dhe si e tillë ajo shtiret në lloj-lloj mënyrash për të shpëtuar,s'i zihet besë*[19]. Por kur qëllojnë të tre të bashkuar, Toska, Gega dhe Arbëri, dhelpra dinake bie pa jetë përdhe! Mesazhi që përcillet është i qartë, Kristoforidhi u jep mësim shqiptarëve që të bashkohen, sepse sa herë ata do të jenë të bashkuar nuk do t'i mposhti askush, pasi bashkimi bën fuqinë. Gjithashtu dhe emrat e përdorur: Toska, Gega dhe Arbëri tregon një qëllim, qëllim bashkimi të shqiptarëve.

Nëpërmjet dialogut fëmijët njihen me disa nga kafshët e pyllit, me karakteristikat dhe veçoritë e jetesës së tyre, me mënyrën e organizimit të gjuetarëve. Kjo e bën kallëzimin të marri karakterin e një tregimi diturak. Ai i njeh lexuesit fëmijë me gjahun e gjahtarëve, sjell njohuri mbi shtazët e pyllit etj. Interesante janë portretet e këtyre kafshëve, të cilat Kristoforidhi i jep thjesht, shkurt e me mjeshtri, me figuracion: *Një derr i madh që m'i ka dhëmbëtë një pëllëmbë e një bërxhik nxjerrë jashtë nofullash! Të doli përpara një dre me një palë brirë të mëdhenj, Dreri ra mbë gjunjë dhe derdhi lotë nga syri, u duk një arushë e murgët. Ishte e madhe sa një gomare, Vraje atë lepur se po të shkon pranë....*

Gjithashtu lexuesve të vegjël u frymëzohet dashuri për figurën e shqiptarit trim, që mishërohet në personazhet Mark Shalëgjati dhe gjuetarëve të tjerë. Ja një pasazh nga zhvillimi i gjahut me arushën:

- *Mos e vrisni, mos e vrisni (thotë Gjergji), se po vete unë vetë e po e zë të gjallë.*
- *Mos, o Gjerq, se të kafshon me dhëmbë!*
- *Pushoni, ju s'dini gjë: harusha nuk kafshon me dhëmbë, po të shtrëngon me të dy duart' e para e të merr frymënë: të pështyn me gojë e të lak e të bën qullë: sjell edhe me gur e të godit: po e sjell gurë së prapthi, jo për së mbari; ngjitet edhe ndë majë të drurit posi njeri, po ndëpër ato dega që janë shul s'ecën dot; unë s'e kam frikë harushën kurrë (thotë Gjergji) edhe vete përmbi harushën e i fut një thikë ndë zemërë edhe harusha bie pa frymë mbi dhet*[20].

Kështu me detaje shprehëse, është vizatuar sidomos figura e Mark Shalëgjatit, tek i cili autori ka mishëruar tiparet kryesore të shqiptarit, guximin, vendosmërinë etj...

- *Po i mirë është Mark Shalë Gjati?*

[19] Po aty, f. 24
[20] Po aty, f. 22

- *Ay është i vëjyerë. Ay është gjahtar i vjetërë, atij s'i trembet syri, është edhe trim, s'i friketë vdekëjesë, e s'dilje i gjallë ndë dorë t'arëmikutë, është burr' i dheut*[21].

Kristoforidhi e përshkruan Mark Shalëgjatin me zotësi të rrallë, gjahtar i vjetër, trim edhe përballë vdekjes, duke mishëruar kështu portretin e shqiptarit të kohës.

Po në lidhje me realizimin e personazheve, duhet thënë se përveç figurave të Markut dhe Gjergjit, të tjerët mbeten vetëm emra. Personazhet e tjerë, Gjoni, Nikolla, Andrea, Mërkuri, Filipi, Premti vizatohen me tiparet e tyre malësore, por përherë trima e bujarë, për të ngjallur dashurinë e fëmijëve ndaj tyre. Disa prej këtyre emrave si Mark, Prend, Mërkur janë paganë, që ringjallin botën e lashtë shqiptare.

Gjithashtu, në tregim të bie në sy kënga që këndojnë gjahtarët mbi bëmat e Skënderbeut, duke nxitur kështu përfytyrimin dhe njëkohësisht të edukojë e të ringjallë lavdinë e Motit të Madh të shqiptarëve përballë pushtuesve: "*As na këndo, ti o vashë, një këngë me zë të trashë. Që t'a dëgjojmë me veshë. Ashtu gëzuarë të jeshë.*

Kush është' ai burr që po vjen, si hën' e plotë kur shkëlqen. Vesh' e ngjeshë nd'ar' e nd'argjent, armatosurë kënt e kënt? Skënder Beg luftëtari, Trim i math Shqipëtari"[22].

I gjithë tregimi është ndërtuar në bazë të përvojës që zotëron autori nga krijimtaria artistike popullore. Dhe kjo duket në dialogun që përshkon veprën duke i dhënë rrëfimit dinamizëm dhe plasticitet. Dialogu i këtij tregimi realizon edhe dramacitetin e jetës shqiptare; ai i çon fëmijët në jetën e lirë shqiptare të kohëve të lashta.

Onomatopetë që shoqërojnë dialogun ta krijojnë bukur e me psikologji fëminore atmosferën e gjahut:

Ty ty ty! Ty ty ty! (bie trumbet' e bririt).
Ha ha ha ! ha ha ha! Ha ha ha! (ndërsejnë qentë).
Kam kum! Kam kum! Kam kum! (lehënë qentë).
Taf tuf! Taf-tuf! Taf-tuf! (kërcejnë pushkatë).

- *Prite, o Mark!*
- *Prite, o Gjergj!*
- *Prite, o Gjon!*

Taf tuf! Ha ha ha ! Ty ty ty![23]...

Kështu, tregimin e bëjnë më të këndshëm gjuha e gjallë lodruese, krismat e pushkëve, lehjet e qenve, oshëtima e bririt, imitimi i zërave të kafshëve si dhe përshkrimi i kafshëve të pyllit, humori shpotitës midis gjahtarëve që burojnë natyrshëm nga situata që krijohen. Autori e bën këtë për të dhënë traditën e gjahut shqiptar dhe të organizimit të tij, për ta bërë sa më konkret rrëfimin (në sytë e fëmijës).

Në këtë tregim bien në sy edhe ngjyrimet e përshëndetjeve të shumta të cilat autori i ka qëmtuar prej brumit të shqipes si:

Bëfshi natën e mirë,o shokë!

[21] Po aty, f. 12
[22] Kostandin Kristoforidhi, "Gjahu i malësorëve" (Hieja e Tomorrit), Tiranë, 1950, f. 16
[23] Po aty, f. 20

Tungjatjeta!
Mirë se erdhët!
Udha e mbarë!

Kristoforidhi në këtë vepër ka shfrytëzuar shumë frazeologjinë popullore, rrëfimin, dialogun, koloritin popullor të gjuhës poetike duke ia shtuar kallëzimit forcën kuptimore e simbolike. Dhe si e tillë, themi që tregimi "*Gjahu i malësorëvet*" është një tregim antologjik, që shënon fillesat e prozës shqipe për të vegjëlit.

Studiuesi Prof. Bedri Dedja thekson se *Ky është tregimi i parë i prozës shqipe për fëmijë. […] "Gjahu i malësorëve" është një vepër karakteristike për fëmijë, si në pikëpamje të formës dhe të stilit, ashtu dhe në pikëpamje të përmbajtjes*[24].

2.3 NAIM FRASHËRI (1846-1900)- THEMELUES I LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË

Naim Frashëri është poeti i madh i kombit dhe figura qëndrore e letërsisë shqiptare të Rilindjes. Ai u bë shprehës i aspiratave të popullit për liri e përparim. Tradita që krijoi Naimi, është e gjallë dhe frymëzuese edhe në jetën e shoqërisë sonë të sotme. Naimi më tepër se shkrimtar, është poeti më i madh i Rilindjes sonë Kombëtare, është atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit dhe i kulturës shqiptare. Ai i ngriti hymn atdheut dhe lirisë, gjuhës dhe shkollës, diturisë dhe përparimit:

Dhe drit' e diturisë,
Përpara do na shpjerë
Përpara drejt lirisë!

Krijimtaria letrare për fëmijë e *Naimit* është mjaft e gjere dhe e pasur. Ai ka qenë ndër të parët rilindës që kuptoi- siç thotë Nonda Bulka,- nevojën e krijimtarisë për fëmijë si mjet të rëndësishëm për emancipimin kulturor e shpirtëror të brezit të ri.Në konceptin filozofik të Naim Frashërit shprehet motivi i qartë i tij "*s'mjafton të bëhet Shqipëria",* po*"duhen bërë edhe shqiptarët*"[25].

Në vitet 1884-1885, së bashku me Jani Vreton dhe me Samiun, botoi revistën kulturore *Drita* (e cila pas disa numrash u titullua *Dituria*), gjithsej 12 numura, ku veç poezive për të rriturit, filloi të publikonte edhe shkrime mësimore e letrare për të vegjëlit.

Veç veprave për të rritur ("Bagëti e bujqësi", "Lulet e verës", "Historia e Skënderbeut", "Qerbelaja" etj.), Naimi botoi edhe tekste për shkollat e para shqipe *Histori e përgjithshme, Histori e Shqipërisë, Dituritë* (në botimin e dytë të saj u titullua *Gjithësia),* si dhe tre libra të tjerë, ku përmblidhet kryesisht edhe krijimtaria e tij letrare për fëmijë:

- *Vjersha për mësonjëtoret e para.* Bukuresht 1886

[24] Bedri Dede, "Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë", Tiranë, 1971, f. 60
[25] Nonda Bulka, "Naimi dhe fabulat", Nëntori, Nr. 5, 1971, f. 51

- *E këndimit çunavet këndonjëtoreja.*Copë e parë, Bukuresht 1886
- *E këndimit çunavet këndonjëtoreja.*Copë e dytë, Bukuresht 1886

Në tërë këtë krijimtari letrare, *Naim Frashëri* na shfaqet jo vetëm si shkrimtar e poet i shquar por, njëherësh edhe si pedagog i madh. Me tregimet e shkurtra në librin *E këndimit çunavet Këndonjëtoreja* ai u cilësua si prozator i talentuar për të vegjël, ndërsa me artin poetik,në përmbledhjen *Vjersha për mësonjëtore te para* ai u bë themeluesi i poezisë për fëmijë. Aty ku jane plot 37 krijime poetike, një mozaik i vërtetë, një përzierje fjalësh të urta të vëna në vargje, përrallash të marra disa nga fabulisti francez i shekullit të XVII, La Fontene, e disa të krijuara nga ai vetë. Gjenden dhe plot poezi me tema filozofike, si: *Gjithësija, Njerëzija, Mejtimi*, ku Naimi del në rolin e edukatorit dhe bëhet propagandist i virtyteve fisnike të dashurisë për punën, të nderit, të besës, të drejtësisë, të së vërtetës, të humanizmit, të dëshirës për mësim e dituri, të atdhedashurisë [26].

Merita më e veçantë e Naimit në këtë krijimtari letrare qëndron se ai ngriti letërsinë për fëmijë në një nivel më të lartë artistik, duke ndikuar fuqishëm tek rilindësit e tjerë. Në vështrimin e përgjithshëm të kësaj letërsie Naimi si poet dhe shkrimtar nëpërmjet gjinive dhe llojeve të ndryshme, synon t'u japë këshilla, të përcjellë urtësi dhe filozofi por edhe të rrezatojë edhe elemente të kulturës dhe edukatës, të sjelljes dhe moralit.

Naimi, ashtu si pararendësit e tij Naum Veqilharxhi dhe Kostandin Kristoforidhi, iu përkushtua letërsisë për fëmijë për të ndikuar thellë në ndërgjegjjen e moralin e fëmijëve. Në këtë këndvështrim ka dhe një arsye tjetër, që Naimi iu kushtua letërsisë për fëmijë: ai ishte i bindur se themelet e kulturës gjuhësore të kombit vihen në shkollë dhe në vegjëli. "*Djemt' e vegjël e vashat e vogëla lipsetë të mësojnë gjuhën e tyre, ta këndojnë drejt, e ta shkruajnë mirë*"[27]. Në këtë mënyrë proza dhe poezia për fëmijë i nënshtrohen qëllimit të tij: edukimit artistik dhe atdhetar të fëmijëve.

Një nga tiparet themelore të krijimtarisë letrare për fëmijë është se ai përmbledh e shkruan vjersha, proza e krijime që u drejtohet fëmijëve, ku ata janë personazhe.

Në krijimtarinë letrare për fëmijë dallohen edhe proza të shkurtëra, disa prej të cilave kritika letrare i ka quajtur skica.

Në ***prozën për fëmijë*** të këtij shkrimtari, disa krijime kanë veçori të tregimit, disa të fabulës; gjithsesi, ato kanë karakteristikat e tipit dituror, nëpërmjet të cilave në botën e fëmijëve sjellin njohuri mbi natyrën, shoqërine dhe gjithësinë.

Në tregimin *Vash'e urtë*, fëmijët mësojnë për Diellin dhe yjtë e tjerë. Si janë krijuar? Si lëvizin në hapësirë? Në radhët e këtyre tregimeve natyrshëm përcillen mendime të urta e këshilla, siç ndodh në këtë rast kur e ëma i thotë së bijës: "*Këndo e mëso të març vesh gjithësinë edhe Perëndinë*"[28].

[26] Zija Xholi, "Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare", Tiranë, 1987, f. 173
[27] Naim Frashëri, " E këndimit çunavet Këndonjëtoreja", copë e dytë, shtypurë prej Shoqërise Drita, Bukuresht 1886, f. 3
[28] Po aty, f. 38

Ndërsa te tregimi *I urti dhe i marri* kallëzohet sesi fëmija i urtë mëson, prandaj kujdeset të jetë i pastër, kurse përballë tij qëndron *i marri*, i prapti, i cili jo vetëm nuk mëson por mbart edhe vese.

Në prozën me titull *Kalorësi*, Naimi e shquan porosinë: njeriu duhet të pranojë zemërgjerë, si të mirën ashtu edhe të keqen, sepse e keqja, herë-herë, mund të ketë të mirë. Njeriu rritet mes vuajtjeve e vështirësive, ashtu si kalorësi Qendro, i cili duhet të dijë t'u shmanget rreziqeve të jetës.

Duke synuar edukimin artistik dhe atdhetar të fëmijëve, Naim Frashëri ka hartuar proza të shkurtra: "*Aristoteli","Ipokrati", "Themistokliu*" në të cilat shpalosen njohuri historike, ngjarje dhe personazhe historike, duke shfrytëzuar tharmin e anekdotave historike. Kështu, përmes trimërive dhe bëmave të Skëndebeut, shkrimtari e ndërton prozën e vet për të ravijëzuar në sytë e fëmijëve lavdinë shqiptare të shekujve. Kjo vepër në të vërtetë është apotheozë e trimërisë, e nderit, e burrërisë, e krenarisë e mbi të gjitha apotheozë e lirisë dhe e pavarësisë.

Kështu ai tregon anekdotën për *Themistokliu*n, që detyrohet të ikë prej Spartës në Persi, por pastaj më me qejf do të pijë helmin sesa t'i prijë ushtrisë persiane kundër atdheut të vet.

Proza për *Aristotelin* përbëhet prej dialogut ndërmjet filozofit grek dhe nxënësit të tij, Aleksandrit të Maqedonisë, për rindërtimin e qytetit të Stagirës, që e kishte rrethuar i ati, Filipi i Maqedonisë.

Hipokrati, jep dialogun ndërmjet mbretit të Persisë, që e fton Hipokratin të shkojë të jetojë pranë tij dhe këtij mjeku të përmendur grek që i përgjigjet: *Nuk mund të lë nevojën e mëmëdheut tim e të ndjek të mirën tuaj*.

Nëpërmjet dialogëve dhe kallëzimeve, shkrimtari ndërton një botë interesante për fëmijët. Në prozën e Naim Frashërit zënë vend edhe mjaft përshkrime, përralla e anekdota mbi jetën e kafshëve. Të tilla janë tregimet: *Qeni dhe besa e tij, Kali, Qeni, Qengji, Dimri etj*. Te tregimi i parë, lexuesit i ngel në mëndje figura e qenit Xhuf, i cili jep jetën për të ruajtur pasurinë e të zot. Në tregimin *Dimri* kemi një vajzë të mbarë, Kaçen, që gjatë stinës së ftohtë ushqen një zog të vogël, i cili miqësohet me vogëlushen. Autori krahas personazheve kafshë vizaton edhe portrete të fëmijëve që ushqejnë një dashuri të veçantë për natyrën, kafshët, zogjtë, jetën.

Megjithatë në prozën për fëmijë të Naim Frashërit vihet re prirja romantike për të pasqyruar temën historike, gërshetuar me temën bashkëkohore; në të ndihet frymë realiste që mund të quhet zotëruese e tyre ideostilistike. Artistikisht më të sukseshme se kjo, ndërkaq, mund të quhen ato proza për fëmijë që prej rrafshit realist ngrihen në rrafshin fantastik[29] .

Prof. Rexhep Qosja me të drejtë vë në dukje se: *Naim Frashëri [30], shpesh, i fillon prozat e tij ashtu sikundër edhe fillojnë përrallat dhe, në këtë mënyrë, edhe prozat dukshëm realiste, herë-herë, i ndërton sipas procedimit të përrallës*.

[29] Bedri Dede, "Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë", Tiranë 1971, f. 71
[30] Rexhep Qose, "Porosia e madhe", Tiranë 1989, f.120

Në këtë këndvështrim, duke analizuar disa prej tregimeve të shkrimtarit, në nisjen e tyre vihet re lehtë natyra e përrallave popullore në prozën e tij: *Një mëmë kish një djal' e një vashe (*Te urtete*). Një djalë thosh gjithnjë të rreme* (Gënjeshtari), *Një mëmë kish tre të vegjëlë* (Vetëdija), *Një njeri kish marr' udh' e ish lodhure* (Njeriu pa ment), *Një mëmë kish tre djem,kish dhe nj'unazë* (Mëmë e mirë) etj.

Natyrën e prozës popullore shqipe, elementët përrallore dhe kallëzimet Naim Frashëri i shfrytëzon edhe për një arsye tjetër.

Në këtë mënyrë trajta ligjërimore i përshtatet botës psikologjike të fëmijëve. Brenda tyre ka urime, lutje e përshëndetje që krijojnë një botë emocionale të pasur tek fëmijët.

Një nga tiparet e tjera të prozës së tij është se situatat, ndodhitë dhe trimëritë në të cilat gjallërojnë fjalët e mençura dhe të urta, shpeshherë marrin kuptimin e gojëdhënave të cilat realizojnë mesazhe diturore, morale dhe artistike te fëmijët.

Të gjitha prozat për fëmijë të Naim Frashërit kanë përmbajtje fare të thjeshtë, të dhëna në vija të përgjithshme, pa thellime psikologjike dhe tematike, në të cilat vetëm sa përvijohen idetë e porositë morale. Në to rregullisht ballafaqohen ide të kundërta, e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara, urtësia e mosdija. Kjo vetëdije mitologjike në përvetësimin e botës, thekson Prof. Qosja, *i bën interesante për botën e fëmijëve, veç i thjeshton shumë artistikisht. Pra, duke ia nënshtruar me çdo kusht ndërtimin e prozave porosisë së përshkuar prej ndjenjash të flashkëta morale, Naim Frashëri i dëmton artistikisht ato. Për këtë arsye disa nga prozat e tij për fëmijë qëndrojnë me afër artikullit moral sesa prozës artistike*[31].

Në krijimtarinë letrare për fëmijë të *N.Frashërit* një vend të rëndësishëm zë **poezia**. Ky art poetik zë një vend të veçantë te ***Vjersha për mësonjëtoret e para (***1886), libër që është i pari vëllim me vjersha në historinë e letërsisë shqiptare për fëmijë, por edhe në përmbledhjen *Parajsa dhe fjala fluturake* (1894). Si sasi është më e madhe se proza, ndërsa nga përmbajtja poezitë dhe prozat janë të afërta dhe të ngjashme. Vjershat e Naim Frashërit për fëmijë, në përgjithësi, janë më të përbëra, kuptimisht më të ngjeshura, prandaj edhe më të rënda për përvetësim: ato janë vjersha që u dedikohen fëmijëve po aq sa u dedikohen edhe të rriturve dhe për këtë arsye kërkojnë ndihmën e prindit e të mësuesit.

Kjo duket në vjershën *Fjalët e qiririt* (që, megjithëse është futur te teksti "*Vjersha për mësonjëtoret e para*" është më tepër krijim për të rriturit), ku poeti shpalos misionin e tij si edukator, që porsi qiriu i ndezur, duhet të digjet e të përvëlohet, vetëm e vetëm të ndriçojë mëndjen e njerëzve. Duke zotëruar idetë iluministe, poeti ynë kërkon të përsosë moralisht njeriun (fëmijën), të përcjellë tek ai mendime e ide për "mbrothësinë" dhe qytetërimin.

Ja se si këndon:

Në mes tuaj kam qëndruar

[31] Po aty, f. 121

E jam duke u përvëluar,
Që t'u ap pakëzë dritë,
Natënë t'ua bëj dritë!

Do të tretem, do kullohem
Do digjem, do përvëlohem,
Që t'u ndrinj mirë të shihni
Njëritjatrinë të njihni!

Për ju do të rri të tretem
Asnjë çikë të mos mbetem!
Të digjem të qaj me lot,
Se mallin s'e duroj dot!

Kur më shihni se jam tretur
Mos më quani se kam vdekur!
Jam i gjallë, jam në jetë
Jam në dritë të vërtetë!

Vjershat e Naimit i edukojnë të vegjëlit me ndjenjat e humanizmit të thellë e të patriotizmit të flaktë, që e shquanin vetë poetin tonë. Te brezi i ri ai shihte shpresën e të ardhmes së vendit, ndaj edhe iu përkushtua me aq zjarr. Ky vizion i poetit gjeti mishërim më të plotë sidomos në vjershën *Të vegjlit*, ku adhurimi për fëmijët njëjtesohet me dashurinë për Atdheun:

" Lërini të gjithë të vijnë,
të vegjlit ndaj meje...
.....
O foshnjëzat e uruar!
U kam mall' e dashurinë,
me kënda t'u mbaj në duar...
Ju dua si perëndinë.
Zot i madh e i vërtetë!
Falu gjith mirësitë
Të rrojnë me nder në jetë,
Të mësojnë dituritë,
Të bëhenë të vërtetë,
Të nderojnë mëmëdhenë,
Vleftënë t'ia lartësojnë,
Mbi gjithe botën ta ngrenë
Si lule ta zbukurojnë!" [32]....

Në krijimtarinë e larmishme poetike të Naim Frashërit vend të konsiderueshëm zë poezia diturore, ku i kushton rëndësi ngritjes diturore të njerëzve, veçanërisht fëmijëve. Ai nuk nguron që përhapjes dhe popullarizimit të dijes t'i flijojë edhe poezinë.

[32]Ramazan Çadri, "Letërsia shqipe për fëmijë", Tiranë 2001, f. 82

Për popullarizimin e njohurive të këtij karakteri në shkrimet e veta poeti ynë shpeshherë ka krijuar pasazhe me nuanca emocionale, të përshtatshme për të plotësuar kërkesat e fëmijëve dhe në përputhje me psikologjinë e tyre. Nëpërmjet figurave poetike fëmijët ngulitin në mendjen e tyre disa të vërteva shkencore dhe të natyrës. Në to mund të mësohet se Toka është trup qiellor që sillet rreth Diellit, kurse Hëna rreth Tokës. Kështu përmes mënyrës së qëlluar personifikuese të trupave qiellore, autori ka bërë karakterizimin e planetit tonë me anë të këtyre vargjeve lakonike në vjershën *Gjithësija*:

Dheu është një yll i qiellit,
që lëvrin në hapësirë,
i vjen rreth e rrotull Diellit,
merr të ngrysur e të gdhirë,

Djellinë e ka atë,
E hënënë e ka bijë,
Bashkë me ta dit' e natë
Rron si ç'është një fëmijë[33].

Në përfytyrimin e fëmijëve nëpërmjet marrëdhënieve babë-mëmë-bijë, zbërthen trupat qiellorë dhe njohuritë t'u nguliten thellë në mendje. Po kështu, përmes figurave mësojmë se trupat qiellore janë krijuar prej një përplasjeje në Gjithësi, se ata trupa janë të zjarrtë, në gjëndje të përhershme lëvizjeje, se Dielli është shumë më i madh se Toka e rreth tij vërtiten shumë planete.

Prej vjershave shpjeguese diturore të Naim Frashërit mund të mësohen njohuri edhe për një sërë dukurish natyrore: sesi krijohet shiu, bora, era, rrufeja; njohuri për kontinentet; për njeriun dhe rracat e njerëzve etj, etj.Në disa nga këto krijime shfaqen edhe ndjenja patriotike të Naimit. Kështu në vjershën *Dituritë* poeti tregon se populli shqiptar është ndër të parët në ato popuj më të lashtë që erdhën nga Hindia dhe zunë vend në kontinentin evropian:

Pelasgët qenë syresh të parët,
Dhe bijt e tyre ne Shqiptarët[34]*...*

Në këto vjersha spikat mjeshtëria e Naimit si shkrimtar dhe pedagog për t'u dhënë fëmijëve dije shkencore në mënyrë origjinale, të thjeshtë, por edhe tërheqëse. Ndaj, poeti ynë i kushtoi shumë rëndësi poezisë shpjeguese diturore sepse kërkon të ndikojë te lexuesit e vegjël, të krijojë tek ata mendime të drejta për botën, që të mos u nënshtrohen paragjykimeve fetare.

Një cikël të tërë vjershash Naimi ia kushton ngritjes morale të njeriut, edukimit dhe arsimimit të tij. Të tilla janë vjershat *Njerëzija, Falja, Mejtimi, E vërteta, Fjalët e të urtët* si dhe fabulat e përshtatura prej La Fontenit dhe fabulat origjinale që shkruan vetë.

[33] Naim Frashëri," Vepra të zgjedhura 2", Prishtinë 1978, f. 17
[34] Po aty, f. 60

Cilat janë virtytet që Naim Frashëri dëshiron t'i zhvillojë te fëmijët?

Naimi shkrimtar dhe pedagog, përmes krijime, synonte aktivizimin e mendimit intelektual e arsimor si dhe emancipimin moral shpirtëror të fëmijëve.

Kështu, në mjaft vjersha të ciklit *Fjalët e t'urtëve*, nga pozita të përparuara për kohën, jepen mësime e porosi morale që i vlejnë çdokujt në jetë, bëhet vlerësimi i virtyteve dhe i ndjenjave të pastra njerëzore, flitet për rëndësinë që ka puna dhe dija në jetën e njeriut, qortohen veset e dëmshme, lartësohen ndjenjat fisnike të dashurisë për gjuhën, Atdheun, prindërit, shokët etj.

Pavarësisht nga fryma përgjithësisht didaktike-morale, në vjershat e këtij karakteri bie në sy puna e kujdesshme e mjeshtërit të madh të gjuhës shqipe. Në të shumtën e herës mësimet e porositë morale në to jepen në formë lakonike, me ton të qetë prindëror dhe në mënyrë të poetizuar, duke përdorur për këtë qëllim figura stilistike, përsiatje dhe asociacione të thjeshta të cilat e lehtësojnë përvetësimin e kuptimeve me vlera të universalizuara, si p.sh:

"*Po të mësojmë,*
Të këndojmë
Mirë do të rrojmë
Në këtë jetë,
Se dituria
E njerëzia
Dhe mirësia
Njerinë e çquajnë
Mëndja ndritohet,
Zemëra ngrohet
Shpirti madhohet"[35]

Sipas mendimeve të poetit, dija është një prej kushteve të para, themelore të ngritjes morale të njeriut. Dija për të është pasuria më e çmuar e njeriut, që nuk e lë kurrë në varfëri.

Ose, te *Fjalët e të urtit*, që gjithashtu janë shkruar në vargje, vlerat e dijes jepen në mënyrë të tërthortë. Në qoftë se është e vërtetë se dituria është mëma e mirësisë, është po aq e vërtetë edhe e kundërta se padija është burimi i të keqes. Ajo sjell marrëzitë dhe ligësitë.

"*Kusaria, ligësia,*
dhe sa të këqia janë
te e gjithë njerëzia
padijen mëmë kanë"[36].

Naimi dëshiron t'i mësojë fëmijët që të dënojnë gënjeshtrën, shpifjen, smirën, urrejtjen, veset:

[35] Naim Frashëri, "Vepra të zgjedhura2", Prishtinë 1978, f. 21
[36] Po aty, vepra 2, f. 14

Duhet të rronç i vërtetë,
Pa të lësh emër për jetë[37].

Bamirësia është njëra prej cilësive të rëndësishme morale të njeriut, ku, Naimi do të përsërisë shume herë, qoftë në vjershat morale që krijonvetë, qoftë përmes fabulave që përshtat nga La Fonteni, se në fëmijëri duhet zhvilluar ndjenja e mirësisë:

Duhet që nga vogëlija,
Bërë zakon mirësija[38].

Naim Frashëri dëshiron të zhvillojë tek fëmijët dashurinë për punën. Vetëm nëpërmjet saj fëmijët mund të bëhen të vyeshëm për prindërit, për popullin, për njerëzimin.

Një kujdes të veçantë Naimi do t'i kushtojë edhe një ndjenje: atdhedashurisë. Megjithëse ka pak vjersha që mund të quhen atdhetare, Naim Frashëri ka shume vargje që mund të quhen të tillë:

Njeriu po s'deshi kombin e tija,
e mëmëdhenë,
Nuk ka pjesë nga njerëzia
S'do as vethënë[39].

Ndërsa tek vjersha *Fjala*, poeti shpreh misionin e tij që fëmija të edukohet dhe të vëllazërohet për përparimin e jetës dhe kombit.

Zot! falna vëllazërinë,
Dashurin' e miqësinë,
Epna dëshirë të msojmë,
E të mirat të punojmë,
Bëna të but' e te qetë,
E të urt' e të vërtetë,
Jetënë ta trashëgojmë[40].

Naim Frashëri përpiqet për një edukim të ri të fëmijës, që do të mbështetet në diturinë e jo në fenë.

Mjaft të këndshme për të vegjëlit janë dhe ***fabulat,*** të cilat konsiderohen ndër krijimet më të bukura të Naim Frashërit.

Të terheqim vëmendjen 23 fabula që ai i përshtati në mënyrë mjeshtërore nga La Fonteni ose i sendërtoi ato sipas motiveve të fabulistit të njohur. Këto i botoi së pari gjatë vitit 1885, në revistën *Dituria*, në një rubrike të veçantë me okelio " *E vërteta ndë përralla*" dhe në vitin pasues ato hynë në përmbledhjen *Vjersha për mësonjetoret e para*. Në këtë përshtatje të bie në

[37] Po aty, vepra 2, f. 30
[38] Po aty, vepra 2, f. 30
[39] Po aty, vepra 2, f. 54
[40] Po aty, vepra 2, f. 34

sy ndihmesa origjinale e shkrimtarit tonë si në drejtim të përzgjedhjes tematike të fabulave, që i shkonin më shumë situatës, ashtu dhe në zgjerimin e vlerave shprehëse të tyre. Ideja morale përgjithësisht përftohet në mënyrë të qartë, nga vetë zhvillimi i ngjarjes dhe i veprimit të personazheve konvencionale, të cilët përshkruhen me stil të thjeshtë e me figura artistike konkrete[41].

Pjesa më e madhe e fabulave aludojnë për dukuri të realitetit shqiptar, shprehin protestën kundër shtypësve, padrejtësive shoqërore dhe dënojnë norma e vese njerëzore të dëmshme.

Kështu në mënyrë mjaft të natyrshme, përmes rrëfimit me ton të shtruar pavarësisht se autori ka përdorur varg të gjatë, mesazhi del i qartë në fabulën "*Dhelpra dhe lejleku*":

Dhelprës një kocke i kishte mbetur
Në grykë e kishte rënë e mekur,
Lejleku e pa dhe qepn' e përpoqi
Zbriti, ja zuri kockën e ja hoqi,
Dhelpra u ngrit, për gruk' e përfshiu.
.....
I ligu, dore s' heq nga e tija,
Ndaj atij nuk i vlen mirësia[42].

Ndërsa në fabulën *Dimëri dhe vera* vargu është më i shkurtër, ritmi i shpejtë dhe intonacioni i shkathët.

Dimëri dhe vera
Haheshin një ditë
Njëri thoshte të tjetra,
Tjetri të titë:
Vera thosh që unë
Vinj e ndreq çdo punë:
Qielli ndrin
Dhe vetëtin.
E dheu mbleron,
Dhe lulëzon,
Bilbili del,
E gjethi çel[43]...

Masa e vargut në fabulat e Naimit ndryshon në përputhje me vete karakterin e ngjarjes që rrëfehet. Një pjesë e mirë e fabulave, nga shtjellimi i subjektit, të kujtojnë motivet e përrallave popullore shqiptare,si: *Dimri e vera, Kunadhja e veshur si këndes, Ujku dhe qengji, Dragoi dhe ujku, Qeni dhe hieja e tij* etj.

Karakteristikë e këtyre fabulave është origjinaliteti i tyre[44]. Naimi ka bërë një punë me të vërtetë krijuese me to. Ai merr nga burimi disa detaje a

[41]RamazanÇadri,"Letërsia shqipe për fëmijë", Tiranë 2001, f. 84
[42] Naim Frashëri, "Vepra të zgjedhura2", Prishtinë 1978, f. 72
[43] Po aty, f. 83

elemente dhe i përpunon e i zhvillon më tej me mënyrën e vet të të shprehurit, me stilin e tij individual, me talentin e vet poetik. Të bie në sy në to edhe fryma romantike e jetës. Kafshët humanizohen dhe jepen si bartëse të virtyteve e të veseve njerëzore.

Qëllimi i autorit në fabula nuk është vetëm didaktik e moralizues. Si mjeshtri La Fonten, edhe Naimi përpiqet së pari të na japë një krijim të bukur artistik. Dhe, pasi lexuesi të jetë kënaqur me ngjarjen tërheqëse, me detaje të ndryshme, me dialogjet dhe sjelljet e ndryshme të personazheve kafshë, autori arrin në porosinë morale.

Te fabula *Gjinkalla dhe miz' e dheut*, ndërsa fabulistët e tjerë klasike botërore e vdesin urie gjinkallën dembele, Naimi vepron ndryshe. Miza e dheut i jep asaj ushqim sa për të mbajtur veten gjallë deri në pranverë dhe e këshillon:

Pa shih tjatër herë,
sa pa shtrenguar, pa prishur moti,
të mbledhc gjë ndë verë.

E më tej porosia moralizuese:

Kush nukë punon, fort mirë ta dish,
që kurrë s'ka pjesë[45].

Është një predikim i urtë e zemërgjerë, në përputhje me karakterin, botëkuptimin e temperamentin e poetit tonë të madh.

Te fabulat e Naimit në përgjithësi zotëron karakteri narrativ. Veç ka edhe të tilla ku aksioni zhvillohet pa komente dhe pa ndërhyrjen e autorit. Dhe këto janë nga krijimet më të bukura.

Përmendim, për shembull, fabulën *Ujku dhe qengji* e ndonjë tjetër, ku fabulisti ynë i paraqet personazhet në kushte natyrore: në pyje, livadhe etj. Ja si fillon fabula *Të dy qetë dhe ujku*:

Ishte një fushë me lule shumë,
nëpër mes të saj shkonte një lumë….

Fryma popullore është mjaft e pranishme në këto fabula, ku autori përdor lokucione apo frazeologji të popullit. Edhe fillimi i tyre shpesh është si në përrallat tona, pa zgjatje, por duke përshkruar mjedisin ku do të zhvillohet ngjarja. Kësisoj, fabulat e Naim Frashërit janë krijime poetike pothuajse origjinale.

Duke përfunduar themi se Naim Frashëri e ka pasuruar letërsinë shqipe për fëmijë si me larminë e përmbajtjeve ashtu edhe me larminë e trajtave poetike.

---

[44]Astrit Bishqemi, " Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë", Elbasan, 2001, f. 60

[45] Naim Frashëri, "Vepra të zgjedhura2", Prishtinë, 1978, f. 40

Po meritat e Naim Frashërit si shkrimtar i fëmijëve, si prozator dhe vjershëtor i fëmijëve, mund të shihen në plotësinë e tyre vetëm në qoftë se merret parasysh se në kohën kur ai shkruan shqip për fëmijë, letërsia për fëmijë nuk kishte ndonjë traditë posaçërisht të zhvilluar jo vetëm në Ballkan, por as në Evropë.

Me Naimin u çel një traditë e re letrare që do të zgjerohej e pasurohej më tej nga pasardhësit. Pikërisht për këtë kontribut të shënuar që solli, Naim Frashëri ka merituar pagëzimin e themeluesit të letërsisë shqipe për fëmijë dhe të përfaqësuesit kryesor të saj gjatë Rilindjes Kombëtare.

2.4 Sami Frashëri i abetares së Stambollit

Sami Frashëri (1850-1904) është ideologu më i shquar i lëvizjes sonë kombëtare. Si udhëheqës ideologjik, demokrat, mëndje e ndritur prej dijetari, ai mbetet një nga personalitetet më të rëndësishëm të Rilindjes. Ka dhënë një ndihmesë të shquar edhe në zhvillimin e letërsisë shqiptare për fëmijë dhe në arsimin tonë kombëtar.

Krijimtaria e Samiut në gjuhën shqipe është e lidhur tërësisht me idealet e lëvizjes kombëtare për çlirim, me nevojat e shkollës e të kulturës kombëtare. Pa dyshim ai është një nga themeluesit e saj. Proza e tij per femije eshte e paket, por e denje per ta quajtur autorin shkrimtar per femije.

Qysh në botimin e veprës së tij "**Shqipëria ç'ka qenë,ç'është e çdo të bëhete**", pjesë të së cilës u përfshinë në librat e abetareve dhe këndimeve dha një shembull të qartë në lëvrimin ligjërimor dituror poetik. Në thelb të kësaj kulture letrare qëndron gjuha popullore me mençuritë dhe ngarkesat leksikore të saj.

Me të drejtë studiuesit kanë vënë në dukje se prozat e Sami Frashërit kanë përkushtimin e dijetarit. Edhe pse mjaft rrëfime e tregime të tij kanë karakter historik dhe publicistik, mjetet që përdor shkrimtari kanë një gjuhë të pasur artistike. Peshën e fjalës artistike e përcakton kryesisht gjallëria, figura e mendimit por edhe elementet retorike nuk janë të pakta. Ja një pasazh nga Sami Frashëri në "*Këndimin*"e klasës së tretë, botimi i Ministrisë së Arsimit (1923),: *Këto kombe ngjajnë m'ato barëra q'ushqehen e shëndoshen nën dëborët të dimrit edhe,kur hiqet kjo barr'e ftoht'e rëndë nga faq'e dheut,ato zën'e lulëzojnë e zbukurohen në çast*.

Ashtu si te kjo pjesë, metaforat në prozën e Sami Frashërit zbërthejnë ide, por ushqejnë dhe shpresa në jetën njerëzore, duke kultivuar tek fëmijët besimin për të ardhmen. Në ndërtimin e këtyre fjalive shfaqet edhe imagjinata e bota emocionale e autorit. Proza e Sami Frashërit kryesisht është botuar në librat që i kanë shërbyer arsimit kombetar.

Veprimtaria e Samiut per arsimimin e femijëve shquan që në vitin 1879, kur boton **Alfabetare e gjuhës shqip**. Kjo qe një vepër e përbashkët e katër ardhetarëve të shquar: Sami Frashërit, Pashko Vasës, Jani Vretos e Koto Hoxhit. Ky libër i vogël me 136 faqe, me material nga gjuha, aritmetika, historia, gjeografia, morali e filozofia, zë vend të nderuar midis veprave më

me vlerë të Rilindjes sonë Kombëtare. Në dhjetë faqet e para të saj jepet alfabeti i ri i Stambollit me 36 shenja për gjuhën shqipe dhe shembuj me rrokje e me fjalë për mësimin e tij.

Abetarja shërbente si tribunë ku autorët me shkrimet e tyre ushqenin te shqiptarët dashurinë për atdheun, gjuhën dhe krenarinë kombëtare, evokonin epokën e Skënderbeut dhe bënin thirrje për gatishmëri ndaj detyrave të mëmëdheut. Këtë karakter e këtë frymë kishin shkrimet *Shqypnia e shqyptarët* i Pashko Vasës, *Udhë e të shkruarit të gjuhësë shqip* e Jani Vretos etj. Sami Frashëri në këtë vepër përfaqësohej me dy shkrime të gjata. I pari, *Gjuha shqip* (faqe 24-33), tregon rëndësinë e përhapjes së diturisë në gjuhën amtare: *një komb që humbet gjuhënë e vet, ësht' i humbur e i haruarë; që me të humburit të gjuhës së tij është i humburë dhe ay vetë*.

Nga ky parim autori nxirrte dhe porosinë: *Sot është dita që edhe shqiptarët të zënë e të shkruajn' e të këndojnë gjuhën e tyre, që të mundinë të ruajnë kombinë* [46]...Shkrimi tjetër *Dheshkronjë* (faqe 71-84) jep njohuri fillestare shkencore për gjeografinë.

Abetarja e Stambollit e vitit 1879 do t'u mësonte fillestarëve sa më lehtë dhe sa më qëndrueshëm gjuhën shqipe. Në këtë vepër të vogël, por me peshë të rëndë shoqërore e kulturore u shfaqën edhe njëherë dhuntitë e jashtëzakonshme të Samiut si pedagog, si psikolog, si linguist, si shkrimtar dhe në të njëjtën kohë sensi i tij i lartë atdhetar [47].

Fjalet dhe mendimet e pjesës me të cilën e mbyll abetaren janë fjalët e mendimet e atdhetarit të zjarrtë të kohës siç ishte Samiu, janë qëllimet dhe dëshirat për të cilat ai do të luftojë e do të përpiqet gjatë gjithë jetës së tij: *Ah, sa e bukurë qenka gjuha jonë*!

Punën për hartimin e teksteve shkollore Samiu e vazhdoi edhe në vitet e mëpasme. Në Bukuresht botoi librat: ***Abetare e gjuhës shqipe*** (1886), që e përpiloi enkas për nxënësit e mësonjëtores së parë të Korçës e që njohu disa ribotime. **Shkronjëtoreja e gjuhësë shqip** (1886) – e para gramatikë shkollore. **Dheshkronjë** (1888) – tekst gjeografie.

Më të shumtën e prozave të tij ai i botoi në librin shkollor *Abetare gjuhes shqipe* (1886), e cila i kalon kufijtë e tekstit shkollorë me artikujt, tregimet e përrallat që përmban. Artikujt letrarë me karakter mësimor, si *Anija, Fotografia,Vendet e largëta të Veriut* etj., në përgjithësi janë të shkurtër, japin përshkrime mbi sende e dukuri natyrore, shërbejnë për të vegjëlit të ushtrojnë leximin dhe kanë karakter diturak.

Për shembull: *Anija është një govatë e madhe, e bërë prej trarësh, që qëndron mbi ujë dhe ecën duke u shtypur prej erës*...etj.

Përrallat e tregimet, megjithëse janë të pakta, janë tërheqëse dhe kanë vlera letrare.

Përmendim katër përralla, që janë më të bukura. Tematika e tyre e përbashkët është puna, vlera e dobia e saj.

---

[46] Alfabetare e gjuhës shqipe, Kostandinopojë 1879, f. 24 -33

[47] Zija Xholi, "Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare", Tiranë, 1987, f. 314

Në përrallën e parë, *Dheu është flori*[48], përshkrimi ka elemente të legjendave të moçme. Aty jepet portreti i bujkut plak në çastin e vdekjes, duke u lënë amanetin të bijve. Ata kërkojnë më kot shtambën e florinjve dhe në këtë mënyrë toka e punuar u fal prodhime të bollshme. Kësisoj autori shtjellon një problem të madh moral të kohës: *Begatia vjen nga puna dhe djersa që derdhin njerëzit*.

Përshkrimi i tablosë ku tre bijtë punojnë tokën për të gjetur shtambën me florinj në vresht, zbërthen natyrshëm mendimin filozofik dhe artistik të autorit, duke shfrytëzuar natyrën e prozës popullore shqiptare.

Në të dytën, me titullin e gjatë *Mbollën të tjerët, ha ti, mbill ti, të hanë të tjerët*[49], plaku 90-vjeçar mbjell pemë frutore. Në të tretën, *Kush s'punon, mbetet i uritur*[50], krijimi përcjell tek fëmijët kontrastin midis përtaces dhe punëtores. Personazhet e kësaj përralle: *Gjinkalla dhe Milingona*, përshkruhen ashtu si në rrëfimet dhe përrallat popullore.

Në të katërtën, *Fili*, djali jetim bëhet kujdestar i elefantit. Përrallat vënë në lojë përtacinë dhe rehatllëkun, parazitizmin dhe injorancën. Ato nuk ndërtohen mbi bazën e moralizimeve, madje edhe në fund nuk kanë përfundime moralizue, siç vihet re në fabula.

Tregimi historik a gojëdhëna *Soloni dhe Krisua*[51] është proza më e bukur e Samiut për fëmijë. Mbreti i një shteti të Azisë së Vogël pyet Solonin, dijetarin e madh grek, se kush është më i lumtur në botë. Lumturinë më të madhe Soloni e shikon te " plaku...me shumë fëmijë...të prokopisur", te njerëzit e punës, te vëllezërit e fortë e trima, të cilët e donin shumë nënën e tyre. *Lumturia nuk vjen nga pasuria* – kjo është idea që përcillet.

2.5 ANDON ZAKO – ÇAJUPI (1866-1930) - Përshtatësi më i talentuar i përrallave të La Fontenit

Çajupi i takon periudhes së Rilindjes Kombëtare, në të cilën shoqëria shqiptare duhej të zgjidhte disa detyra historike:

Të shpëtonte nga zgjedha e gjatë e sundimit osman, të fitonte Pavarësinë Kombëtare dhe të hynte në udhën e zhvillimit demokratik.

Çajupi me veprimtarinë dhe krijimtarinë e tij letrare iu përgjigj me besnikëri këtyre detyrave. Ai solli kontribut të veçantë në thellimin e problematikës shoqërore të Letërsisë së Rilindjes Kombëtare. A. Z. Çajupi duhet shikuar jo vetëm si atdhetar e shkrimtar për të rriturit por edhe si shkrimtar e poet për fëmijë.

Vepra e tij e parë poetike, që e bëri menjëherë të njohur, ishte *Baba Tomorri*, botuar në Kajro më 1902. Faik Konica, i magjepsur nga freskia dhe thjeshtësia e vjershave të kësaj përmbledhjeje shkroi po atë vit: Na leu një vjershëtor! Dhe nuk gaboi. Poezisë shqipe i kishte ardhur një vjershëtor me zërin e tij të veçantë, me vizionin e tij të veçantë për jetën dhe me një ndjeshmëri të hollë për të pathënat e shpirtit njerëzor, me një gjuhë poetike që rridhte si këngët dhe ujët e burimeve të

[48] Sami Frashëri, "Dheu është flori", Tiranë, 2000, f. 3
[49] Sami Frashëri, "Dheu është flori", Tiranë, 2000, f. 4
[50] Po aty, f. 5
[51] Po aty, f. 16

Zagorisë, e çliruar nga klishetë e ngurta, e mbrujtur me mallin e mëmëdheut dhe me mallin e dashurisë, përzier me erë trëndeline dhe me erë gjethesh.

Baba Tomorri është vepra më e rëndësishme e Çajupit dhe një nga veprat më të rëndësishme të poezisë shqipe të Rilindjes. Megjithëse nuk shkroi vepra posaçërisht për fëmijë, shumë nga vjershat që përmblidhen te *Baba Tomorri* kanë hyrë qysh herët në leximin e fëmijëve tanë, sepse ato janë brumosura me ndjenjën e atdhedashurisë, me urrejtjen për klasat shfrytëzuese dhe janë shkruar me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, që mund të shijohet nga të gjitha moshat.

Te *Baba Tomorri* u shfaq profili krijues novator i Çajupit, veçoritë e stilit dhe të talentit të tij të vetvetishëm. Shpirti atdhetar s'kishte njohur më parë një poet me temperament aq të vrullshëm, shpirti rebel një këngëtar aq të përkushtuar të lirisë, shpirti erotik s'kishte gjetur një shprehje aq të hollë dhe aq tundonjëse, shpirti shpotitës një penë aq të mprehtë e të guximshme dhe vjershëria shqipe një gjuhë poetike aq të njomë e aq të afërt me këngën e popullit.

Përmbledhja poetike *Baba Tomorri* përbëhet nga tri pjesë, që autori i titullon: *Atdheu, Dashuria* dhe *Përralla të vërteta e të rreme*.

Motivi atdhetar, dashuria për baltën dhe gurët e mëmëdheut dhe malli për ta, kujtimi i së kaluarës heroike dhe krenaria për traditat e të parëve, dëshira për ta parë atdheun të lirë dhe thirrja për të rrokur armët kundër pushtuesit, i japin poezisë së Çajupit atë tharm frymëzimi dhe atë patos luftarak që e bën të hyjë thellë në shpirtin e shqiptarit dhe ta trondisë atë.

Tema atdhetare fiton në penën e Çajupit një përmbajtje konkrete e të prekshme, sepse ai shprehu ndjenjat dhe mendimet e njeriut të thjeshtë, të bujkut e të bariut, lidhur me baltën e mëmëdheut dhe me varret e stërgjyshëve.

Sidomos kjo vihet re në vjershën " *Mëmëdheu"*. Është vështirë të gjesh një njeri, që ka mësuar në shkollen shqipe e të mos e mbajë mend, që nga fëmijëria këtë poezi.

Mëmëdhe quhetë toka,
Ku më ka rënurë koka.
Ku kam dashur mëmë e atë
Ku më njeh dhe guri i thatë….
……..

Mëmëdheu është toka ku njeriu lind, mëson gjuhën e nënës, njeh prindërit, ku rron me ëndrra dhe me shpresa, ku dëshiron të ketë varrin. Ky vend për shqiptarin është Shqipëria.

Ku i duket balta
Më e ëmblël se mjalta,

shkruan poeti. Atdheu i jep njeriut nder, i jep kuptim dhe vlera morale jetës së tij. Eshtë një ndër vjershat më të njohura e më të dashura, ku i këndohet dashurisë së pakufishme që ka autori për mëmëdheun e tij, Shqipërinë. Vjersha ndihmon në edukimin patriotik të fëmijëve. Këto vjersha ai i shprehu me një gjuhë të thjeshtë, me një një varg që rrjedh i çlirët, si në këngët e popullit, me një fjalor poetik konkret dhe me një ndjenjë aq të sinqertë e aq të çiltër, sa e bën aty për aty për vehte lexuesin dhe i ngulitet në mendje e në zemër.

Jeta është e bukur në atdhe kur njeriu gëzon lirinë, liria është gjëja më e shtrenjtë për njeriun, do të shkruante poeti, por shqiptarët e kishin humbur atë dhe kishin rënë në një robëri të rëndë shekullore:

Pesëqind vjet kemi rruar
me pahir,
Lidhurë këmb' e duar
me zinxhir!

Shkruante Çajupi në poezinë *Shqiptar*, duke lëshuar kushtrimin:

Çvish rrobat e robërisë,
Mëmëdhè,
Vish armët e trimërisë,
se ke ne!

Në këto vargje të përziera, katërrokëshi thyen monotoninë e tetërrokëshit, duke i dhënë një ritëm të ri shprehjes poetike, kurse aliteracioni i jep një timbër të veçantë. E gatuar me frymën kryengritëse, poezia atdhetare e Çajupit ishte kështu një kushtrim lufte; në të shpirti luftarak dhe motivi atdhetar i poezisë së Rilindjes gjeti shprehjen e vet më të gjallë dhe më të hapur. Poezia atdhetare e Çajupit është poezia e toneve të forta, një poezi e trazuar që vlon nga malli e dashuria për vendlindjen dhe nga zemërimi e thirrja për luftë. Ajo shënoi kulmin e poezisë atdhetare të Rilindjes, prandaj dhe u bë himn atdhedashurie edhe vetëmohimi për çetat e lirisë, gjatë Rilindjes e më pas.

Në të gjitha librat e leximit, që u përdorën nepër shkolla fillore, gjenden vjershat e Çajupit. Po kështu popullaritet të madh kanë gjetur në leximet për fëmijë vjershat: *Baba Tomorri, Shqipëtarë, Ku kemi lerë, Trim i Shqipërisë, Robëria, Fshati im, Dheu* etj.

Këto vjersha, së bashku me shkrimet e tjera të Çajupit për fëmijë, u përmblodhën për herë të parë më 1964 në një vëllim të posaçëm për nxënësit e shkollave nën titullin *Shqiptar!* Dhe më vonë, më 1967, nën titullin *Mëmëdheu*.

Çajupi ka botuar posaçërisht për fëmijë vetëm një vepër: *Andon.Zako (Çajupi)* ***Përralla të zgjedhura nga të vjershëtorit të madh La Fonten***, botuar në Heliopolis (Egjipt) në vitin 1921.

Kjo vepër, përmban fabula të poetit të shquar francez . Nga 242 fabulat që ndodhen në 12 librat e La Fontenit, Çajupi mori 112. Zgjodhi ato fabula ku theksohej ideja se me armikun nuk ka kompromis, se po t'i bësh mirë armikut do të gjesh keq, se ndaj atij duhet të jesh vigjilent, si dhe fabula te tjera, ku demaskohen një varg vesesh e të metash njerëzore, si thashethemet,vetëmburrja etj. Duke u mësuar nga kjo, ne mund të themi me plot të drejtë se kjo vepër e bëri Çajupin, një përkthyes të shquar për të vegjlit, poet për fëmijë dhe një nga personalitetet e Rilindjes, që luftoi për zgjerimin e leximeve të fëmijëve shqiptarë me veprat e letërsisë klasike botërore. Këtë qëllim autori e shpreh në vjershen *Për çunat shqiptarë*, e cila është e vetmja vjershë krejtësisht origjinale e Çajupit, shkruar për fëmijë.

Kujt t'ja fal keto perralla
Fort te rralla?...
Do t' i fal dorë –më- dorë
Te çunat e shqipërisë
Se janë shpresë e Lirisë!

Vëllimi shoqërohet edhe me një shënim në formë parathënieje me titull Jean de la Fonten. Ky shënim përmban edhe disa elemente biografike të shkurtra për La Fontenin, të shkruara për të vegjlit dhe jo pa humor:... *Ish një vjershëtor francez, lindur në vitin 1641, vdekur në Paris me 1695. Ka qenë gjahtor i prapë dhe pëlqente jetën fusharake. Duante shume shtazët e shpezët. Në përrallat që ka shkruar kaq bukur, i bën të flasen e të kuvendojnë me vjersha të hijshme.* Shihet qartë, që Çajupi ka zgjedhur disa aspekte konkrete, të kuptueshme dhe tërheqëse për fëmijët mbi jetën e La Fontenit dhe kjo gjë flet për njohjen e natyrës së fëmijëve nga ana e tij. Synimi i poetit ishte që, nëpërmjet këtij vjershërimi të fabulave, të paraqiste jetën dhe moralin e shoqërisë së kohës, prandaj dhe natyra e poetit, hokatare e gazmore dhe herë-herë shpotitëse, shpaloset midis vargjeve duke marrë ngjyrime të filozofisë dhe mençurisë popullore.

Dihet që Çajupi lëvroi fabulën pas një përvoje të gjatë që pati fituar në fushën e poezisë. Lexuesi, në krijimtarinë e tij, kishte vënë re talentin, stilin e tij poetik por edhe qëndrimin e mprehtë ndaj fenomeneve të shoqërisë. Parë me këtë sy edhe në punën si shqipërues i fabulave, në thjeshtësinë e vargjeve te tij fshikullon toni i rreptë, humori, ironia dhe satira ne zbulimin e të metave,veseve të shoqërisë.

Në këtë mënyrë Çajupi u dallua ndër poetët e Rilindjes sonë Kombëtare edhe për frymën luftarake në artin e tij poetik. Ai demaskon jo vetëm padrejtësitë në shoqërinë shqiptare, por edhe veset dhe të metat e njerëzve, vetëmburrjen, thashethemet, grindavecët, frikën, pertacinë etj (*Nje mbledhje qe bene minjte, Kokoshi e margaritari, Ujku dhe qengji, Bretkosa qe donte te trashej sa nje ka* etj.) kurse nga ana tjetër nuk lë pa përkrahur ndershmërinë, dashurinë për njerëzit dhe punën.

Te fabula *Kali dhe dreri* duket që Çajupi e vlerëson lirinë, prandaj ai këmbëngul:

"Liria,shokë,liria,
s'çmohet dot në këtë jetë……"

Ndërsa tek fabula *Korbi dhe dhelpra*, Çajupi i mëson të vegjëlit të nderojnë thjeshtësinë. Në mjaft fabula: "*Gjinkalla dhe miz'e dheut*","*Plaku dhe vdekja","Luani dhe miu","Kali dhe ujku","Punetori dhe djemt e vet","Mushka fodulle","Maçoku dhe miu plak","Millonai,i biri dhe nje gamar","Dragoi me shume koke","Dragoi me bishta shume","Dhelpra dhe lejleku","Kali dhe ujku","Ujqrit dhe dhente","Fshatari dhe gjarpri", "Gomari dhe qeni","Korbi dhe dhelpra*"etj., shfaqet karakteri didaskalik moralizues, kryesisht për fëmijët e vegjël.

Origjinalitetin e Çajupit në thurjen e këtyre fabulave e përcakton qartë dhe fryma popullore që ato mbartin, si dhe vargu e muzikaliteti i tij.

Çajupi mori prej La Fontenit, këtij fabulisti të madh, mjaft mendime përparimtare e morale, të cilat i ndërtoi në vjershërime origjinale.

Puna origjinale e Çajupit me fabulat e La Fontenit shfaqet edhe në mjeshtërinë e tij, për të shfaqur shpeshherë mjedisin shqiptar. Kështu, ai futi mjaft elemente të botës dhe jetës shqiptare: në vend të *Olimpit* shënohet *Tomorri,* në vend të *gjykatësit* shënohet *Kadiu* etj.

Çajupi në lëvrimin e fabulistikës dha kontributin e vet që këto fabula të kenë freskinë dhe frymëzimin e thellë të poezisë popullore.

Duke ndjekur rrugën e përkthimeve të bëra edhe më parë prej Anton Santorit e Naim Frashërit, Çajupi pati sukses në këtë fushë sepse:

- Ai bëri një hap origjinal në pasurimin tematik të fabulës, ashtu dhe në zbulimin e mundësive shprehëse të shqipes, në theksimin e frymës popullore.
- Vargjeve u dha tingëllimë baritore shqiptare. Vargun e gjatë aleksandrin ose vargun e lirë dhe shumë të shtrirë të fabulistit francez e zëvëndësoi me vargun e shkurtër popullor duke e bërë rrëfimin më të gjallë dhe më dinamik.
- Autori ynë, në ndonjë rast tonin didaktik e zëvëndesoi me urtësinë popullore.
- Porositë morale shpesh Çajupi i ndryshon nga origjinali i fabulistit francez. Për shembull në fabulën *Ujku dhe qengji*:

  Me gjak, me të rreme mbretëron dhe Turku,
  Pa faj na ha kokën, se punon si ujku!
- Çajupi nuk bëhet skllav i origjinalit. Ai i jep atij formë më të thjeshtë, hedh ose shton detaje, shton në ndonjë rast dialogun.
- Shumica e fabulave fillojnë si edhe përrallat popullore:

  Ishte një njeri njëherë
  që pinte raki dhe verë.
- Autori ynë i nis fabulat pa komente, duke i shkurtuar hyrjet, hidhet drejt e në rrëfim.
- Fabulat i bën më të kuptueshme për lexuesin shqiptar. Emrat e huaj i zëvëndëson me emra shqiptare (Le Gros Jean = Andon etj.)
- Të rrëfyerit është i drejtpërdrejtë; personazhet flasin vetë, dialogojnë vetë midis tyre duke bërë kështu që rrëfimi të bëhet mjaft dramatik. Çdo gjë në fabul është në lëvizje, në veprim. Na duket sikur i dëgjojmë jo vetëm njerëzit, po edhe erën tek fryn, edhe përroin tek rrjedh...

Siç përcakton Prof. Floresha Dado, *Çajupi mbeti përshtatësi më i talentuari i perrallave të La Fontenit* [52].

Me shkrimet e tij origjinale, si dhe me përkthimet nga letërsia klasike botërore, luftoi për të përhapur dije dhe kulturë te brezi i ri i Shqipërisë.

[52]Floresha Dado, " A. Z. Çajupi – Jeta dhe vepra", Tiranë ,1983, f. 231

2.6 Papa Kristo Negovani (1875-1905) – themeluesi i novelës për fëmijë

..O djem, o vasha, vraponi
Nd' i bekuar mësim!
Gjuhën e Mëmës mësoni
Me dëshir' e mallëngjim!

Sepse:

Mësimi do t'shpëtonjë
të varfrënë Shqipëri!...

Me të tilla vargje Negovani u bënte thirjen Shqiptarëvet kudo e veçanërisht bashkëfshatarëvet të vet. Puna ideale e tij mori rrugën e mbarë: njëqind djem e vajza katundare natë për natë në këthinën e ngushtë të shtëpisë së tij mësonin abecenë shqipe dhe historinë lavdiplotë kombëtare nga goja e At Kristos. Papa Kristoja iu përkushtua çështjes kombëtare duke i kundërshtuar e luftuar hapur synimet shkombëtarizuese të Kishës dhe të qarqeve shoviniste greke.

Ai nuk u nënshtrua as para kërcënimeve të hapura dhe shantazheve të vazhdueshme që i bëheshin nga klerikët e kishës greke të cilët provuan që Negovanin ta frikojnë me qëllim që ai të hiqte dorë nga veprimtaria kombëtare, provuan që ta blejnë më flori, dhe në fund vendosën ta likuidojnë në mënyrën më barbare. Shovenistë grekë e vranë Papa Kristo Negovanin, duke e masakruar barbarisht duke ia prerë jetën në mes, atëherë kur ai kishte vetëm 30 pranvera, pikërisht më 12 shkurt 1905.

Sot Papa Kristo Negovani mban titullin e lartë" Mësues i Popullit".

Tek ai vleresohet fakti që qe nga të parët priftërinj, i cili filloi të mëshonte shqip..

Veprat[53] që Negovani i la të shkruara, janë kryesisht në vargje lirike, krijime didaskalike për fëmijë etj. Në ngjallje të vet Negovani botoi gjashtë vëllime, kurse dy të tjerat panë dritën e botimit pas vdekjes së autorit;

Po të ndalemi në ***poezinë për fëmijë*** të Negovanit do të shohim se autori ka botuar vëllime me vjersha për të vegjlit, duke ndjekur rrugën e Naim Frashërit. Përmendim përmbledhjen *Vjershëshkresetoreja*. Pas vdekjes së autorit u botua edhe një vëllim tjetër me vjersha të tij, *I drunjti kryq*, ku cilësia artistike shënon rritje.

Në këto vëllime ka vjersha që i kushtohen natyrës, si: *Marsi, Dimri, Vera, Të katër kohët e motit* etj. Vjershat e tjera u kushtohen fëmijëve, jetës së

[53] Veprat e tij janë:
Vjershë shkresëtoreja, që u botua me 1899, Sofje,
Istori e Dhjatës së vjetër, Bukuresht, 1899
I vogli Donat Argjendi (1900)
Prishja e Hormovës, botuar me 1903, Sofje
Hijetore histori, 1903, Sofje
Bënjat e shenjtoreve dërgimtare, 1903, Sofje (Bëmat e apostujve shenjtore)
I drunjti kryq, botuar me 1906. Sofje
Istorishkronje e Pilkatit, Selanik 1909.
Pas çlirimit, më 1960, me krijimtari të zgjedhur të këtij autori u botua përmbledhja Prishja e Hormovës (vjersha e tregime), përshtatur nga Dhimiter Fullani.

tyre në familje e në shoqëri, dashurisë ndaj prindërve, punës apo gjuhës shqipe (*Gjumaraku dhe këndezi, Të dy djemtë, Gruaja punëtore, Mendimi i djalit të mirë*.)

Krijimet poetike të Negovanit kanë karakter atdhetar, fetar e didaskalik, por duhet thënë se në to ka shumë moralizime:

Kur do të qortosh të tjerët
Vështro veten përnjëherë,
mos edhe ti për të qortuar
je dhe del i turpëruar.

Në krijimtarinë poetike të Negovanit, rëndësi të veçantë kanë fabulat. Numri i tyre arrin rreth 15. Përmendim: *Dhelpra dhe rrushtë, Dragoi dhe dhelpra, Ujku, qengji dhe dhelpra* etj. Studiuesit Dhimitër Fullani[54] dhe Veli Veliu[55] arrijnë në përfundimin se fabulat e Negovanit janë përshtatje të lira nga Ezopi dhe La Fonteni, madje ndonjëra prej tyre mund të jetë dhe origjinale. Sikurse Naimi, edhe Negovani zgjedh tema që u përgjigjen qëllimeve të mësuesit dhe edukatorit atdhetar duke goditur veset njerëzore ose ushqen veti të mira të bashkatdhetarëve. Autori bën përpjekje për ta vënë pendën në shërbim të lëvizjes atdhetare.

Duhet të theksojmë se në fabulat e Negovanit ndjehet ndikimi i folklorit tonë, sidomos në metrikën e tyre , ku dominojnë vargjet gjashtë dhe tetë rrokshe, si në poezinë popullore. Te Negovani nuk kemi gërshetime vargjesh të gjata me të shkurtra, gjë që do t'i bënte më të gjalla krijimet.

Meritë kryesore e këtij autori në lëmin e poezisë për fëmijë është se zhvilloi në stil të gjerë gjininë e fabulës dhe të përrallës në vargje, gjithashtu zgjeroi tematikën, duke shkruar për jetën e fëmijëve dhe për natyrën[56].

xxx

Negovani mund të quhet themelues i tregimit të gjatë (novelës) për të vegjlit. Vlejnë të përmenden rrëfenjat *I drunjti kryq* dhe *I vogli Donat Argjendi*.

Novela *I vogli Donat Argjendi* doli më 1900, si botim i shoqërisë atdhetare të Kostancës. *Është një vepër italishte, e sjellë në shqip nga gjuha greke*[57], mesa duket nga një tregim i botuar për shkollat fillore.

Proza me karakter didaktik e P.K.Negovanit shquhen për dashurinë ndaj shkollës shqipe, atdheun dhe për vatrën familjare. Me natyrën e tij krijuese Negovani shpreh qartë karakterin përshkrues të cilat mbartin sentimentalizmin romantik.

---

[54]Dhimitër Fullani, Papa Kristo Negovani [parathënie e librit "Prishja e Hormovës"]. Tiranë, 1960

[55]Veli Veliu, "Fabula shqiptare e periudhës së Rilindjes", Shkup, 1993

[56]Bedri Dede, " Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë", Tiranë 1971

[57]Akademia e Shkencave e Republikës të Shqipërisë, "Histori e letërsisë shqiptare", Tiranë 1983, f. 336

Novela *I vogli Donat Argjendi* qysh në tablotë e saj të para shpalos përshkrimet plot bukuri të natyrës, në të cilat shfaqet edhe fati i dhimbshëm i personazhit kryesor Donat Argjendi. Ky personazh, i biri i gjeneralit shqiptar Argjendi, vizatohet mes trimërisë dhe luftërave çlirimtare të kohës, bëhet mjaft i dashur për të vegjelit, qysh në momentin që rrëmbehet nga kusarët dhe ata e fshehën mes malesh në një shpellë. Më vonë arratiset. Me ndihmën e një bariu, bie në duart e priftit Savë, i cili i jep mësimet e para. Me kujdesjen e tij djali kthehet përsëri te prinderit; kusaret zihen e dënohen. Fundi i rrëfenjës është një himn, këndon lumturinë familjare dhe që dënon të keqen shoqërore.

Në novelë përcillet ideja e triumfit të së mires dhe të çdo gjëje njerëzore. Gjithashtu novela ka meritë të veçantë sepse kemi përpjekjen e parë për formimin e personazheve me fizionomi pak a shumë të përcaktuar si: Teftën, Donatin, Savën. Gjeneral Argjendi është një pasanik patriot, luftëtar për lirinë e atdheut dhe baba i mirë. Zonja Teftë – grua besnike, mëmë e apasionuar për fëmijën e vet. Prifti Savë dhe bariu janë mirëbërës; Premtja është shërbetore e penduar për fajin e vet. Muzaka, megjithëse ndodhet në çetën e kusarëve, ka shpirt të mirë dhe e do Donatin.

Vend me rëndësi në rrëfenjë zënë përshkrimet e natyrës. Mjediset e kusarëve janë të errëta, kurse ato të njerëzve të thjeshtë e të ndershëm, tërë dritë.

Në rrëfenjë mësimet e priftit Save mbi sendet dhe dukuritë e natyrës janë dhënë me psikologji fëminore dhe studiuesi Mitrush Kuteli e quan këtë vepër një rrëfenjë e zgjedhur me tendencë pedagogjike. Keshtu, për shembull, Donati pyet plakun Savë për Diellin: *Cili e ndezi atje sipër atë dritë të bukur e të artë...Kandili i ndezur në shpellën tonë ishte ndryshe, me dritë të dobët*[58]*;* ai çuditet kur bie shi: *Cili hypën atje lart në majë të kodrës për të derdhur ujë që të njomen lisat?*[59]*.* Takohet me fëmijë të tjerë: *Oh sa njeri i vogel si unë! Sa bukur! Paska edhe njerëz të tjerë të vegjël*[60] etj.

Novela ka gjuhë të vështirë, plot greqizma dhe fjalë të shpikura. Për shembull, Negovani përdori pa nevojë fjalë të reja aty ku të tjerët kishin krijuar një neologjizëm: *atëresë* (atdhe), *mësonjësi* (nxënësi), *lindësit* (prindërit) etj.

Vende- vende ka situata ireale, të trilluara dhe të paarsyetuara; rrëfenja vuan nga ngjyresa romantike.

Në analizën që i kanë bërë studiuesit kësaj vepre, me të drejtë kanë vënë në dukje se kjo novele mbart edhe elemente mistiko- fetar, por rrëfimin e tij e gjallërojnë mjaft skena e tablo të trilluara të cilat krijojnë një botë të thellë psikologjike për fëmijët. Me prozën e tij Papa Kristo Negovani solli një notë të re rrëfimtare në letërsinë e Rilindjes sonë Kombëtare.

[58] Papa Kristo Negovani, " Prishja e Hormovës", Tiranë, 1960, f. 88
[59] Po aty, f. 92
[60] Po aty, f. 93

2.6.1 "I vogli Donat Argjendi" nga Negovani te Fullani e, më tej, te Dedja

1. Krijimi *I vogli Donat Argjendi,* së bashku me *Gjahu i malësorëve,* janë veprat themeltare të prozës së mesme (novelës) në letërsinë shqiptare për fëmijë. Por "*I vogli…"*, në dallim nga "*Gjahu…*" i Kristoforidhit, sendërzon përpjekjen e parë për skalitjen e personazheve, të tillë si: Tefta, Donati, Sava, Gjeneral Argjendi, Premtja, Muzaku. Këtë *vepër italishte të sjellë në shqip nga gjuha greke*[61] vetë Negovani e ka përshtatur duke na dhënë një rrëfenjë mbi kohërat e princave shqiptarë të Toskërisë. Ne e dimë se është botuar në Sofje më 1904, por është interesant shënimi i shkrimtarit Mitrush Kuteli[62], që na dëshmon edhe një botim më të hershëm, më 1900 (U munduam ta shtinim në dorë këtë botim në Bibliotekën Kombëtare e gjetkë, por pa sukses).

Më tej ky krijim u përshtat nga Dhimitër Fullani dhe u botua në përmbledhjen "Papa Kristo Negovani. *Prishja e Hormovës* – N. Sh. Botimeve "Naim Frashëri", Tiranë 1960". Pikërisht këtë përpunim ka patur për bazë profesor Bedri Dedja.

Neve na bie për detyrë të vëmë përpara botimin e Dhimitër Fullanit ndanë atij të B. Dedjes e t'i krahasojmë, të hulumtojmë punën që ka bërë shkrimtari e njohësi i mirë i letërsisë për fëmijë Bedri Dedja për ta risjellë shkrimtarin e Rilindjes, martirin e gjuhës shqipe, Negovanin, përsëri të dashur për lexuesit e vegjël të sotëm, pas më tepër se një shekulli.

2. Përpunimi dhe ritregimi është një fushë e veprimtarisë së hershme të Prof. Bedri Dedjes në letërsinë për fëmijë. Themi *e hershme*, sepse me këtë praktikë janë hartuar disa libra artistikë prej tij, duke filluar nga *Përralla popullore mbi kafshët* (1957), *Përralla e tre vëllezërve* ('58) dhe duke vazhduar katër dekada më vonë, në periudhën e fundit të krijimtarisë, me *Republika e 1100 çudirave* (1997), *Përralla ruse (1998), Tetë përralla shqiptare të zbuluara në Amerikë* (2002), romani *I fundit i Kastriotëve* (2002) i Andon Frashërit apo me novelën *I vogli Donat Argjendi* ("Pegi", 2002) të Papa Kristo Negovanit.

Siç mund të vihet re, gurrat nga i ka marrë materialet për përpunim mjeshtri ynë janë katër:

a) folklori kombëtar;

b) krijime e botime me peshë të qëmtuara nga autorë shqiptarë, si Frashëri e Negovani;

c) shkrimet e veta të mëparshme (si poemat: *Patku në plazh, Shkolla e pyllit*, të botuara në përmbledhjen *Republika e 1100 çudirave*), me qëllim që t'i mbijetonin kohës, tranzicionit tonë demokratik);

d) autorë rusë. Kësisoj, Bedri Dedja jo vetëm e përktheu në vargje, ta zëmë *Përrallën e peshkatarit dhe të peshkut të artë* të Pushkinit dhe e botoi më 1956-n, por më 1998, e ribotoi të ritreguar në prozë atë krijim në librin *Përralla ruse*. Po te kjo përmbledhje do të gjejmë të përshtatura në prozë edhe krijimin tjetër të Pushkinit *Përralla e Kurnacit dhe e shërbëtorit të tij Tullacit* apo disa fabula të Krillovit, si edhe poemat-përralla të Samuil Marshakut: *Miu i vogël budalla, Kush është më i rëndësishëm, Dremitja e gogësima*, të Nikolai Nekrasovit *Gjysh Mazai dhe lepujt* apo *Kali gërmuq* të Pjotër Jershovit e ndonjë krijim tjetër.

[61] Akademia e Shkencave e RPSSh të Shqipërisë: Histori e letërsisë shqiptare, T. 1983, f. 336
[62] Mitrush Kuteli, Vepra letrare 5, Tiranë 1990, f. 148.

Në këtë studim do të merremi vetëm me përpunimin e ritregimin e veprës së Papa Kristo Negovanit "I vogli Donat Argjendi".

3. Libri është *përpunuar e ritreguar*. Ç'kuptojmë me këtë? Novela ka qenë përshtatur më parë nga Dhimitër Fullani. Pra, gjuha arkaike e më shumë se një shekulli të shkuar, kur u botua libri, qe *përshtatur* më parë në gjuhën e sotme (jostandarde, botimi është bërë më 1960, para Kongresit të Drejtshkrimit). Kurse tani, në këtë përpunimin e dytë, novela u bë më e lexueshme për fëmijë nga dora e një mjeshtëri të letërsisë për fëmijë. I gjithë teksti u përpunua dhe u ritregua më me art.

Konstatojmë se Dedja nuk ka vënë dorë te fabula e novelës. Si në original, edhe në ritregim ajo bën fjalë kryesisht për Donatin, djalin e vetëm të gjeneralit shqiptar Argjendi. Gjenerali shkon në luftë dhe plagoset rëndë. Gruaja e tij, Tefta, lë foshnjen e vet dhe niset te i shoqi. Nga pakujdesia e kujdestares Premte, Donatin foshnjë e rrëmbejnë kusarët, me qëllim që ta përdorin si mjet për t'i shpëtuar drejtësisë. Koha rrjedh dhe Donati rritet në limerin e kusarëve. Më tej arratiset dhe, me ndihmën e një bariu, bie në duart e priftit Savë, i cili i jep mësimet e para. Me kujdesjen e tij djali kthehet te prindërit; kusarët zihen e dënohen.

Ku qëndron pikërisht ritregimi atëherë?

Përpunimi e ritregimi fillojnë që nga kompozicioni i novelës. Kështu, varianti i Fullanit ka 14 krerë (numurimi aty është bërë gabim, ndaj del me 15), kurse përpunimi i Dedjes – 17. Krerët 4 dhe 5 janë ndarë në dy pjesë duke na përftuar dy të rinj (*V. Donati mpreh gjuhën dhe këmbët; XVIII. Historia e dhimbshme e bareshës*). Kapitulli I te Fullani është pa kokë, Dedja e ka emërtuar: *Gjeneral Argjendi plagoset në luftë*. Janë rishikuar edhe titujt e disa krerëve (Kreu 7. *Dielli dhe lulet → Donati njeh botën;* Kreu 15. *E mira shpërblehet, e liga dënohet → Kjo botë nuk i fal padrejtësitë*).

Ndonjë përpunim i lehtë mund të hetohet në përmbajtje. Në ritregim novela, nga realiste, herë-herë sikur merr një ngjyrim të lehtë përralle. Kështu, për shembull, Negovani thotë se shpella e kusarëve kishte një derë hekuri me dry; Bedri Dedja: me shtatë dryna. Kurse Gjeneral Argjendi në ndonjë rast i përngjason paksa një mbreti. Kusarit me cilësi pozitive Muzaku, të cilit Negovani i jep dënim me kusht; te Dedja Gjenerali e liron, i fal edhe një kalë. Një denatyrim pëson edhe një personazh tjetër, prifti Savë në shpjegimin e dukurive natyrore… Mund të hetojmë mandej edhe ndonjë ndryshim tjetër të vogël. Fjalabie, në shpellë, Muzaku i sjell Donatit një abetare, gjë që nuk është në original.

Le të vazhdojmë në hulumtimin tonë rreth përpunimit e ritregimit të aplikuar.

4. Mitrush Kuteli e quan këtë novelë *një rrëfenjë e zgjedhur me tendencë pedagogjike (një lloj "Emili")*. Profesori i psikologjisë dhe i pedagogjisë Dedja i thellon këto vlera, pa harruar veshjen artistike të teksit.

Kështu, për shembull, në një pasazh, kur djali del nga shpella, Negovani thotë:

Befas pa një qengj të vogël, i cili kishte rënë të flinte nën një trëndafil të lulëzuar.

- O qengj i egër!- klithi me gëzim çuni dhe shpejtoi ta zërë.(f. 85)

Bedri Dedja e jep më bukur, më të gjallë e më me ndjenjë këtë përballje me befasinë, me të panjohurën:

Shtangu kur pa një qengj të vogël. Qengji blegëriu, duke vështruar, kurse çuni u tremb nga blegërima. Nisi të ecë së prapthi në drejtim të së çarës së shkëmbit, duke u dridhur, po përsëri u përmbajt.

- Ç'është ky? – klithi përsëri.

- Beee!
- Paska zë…
U afrua, e përkëdheli dhe u kënaq kur preku leshin e butë. Qengji ngriti kokën nga bari dhe e lëpiu në faqe. Donati i foli me gjuhën e vet, po ç'e do se ai dinte vetëm një fjalë: "Beee". (f.16)
Kujtojmë një episod tjetër, kur Atë Sava fillon të ujitë lulet dhe Donati e pyet i çuditur se ç'bënte ashtu, Negovani shpjegon në vetë të tretë, me fjalët e autorit:
Sava i tha duke qeshur se lulet dhe lakrat, kallinjtë e grurit dhe hardhitë, dushqet dhe lisat, kishin po aq nevojë për ujë, sa kishte Donati për të pirë.
Ndërsa Dedja, më artistikisht e më pedagogjikisht, duke përdorur dialogun, të ashtuquajtën metodë e bisedës sokratike:
- Ti, o Donat, a pi ujë kur ke etje?
- Po.
- Kështu, o biri im, kanë etje dhe kërkojnë ujë edhe lulet, lakrat, kallinjtë e grurit, dushqet dhe lisat, mollët dhe dardhët.
Ose, në f. 85 të Fullanit, Donati pyet për Diellin:
- Ç'është kjo dritë e çuditshme?!
Ndërsa Dedja, duke u futur bukur nën lëkurën e personazhit, shton edhe një pyetje "nga xhepi", sipas parimit pedagogjik për përvetësimin e dijeve "nga e njohura tek e panjohura":
- Ç'është kjo dritë e çuditshme?- pyeti Donati.- Ç'është ky qiri kaq i madh?
Madje Dedja, kur ka rast, mundohet të japë edhe ndonjë njohuri shtesë. Ja, po në këtë episod, kur Atë Sava i shpjegon se Dielli rrotullohet e nuk pushon asnjë çast, ritreguesi ynë shton për atë yll se ai *madje nuk harron të na ndezë edhe Hënën që na bën dritë natën* (f. 21).

5. Përpunim qilizëm ka bërë shkrimtari Dedja në gjuhë.

Në të gjithë tekstin jo vetëm që përdoret më shpesh dalja kryeradhë, por kudo ka vepruar ligji i koncizitetit. Ka paragrafë të tërë të qethur ose të rrudhur. Kështu, bie fjala, në faqet 82 dhe 83 të Fullanit janë hequr fare përkatësisht nga 16 rreshta, në faqen 79 janë hequr 10 rreshta, kurse 7 rreshtat në fillim të kreut III janë rudhur në 1 rresht e gjysmë...
Por le t'u largohemi statistikave. I rëndësishëm është fakti që në ritregim shprehja ka fituar tingëllimë bashkëkohore. Psh.:
[djalin] shpjere në kopsht të marrë erë të qëruar (f. 76) → *çdo ditë ma nxirr në kopsht, në ajër të pastër* (f.6)
Ose:
Të ikurit e atit Savë qe shumë i mallëngjyer (f.102) → Dedja: *Atë Sava u mallëngjye shumë kur iku.* (f.31)
Tëharrja e tekstit është bërë me shumë kujdes, fjali për fjali, duke e sjellë trajtën e tyre në formë më të rregullt:
Natën ra një shi i butë. (f. 76) --> *Një shi i butë ra gjithë natën.* (f. 6) (kryefjala ka zënë kryet e vendit).
Aty ku është parë e domosdoshme janë shtuar edhe fjali apo shprehje të tjera, si: "*... dhe pastaj t'i jepte një dhallë të ftohtë e një kafe për t'u çlodhur*" (f.29)
Renditja e fjalëve apo e fjalive bëhet sipas ngarkesës emocionale. Për shembull, kur Tefta takohet papritur me të shoqin dhe djalin, Negovani vë në gojën e saj:
- O im shoq! O biri im!
Ra në duart e Gjeneralit dhe u shkreh në vaj.
Kurse Dedja:

- O biri im! O, im shoq! – dhe u plas në vaj në krahët e të dyve.
Herë tjetër ndryshon edhe natyra e fjalisë. Kështu, p.sh, fjalinë dëftore "*Biri i gjeneralit s'është më në shtrat të tij*" (f..78), ritreguesi e bën më të ndjeshme, duke e kthyer në dëftore-thirrmore: - *O njerëz! Biri i gjeneralit është zhdukur! Njerëz, e mjera unë! Kush ma rrëmbeu djalkën, o njerëz*! (f.8) (Vini re: është përdorur tri herë fjala *njerëz*, mandej, në vijim, po aty, edhe disa herë të tjera:
- Ndihmë o njerëz!
Njerëzit u sulën për të kërkuar Donatin…)
Në një episod tjetër, kur u gjet djali, Negovani shprehet: *Atëherë u dërmua zemra e vashës prej këtij gëzimi të papandehur e të habitshëm* (f.95). Ndërsa Dedja: *Sa u shkërmoq zemra e vashës nga ky gëzim*! Pra, jo vetëm që fjalia dëftore është kthyer në dëftore-thirrmore, po edhe kallzuesi *u dërmua* (për zemrën) është dhënë më bukur me metaforën folje *u shkërmoq*.
Ritreguesi e ka përpunuar fjalinë, duke i hequr apo duke i shtuar edhe fjalë të tjera. Kështu, në çastin kur sjellin kusarët e arrestuar, në original thuhet: *Përpara qerres ecte shtriga*. (f.101), ndërsa Dedja: *Përpara qerres ecte e lidhur shtriga plakë*. (f.30)
Ose, po në këtë skenë, në original kryekusari *murmuron plot zemërim: "Besonim se asnjeri në botë nuk mund të ishte më i zoti se ne për dinakëri…"* (f.101)
Ndërsa Dedja:
Kryekusari nxorri shkumë nga goja, aq shumë ishte xhindosur:
- Nuk besoja të kishte në botë njeri më të fortë se ne për dinakëri. (f.30)
E pra, mjeshtri Dedja nuk resht së limuari çdo fjali. Ja portreti i gjeneralit në original: *burrë i madh e i hijshëm, me fytyrë të këndshme dhe sjellje gazmore e të ëmbla* (f. 97), kurse ritregimi: *burrë i gjatë me fytyrë të hijshme dhe me sjelljen e një kalorësi zemërmadh* (f. 26).
Dhe kujdesi bëhet jo vetëm me fjalinë, por edhe me fjalën, për të gjetur atë më të saktën, atë që e jep më mirë kuptimin e duhur.
Kështu, për shembull, ndajshtimi "zonjë" i shkon për shtat Teftës e aspak plakës shtrigë, rrëmbyeses së foshnjes. Ndaj, në episodin kur në zgavrën e tyre kryekusari i drejtohet asaj "zonja mëmë" (f.81), në ritregim i hiqet ky titull nderues, dhe kryekusari i drejtohet me fjalët "mëma jonë" (f. 11), mëmë kusarësh medemek; madje Dedja e përdor këtë ndajshtim dy herë për ta përforcuar.
Ja edhe disa shembuj të tjerë ku me fjalën vazhdon e ashtuquajtura *labor limae*:
Kreu 2. *<u>Një</u> mjerim i madh nga <u>një</u> pakujdesi e vogël* (f.76) → *Mjerim i madh nga pakujdesia e vogël* (f.8)

. *Donati ishte ende i vogël, sa s'mund të fliste e të thoshte emrin <u>e tet</u>* (f.75) --> *… e vet*. (Sepse fëmija mëson më parë emrin e vet në jetë, pastaj atë të të atit)

. *Gjenerali ishte plagosur <u>për vdekje</u>* (f. 75 → *rëndë*.

. *Mandatprurësi* (f.75) → *lajmëtari*

. *mëndesha* (f.75) →*dadoja* (sepse Premtja, ishte vajzë e re dhe nuk e mendëte me qumësht gjiri Donatin)

. *qerre* → *karrocë* (Është jashtë logjike të besosh se z. Teftë të ketë udhëtuar me qerre nga kështjella drejt frontit të luftës për të takuar të shoqin, gjeneralin.)

. *mandatarët* → *armëtarët* (njerëzit që z. Teftë dërgoi për të kërkuar foshnjen e rrëmbyer)

. *korë* → *medalion* (sepse Donati atë e mbante të fshehur në gji: kora ka përmasa më të mëdha)

. *u varros* → *u plagos*

. *I ra vilani dhe <u>për pak u përplas</u> në tokë…* (f.79) → *desh u shuk* (f.9)

. *Ditën fshihej nëpër dushqe të dendur, ose në mes të <u>kallinjve të drithit</u>…* (f. 81)
→*… kërcenjve të misrit*

Etj. etj.

Duken si vogëlsira, por nuk është ashtu për një shkrimtar, për një psikolog.

6. Më tej, përpunimi e rikrijimi vazhdon thellë në stil, duke iu përshtatur kërkesave të letërsisë për fëmijë në disa komponentë:

a) Dedja mundohet t'i përmbyllë kapitujt me nga një enigmë, në mënyrë që ta bëjë sa më kureshtar lexuesin e vogël, ta nxisë që të kridhet sa më shpejt në kapitullin pasues. Kësisoj, në f. 94, kreun e dhjetë ekzistues, Dedja e ndan në dy krerë të rinj, duke e vënë gardhin mindis tyre te enigma:

Po pse baresha i kishte sytë të pikëlluar?

Çfarë kishte ndodhur me të? (f. 22)

b) Kur ligjërimi i ndonjë personazhi është i gjatë, Dedja e kalon atë në vetë të tretë, e vë në gojën e autorit. Kështu vepron, për shembull, me rrëfimin e bareshës (f. 94) ose edhe në episodin e hanit, kur ushtarët rrëfejnë peripecitë e Gjeneral Argjendit (f. 97 → f. 25).

c) në ritregim përshkrimi fiton konçizitet e ritëm, dinamizëm:

Gëzimi i përgjithshëm u kthye në të qara e lot. Ulurinin sikur të dilte ndonjë i vdekur nga shtëpia (f.78) → me shkallëzim ngjitës: *Gëzimi dhe hareja në kështjellë u kthyen në të qara dhe lot, në kujë e hidhërim, në ulërima e ofshama.* (f.8)

d) Peizazhet janë dhënë më shkurt se origjinali. Për shembull, paragrafi i f. 84, që fillon me fjalët "*Ishte një mëngjes i bukur përrallor…"* dhe që zë 13 rreshta, është dhënë me 3 rreshta (në f. 16).

e) Dihen përparësitë e dialogut në letërsinë për fëmijë, ai e bën më dinamik ngjarjen. Ndaj edhe mjeshtri Dedja e përdor shpesh atë duke e shtuar edhe aty ku mendon se është i nevojshëm. Për ilustrim mund të sjellim dialogun midis Donatit e bariut, që në orgjinal mungon fare, sepse Negovani e ka dhënë me fjalët e autorit:

- *Si e ke emrin?*
- *Donat.*
- *Nga po vjen?*
- *Nga zgavra… atje ku jetojnë ata njerëzit e liq…*
- *Kush? Kusarët?*
- *Po.*
- *Ku jetojë ata?*
- *Atje në shpellë…*
- *Eja Donat, të ikim me vrap! Ata mund të na rrëmbejnë…* (f. 16)

Madje, edhe shumë monologje (si ai i Muzakës, f. 83) janë kthyer në dialogje (Shih f. 13).

Ndërsa në dialogjet ekzistuese, në përputhje me kërkesat e letërsisë për fëmijë, Dedja i bën më të shkurtra tiradat. Shembull:

Çunit i tha: "Të gëzohesh me gjithë zemër, i dashur Dhonat. Dua të më kesh si babën tënd të përkohshëm, gjer sa të të jap në duar të prindërve të tu të mirë. Që tani mos më quaj më ndryshe veçse at." (f.87)

Kurse Dedja:

- *Qetësohu, biri im, Donat! Mua do të më kesh si baba, gjersa t'i gjejmë prindërit e tu, prandaj më thirr Atë!* (f. 17)

Ose një pasazh tjetër:

Donati, i habitur, përpoqi duart. "Sa shumë ujë, klithi, rrjedh jashtë prej gurit! Duket me forcë! Po nga e marrin dhe cili e shtie këtë që sipër shkëmbit, për të mbushur depon? Duhet mbyllur gryka, që ta kursejmë ujët, se ndryshe do të shterojë." (f. 91)
Në ritregim:
- Oooo! Sa ujë paska këtu! Kush e hedh këtë ujë aty prapa shkëmbit? Ndale, ndale… se mos na mbarohet ujët!(f. 21):
Ndonjëherë, për ta shkurtuar tiradën e gjatë të ligjëruesit, Dedja e ndan atë në dy pjesë. Ja, te rrëfimi i Gjeneral Argjendit për merakun e djalit, Dedja ndërkall diku nga mesi këtë fjali përshkruese të autorit: "*Gjeneral Argjendi mori frymë thellë, psherëtiu për së dyti*" (f. 26). Dhe më tej fillon më vete, në tiradë të re, pjesën e dytë.
Ose, gjithnjë që ta bëjë më të shkurtër dhe më ekspresive tiradën, një pjesë e ligjëratës së drejtë hiqet dhe kalon në fjalët e autorit:

"O Perëndia ime, thërriste duke ndjerë një pikëllim të thellë, cili do të besonte se një pakujdesi kaqë e vogël do të kishte një pasojë kaqë të tmerruar?!" (f. 78) → E përpunuar:

" – Oh, e zeza zonjë! Asaj do t'i pëlcasë zemra!

Asnjeri nuk do të besonte se nga një lajthitje kaq e vogël do të vinte një pasojë e tmerrshme. (f. 8)

f) Gjithnjë në pajtim me kërkesat e letërsisë për fëmijë, është hequr përshkrimi i imët i portreteve.
Ja portreti i At Savës. Në original: *Koka e tij tullace kishte disa qime të rralla. Mjekrën e kishte të bardhë si bora, por faqet e tij ishin si lulet e kuqe, si faqet e djemve të rinj*. (f. 87) → *Koka e atit qe pa flokë, kurse mjekra e bardhë si bora i varej gjer në gjoks.* (f. 17)
Edhe te portreti i Premtes janë hequr prej origjinalit fjalët: *… me shpirt të qetë, tipare të gjalla e të qeshura dhe fytyrë të pëlqyer e të freskët* (f. 76)

Është thënë se kërkesat stilistike të letërsisë për fëmijë më tepër veprojnë në krijimtarinë që u adresohet grupmoshave të vogla të lexuesve. Edhe në rastin tonë, ngaqë ritregimi është bërë në përputhje me kërkesat e teorisë së letërsisë për fëmijë, mendojmë se krijimit sikur i është ulur ca mosha e adresimit që ka patur në përshtatjen e Dh. Fullanit; tani u shkon më për shtat lexuesve të grupmoshës së klasave I-III (cikli i ulët).

7. Në përfundim mund të themi se, me ritregimin e Negovanit, Prof. Bedri Dedja na dëshmon edhe një herë se është jo vetëm teoricien i letërsisë për fëmijë, por edhe një shkrimtar që në praktikën e vet krijuese i ka parasysh kërkesat teorike të saj, duke na dhënë modele përvoje mjeshtërore edhe në përpunimin e teksteve letrare të traditës së Rilindjes. I bën kështu ato të afta e të përceptueshme ndaj një horizonti pritjeje të ri, ndaj lexuesve fëmijë të kohës sonë.

Ne nuk e idealizojmë Bedri Dedjen për ritregimin mjeshtëror që na ka dhënë. Ai ka lënë jashtë edhe ndonjë fjali që meritonte të mos përjashtohej. P. sh. Ajo e f. 98, *Çuni flinte ëmbël porsi qengj dhe dukej si një engjëll i gjallë.* Pyesim veten: përse është përjashtuar kjo fjali? Nga krahasimi me engjëllin i fëmijës që fle?!

Gjatë studimit tonë krahasues na u krijua parandjenja se edhe Dhimitër Fullani, nga ana e vet, do ta kishte thjeshtuar ca nga shprehjet fetare origjinalin, meqë në përshtatjen e tij nuk përmendet fare Perëndia si krijues i botës që na rrethon, ndonëse Donati e pohon vetë se duhet të jetë një forcë e madhe ajo që i ka bërë gjithë këto mrekulli… Kjo hamendje na bëri që të kërkonim origjinalin, botimin e vetë

Negovanit. Ai titullohej: "*I vogëli Donat Argjendi* prej P.H.H.N. [Papa Harallamb Hristo Negovani – shënimi ynë] Sofje. Ndë shtypshkronjet *Mbrodhësia*, Kristo P. Luarasi. 1904". Pikërisht, ishte ky tekst, që, së bashku me shkrime të tjera të Negovanit, u ribotua në përmbledhjen "Papa Kristo Negovani: *Prishja e Hormovës* (vjersha e tregime) Përshtatur nga Dhimitër Fullani. N.Sh. Botimeve *Naim Frashëri*, Tiranë 1960".

Dhe ç'konstatuam?

Novela origjinale e Negovanit ka 15 kapituj. Në botimin e Fullanit -14. Është hequr krejt kreu me numër 10 "*Fort e nxema pyetje edhe fort e ornata përgjigje*".

Me termin "përshtatje" të Fullanit kuptohet vetëm sjellja në gjuhën e sotme të tekstit dhe redaktimi i tij duke përdorur gërshërët. Pra, Fullani i ka ngelur besnik Negovanit, nuk ka shtuar asgjë nga veja, ka bërë vetëm shkurtimet që ia imponontе koha, sistemi totalitarist, ideologjia komuniste, metoda socrealiste. Kështu, i gjithë kreu nr.10 (f. 30-35) që është qethur, bën fjalë për mësimet që merr i vogli Donat nga Atë Sava. Fëmija që ishte rritur në errësirën e shpellës së kusarëve, çuditet me natyrën e ndritshme, me diellin, me botën bimore e shtazore që e rrethon, me qengjin e gjallë, me lakrat e lisat, me kroin dhe shiun. Pyet se cili është krijuesi i tyre. Dhe prifti i mirë, plaku Savë, i shpjegon:

" *...një është ai që i ka bërë të gjitha këto, edhe këtë Gjithëfuqimtar, gjithëurtinë edhe gjithëmirësinë i cili krijoi gjithë këto gjëra, të gjithë botën, i dha edhe njeriut rrojtje, këtë e quajnë Perëndi, është ati i të gjithave*" (f. 32)

Dhe më tej, Donati i falet dhe i është mirënjohës:

"*I dashuri Perëndi! Të falenderoj edhe që më lirove nga e errta shpella ime, edhe që më udhëhoqe te ky njeri i mirë, i cili më tregoi për Ty kaq gjëra të bukura e të ngazëllyera!*" (f. 34)

E pra, janë jo vetëm shprehje të tipit "*Ah, Perëndia im!*" (f.45), "*Kjo është punë e Perëndisë... Perëndia edhe këtu tregon fuqinë e tij duke shpëtuar të pavenyrin edhe duke munduar të fajmitë*" (f.51), "*Paqa e Perëndisë qoftë bashkë me ju! Në qiell prapë përsërishikohemi..."* (f.53) etj., po edhe paragrafë të tërë që u ka rënë gërshëra, si në f.7, 46, 47, faqe të tëra, si ajo 49, apo edhe krerë të plotë, siç përmendëm më sipër.

Ne nuk mund të jemi dakord edhe me vërejtjet e kritikës socrealiste për këtë krijim: "*Vlen të theksohet këtu se Papa Kristoja, kur do të japë njohuritë mbi botën, mundohet t'i trajtojë ato shkencërisht [...]; po gjithë ky trung i shëndoshë cënohet në fund nga ideja mbi krijuesin. [...]; pasi i ka analizuar nga pozita materialiste fenomenet në natyrë, papritur Negovani del te perëndia që krijoi çdo gjë, që ne nuk mund ta shohim, po ai na sheh gjithkund dhe drejton fatin tonë. Të gjitha këto duket sikur nxirren me zor të madh* […] " [63]) Jo. Negovani nuk i shpjegon nga pozita materialiste ndërtimin e natyrës dhe nuk del papritur te Perëndia. Kjo përshtypje të krijohet nga cungimet që përmendëm në botimin e Fullanit; nga gërshëra që ka rënë në krejt kreun nr.10 e më tej.

Materialisti Dedja ka shkuar, tërë kujdes, edhe më tej, duke tëharrur madje edhe Fullanin, duke eleminuar fare Perëndinë dhe, në vend të saj, duke futur si krijuese të

[63] Pandora Dedja: Novela e parë shqipe për fëmijë "I vogli Donat Argjendi" e P.K. Negovanit – PROBLEME TË TRADITËS DHE TË AKTUALITETIT NË LETËRSINË TONË PËR FËMIJË, "N. Frashëri", T. 1976, f. 69

gjithçkaje… *Natyrën*, term ky që në original nuk haset fare. Kjo vënie dorë në idetë religjionale që autori mëton t'i kumtojë lexuesit fëmijë, e ka denatyruar priftin Savë në ritregim, çka lë edhe shteg për debat. Në fillim të këtij shekulli, në epokën e Demokracisë, kur nuk ekzitojnë më kufizimet ideore allakomuniste, mendojmë se Bedri Dedja jo vetëm që nuk duhet të ishte bërë "nun" i Fullanit, por, përkundrazi, medoemos duhet t'i ishte drejtuar edhe burimit kryesor, vetë botimit të Negovanit, dhe të mos ia hiqte thelbin ideor novelës të tij…

Edhe diçka tjetër. Dedja nuk ka mundur ta evitojë deri në fund një inkonseguencë të origjinalit (si dhe të përshtatjes së tij nga Fullani) në lidhje me bariun që e gjen Donatin dhe e dërgon te Atë Sava, të atin dhe vëllanë e tij të vogël.

Ai që e gjen Donatin e arratisur dhe ia dorëzon priftit Savë është "*një bari i bukur, djalosh llastar me faqe të kuqe dhe me flokë të verdha…*" (Fullani, f.85). Pasi e mban dhe e mëson disa muaj, Atë Sava "*kishte thirrur atin e djaloshit , që i kishte shpënë djalin*" Më tej prifti me Donatin udhëtojnë nëpër male. Diku pushojnë. "*Erdhi te këta çuni i vogël i bariut që t'i puthë dorën atit Savë*". Këtu nuk del qartë nëse ky fëmijë është ai që gjeti Donatin apo vëllai i tij. Madje, ka edhe një moment të bukur: "*Donati i vogël kërceu përpjetë e thirri me çudi të madhe: "O, ja një njeri i vogël si unë! Sa bukur! Paska edhe njerëz të tjerë të vegjël.*" (f.93). Më tej prifti e Donati takojnë e njihen me Premten, që, pas humbjes së Donatit, ishte larguar nga kështjella dhe kishte hyrë bareshë. Të tre kalojnë një natë te kasollja e fshatarit. "*Bariu i vogël i dhive… mori përsipër të ruante dhentë e Premtës […] Ati Savë, Dhonati dhe Premtja, të shoqëruar nga bariu i vogël, vazhduan rrgën e gjatë […] ikën me një qerre të ngarkuar që dinte ta ngiste mirë djaloshi.* (f.95) Këtu nuk del qartë se cili është ky djalosh që i shoqëroi; mesa duket është ai që gjeti fillimisht Donatin. Ky personazh na del edhe në faqen e fundit të novelës: *Djaloshi malësor, si mori prej Gjeneralit plot dhurata, u kthye tek prindët e vet*. (f.102)

Në përpunimin e tij, edhe Dedja po kështu thotë që Donatin e arratisur e gjeti një djalosh bari. Më tej, në udhëtimin nëpër male, Prifti me Donatin e takuan rishtazi mikun e tyre. "*Bariu i vogël ndenji për të ruajtur dhentë e Premtes […] (f.23) Atë Sava, Donati dhe Premtja […] vazhduan rrugën e gjatë, të shqoqëruqr nga malësori* "(Dedja, f. 31). Pra, Dedja, duke e hequr fare atë pasazh të bukur të habisë së Donatit nga fëmija i vogël, e redukton fare si personazh atë; te ai Donati takohet vetëm me mikun e tij të dikurshëm, kurse për t'i shoqëruar udhëtarët drejt kështjellës vë të atin e djaloshit bari, malësorin. Por në faqen e fundit të novelës së tij, përsëri kemi një ngatërresë. Dedja shkruan se bujtësit, pasi dorëzuan djalin në kështjellë, ndenjën dhe ca ditë dhe ndahen: "*Malësori dhe i biri i tij* (!!!), *bariu i vogël, gjithashtu u ngarkuan me dhurata, morën qerren dhe iu ngjitën malit*" (Dedja, f. 31).

KREU III

LETËRSIA SHQIPTARE PËR FËMIJË NË DY-TRI DEKADAT E PARA TË SHEKULLIT XX

(PARA E PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË)

3.1 Tablo panoramike
3.2 Ndihmesa në letërsinë për fëmijë e Anton Xanonit
3.3 Ndre Mjeda – mjeshtër i vargut poetik
3.4 Asdreni – poeti i natyrës dhe i kushtrimit luftarak për liri
3.5 Luigj Gurakuqi – pionieri i qytetërimit perëndimor

3.1 Vështrim panoramik

Një varg kryengritjesh çlirimtare në Veri dhe në Jug të vendit si dhe shpallja e Pavarësisë Kombëtare më 1912 dëshmojnë përpjekjet e mëdha të rilindësve tanë të cilët ishin mësues, ideologë si dhe pjesëmarrës aktivë në lëvizjen e armatosur.Vetë këto probleme të mëdha të jetës shqiptare si dhe shpirti liridashës i shqiptarëve ushqyhen me tema, detaje e motive edhe letërsinë shqipe për fëmijë.

Në dhjetëvjeçarët e parë të shekullin XX letërsia shqipe për fëmijë nuk njohu ndonjë vepër letrare të spikatur. Vazhdonin të shkruanin ende në dekadat e para të shek.XX disa nga përfaqësuesit më në zë të Rilindjes sonë Kombëtare, si: Çajupi, Asdreni, Fishta, Mjeda, Gurakuqi, Xanoni, J.Bageri etj. Në krijimtarinë e tyre letrare ende vihej re fryma romantike e ekzaltimit të dashurisë për Atdheun, për natyrën e Gjithësinë, por, herë-herë. Në tërë krijimtarinë e kësaj periudhe dashuria për Atdheun ishte e lidhur me dashurinë për gjuhën dhe përpjekjet e mëdha për çeljen e shkollave shqipe, jehonën e luftërave për liri dhe pavarësi, si edhe me përshkrimin e natyrës, të zogjve dhe luleve si dhe me botën fantastike–përrallore që ushqente letërsia botërore.

Ndër poetët dhe shkrimtarët e shquar,që lanë gjurmë në letërsinë për fëmijë qysh nga shekulli XIX, ishin edhe Gj.Qiriazi, A.Xanoni, N.Mjeda dhe J.Bageri, të cilët në krijimet e tyre për të vegjël dhanë mbresa dhe përjetime që ndikuan në botën emocionale të fëmijëve.

Të kushtëzuar nga rrethanat historike të jetës shqiptare të kohës (psh; lufta çlirimtare për pavarësi) ende në këtë periudhë, në krijimtarinë për fëmijë, ndihen motivet atdhetare dhe pasqyrimi i historisë kombëtare, periudha e Skënderbeut. Duke mbartur këto tipare, tërë kjo letërsi artistike u zhvillua në shërbim të shkollës shqipe për edukimin atdhetar dhe etiko-moral të nxënësve.

Një pjesë e madhe e kësaj krijimtarie letrare është përfshirë në tekstet shkollore, duke shërbyer si lexime jashtë klase dhe për mësimin e gjuhës amtare.

Pas Gjergj Qiriazit në letërsinë shqipe për fëmijë shfaqet një prej përhapësve të gjuhës shqipe dhe arsimit kombëtar, poeti dhe publicisti **Josif Bageri** nga Reka e Dibrës, i cili krahas vjershave, copëzave letrare dhe folklorit që botonte në revistën e tij "*Shqypja e Shqipnisë*" (në Sofje të Bullgarisë), nxori në dritë vëllimin me vjersha"*Kopsht malësori*"(1910).

Qysh në parathënien e këtij botimi poeti i këshillonte shqiptarët që të rrisin vetëdijen kombëtare tek fëmijët, të kultivojnë qytetërimin dhe kulturën kombëtare duke u rrënjosur atyre dashurinë për vjershat, përrallat, dituritë. Ai e shikon poezinë për fëmijë si një "ilaç" që shërben për mjekimin e sëmundjes së padiurisë që zotëronte në mjaft vise të Shqipërisë.

Libri, thotë poeti, u ndriçon fëmijëve jo vetëm mendjen por edhe shpirtin dhe zemrën. Aq më shumë që ne, shqiptarët, nga padituria anadollake e pushtuesve otomanë e kemi vendin "ndë errësirë", prandaj lipset dituria për fëmijët dhe për qytetërimin e kombit.

Në copëzat letrare dhe vjershat e tij, poeti Josif Bageri shpalos botën e thellë shpirtërore të fëmijëve nëpërmjet botëpërjetimeve të frymëzimit të vet, duke i kënduar natyrës dhe stinëve,shtëpisë dhe familjes që rrit dhe edukon fëmijët, por edhe mjediseve shqiptare ku lind dhe rritet trimëria dhe dashuria.

Për herë të parë në vëllimin poetik për fëmijë të Josif Bagerit na shfaqen portrete figurash epike dhe historike si ai i Bajram Currit, kreshnikut legjendar të malësisë sonë, Naim Frashërit, poeti që i këndon me dashuri atdheut; si dhe mjaft luftëtarëve dhe martirëve të rënë në luftërat për liri e pavarësi. Në ciklin e vjershave për nënën dhe babanë Josif Bageri krijoi tipin e një poezie të re ku vetë fëmija dialogon, kuvendon me njerëzit më të dashur të tij,babanë, nënën, motrën,vëllanë.

Në mjaft vjersha të tjera për stinët, sidomos ajo kushtuar pranverës, shpaloset peizazhi dhe bukuria shqiptare. Në to ndihen edhe nota gëzimi e besimi, pasi poeti dëshiron t'u tregojë fëmijëve që vendi më i dashur në këtë botë është vendlindja, Atdheu. Në mjaft vargje poetike Josif Bageri u tregon fëmijëve edhe plagët e shoqërisë shqiptare.

Në vargjet e vjershës *Vajtim e mallkim* poeti bashkëbisedon me fëmijët për rolin e tyre të madh në jetën shoqërore shqiptare. Ai pohon me të drejtë se edhe fëmijët, me ndjenjat dhe botën e tyre, mund të ndikojnë në

vëllazërimin e shqiptarëve, sidomos në përpjekjet e tyre për të shmangur vëllavrasjen, përçarjet dhe intrigat që helmojnë shoqërinë.

Ashtu si Naim Frashëri, A.Z.Çajupi e Ndre Mjeda, edhe Josif Bageri kërkon bashkimin e shqiptarëve për "mbrothësinë" dhe qytetërimin e kombit, pasi ai u flet fëmijëve me një zë të zjarrtë, duke iu treguar atyre krenarinë kombëtare dhe traditat e të parëve.

Një botë të thellë poetike përjeton edhe vjersha *Reka-vendi im*, vjershë ku ndihet malli i thellë për vendlindjen në Dibër si pjesë e Atdheut. Shpeshherë në vargjet e poetit Atdheu personifikohet e pikturohet me ngjyra të bukura, me zë kushtrues dhe prijësa heroikë që kanë dhënë ndihmesë edhe për popujt të tjerë të Europës.

Josif Bageri, ashtu si rilindësit e tjerë, në mjaft vjersha si: *Msoni gjuhën e vet* dhe *E ama dhe i biri*, i këndon shkollës shqipe si vatra e dijes dhe diturisë së shqiptarëve.

Nëpërmjet bashkëbisedimit midis nënës dhe birit tek vjersha *E ama dhe i biri*, fjalët e urta dhe të mençura të nënës shprehin dhe dëshirën e vërtetë të shqiptarëve që fëmijët të bëhen të ditur në shkollë dhe kalorës të lirisë:

Kështu bir bota msojn
Dhe shum thell kta mendojn;
Gjith se c'ka ne këtjetë,
Kta me msim i kan gjet.

Përcjellja e ideve të tilla janë bërë nga poeti me qëllim të ngulitet në botën shpirtërore të fëmijëve, roli i shkollës në shërbim të atdheut. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe vëllimi poetik *Kopsht malësori*, i cili ka patur përhapje të gjerë jo vetëm në Dibër, Tetovë, Shkup, Manastir, por edhe në Myzeqenë e Fierit, në Vlorë, Shkodër, Durrës, Elbasan. Bageri i hartoi vjershat nen ndikimin e folklorit popullor.

Në letërsinë shqipe për fëmijë në gjysmën e parë të shekullit të XX dhanë kontributin e tyre të shquar edhe mjaft mësues të cilët krijuan përralla për të vegjël duke i praktikuar në shkollë.

Ashtu si Anton Xanoni, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda e të tjerë mësues-poetë, edhe A.Asllani, V.Harxhi, J.Minga, A.S.Drenova(Asdreni), L.Skëndo e Gjergj Fishta na shfaqen shpeshherë në shtypin e kohës si edhe në librat e këndimit me copëza letrare e vjersha, të cilat u këndojnë atdheut, lodrave të të vegjëlve si dhe shpirtit liridashës të fëmijëve.

Letërsia shqipe për fëmijë u pasurua më tej edhe me rrëfenjat e **Lumo Skëndos** (Mithat Frashërit) të botuara në librin me titull *Hi dhe shpuzë (*Sofje, 1915*)* ku autori i drejtohet sidomos brezit të ri, apo me përrallat e shkruara nga **Faik Konica** me një kulturë të thellë gjuhësore e letrare. Disa nga krijimet e Konices shërbejnë si lexime për moshat e njoma. Përmendim, për shembull, prozat poetike *Anës liqenit*, *Në liqen*, *Malli i Atdheut*, etj. Konica ka shkruar tri përralla: 1. *I urti i Malit*, 2. *E bija e mbretit dhe*

trëndafilit, 3. *Tërkuza*. Ato janë të shkurtra, kanë domethënie të qartë, humane, madje edhe me elemente patriotike. Siç vlerëson studiuesi Prof. Nasho Jorgaqi, *me një subjekt oriental s'është e vështire të thurrësh një përrallë, por Konica, falë aftësisë kreative të artistit të vërtetë, ndjenjës së hollë, sensit të masës dhe muzikës së gjuhës, ka krijuar një kryevepër në llojin e vet*[64].

Po ashtu përmendim mjaft vjersha e lexime për fëmijë të hartuara nga **Gjergj Fishta**, poeti i madh kombëtar, i quajtur ndryshe edhe Homeri shqiptar. Fishta nuk shkroi për fëmijët. Veç shumë nga vjershat e tij u bënë këngë që u kënduan nga i madh e i vogël dhe hynë në tekstet shkollore. Nëpërmjet dashurisë për gjuhën shqipe, ai u edukon fëmijëve dashurinë për kombin :

Porsi kënga e zogut t'verës,
Qi vallëzon m'blerim të prillit,
Porsi i ambli fllad i erës
Qi lmon gjit e drandafillit;
Ashtu është dhe gjuha jonë amtare.

Në këto krijime ndihet koncepti origjinal i poetëve dhe shkrimtarëve që gjithnjë e më shumë i afrohet botës së fëmijëve. Me të drejtë kritika letrare ka vënë në dukje se vlera të veçanta në letërsinë shqipe për fëmijë në fillim të shekullit XX ka përftuar edhe krijimtaria e **A.S.Drenovës,** në të cilat jepen tablo të gjera të jetës shqiptare me mjeshtëri artistike.

Ky nivel i ri artistik në letërsinë për fëmijë u pasua edhe nga krijimet e **Hil Mosit** (sidomos vjershat por edhe këngët e tij shkollore) si *Eja verë, Djali shqiptar etj*, të cilat u mësuan përmendsh nga fëmijët shqiptarë. Në shërbim të arsimit tonë kombëtar ka qenë edhe krijimtaria e **Milto Sotir Gurrës** *Rrëfenja* (1911). Kjo dëshmon për një përpjekje tjetër serioze për pasurimin e letërsisë për fëmijë e të rinj.

Gjithsesi, tabloja e letërsisë shqipe për fëmijë në fillim të shekullit XX dëshmon për kujdesin e shkrimtarëve dhe poetëve që arritjet e letërsisë romantike të zhvilloheshin e të kultivoheshin më tej.

3.2 Ndihmesa në letërsinë për fëmijë e Anton Xanonit (1862-1915)

Atë Xanoni, së bashku me poetin e gjuhëtarin e shquar Ndre Mjeda ishte anëtar aktiv i shoqërisë letrare *Agimi,* themeluar më 1901, e cila punonte për nxitjen e krijimeve letrare në gjuhën shqipe, duke përdorur edhe një alfabet të ri.

Studimet fetare i bëri jashtë. Më 1893 u kthye në Shkodër, ku shërbeu si mësues nëpër shkollat e mesme fetare derisa vdiq. Xanoni pati interesim të veçantë për poezinë: përktheu disa ekloga të Virgjilit, përktheu e përshtati poezi e fabula të ndryshme për nevojat shkollore, shkroi edhe disa poezi patriotike.

[64] Nasho Jorgaqi, Paraqitje [parathënie e librit "Faik Konica – Vepra", Tiranë, 1993], f. 27

Në qendër të kësaj krijimtarie ishin evokimi i luftërave dhe bëmave të Skënderbeut, përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe pavarësi, si dhe te adhurohej gjuha shqipe. Fillimisht së bashku, Anton Xanoni dhe Ndre Mjeda u shfaqën në letërsinë shqipe me tre librat "*Këndime për shkollat e para të Shqipnisë*", botuar në Shkodër më 1904-1911.

Këto tekste mësimore dallohen për dashurinë e thellë të poetëve për fëmijët dhe arsimin kombëtar, pasi të dy autorët ishin ndër organizatorët e Kongresit të Manastirit, dhe derdhën talent në përpjekjet e shqiptarëve për krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Edhe në faqet e këtyre teksteve ka mjaft vargje poetike të cilat japin tablo të dashurisë për Atdheun por edhe të dhimbjes për të, pse ende ishte i robëruar nga pushtuesit e huaj. Krahas saj në mjaft vargje jepet dashuria për prindërit dhe mësuesit, për shkollën dhe bashkëmoshatarët.

Veçanërisht Xanoni u shqua si fabulist. Tek e përmuajshmja fetare *Elcija*, në vitet 1902- 1910, botoi disa fabula origjinale ose të përshtatura, poezi e artikuj me karakter dituror.

Te fabulat origjinale ai tregoi një aftësi të veçantë, për të krijuar ambientin dhe personazhet shqiptare. Qe shumë i kujdesshëm për teknikën e poezisë e dha shpesh modele shembullore strofash e metrash. Përmendim fabulat interesante: *Rrena*, *Ujku*, *Këshillë e mikut* e ndonjë tjetër të cilat shquhen për muzikalitetin e vargut dhe përcjelljen e mesazheve etike dhe morale.

Fëmija: Rrena, moj nane, si asht ba?
A shifet? A përkitet?
A thue prej gojet qitet?
A i ngjan asaj ndoi gja?

Nana: A e di se c' asht? Asht kore,
Asht nji gjasend i ndytë,
Nuk mund ta shofin sytë,
Nuk mund ta preksh me dorë[65].
(Rrena)

Xanoni është autor i teksteve: *Gramatika shqype* (1903), *Shkurtorja e historisë së moçme* (1910), *Prisi ne lamë t'literatures* (1911) dhe i veprave letrare: *Llogoret e mullinjve, Skënderbeu* (drame), si dhe i shqipërimeve *Muzhikatari i verbër, Gjenovefa, Mësimet e plakut*.

Krijimet në vargje të Xanonit, pas Clirimit, të mbledhura e të redaktuara nga Mark Gurakuqi, u botuan në vëllimin *Vjersha për të vegjël* (1967), ndërsa proza e tij së bashku me atë të Mjedës, u botuan në një vëllim të përbashkët me titull *Agimi* (1962, kallëzime).

Në parimet pedagogjike të hartimit të këtij libri, vjershat, fabulat dhe rrëfimet janë të organizuara sipas moshës së fëmijëve, që autorët e njohin mirë, pasi një kohë të gjatë janë marrë me çeljen e shkollave shqipe,me përparimin e arsimit kombëtar.

[65] Poetë të Rilindjes, Tiranë, 1973, f. 257

3.3 Ndre Mjeda – mjeshtër i vargut poetik

Krijimtarinë për fëmijë Ndre Mjeda (1866-1937) e nisi me vjershat që u përfshinë në librat shkollore duke dhënë ndihmesë të shquar për shkollën shqipe, si dhe duke pasuruar më tej letërsinë për fëmijë. Shkrimet e Mjedës për të vegjëlit, karakterizohen nga zgjerimi i tematikës dhe i problematikës shoqërore, thellimi i realizmit, pasurimi i figurave dhe i mjeteve shprehëse, gjë që solli forcimin e notave lirike në vjershat për fëmijë.

Një ndihmesë të veçantë Mjeda ka dhënë për alfabetin e gjuhës shqipe. Hulumtuesi pasionat Dr. Mentor Quku[66], gjatë gjithë shtrirjes së veprës në fjalë i provon me dokumente bindëse punën këmbëngulëse njëzetvjecare të Mjedës për një alfabet shkencor dhe praktik për të gjithë shqiptarët dhe në mënyrë të veçantë rolin e tij të shquar në punimet e Kongresit të Manastirit.

Në vitin 1901, së bashku me të vëllanë, Lazer Mjedën, kryepeshkop i Shkodrës, krijuan shoqërine letrare *Agimi*. Ajo kishte alfabetin e vet, me të cilin u shtypën edhe disa tekste shkollore (*Këndime për shkollat e para të Shqypnisë*, 1904-1911) në kohën e pushtimit osman dhe që u ribotuan disa herë deri në vitin 1927. Në hartimin e tyre Mjeda bashkëpunoi me shkrimtarin Anton Xanoni.

Në vjershat e tij për të vegjël shpaloset një peizazh madhështor e i mrekullueshëm i Atdheut, por dhe dashuria e fëmijëve për të. Vjershat e Mjedës kanë brendi edukative dhe formë të larmishme. Nëpërmjet tyre autori përpiqet të fisnikërojë shpirtin e të vegjëlve, t'i aftësojë ata që të çmojnë të bukurën, të dobishmen dhe të moralshmen në jetën e njeriut. Megjithatë, mendimet, ndjenjat, idetë dhe mësimet morale jepen në mënyrë tërheqëse, me gjuhë të saktë, figura të thjeshta dhe detaje shprehëse. Ndër krijimet më të arrira janë vjershat që u këndojnë bukurive të natyrës së vendit tonë dhe stinëve të motit. Ato përftojnë tek të vegjlit dëshirën për të admiruar hijeshitë e natyrës e për të shijuar nga afër bukuritë e saj mahnitëse.(*Pranvera, Mbrrini vera, Filloi toka m'u përtri, Vera, Vjeshta, Dimni e plaku, Mbramja* etj.). Poeti nuk përshkruan vetëm stinët, por i lidh me njerëzit, me mendimet e ndjenjat e tyre. Përmendim vjershën *Pranvera* e cila mbyllet me këtë strofë kuptimplotë:

Ndeje bri votres njeri myket:
Vrapo, bulk, ku puna t'therret;
Tue vrue fushën kau bërlyket,
Lyp m'u vu për laver t'vet[67].

Në këto si dhe në vjershat *Puna, Një qortim, Guxo* etj., që frymëzohen nga motivi i punës, poeti i thurr himn veprimtarisë njerëzore, si mirëqenies së njerëzve të thjeshtë dhe punëtorë, të cilët nuk e kalojnë kohën kot, por përpiqen që t'i rrëmbejnë natyrës, me mund e djersë, gjithçka të mirë e të dobishme për jetën e tyre. Puna është burimi i gjithë të mirave. Në vjershën *Guxo!*, për shembull, puna ngrihet në lartësinë e heroizmit dhe të guximit, si burim i vetëm i lumturisë së njeriut në jetë:

[66] Mentor Quku, "Mjeda- 3" libri i parë Alfabeti (1899-1912)
[67] Ndre Mjeda, "Poezi", Tiranë, 1978, f. 46

Tue u talle e tue pertue,
Asnjë send nuk del në dritë!
Çfarëdo gjë që të fitosh,
Timni lypset e guxim![68]

Çdo qënie e gjallë punon, thotë autori. Punojnë bletët, thneglat, dallëndyshet. Ai ka respekt të veçantë për punëtorin, detarin të cilët me punën e tyre sjellin begati. Edhe te vjersha *Puna*, duke përdorur paralelizmin figurativ, Mjeda tregon për punën e vështirë dhe shqetësimet e punëtorit të bujqësisë:

Bleta punon gjithë ditën,
Tue rrmue me thithm ndër lule,
E kësaj e asaj ia ngule
Me mbush fashojt e vet.

Djersit në diell punëtori,
Krrut mbi parmenë me qe,
E prish njat t'lumin dhe
Q'i ditë gjallnin i qet.

Krahas tyre, tematika e poezisë për fëmijë te Mjeda pasurohet e zgjerohet me motive të tilla për stinët dhe zogjtë, për shkollën dhe mësuesit, por edhe për dukuri të tilla që ngjallin humorin tek fëmijët, ndihma ndaj shokut, ndihma ndaj të moshuarve etj. Te vjersha *Dashnia ndaj prindet* ai shkruan:

Bab' e nan', sa keni derdhe
Mbi shteg tem hire e dritë.
Ah! Sa mirë m'keni gatitë
Për çdo koh' e për çdo vend...

E më poshtë thekson se janë ata që i kanë ndezë në zemër flakën për punë të larta e për lumturi.

Në vjershën *Ndera e fëmijëve për mjeshtra* (mësues), poeti rreshton të gjitha meritat e edukatoreve. E nxënësit e tyre, me mirënjohje, do të ndjekin rrugën që u kanë treguar ata:

Te ju, qi lodheni me ne gjithë ditën
Kjo mëndje e vorfën, kjo zemër shkon:
E sa t'kem shpirtin, sa t'shofim dritën,
Dashninë e nderen gja s'na i pakon.

Dashuria e fëmijëve për prindërit, si dhe dashuria e prindërve për fëmijët, është një ndjenjë e bukur, e thellë dhe e pastër. Gjithashtu duhet të theksojmë që autori ndjen keqardhje për njerëzit e varfër që përpiqen t'u bëjnë ballë vështirësive të jetës. Kjo gjë vihet re sidomos në vjershën *Vera*, ku flitet për një vajzë fatkeqe që korr grurin e vetmuar, sepse ka mbetur pa të dashurit e saj. Këtu kemi të bëjmë me një përshkrim realist të realitetit shqiptar të asaj kohe:

[68] Ndre Mjeda, "Dimri dhe plaku", Tiranë, 2002, f. 24

Veç n'atë arë, porsi nji e tretun,
Zi ndër petka e në fëtyre terr,
Korre nji cucë pa shoqe, vetun
Me hije t'vet qi prapa e merr.

Tjera herë ti vete e treta
Korrshe, o bijë, me motra n'shend
Sivjet vetëm tue korre t'gjeta
Pa nji motër, pa gazmend[69].
(Vera)

Mjaft e fuqishme tingëllon në këtë vështrim veçanërisht vjersha *Dimni*, ku përshkruhet me realizëm gjëndja e plakut, i cili ka rënë në hall të madh me të ftohtin dhe stuhinë.

Nëpër fushë e nëpër male
Fryn murlani me stuhi;
O murlan, at frymën ndale,
Ndalu,akull,mos më ngri;
Mos ma ngrini këthough pik gjak.
Srtuku,struku i shkreti plak[70].

Ndre Mjeda i kushtoi rëndësi të veçantë gjuhës shqipe. Kështu si Naimi, që i këndoi gjuhës amtare, u frymëzua nga idealet e kohës dhe shkroi vjershën *Gjuha shqipe*. Në këtë poezi, me mjeshtëri të veçantë, ka gërshetuar me forcë historinë e një kombi dhe fizionominë shpirtërore të një populli, me heroin (Mjedën), apo studiuesin e përkushtuar të gjuhës shqipe, dhe së fundmi shpirtin optimist të tij që ka shperthyer në përbetim, për të qenë një bir i denjë i atdheut:

Përmbi za që lëshon bylbyli,
Gjuha shqipe m'shungullon,
Përmbi erë që jep zymbyli
Pa da zemrën ma ngushllon[71].

Autori e krahason gjuhën tonë të dashur me zërin e bilbilit, por edhe me aromën dhe me bukurinë e zymbylit. Natyrshëm, ai e lartëson gjuhën shqipe, sepse tingulli dhe pa dyshim freskia e saj ia kalon bilbilit dhe zymbylit me mjetin letrar te krahasimit, që përdor autori, vlen për të bërë më tepër efekt. Por edhe lidhet shumë më mirë me ndjenjën e çdo shqiptari për gjuhën amtare (duke edukuar tek fëmijët) sepse logjikisht, për vetë rrethanat e kohës, gjuha shqipe, gjuha e nënës, për të cilën ishte sakrifikuar e derdhur gjak nga rilindësit, i duket shumë e bukur, më e bukur, se çdo gjuhë tjetër në botë.

Një vlerësim i tillë është real, sepse që në fëmini çdokush nga ne, është rritur, është përkedhelur me dashuri të veçantë nga nëna, është mëkuar me historinë e popullit, e

[69] Ndre Mjeda, "Poezi", Tiranë, 1978, f. 47
[70] Po aty, f.49
[71] Ndre Mjeda, "Poezi", Tiranë, 1978, f. 18-19

në veçanti, me madhështinë e Shqipërisë, prandaj Mjeda i këndon gjuhës edhe në mënyrë të veçantë, në raport me fatin e vet, fatin e një të mërguari:

Ndër komb'tjera, ndër dhena tjera,
Ku shkoj jetën tash sa mot,
Veç për ty m'rreh zemra e mjera,
e prej mallit dredhi lot.

Ndre Mjeda, duke u mbështetur edhe në traditën e pasur folklorike shqiptare, për të përcjellë tek fëmijët urtësi dhe mençuri, ka thurur edhe disa fjalë të urta, si:

Ari me zjarrm provohet
Miku n'rrezik kuptohet.

Kush prej deke e kap ikën
Shi n'rrug't'madhe shpesh gjen pikën.

Nieri i lehtë
Mba kryet përpjetë.

Këta distikë, të ndërtuar sipas strukturës popullore, përcjellin mendime që mbeten në mendjen e fëmijëve.

Mjeda përdor në poezinë e tij për fëmijë, lirikën edukative apo moralizuese, fabulën dhe enigmën. Ai shfrytëzon poezinë gojore dhe ka një gjuhë të qartë, të rrjedhshme e të pasur.

Kështu një vend të veçantë zënë dhe gjëegjëzat (kashelashat), të cilat kanë nxitur dhe do të nxitin ngahera kërshërinë e të vegjëlve. Gjëzat të tërheqin, sepse paraqesin një bote reale, konkrete dhe, në të njëjtën kohë, nxitin fantazinë, të vënë në lëvizje, të bëjnë të mendosh. Këto vjersha-gjëza janë shkruar shkurt, zakonisht me katër, gjashtë ose tetë vargje, dhe japin me figura të zgjedhura karakteristikat e sendit që duhet të njohë fëmija. Kështu, për qiriun, Mjeda shkruan:

Dhjamë kam trupin, pambuk shpirtin
Nji flak' t' vogël kam mbi krye
Gjithkujt dritën tue shkëlqye
I jap, emnin kush ma di?

Të gjitha krijimet e tij poetike nuk i kalojnë tri-katër strofat. Dhe me kaq pak vargje ai ia arrin me sukses të japë përmbajtjen, të transmentojë emocione te lexuesit e vegjël, t'u zgjojë mendime.

Në krijimtarinë poetike të Mjedës për fëmijë duhet të përmendim edhe **fabulat** e tij. Numri i tyre është i vogël, rreth pesëmbedhjetë. Nismën ato e marrin nga gurra e La Fontenit, ajo e Ezopit, nga thesari ynë popullor etj., por ndryshojne shumë prej tyre[72]. Për shembull krahasojmë, fabula *Mini* ka ngjashmëri me atë të Ezopit apo të La Fontenit. Po atje miu i fushës shkon në qytet e anasjelltas, dhe asnjërit nuk i pëlqen

[72] Veli Veliu,"Fabula shqiptare e periudhës së Rilindjes", Shkup, 1993

jeta e tjetrit. Kurse te fabula e Mjedës miu i fushës nuk arrin të kthehet në vendin e vet, pasi në qytet bie në thonjtë e maces. Dhe porosia e Mjedës është:

Atë rrugë, ku mir' jeton
N' e ndrofsh pa arsye, gabon.

Fabulat e Mjedës janë të shkurtra, të pangarkuara me shumë detaje, zbukurime e dialogje. Në anën strukturore ato nuk ndryshojnë fort nga poezitë e tjera: ndahen në strofa, gjë që nuk është praktike e fabulistëve klasike dhe e atyre shqiptarë. Porosia morale është gjithnjë koncize dhe jepet me një strofë dyvargëshe.

Disa nga krijimet që u shkruan posaçërisht për fëmijë, si dhe disa që Mjeda shkroi për të rritur por që u përfshin në leximet letrare për dhjetëra vjet (si: *Gjuha shqipe*, *Vaji i Bylbylit* etj), u përmblodhën nga Mark Gurakuqi në vëllimin *Guxo* (vjersha, 1953, ku disa vjersha i janë atribuar gabimisht Mjedës, pasi ato janë të Xanonit). Më tej me to u botuan edhe: *Agimi* (kallëzime, 1962, me bashkautor Xanonin), *Vjersha për të vegjël* (1967), *Poezi të zgjedhura për fëmijë* (1975), *Zambakët* (vjersha, gjëegjëza, fjalë ari, 2000) etj.

Në vjershat për fëmijë të Mjedës notat didaktike dhe moralizuese nuk ndihen aq të forta sa në krijimtarinë letrare të rilindasve të tjerë. Përpjekja për të paraqitur mendimet dhe ndjenjat e heroit lirik për jetën çoi në forcimin e lirizmit dhe në pasurimin e figuracionit shprehës.

Mjeda është mjeshtër i vargut; ai ka aftësinë që me pak vargje, të shkurtra, me gjuhë të pastër e me figura të zgjedhura, t'u ngjallë mendime dhe emocione lexuesve të vegjël, të gjallërojë fantazinë e tyre dhe t'i edukojë.

3.4 Asdreni – poeti i natyrës dhe i kushtrimit luftarak për liri

Aleksandër Stavre Drenova (1872-1947), i njohur në letërsinë tonë me pseudonimin Asdreni qe nga ata poetë krijimtaria e të cilëve u përket njëherësh dy periudhave. Poezia e tij u shtri që nga faza e fundit e Rilindjes deri në periudhën e Pavarësisë, një veprimtari e gjatë letrare, prej më se dyzet vjetësh. Në vitin 1900 filloi të botojë dhe të bëhet i njohur si talent i ri që premtonte. Vjershat e tij të para mbajnë tituj karakteristikë si: *Ardhi Dita, Palla e Skenderbeut*[73] dhe janë kushtrime të vërteta për kyengritje të armatosur dhe për çlirim.

Poeti i ri u bë shumë shpejt i njohur. Çajupi e çmon fort opinionin që i shpreh Asdreni më 1903 për *Baba Tomorrin*. Libri i parë i Asdrenit, *Rreze drite* (1904), u prit mirë nga lexuesit dhe shtypi. Çajupi i shkruan mikut të vet: "*Tani besoj se Naim beu nukë vdiq, se vendin qe la ai bosh e zure ti"* [74].

Asdreni u bë një nga udhëheqësit e lëvizjes atdhetare ndër shqiptarët e Rumanisë. Çeli një shkollë shqipe me 60 nxënës në Kostancë për fëmijët e mërgimtarëve shqiptarë, duke dhënë ndihmën e tij jo vetëm si mësues, por edhe si hartues i vjershave, përkthimeve dhe përshtatjeve në gjuhën shqipe, fabula e tregime, që në të

[73] Botuar së pari te revista Albania 1901, fq 119 dhe 172, ribotuar te "Rreze drite".
[74] Letër e Çajupit dërguar Asdrenit më 3 shkurt 1904

shumtën ngelen dorëshkrim (Përmendim një përmbledhje të *Iliadës* e të *Odisesë* në prozë).

Ndërsa ne vitin 1909 Asdreni botoi për herë të parë te "*Liria*" fabula e tregime të përshtatura e përkthime nga De Amicis e autorë të njohur për fëmijë, si për shembull: *"Gjaku i stërgjyshërve", "Ariu, qeni dhe macja"* etj. Shkroi herë pas here ndonjë prozë të vogël për fëmijë, si: "*Mësuesi im", "Unë, flamuri, po ju flas"* etj. Në dorëshkrim mbeten edhe krijime të tjera për të vegjël, si: *Ëndërr e vërtetë, Liqeni i Prespës, Kujtime nga Shqipëria, Dallëndyshet, Rebeka e dallëndyshet* etj. Pasqyroi në shkrimet e veta ngjarjet e Shqipërisë, mblodhi ndihma për kryengritësit e Kosovës, bashkëpunoi me Nolin për shkëputjen e kishës shqiptare të Bukureshtit nga kisha greke, ishte sekretar i mbledhjes së Bukureshtit që e kryesonte Ismail Qemali në vjeshtë të vitit 1912 dhe ku u vendos shpallja e menjëhershme e Pavarësisë. Jo më kot pikërisht në atë vit del në dritë vëllimi i dytë me vjersha i Asdrenit "*Ëndrra dhe lotë*" ku shfaqet plotësisht talenti i tij dhe që solli një ndihmesë të shquar në letërsinë shqiptare të Rilindjes.

Poeti ynë botoi edhe një përmbledhje tjetër poetike për të rritur: *Psallme murgu* (1930), ndërsa më 1937 përgatiti vëllimin *Kambana e Krujës*, por nuk mundi ta botonte; ai pa dritën e botimit më 1971, në Kosovë, nën kujdesin e Prof. Rexhep Qoses.

Asdreni trajtoi në mënyrë të gjerë gjithë temat e poezisë së Rilindjes. I nisur nën ndikimin e Naimit dhe të Samiut, ai, në vargjet e para, është një poet luftarak.

Në vëllimin "Vlera e Atdheut" ka mjaft vjersha në formë hymnesh e marshesh, të cilat ngjallnin te të vegjlit krenarinë kombëtare.

Le të kujtojmë *Betimin mbi flamur* të botuar, për herë të parë më 1912[75] dhe që u bë hymni ynë kombëtar.

Rreth flamurit të përbashkuar,
me një dëshirë e një qëllim,
të gjithë atij duk iu betuar
të lidhim besën për shpëtim.
.....

Në dorë armët do t'i mbajmë,
të mbrojmë atdheun në çdo kënd,
të drejtat tona ne si ndajmë;
këtu armiqët s'kanë vend.
se kombe shuhen përmbi dhe,
po Shqipëria do të rrojë,
për të, për të, luftojmë ne!

Ose një tjetër të po atij viti, vjersha "*Përpara*", që dallohet nga një stil patetiko-oratorik, i cili shpreh një patos të zjarrtë të brendshëm. Vargjet e shumta dinamike dhe njëkohësisht të thjeshta, kanë një forcë komunikuese të veçantë. Janë kushtrime të vërteta për kryengritje të armatosur e për çlirim:

[75] Te gazeta "Liri e Shqipërisë", Sofje 21 Prill, ribotuar te "Ëndrra e lot", po atë vit.

Lart, Shqipëri,
ti je e zonja,
nga lufta sot mos ndalesh;
me trimëri
porsi shqiponja
armiqve mos iu falësh!
Si burr' u sul, ata dërrmoi,
me gjak të drejtat mbroi!
Përpara shko, përpara!

Krahas kësaj retorike që shkrihet në vjershën *Përpara* me një ndjenjë të sinqertë, gjejmë edhe lirika të tjera ku dashuria për atdheun shprehet më me thjeshtësi e spontanitet ndjenje përmes mallit për atdhe të mërgimtarit të djegur:

Me sa mall e sa dëshirë
Atë ditë po e pres,
që edhe unë atje i lirë
pranë prindërve të vdes!
("Në mërgim")

Asdreni si Çajupi, vë gishtin te plaga e dhimbshme e kurbetit dhe dënon ata që e harrojnë vendin e tyre. Poeti vijon ta lëvrojë lirikën atdhetare dhe pas Shpalljes së Pavarësisë.

Kjo duket mjaft qartë dhe tek poezia "*Vlera e Atdheut*":

Sa të dua ,o Shqipëri,
sa mall ndiej e sa dëshirë!
Për ty gaz e dashuri
mu në zemër më ka mbirë.

Se për mua ti,o Atdhe,
je një lule aq e vyer,
sa nuk gjëndet përmbi dhe,
shpirtin tim për të ushqyer.

Tema shoqërore i ka frymëzuar Asdrenit edhe vjersha ku ai shfaq shpresën tek populli, si vjersha "*Lulëkuqja*" (1912), çuditërisht e thjeshtë dhe plot lirizëm, po edhe plot forcë ku nëpërmjet këtij simboli të gjetur bukur himnizohet populli dhe pohohet besimi tek ai. Me Lulëkuqen autori simbolizon të varfërit, për të cilët nuk kujdeset askush; ngjyra e lules të kujton lëvizjen për çlirim shoqëror të tyre:

Ajo ngjyrë kur zë shfaqet
Mbreti fronë shkon e lë
Njerëz robër fare s'sheh
Vjen e drejta del në faqet
Si zot je.

Fakti që me titullin e kësaj vjershe autori deshi të emërtonte vëllimin "*Ëndrra e lot"* tregon se sa i ndërgjegjshëm ishte ai për idetë e guximshme që po fuste në krijimtarinë e vet poetike.

Në vjershën e gjatë *Burri i dheut*, që e shkroi me 1920, duke i kënduar Luftës së Vlorës, Asdreni thekson karakterin popullor të saj dhe krijon një portret kolektiv të popullit të shfrytëzuar. Te heroi i vjershës, lexuesi gjen fshatarët e varfër që lanë arat e bagëtitë dhe mbi guna kapërcyen telat me gjemba. Në gojën e nënës së heroit, që më kot pret të birin e vrarë, poeti vë fjalët:

Jemi bujq e truall s' kemi
zotërinjt' e mbajnë frerin,
prej lëmoshës tyre rrojmë:
Ne me lot ata me nderin[76].

Në lirikën e natyrës Asdreni tregohet tepër origjinal duke na e dhënë natyrën (për herë të parë në krahasim me rilindësit e tjerë) të shkrirë me jetën e vet. Për Asdrenin, mund të themi, se krijoi peisazhin poetik të pavarur, ku natyra, kryesisht ajo e vendlindjes, u bë objekt frymëzimi.

Në përmbledhjen e pare, *Rreze Dielli*, boton gjithsej 11 vjersha mbi natyrën; në përmbledhjen e dytë, *Endrra dhe lotë*, boton 15 vjersha mbi natyrën; në përmbledhjen e tretë, *Psallme Murgu*, boton gjithashtu 15 vjersha mbi natyrën, kurse disa prej vjershave të parapara për përmbledhjen e katërt, *Kambana e Krujës*, po ashtu zënë një vend edhe më të rëndësishëm duke i kushtuar gjithnjë e më shumë rëndësi poezisë mbi natyrën në krijimtarinë e tij.[77]

Asdreni është një ndër poetët e Rilindjes që shkroi më shumë për natyrën, natyrën shqiptare, fshatin shqiptar, apo dhe për natyrën në përgjithësi. Jeta e fshatit tek ai, zakonisht del me përmallimin e admirimin e mërgimtarit dhe me dëshirën e idealistit, që pa bëjë atdheun sa më të dashur për shqiptarët. Kështu, shumë e njohur është vjersha *Ditë prandvere*:

Dita gdhihet, çel agimi,
Derdhet drita porsi ar,
Çduket nata, shkon qetimi,
Dielli rrezet si mburimi
I çon poshtë posi zjarr.

Ndriten kodrat, fshati zgjohet,
Lumi qiellin pasqyron,
Fusha, bregu, ngjyra ndrrohet,
Fletët dridhen, era ngrohet;
Shkëmbi majën sbardhëllon.

Prej kasolles bagëtia
Fushës dalin për ushqim...

Natyra përshkruhet zakonisht në lidhje me njeriun dhe me punët e tij, me hallet dhe gëzimet e tij.

[76] Asdreni, "Psallme murgu", (Vjersha të tjera, Përkthime), Tiranë, 1980, f. 43
[77] Rexhep Qosja, "Asdreni- Jeta dhe vepra e tij" (monografi), Tiranë, 2002, f. 324

Për Asdrenin pranvera është gjithmonë stina më e bukur dhe më e dashur e vitit për shkak se ajo sjell gjallëri, përtërin jetën dhe natyrën, shënon fillimin e një cikli të ri të jetës dhe të punës së njeriut. Ajo është simboli i gëzimeve, i dashurisë, i fuqisë dhe i rinisë; ajo, si thotë në vjershën *Eja prendverë*!, i sjell flakë e zjarr jetës së njeriut:

Pra eja o moj prendverë
Prej dimnit rëndë nxjer-na,
Ballsamin t'ënt me vlerë
Në shpirt t'onë shtjer-na;
Posht' rezet derdhi si ar
Dhe mbushna flak' e zjar!

Këtë motiv na e vë në dukje dhe studiuesi Prof. Rexhep Qosja: *Natyra ishte e para punë që e dëfrente autorin, ato i mbeten në kujtesë përgjithmonë dhe e frmëzojnë saherë krijon vjersha mbi natyrën.*[78]

Nga mënyra si e ndërtoi poezinë *Vjeshta*, në pjesën e parë të përbërë nga katër strofa, autori jep karakteristikat e vjeshtës, duke i treguar ato me saktësi, ashtu siç ndosh realisht, pa zbukurime: *koha e nxehtë kaloi*, *bilbili s'këndon bukur*, ashtu si në stinën e verës, *qielli ndryshon*. Ja vargjet:

U zhduk vapa, shkoi vera,
dhe bilibili më s' këndon,
erdhi vjeshta me të tjera,...
syri ynë që i shikon.

Pra duket se Asdreni është një vëzhgues i veçantë. Trishtohet se peizazhi natyror s'ka bukurinë e verës, sepse shiu është i pranishëm orë e çast, dhe qilimi i blertë, çlodhës, prej bari të njomë s'është, kështu dhe lulet, kënaqësia e jetës, s'jane më.

Teret koha, hapen retë,
Pemët zhvishen si nga mot
Mali, fusha s' ka më hijen,
që e kishin gjer më sot.

Me këtë enumeracion fjalësh jep qartë e saktë se si ndryshojnë stinët, duke marrë secila prej tyre, karakteristikat e veta. Detaj tjetër që rreh Asdreni për fëmijë është ai i punës. Edhe vjeshta ka veçoritë e veta, prodhimet e ndryshme, bujku shqiptar e i palodhur nxjerr frytet e punës së tij, vjel me kënaqësi nëpër vreshta, por edhe punon me kënaqësi arat, për të siguruar përsëri prodhim sa më të bollshëm.

Por e mirë është vjeshta,
Sepse bujku gjith' punon,
Për të vjelur sot ka vreshta,
nesër arat po leron.

Poezinë autori e mbyll duke nxjerrë përfundimin: *Bota do të fitojë, vetëm me punë.* Asdreni e pasuron në mënyrë të veçantë poezinë tonë edhe në lëmin e formës, duke krijuar lloje të reja strofash e vargjesh, duke lëvruar madje edhe vargun e lirë. Ai sjell

[78] Po aty, f. 25

në letërsinë tonë një figuracion të begatshëm. Simbolet, krahasimet dhe epitetet e tij shquhen në përgjithësi për origjinalitetin e tyre. Poezitë më të bukura Asdreni i shkruan kur shkrin origjinalitetin në brendi e në formë me thjeshtësi:

Me vite jam larguar,
i dashur Atdhe,
por nuk të kam harruar,
se shumë i ëmbël je.

Të fala të dërgoj,
këndej ku jam Atdhe,
gjithnjë po të kujtoj,
(I dashur Atdhe)

Pas çlirimit nga Asdreni te ne janë botuar përmbledhjet *Lulëkuqja* (1958) me vjersha, tregime e përralla, të zgjedhura e të redaktuara nga Dhimitër Fullani, *Vlera e Atdheut* (vjersha të zgjedhura për fëmijë, 1977) etj.

3.5 Luigj Gurakuqi – pionieri i qytetërimit perëndimor

Atdhetari Luigj Gurakuqi (1879-1925) krahas veprimtarisë së tij patriotike dhe arsimore, ka vendin e vet në zhvillimin dhe pasurimin e letërsisë shqipe dhe, në veçanti, të letërsisë për fëmijë. Luigji u shkollua në kolegjin arbëresh te Shen Mitër Koronës, ne Kalabri, pastaj ndoqi studimet në Universitetin e Napolit, në fakultetin e shkencave të natyrës, ku dhe u diplomua. Studioi edhe filozofi; qysh në fillesat poetike të tij shfaqi frymë romantike me elemente të thella realiste. Luigj Gurakuqi pati fatin se ra në duar të mësuesve tepër të zot, atdhetare e intelektuale të shquar si Anton Xanoni, Gasper Jakova - Mërturi dhe Jeronim De Rada, i cili nuk qe vetëm edukator i vërtetë për të, por dhe një figurë që e frymëzoi për tërë jetën.

Në rrugën e parë të poezisë Gurakuqi pati edhe një udhërrëfyes e mësues tjetër të shquar, vjershëtorin e mallit për atdhe, Filip Shirokën, i cili në fund të shekullit XIX ishte bërë i njohur me pseudonimin Geg Postriba. Ky komunikim i dy poetëve shkodranë: Luigj Gurakuqi dhe Filip Shiroka, më tepër ishte nje dialog poetik, ku shfaqet malli dhe dashuria per vendlindjen, nga mërgimet e gjata te tyre. *Dallëndyshja* e Gurakuqit ashtu si *Dallëndyshja e* Shirokes i çon poetët në vendlindje, Shkodër, tek varret e të parëve të tyre, tek kujtimet dhe malli për Shkodrën.

Tek personaliteti i Luigj Gurakuqit spikat kultura e gjerë dhe enciklopedike. Ishte njohës i thellë i trashëgimise kulturore të popullit të vet dhe i kulturës klasike romake e latine. Historia e vendit dhe ajo botërore ishin objekt i përhershëm i studimeve të tija. Njihte arkeologjinë e shkencat ekonomike e financiare, trashëgiminë arsimore kombëtare dhe europiane.

Gurakuqi ishte poliglot. Përveç shqipes, zotëronte në mënyrë të shkëlqyer latinishten, italishten, turqishten dhe frëngjishten. Dinte greqisht e gjermanisht. Ka të ngjarë edhe anglishten. Fan Noli e cilësonte Luigj Gurakuqin pionier të qytetërimit perëndimor në Shqipëri, si një nga shqiptarët e flaktë që thithi me themele kulturën e

Perëndimit dhe si njeriun që punoi më gjatë e më shumë se kushdo tjetër për të mbjellur farën e saj në Shqipëri.

Luigj Gurakuqi ka meritën se është ndër hartuesit kryesore të programit arsimor e kulturor të lëvizjes sonë kombëtare për liri e pavarësi. Në këtë kuadër ai ishte njohësi dhe propaganduesi më i mirë i traditave të popullit tonë, i traditave kulturore e patriotike, i traditës gojore e shkrimore dhe i psikologjisë së popullit tonë. Thelbin e qëndrimit të tij në këtë fushë e përbën ideja se nuk duhen mohuar të parët, paraardhësit, sepse përndryshe nuk do jemi shqiptar, s'kemi kujt t'i shkojmë mbrapa e prej kujt të frymëzohemi.

Duke propaganduar me zjarr traditat e popullit tonë ai kishte një synim të qartë: Shqiptarët të njohin vlerat e veta, të njohin e çmojnë vlerat e gjakut të tyre.

Gurakuqi është një ndër personalitetet kryesore që luftoi për njësimin e alfabetit. Edhe në këtë problem ai u udhëhoq nga parudha *një komb, një gjuhë dhe një alfabet*.

Gurakuqi ka qenë figurë qëndrore e Komisisë Letrare të Shkodrës. Luigji, si përfaqësues i Shkodrës dhe i arbëreshëve, mori pjesë në vitin 1908 në Manastir ku u mbajt Kongresi për alfabetin e përbashkët. Madje u zgjodh nënkryetar e anëtar i komisionit që hartoi alfabetin.

Gurakuqi është tekstologu më i shquar shqiptar i fillimit të shekullit tonë. Ai i dha shkollës shqipe, si autor e bashkautor, 8 tekste mësimore me një vëllim prej 738 faqesh. Vepra e Gurakuqit për fëmijë është e madhe dhe e shumanshme. Ajo u botua kryesisht në librat e tij për shkollat: *Knime t' para për msonjtore filltare t' Shqypnis* (botuar në Napoli më 1905), *Abetar i vogël shqyp*... (Bukuresht, 1906), *Abetar i gjuhës shqipe* (Athinë, 1912) për klasën e parë, dhe tri vëllimet *Këndimet e para (e dyta, e treta*) *për çunat* (Athinë, 1912) për tri klasat vijuese, të botuara në dialektin e Elbasanit, për të cilin ishte Gurakuqi në përpjekjet për gjuhën e njësuar.

Poezia e Gurakuqit për fëmijë përfaqëson një prodhim të vogël. Ajo u botua për herë të parë në vitin 1905 në *Knime t' para për msojtore filltare t' Shqypnis*.Vepra poetike për të vegjlit përbëhet nga 14 vjersha, prej të cilave katër janë përkthyer ose përshtatur nga gjuhë të huaja.

Në mjaft vargje e strofa shihet se poeti i këndon atdheut, shkollës dhe familjes, në shpirtin e vocërrakëve ndez fantazine dhe ëndrrat e tyre. I pajisur me një kulturë të thellë, pedagog e psikolog, Luigj Gurakuqi, në botën poetike për të vegjël, pasqyron nje koncept te veçantë artistik: për të, prindërit dhe mësuesit janë kopshtarët që e edukojnë dhe arsimojnë brezin e ri të Shqipërisë, i cili është pasqyra e tyre. Krahas kësaj, familja dhe shkolla, për Gurakuqin, zënë vendin qendror në pajisjen e të vegjëlve me dituritë, duke ndikuar drejtpërdrejt në qytetërimin e ardhshëm të Kombit shqiptar dhe atij evropian. Në mjaft nga motivet e poezisë për fëmijë të këtij poeti, jepet dashuria për nënën dhe vatrën familjare, mjedisin malësor të Veriut, portretet e fëmijëve, por edhe drama e jetës dhe e fatit të tyre në gjysmën e parë të shekullit XX.

Temat e këtyre nuk i kalojnë kufijtë e shkollës dhe janë të njëjta me ato të rilindasve të tjerë: natyra, mësimi, tema morale etj. Në mjaft vjersha të këtij poeti dhe sidomos në atë me titull *Shqiptar,mbajeni këtë vllazni!*, poeti ushqen tek fëmijët shpirtin liridashës të shqiptarëve, dashurinë për atdheun, shenjtërime këto që i bëjnë fëmijët të mendojnë për fatet e ardhme të kombit.

Për të nxitur dashurinë e fëmijëve ndaj atdheut, Gurakuqi ne vjershat e tij përmend Prizrenin, Shkodrën, Krujën, besën dhe mikpritjen shqiptare, malësorët që derdhen në luftërat për liri e mbi të gjitha vetë fëmijët që nxitojnë në udhët e shkollës ”për të shndritur mendjen”.

Poeti Filip Shiroka, duke çmuar vlerat e poezisë së Luigj Gurakuqit (në vjershën e vet *Shqiptarëve lidh në besë)* e cilëson atë *Bilbyl të ri* të kombit shqiptar. Në vjershërimin për të vegjël të Luigj Gurakuqit ka mjaft vargje që përcjellin ndër fëmijët vlerat etike dhe morale, duke shpotitur dhe qortuar veset dhe mendësitë që pengojnë zhvillimin e tyre në jetën e përditshme.

Një cikël më vete, në krijimtarinë poetike për të vegjël të Luigj Gurakuqit, përbëjnë vjershat (*Prendvera, Vera, Vjeshta, Dimni, Stinët e motmotit* etj), në të cilat përshkrimet sjellin një gëzim emocional tek fëmijët, me botën e madhe dhe të gjerë të vetë fëmijëve, ku atyre u duket sikur bëhen pjestarë të peizazhit shqiptar dhe ndërtojnë lodrat e tyre, thurin këngët dhe vallet e tyre, të cilat mbartin edhe elemente rituale e zakonore. Krahas kësaj në këtë peizazh shqiptar shfaqen dhe detaje nga mjedisi shkodran dhe katundet malësore:

Dehet bora!...Ç'kan lulzue
Fushë e mal për bukuri!
Bleta mjaltën tue kërkue
Nëpër lule fluturon;
(Prendvera[79])
.....
Pemët tek janë pjekur – qeshin mbi ne;
Me rreze dielli – gjithcka po xenë,
Por i ftofët uji – e freskon dhenë.
(Vera[80])

Vjeshta mrrijini, pemët jenë pjekë,
T' mbledhim kokrrat tue këndue;
.....
Djersët e ballit ka me i gzue.
(Vjeshta[81])

Bora malet i ka mbulue
Gjethi i landës asht shkrumbue
Mjeri ai qi shpie nuk ka,
Se shumë t' zeza ka me pa:
T' vorfnit pra ti njitja dorën,
Sidomos kur t'shofish borën.
(Dimni[82])

Ndërsa në vjershën *Stinët e motmotit* ai pikturon vetëm pamje nga natyra në kohë të ndryshme. Si pedagog dhe mësues, i pajisur me një kulturë evropiane, por edhe si një rilindës, Luigj Gurakuqi me vjershat e tij për të

[79] Luigj Gurakuqi, "Vjersha" , Bari 1940, f. 30
[80] Po aty, f. 30
[81] Po aty, f. 30
[82] Po aty, f. 30

vegjëlit ushqen dashuri të thellë për ta, sidomos për shkollën dhe mësimin, pasi dëshira e tij e zjarrtë është formimi kombëtar i brezit të ri. Keto ide dhe mesazhe poeti i shpreh në *Vlera e këndimit, Mesimi apo Mbarimi i vjetit të shkollës*, në të cilat zbërthehen marrëdhëniet mësues-nxënës por edhe dashuria e fëmijëve për shkollën si vatër diturie.

Ashtu si rilindësit e tjerë: Naimi, Çajupi etj., edhe Luigj Gurakuqi shpreh botpërjetimin e tij; lumturia e Atdheut dhe begatia e tij krijohet nëpërmjet diturisë dhe qytetërimi të punës. Temën e Atdheut dhe dashurisë për të poeti i shtjellon në mjaft vargje, në të cilat jepen marrëdhëniet e shqiptarëve me Atdheun dhe flijimin e tyre për ta mbrojtur atë nga armiqtë.

Me këto motive atdhedashurie mbruhen edhe vjershat *I tretuni* dhe *Luftetari tue dekë*, të cilat kanë qenë përfshirë në tekstet shkollorë edhe në vitet 40 shekulli XX. Tek vjersha *I tretuni* fëmijët mësojnë se malli i mërgimtarit fluturon si zog nëpër qiej për të puthur ballin e Atdheut por edhe për të përqafuar gruan dhe fëmijët. Në këtë kuptim, poeti shpreh konceptin estetik dhe filozofik se, pa vatrën familjare, nuk ka Atdhe; lumturia e njeriut duhet të krijohet në vatrën e tij dhe jo nëpër mërgime. *I tretuni* është një portret i gjallë i shqiptarëve në brazdat e vuajtjeve dhe mundimeve që fëmijëve u mbetet në mendje.

Po kështu, te vjersha *Luftetari tue deke* poeti ndjell emocione tek fëmijët për të shpalosur në sytë e tyre shpirtin liridashës të luftëtarëve të lirisë, përpjekjet e mëdha të atdhetarëve tanë për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut.

Në tërësi, krijimtaria poetike për të vegjël e Luigj Gurakuqit është thurur prej tij duke njohur mirë botën psikologjike të fëmijëve. Ajo më së shumti ka vlera pedagogjike e didaktike pasi është hartuar si pjesë e teksteve mësimore për t'u mësuar gjuhën shqipe dhe për të rritur krenarinë kombëtare të fëmijëve.

Në përgjithësi vjershat e Gurakuqit janë të shkurtra, me gjuhë të pasur e të bukur, me varg të rrjedhshëm, megjithese nuk u kanë shpëtuar notave moralizuese të tonit urdhëror:

...Nadje herët çohu, o fëmi,
Me lanë shtratin mos prito;
Nisu n'shkollë bashkë me shoqni,
Udh's me luejte mos u ndalo,
Shko me zell n'shkollë e me gzim
Aty gjen për shpirt ushqim.

(*Mësimi*[83])

Gjithsesi, kjo krijimtari poetike e Gurakuqit zë një vend të nderuar në letërsinë shqipe për fëmijë.

[83] Luigj Gurakuqi, "Vjersha" , Bari, 1940, f. 34

Në prozë Gurakuqi na la kryesisht disa fabula të shkurtra për fëmijë. Edhe këto shquhen për thjeshtësinë, për bukurinë e stilit e të gjuhës. Përmendim: *Mendoni për të tjerët, Luani, Gomari e dhelpra* etj, ku Luigji përpiqet t'i bëjë fëmijët të zellshëm, të ndëgjueshem ndaj prindërve, të guximshem në jetë dhe të dashur me të afërmit e tyre.

Krijimtaria për fëmijë, në proze e në poezi, e këtij autori u mblodh pas Çlirimit nga shkrimtari Mark Gurakuqi në vëllimin *Dëshirë* (1960).

Vlen të përmendim se Gurakuqi ka merita të shquara në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe, në përpunimin e gjuhës letrare dhe në njësimin e shqipes së shkruar, në stabilizimin e drejtshkrimit, në pasurimin e fjalorit, në çështjet e leksikologjisë, terminologjisë e të gramatologjisë.

Gurakuqi ka meritën se përcaktoi drejt e qartë, më shume se çdo paraardhës, konceptin mbi shkollën kombëtare shqiptare, përmbajtjen, karakterin dhe parimet e ndërtimit të saj. Ai kërkonte që gjithë fryma dhe përmbajtja e shkollës të ishte në funksion të qëllimeve dhe idealeve kombëtare.

KREU IV

FILLIMET E LETËRSISË MODERNE SHQIPTARE PËR FËMIJË

4.1 Tablo panoramike
4.2 Revistat për fëmijë: *Vatra e Rinisë* e Vasil Xhaçkës dhe *Mituria* e Milto Sotir Gurrës
4.3 Ilo Mitkë Qafëzezi – letrarizonjësi për fëmijë e të rinj
4.4 Dhimitër Pasko – Mitrushi i përrallave dhe i rikrijimeve

4.1 Vështrim panoramik

Letërsinë për fëmijë të viteve ’30 të shekullit XX e pasuroi mjaft lëvrimi i prozës së disa shkrimtarëve të mirënjohur, të cilat shërbenin si lexime për fëmijë. Këtu bëhet fjalë për letërsinë e viteve ‘30, periudhë në të cilën, siç vlerëson studiuesi Tasim Gjokutaj, në periudhën 1912-1939 krijimtaria për fëmijë ka qenë e vakët. *Ndërsa letërsia për të rritur në këtë periudhë nxorri një Nol e një Migjen, një Fishtë e një Konicë, letërsia për fëmijë s’pati individualitete të spikatura, as vepra të spikatura. Në këtë periudhë pati më tepër lexime për fëmijë sesa letërsi të mirëfilltë për fëmijë*[84]. Boshllëkun e librave origjinale të letërsisë për të vegjlit në atë kohë e mbushën deri diku përkthimet nga letërsia botërore. Të kësaj periudhe si shumë të rëndësishme për zhvillimin e letërsisë sonë për fëmijë jane disa vepra klasike të letërsisë botërore për fëmijë, si:

- Romani “*Zemër*” i Edmondo De Amiçisit, libër që u botua i plotë më 1923 në Shqipëri, nga shkrimtari shkodran Prof. Karl Gurakuqi, i cili shquhej për kulturën e gjerë filologjike që kishte marrë në Universitetin e Gracit.
- Një ndihmesë të veçantë ka dhënë një nga përkthyesit e mirënjohur të letërsisë për fëmjë, Ilo Mitkë Qafëzezi. Ai përktheu nga rusishtja mjaft tregime, përralla e legjenda.
- Në Korçë botohet më 1934 “romanca” *Fatbardhi*, përkthyer nga mjeku elbasanas Filip Papajani me pseudonimin Lipi, si dhe libri “me rrëfenja e zbavitje”” *Nastradin Hoxha* (i mungon viti i botimit), përmbledhur prej Dhori Kotit.

[84]Tasim Gjokutaj, Letërsia shqipe për fëmijë ka nevojë më tepër për vlerësim – LETËRSIA SI E TILLË. Tiranë 1996, f. 312

- Romani "*Njeriu i padukshëm*" i Ralf Colfordit, përkthyer nga DAJ-JAKU (pseudonim letrar që i korrespondon shkrimtarit Luigj Filaj).
- Romani "*Robinson Kruzo*" i Daniel Defosë, i përkthyer e i botuar në Selanik që më 1909 nga shkrimtari Lumo Skëndo (Mithat Frashëri), u botua tani në Korçë nga "shtyp & Libraria Dhori Koti".
- Në vitet 1935-37 lexuesit e vegjël shqiptarë lumturohen me *Pinokun* e Karlo Kolodit (përkthyer nga Cuk Simoni, i cili njihet si përkthyes i parë i këtij libri në gjuhën shqipe; më pas në vitet e Demokracisë më 1994, *Pinoku* u ribotua i sjellë në gjuhën e sotme letrare nga djali i Cukut, Zef Simoni.
- Në vitin 1936 në Shkodër sillet në shqip botimi i parë me përrallat e Andersenit.
- Romani i famshëm për të rinjtë *Të tre musketjeret* i Aleksandër Dumasit vjen në Shqipëri në vitin 1938, Korçë, i përkthyer nga Thanas Floqi.
- *Nën hijen e hurmave*, përralla arabe, përkthyer nga Faik Konica, u ribotua në Tiranë më 1943. Në parathënien e tij "për lëçitësin shqiptar" shënohej: *Rrallë na jepet rasti të këndojmë gjuhën shqipe kaq lehtë, t'i shijojme ëmbëlsinë, t'i kuptojmë thelbin si në këtë librë.*
- "*Princi i lumtur dhe përralla të tjera*" të shkrimtarit anglez Oskar Uajldi, përkthyer prej mjeshtrit Skënder Luarasi, Tiranë 1944.
- Dy botime para çlirimit njohu romani *Djemtë e rrugës Pal* i Ferenc Molnarit (ai i vitit 1944 është bërë nga Andon Frashëri).
- Më 1944 u botua gjithashtu edhe "*Liza në botën e çudirave*" i Ljuis Kerëlit etj.

Një vend të veçantë në letërsinë artistike për fëmijë në vitet 1930-40 zënë edhe disa krijime në prozë të autorëve Mitrush Kutelit, Nonda Bulkës dhe Migjenit etj. tregimet e tyre nuk janë shkruar posaçërisht për fëmijë. Por studiuesi Naum Prifti, vëren se në kohën kur u botuan këto krijime *te ne nuk kishte letërsi për fëmijë, qe jashtë konceptit të kohës dhe për t'u bindur mjafton vetëm një fakt. Asnjë nga librat e njohur të letërsisë klasike për fëmijë, të përkthyer e të botuar në atë kohë, si "Pinoku", "Liza në botën e çudirave" ose "Djemtë e rrugës Pal", nuk kanë ndonjë shënim kolane se kujt i adresohen. Autorët e kohës, si shkrimet për fëmijë, ashtu edhe ato mbi fëmijët i përfshinin në botimet për të rriturit*[85]. Ky konstatim u hodh poshtë nga Prof.Astrit Bishqemi.

Krijimtaria artistike e autorëve që përmendëm zuri vend të merituar në tektet e leximeve letrare, duke shtyrë tej letërsinë didaskalike që zotëronte në botimet shkollore në atë kohë, madje edhe pas çlirimit të vendit.

Një nga talentet më të fuqishme të letërsisë shqiptare në vitet '30 qe Migjeni. Edhe pse nuk shkroi për lexuesit e vegjël, ai zë një vend nderi gjithashtu në letërsinë shqiptare për fëmijë. Mjaft nga skicat e tregimet e tij u përfshinë edhe në leximin për fëmijë. Si mësues e poet i talentuar e njohu nga afër jetën e fëmijëve, botën dhe psikologjinë e tyre. Gjë që shfaqet qartë në prozat e poezitë tij. Tregimet dhe skicat e autorit u bënë mjaft tërheqëse për fëmijët e të rinjtë, ato zënë një vend të rëndësishëm në letërsinë për ta, pasi pasqyrojnë mjerimin e shqiptarëve, por edhe kufizimin e jetës së tyre. Në krijimet e tij gdhenden një galeri personazhesh fëmijë, me tiparet dhe veçoritë e veta, duke nxjerrë në pah realitetin shoqëror të kohës.

[85]Naum Prifti, "Një mjeshtër i tregimit" – NËNTORI, nr. 3/1990, f. 35

Në skicat ”*Luli i vocërr*” dhe sidomos ”*Zeneli*”, shkrimtari vuri në dukje aftësitë intelektuale të masave dhe deshirën e zjarrtë për ndryshime në gjendjen e tyre shoqërore. Ai i donte shume femijët. Fati e solli që të bëhej mësues, mësues katundi. Fëmijët që mësonte ishin pothuaj të gjithë të varfër, shokë të Lulit të vocërr, shokë të Zenelit. Duke njohur ata, Migjeni njohu më mirë mjerimin. Misionar në letërsi, Migjeni qe misionar edhe në jetë. Me atë pasion që shkroi për të ngritur e për të ngushëlluar skamnorët e të mjerët, me atë pasion ai mësoi në shkollën e katundit për të ndritur errësirën e mendjes së trashëgueme prej shekujsh robnije. Migjeni i kushton një vend të veçantë figurës së mësuesit. Herë-herë ai i afrohet nxënësit të tij të varfër por të zgjuar dhe e përkëdhel. Kjo përkujdesje e kjo dashuri e mësuesit janë aq të çmueshme për nxënësin vocërrak.

'Nga nji herë i afrohet mësuesi Lulit. Dhe kur e ka fytyren e dlirtë e pa puca mësuesi i a ledhaton faqet, gushën, e Luli i afrohet, ia merr dorën, e shikon me sy pëllumbi dhe kishte me dashtë t'i falte diçka mësuesit. Por vjollca nuk ka. E Luli i vocërr ç'ka mund t'i fali mësuesit tjetër? Dhe ironia e shkrimtarit arrin kulmin: *Veç në i faltë tollumbat e veta që kanë hapun gojën si me dashtë me e hangë mësuesin. Po, po, tollumbat e Lulit të vocërr kanë me e hangër mësuesin*[86]. Përcillet kaq drithëruese dhe ngarkesë emocionale vetëm me një frazë kaq konçize. Është e qartë, Migjeni temën e merr nga jeta në shkollë. Aty del në pah kontrasti i thellë shoqëror. Me mjeshtëri të rrallë skalitet portreti i një fëmije nga shtresat e ulta të popullit.

Dhe pas disa fjalive përshkruese të autorit, për këtë fëmijë që porsa vjen në oborrin e shkollës, zë një cak të veçuar ku mund ta ngrohin ca rrezet e diellit e ku mund të kridhet i qetë në hallet e veta, jehon befas konstatimi i autorit me një ndërhyrje retorike: *More Lul! Shumë herët e ke fillue me shikue punën t'ande*[87]. Luli është një vogëlush i pjekur para kohe. Tek ai ndizet revolta kur sheh moshatarët, fëmijët e të pasurve që janë veshur me rroba të bukura, me çizme të reja e të shkëlqyeshme, kurse vetë me këpucë të vjetra, të grisura. Autori zbulon me psikologji vuajtjet shpirtërore të këtij nxënësi, i cili mbyllet në vetvete dhe tërhiqet i veçuar nga shokët.

Ndërsa tek skica *Zeneli*, autori vë në qendër një tjetër nxënës të zgjuar e të varfër. Përmes fjalëve të tij, paraqitet gjendja e rëndë e malësorëve dhe e fëmijëve: *Mjaft ma, zotni mësues, mjaft na msuet si duhet me jetue, çka asht mirë e bukur, mjaft na msuet, - e megjithatë na po rrojmë siç rrojtën stërgjyshërit tanë, po n'ato gëzime e po n'ato mjerime, të lanun e të tretun ndër këto bjeshkë. Qe, na shiko njëherë: njenit nëpër këmishë të shkyeme i shihet supi i verdhë, tjetrit barku si dërrasë, ai atje asht gati t'i bjerë të fikët nga uria, nji tjetër prapë mezi përmbahet mos t'i bajnë dhambët brrrr nga ethet*...[88]Zeneli e vret mendjen për problemet jetësore, për hallet që e kanë goditur atë, shokët e tij dhe gjithë popullin.

Personazh tjetër shumë i shpeshtë në veprën e Migjenit është lypësi. Kështu, në prozën *Një refren i qytetit tim,* skalitet qartë portreti i fëmijës që rri gjithë ditën me dorën shtrirë duke u lutur: *Zotni, zotni, të lutem zotni, na fal ndoj send*![89] Është një lypës i vogël dhjetë-dymbëdhjetëvjeçar, me këmbë të paralizuar, që, për të siguruar jetesën, detyrohet të gëlltisë fyerje e poshtërime të njerëzve të tjerë egoistë e të pashpirt. Tragjizmi arrin kulmin kur lypësi i vogël pranon të goditet në kokë me një

[86] Migjeni, "Novelat e Qytetit të Veriut", Tiranë, 1999, f. 75
[87] Po aty, f. 74
[88] Po aty, f. 91
[89] Po aty, f. 64

grusht monedhash, të cilat më pas do të bëhen të tijat. Rrëfimi i thjeshtë dhe konçiz, simpatitë qe zbulojnë thelbin e dukurisë, fryma polemike, psikologjizmi i hollë, prirja për t'i dhenë personazhet me disa viza, figura poetike shprehëse, ironia- këto janë veçoritë kryesore të stilit të Migjenit.

Lexuesit mësonin se si shuhej fëmija në një natë të ftohtë dimri, si venin në shkollë Lulët me opinga të grisura e barkun bosh, si endeshin në qytet punëtorët e papunë etj. Në këto shkrime, autori pasqyron gjëndjen e vështirë e të mjerueshme, por ai e parandien se, për vegjëlinë, do të vinin ditë më të mira, prandaj, në veprën e tij, ai i bën thirrje asaj që të ngrihej e të thyente prangat e robërisë.

Duke patur parasysh të gjitha këto, studiuesi Prof. Bedri Dedja, në vitet e Demokracisë, duke iu shmangur kriterit politizues shtroi tezën se pikërisht në vitet '20 dhe në fillim të viteve '30 letërsia jonë për fëmijë kalon nga romantizmi i Rilindjes në realizëm[90]. Letërsia shqipe për fëmijë në këto vite nisi të lëvrohet me më gjallëri, duke dalë nga kuadri i ngushtë didaktik i dekadave të mëparshme. Vlen për t'u përmendur, që në vitet '30 të shekullit XX nuk kemi përmbledhje më vete me vjersha e tregime për të vegjlit, pasi ato botoheshin në mënyrë sporadike në faqet e gazetave e revistave të kohës.

Kontribut i vecante por edhe tipar themelor i letërsise shqipe për fëmije qysh nga Rilindja jonë Kombëtare e deri në vitet e Luftës së Dytë Botërore ishte se, këtë letërsi për të vegjlit e krijuan po ata poetë e shkrimtarë që lëvruan edhe letërsinë shqipe për të rriturit.

4.2. Revistat për fëmijë: **"Vatra e rinisë"** *e Vasil Xhaçkës dhe "Mituria" e Milto Sotir Gurrës*

Shumica e shkrimtarëve të rinj të viteve '30 nuk arritën të dilnin me përmbledhje më vete dhe krijimtaria e tyre mbeti e botuar nëpër gazetat e revistat e kohës. Studiuesi Prof. Bedri Dedja arrin në përfundimin se në vitet '20-'30 zë fill letërsia moderne shqiptare për fëmijë. Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e letërsisë për fëmijë ka dhënë edhe revista "***Vatra e Rinisë***", e cila u botua në Tiranë në vitet 1933-38. Vasil Xhaçka bëri përpjekje për të nxjerrë këtë revistë të posaçme për fëmijët, e cila doli më 5 shkurt 1933, si fletore më vete për fëmijët djem e vajza 8-18 vjeç, dhe vazhdoi të botohej me vështirësi për afro gjashtë vite me rradhë, deri më 10.07.1938, gjithsej 107 numra. Ajo diti t'u përshtatej kërkrkesave e natyrës së fëmijëve, jo vetëm në përmbajtje, po edhe në paraqitjen e saj të jashtme. Qëllimet e detyrat edukative të revistës së Vasil Xhaçkës kishin karakter demokratik, mbështeteshin në një bazë pak a shumë të shëndoshë pedagogjike për atë kohë dhe u përgjigjeshin deri diku nevojave imediate.

Në faqet e kësaj reviste u lëvruan: poezi për fëmijë, tregime të shkurtëra, fabula, gjëagjëza dhe përralla artistike. Meritë e revistës është përpjekja e saj për zgjerimin e pasurimin e fondeve të leximit të të vegjëlve shqiptarë me vepra të letërsisë klasike botërore për fëmijë. Gjithashtu, ajo përkrahu e nxiti mësuesit e nxënësit që të shkruanin për të vegjëlit. Në të bënë hapat e para disa nga shkrimtarrët tanë, si: Qemal

[90] Dedja, Bedri: Fillimet e letërsisë moderne shqiptare për fëmijë – Gazeta MËSUESI, 26 qershor 2000

Stafa, Gjikë Kuqali, Aleks Çaçi, Mark Gurakuqi, Moisi Zaloshnja, Spiro Çomora, Selman Vaqarri, Milto Sotir Gurra etj.

Në vazhdim të revistës "*Vatra e Rinisë"*, në vitin 1944 nisi botimin e vet edhe revista "*Mituria"* e drejtuar nga shkrimtari ***Milto Sotir Gurra*** (1884-1972). Ajo e nisi jetën e saj në prill të 1944-ës si një revistë e përmuajshme kulturore me drejtimin për fëmijë, të mitur e të rritur.

Në faqet e kësaj reviste u botuan mjaft tregime nga vetë themeluesi i kësaj reviste, si dhe nga autorë të tjerë. Kjo ka tiparet e një enciklopedie të vogël dhe eci në vazhdën e *Vatrës së Rinisë* të Vasil Xhaçkës, ruajti karakteristikat e saja, veç e pati jetën më të shkurtër. Qysh në numrin e parë të kësaj reviste, prill 1944, theksohet synimi i saj: "*Qëllimi ynë kryesor është t'i japim këtij brezi të miturish ushqime truri..."*

Kështu nën okeilon "*Dialogu i muajit*", që shoqëron çdo numër të revistës "Mituria", gjejmë një zhanër të ri, pak të përdorur në atë kohë në letërsinë për fëmijë e në krejt letërsinë shqiptare të asaj kohe. Tematika të cilët ata rrahin, janë tema thellësisht patriotike.

Në revistën "Mituria" një vend të veçantë zinin tregimet për fëmijë. Këto tregime origjinale i gjejmë në një numër të konsiderueshëm, gjithsej 13. Tregimet e marrin tematikën kryesisht nga jeta e fëmijëve në marrëdhënie me shkollën ose jashtë saj, nga një ndërthurje mes jetës së tyre dhe jetës së kafshëve e shpendëve dhe ndodhi të ndryshme që u ndodhin atyre. Këtu vërejmë se pjesa dërrmuese e tregimeve origjinale kanë protagonistë vetë fëmijët, pra flitet për fëmijët dhe mbi fëmijët. Makarenko theksonte: *Cilësitë që dallojnë letërsinë për fëmijë nga ajo për të rritur nuk rrjedhin nga fakti se për çka u tregojmë fëmijëve, por nga forma dhe fakti se si ua tregojmë.* Revista lëvroi edhe gjininë e përrallës, pra u mbështet tek folklori për të vegjlit. Në to luajnë rol të rëndësishëm elementët e jashtëzakonshëm e fantastikë. Ato janë vende, ngjarje, situata, personazhe fantastikë etj. Përrallat janë fantastike të mirëfillta sepse kanë subjekt fantastik, elementë të mbinatyrshëm, përdoret hiperbola, personifikimi etj.Në të vërtetë këto janë veshje artistike, paraqitje artistike e dëshirave, përpjekjeve njerëzore, siç janë lufta e njerëzve kundër së keqes në shoqëri, lufta kundër padrejtësive, njerëzve të pushtetshëm, të cilët shkaktojnë mjerim, nënshtrimi i natyrës, arritja e lumturisë (me përpjekje, punë, guxim) etj. Këtu theksohet ideja se popujt mund të luftojnë e të fitojnë, sepse në ta gjendet forca, guximi, zgjuarsia dhe e drejta.

Një kontribut të veçantë në letërsinë për fëmijë ka dhënë dhe shkrimtari ***Milto Sotir Gurra***. Ai është shkrimtari që ka bërë përkthimet e para në shqip të letërsisë klasike ruse për fëmijë .

I lindur në Marjan të Korçës, ku do të kryejë edhe shkollën fillore e më pas shpërngulet tek i ati, emigrant në Odesë të Rusisë, ku mbaron shkollën e mesme. Tregimi i tij i parë "*Fyelli i fabrikës"* botohet në gazetën "*Kombi"*, Amerikë 1908. Pas 1912 bëhet redaktor i gazetës "*Liria e Shqipërisë* " në Sofje e më vonë redaktor i gazetës "*Atdheu*" Shkodër. Kthehet më 1921 në Korçë, nxjerr revistën letraro – kulturore "*Shkëndia*" ku botoi përkthime nga letërsia ruse autorë si: Gorki, Turgenjevi, Pushkin, Tolstoi, Çehovi. Në vitin 1959 ai botoi për fëmijë një vëllim me titull *Plaku i motshëm*. Aty mblodhi krijimet më të mira që i pati shkruar posaçërisht për fëmijët: përralla, tregime, dialogje, si dhe disa shqipërime nga gjuha ruse.

Tema zotëruese e tregimeve të Milto Sotir Gurrës është ajo patriotike, që pasqyron luftën e shqiptarëve kundër pushtuesve turq në fillim të shekullit tonë. Temë tjetër është ajo me subjekte të marra nga jeta e rëndë e vegjëlisë shqiptare pas shpalljes së Pavarësisë.

Heronjtë e tregimeve të tij janë njerëz të thjeshtë, të fshatit dhe të qytetit, njerëz me zemër të madhe, që japin edhe jetën e tyre për kauzën e lirisë. Si autor për fëmijë Milto Sotir Gurra u bë i njohur nëpërmjet faqeve të revistës "*Vatra e Rinisë"* të Vasil Xhaçkës. Aty ai botoi përkthimet e para në gjuhën tonë nga letërsia klasike ruse për të vegjëlit. Gjithashtu ai botoi edhe krijime origjinale, si tregimet: *E shoqja e karvanxhiut, Frikashi Gjon, Djali i arkës, E mori në qafë leku, Si hoqa dorë së vrari zogj,*. Në këtë tufëz tregimesh, siç shprehet dhe shtypi i kohës, shkrimtari pasqyron jetën dhe botën e fëmijëve, gjëndjen e tyre social-shoqërore, mallin dhe dashurinë për njohjen e thellë të psikologjisë së fëmijëve të kohës. Ishte një njohës i mirë i psikologjisë së fëmijëve dhe këto njohuri i vuri në zbatim tek revista që ai do të drejtonte vetë . Ai e organizoi strukturën që do të kishte revista , në mënyrë të tillë që t'u përgjigjej kërkesave e dëshirave të të miturve.

Jeta kulturore në mesin e viteve 30-të e fillim të viteve 40-të njohu një zhvillim të jashtëzakonshëm. Kjo periudhë bën pjesë në atë që konsiderohet modernitet në letërsinë shqipe.

4.3 Ilo Mitkë Qafëzezi – letrarizonjësi për fëmijë e të rinj i figurave të shquara historike botërore

Nuk mund të mos përmendim edhe krijimtarinë e Ilo Mitkë Qafëzezit në fushën e letërsisë për fëmijë, gjë e cila merr rëndësi duke e pozicionuar në kontekstin kohor të viteve 30' kur kjo letërsi kishte nevojë që të krijohej si degë më vete e letërsisë së përgjithshme.

Shkrimet e tij për fëmijë ai i botoi kryesisht te revista "Vatra e Rinisë" e Vasil Xhaçkës dhe te "Gazeta e Korçës", në një hark kohor që përfshin vitet 1933-1936, vite në të cilat ai kishte arritur pjekurinë letrare, siç ka ndodhur shpesh me të gjithë autorët që kanë shkruar për fëmijë, pasi kanë arritur kulmin letrar sepse kjo lloj letërsie paraqet vështirësi relative që lidhen me të kuptuarit e botës dhe psikologjisë feminore. Ndër këto shkrime përmendim dy zhanre të lëvruara prej tij. Tregimet: "*Dhori nazetari", "Eshtë kafshë shtëpiake", "Ortaku i panginjur*", etj dhe zhanrin e përrallës: "*Tre kurrisdalë të këqinj", "Pse s'ka Baliku shtëpi", "I shkreti lepur", "Çafkëlorja dhe shtërgu*", etj.

Për sa i përket përrallave, ato paraqesin interes nëpërmjet elementëve që mbartin duke marrë shpesh dhe trajtën e gojëdhënave, siç ndodh te "*Çafkëlorja dhe shtërgu* ", ku nëpërmjet një gjuhe të këndshme dhe humorit, ai u tregon femijëve se pse çafkëlorja ka mbetur "pa qafëzë".

Veç Ilo Mitkë Qafëzezi(1889-1964) si autor botimesh qe bërë i njohur që më parë. Ai filloi të shkruante në moshën 14-vjeçare në Bukuresht, i nxitur nga Asdreni. Botimi i parë është një vjershë me motive atdhëtare te *Albania*, më 1904. Pas kësaj, gjer në vitin 1908 mblodhi e vjershëroi shtatëdhjetë anekdota popullore satirike, të cilat i përmblodhi në vëllimin *Rrësku arbëror*, (Hazna shqipëtare) – *tregonjëza*

populllore satirike për të mekur së qeshuri, ndë vjersha, 1910, ribotuar në Korçë më 1924; 2- libri që përmban dy krijime për Aleksandrin e Madh të Maqedonisë: *Alekandrijadha a Leka i Math (poemë...)* dhe *Historia e Lekës së Madh (Aleksandër Maqedhoni) në prozë*, botuar në Rumani më 1922 dhe në Korçë më 1927; një libër të kësaj matyre Qafëzezi ka botuar edhe për Kristifor Kolombin: *Kristofor Kollombua dhe zbulimi i Amerikës* (Pjesa e parë e këtij libri mban titullin *Cunëria e Kollombos*).

Ilo Mitkë Qafëzezi është cilësuar si një ndër shkrimtarët që bën pjesë në letërsinë moderne shqiptare për fëmijë të viteve '30, së bashku me M. S. Gurrën, V. Xhaçkën, Migjenin, T. Gjylin dhe Q. Guranjakun, madje është cilësuar së bashku me tre të fundit si një ndër shkrimtarët që njihte mirë botën e brendshme dhe dëshirat e fëmijëve. Këto lloj krijimtarie, padyshim i ka favorizuar dhe profesioni i tij si mësues. Ilo Mitkë Qafëzezi është autor që priret nga humori e satira dhe duket se ka ditur ta shfrytëzojë atë me mjeshtëri.

4.4 Dhimitër Pasko (1907-1966) – Mitrushi i përrallave dhe i rikrijimeve

Personaliteti i Mitrush Kutelit (Dhimiter Paskos), karakterizohet nga dashuria për vendlindjen, kombin dhe pasioni për letërsinë. Të dyja këto tipare u bënë pjesë e formimit të tij që në vogli: I ati ishte aktivist i lëvizjes patriotike dhe pronar i një biblioteke të vogël. Nga periudha e fëmijërisë Kuteli mban mend vizitat e patriotëve (M. Grameno etj) dhe librat e Spiro Dines, Naimit, Cajupit, Lumo Skëndos, K. Kristoforidhit, Gj. Qiriazit etj. Siç është shprehur edhe Prof. Sabri Hamiti"…*nuk mund të ketë vetëdije letrare një qark kulture që harron autorët e njohur të brezave të shkuar*"[91]. Në formimin e tij letrar la gjurmë adhurimi i tij për rilindasit dhe aktet e tyre heroike e Patriotike.

Në vitin 1938 autori botoi në Bukuresht vëllimin e tij të parë me rrëfime *Netë shqiptare*. Në këto proza, që janë shkruar në harkun kohor të viteve 1925-30, ka shumë tregime e skica letrare të bazuara në kujtimet e vegjëlisë së shkrimtarit. Me poezi na zbulohen ngjarje të fëmijërisë. Është një zë origjinal midis tregimtarëve të kohës. Kuteli rrëfen në një mënyrë të veçantë, ka meritën se solli në letërsi bukurinë e mahnitshme të gjuhës së folur. Edhe vepra ka një konstrukt të gjetur. Janë një grup mërgimtarësh shqiptarë në dhe të huaj. Secili prej tyre rrëfen nga një ngjarje që i ka lënë mbresa më tepër nga vendlindja. Megjithatë, të gjitha rrëfimet së bashku na japin një panoramë të Shqipërisë në vitet e kapërcyellit të shekullit XX. Theksojmë se këto proza nuk janë shkruar posaçërisht për lexuesit e vegjël. Por shumë prej tyre hynë në leximet e fëmijëve. Përmendim skicat: *Për kumbulla, Vendosa të shkoj në kurbet, Unë, Culi dhe Marinëza, Rusa Papusa, Babalja* etj.

Një vend të rëndësishëm përbën te ky autor krijimtaria e mirëfilltë letrare për fëmijë. Me këtë lloj krijimtarie Kuteli u mor pas Çlirimit dhe botoi tri vëllime: *Pylli i gështenjave* (1958), *Xinxifillua* (1962) dhe *Tregime të moçme shqiptare* (1965). Mitrush Kuteli qe njohës i mirë dhe i apasionuar i folklorit shqiptar. Puna e tij pati si synim ta ngrinte atë letërsi në nivelin e letërsisë artistike. Provën e parë e bëri me *Xinxifillon*. Aty ai mori disa përralla nga folklori ynë dhe i përpunoi, i ngriti në rangun

[91] Sabri Hamiti, " Letërsia moderne shqiptare", Albas 2000, f. 23

e novelës. Duhet theksuar se veç lëvrimit mjeshtëror të tregimit dhe novelës Kuteli ka meritën se e pasuroi letërsinë shqipe dhe me një lloj të ri letrar, të palëvruar deri atëherë: rrëfenja. Madje rrëfenja u lëvrua prej tij për mëse 40 vjet dhe u kthye në shfaqjen kryesore të individualitetit të tij. Me këtë lloj të ri letrar në letërsinë shqipe, Kuteli ecën në gjurmët e autorëve të mëdhenj botëror si Bokaçio, Andersen, Vëllezërit Grim etj. Për një periudhë të gjatë kohore, u cilësua nga kritika zyrtare e kohës si "*Mitrushi i përrallave*" apo "*Mitrushi i tregimeve të moçme*".

Mitrush Kuteli i ktheu sytë nga letërsia për fëmijë e të rinj, si fushë ku mund ta siguronte më lehtë të drejtën e botimit. Vepra e tij e tij e parë "*Pylli i gështenjave*" u botua më 1958, çka na lejon të arrijmë në përfundimin se iu deshën më shumë se dhjetë vjet që t'i dilte emri në vitrinat e librarive. Poema hapet me parathënien e autorit për dobinë e pyjeve. Poema s'ka bosht ngjarjesh, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por autori ka ditur ta ndërthurë me pasazhe historike. Pyllin e gështenjave ai e shihte si stoli të rrallë të natyrës fizike të Pogradecit, pa përmendur vlerat ushqimore e drusore, prandaj atij i dhemb zemra nga dëmtimet që i shkaktuan pushtuesit.

Në tri këngët e para uniteti ruhet me anë të personifikimit të gështenjës, ndërsa dy të fundit qëndrojnë paksa të veçuara. Autori e ka ndërtuar poemën në bazë të modeleve të këngëve të vjetra, shartuar me këngët rituale të fëmijëve. Hasen shpesh prapashtesat zvogëluese me -zë, -za, -thë dhe -ë, duke i kthyer fjalët nga paraoksitone në preparaoksitone si dallgëtë,gështenjëza, gjumëthin, të ëmbëlthin, liqenitë, për t'i dhënë vargut muzikalitet. Duket sikur Kuteli përpiqet të rindërtojë tiparet e lashta të gjuhës shqipe, e cila dikur ka patur theksa muzikorë, ndërsa theksat tonikë janë dukuri e vonshme. Natyrisht Kuteli e dinte këtë tezë të shfaqur e të përkrahur nga disa albanologë të shquar. Sidoqoftë tradita popullore i ka ruajtur prapashtesat zvogëluese te "britmat," sikurse i quan Kuteli këngët rituale të fëmijëve. Ja dy shembuj: "*Pty, ty, ty, legëza,/ vajta për purtekëza,/gjeta zogjtë e malitë,/ia ngarkova kalitë*," ose te kënga humoristike "*Cili, vili, vilëza,/kush pret motovilëza,/i vdes gruaja dhe fëmijëza...*" Te ky vëllim gjinden edhe disa poezi të bukura për luftën e njeriut me natyrën, si "*Peshkatari*" dhe një peisazh lirik për vendlindjen "*Ndajnatë në Poradec*."

Puna e tij konsiston jo vetëm në përpunimin e disa episodeve të veçanta, por qe një punë tërësore, plot fantazi e humor; përrallat morën një kuptim të ri, më të qartë. Në to u ruajt fryma mitike, por njëkohësisht u bënë më të afërta për kohën, për lexuesin.

Kjo i dha krahë autorit të vazhdonte rrugën e filluar me një ndërmarrje sa të vështirë, aq dhe fisnike, duke kthyer në prozë disa nga epet më të bukura të Ciklit të Kreshnikëve dhe të këngëve arbëreshe për Skënderbeun, të cilat i botoi te vëllimi tashmë klasik "*Tregime të moçme shqiptare."* Autori shprehet: "*Aty bashkohen në një njësi të plotë epika dhe lirika, humori dhe tragjedia, tregimi dhe përshkrimi e dialogu, mençuria e popullit me kundrimin filozofik të jetës dhe të vdekjes, dhe sidomos trimëria dhe qëndresa e paepur në çast vështirësie*."[92]

Megjithatë ai i doli mbanë asaj pune të vështirë, duke u falur lexuesve ajkën e folklorit, trashëgimin artistik të shpirtit të popullit. "*Tregime të moçme shqiptare*" lexohet me ëndje nga të vegjël e të rritur, duke mbetur si model e pikë referimi për përpunimin e epeve dhe të mitologjisë sonë, dëshmia më e lashtë e identitetit tonë

[92] Mitrush Kuteli, "Tregime të moçme shqiptare", Tiranë, 2005, f. 14

kombëtar. Synimi i tij ka qenë modest, t'i njihte fëmijët me bukurinë e folklorit që t'i nxiste të lexonin foklorin origjinal, sapo të kapërcenin vështirësitë dialektore të gjuhës. Mirëpo me punën dhe talentin e tij, ai shkoi përtej synimit fillestar.

Në këtë vepër përmblidhen ristrukturime në prozë të baladave, legjendave e këngëve të visarit popullor. Siç ka vënë në dukje vetë shkrimtari në ngjallje të tij, frymëzimet e para i mori nga rrëfimet në vatrën e tij familjare, por edhe nga traditat folklorike shqiptare që ai kishte mbledhur vetë, si dhe nga përvoja krijuese e përkthimeve të teksteve letrare biblike të përshtatura nga Kostandin Kristoforidhi e Fan S. Noli.

Tradita folklorike, pothuajse në tërë prozën e Kutelit ka shërbyer shpesh si burim i drejtpërdrejtë për të gatuar frymëzimin e vet artistik jo vetëm te rrëfenjat, tregimet e novelat, por edhe në përmbledhjen *Tregime të moçme shqiptare*. Duke përpunuar e ritreguar thesarin e kulturës popullore, shkrimtari zotëron edhe një njohje të thellë të këtij visari popullor, sidomos në mënyrën e rrëfimit e të modelit popullor, subjekteve e detajeve artistike, motiveve e personazheve, përshkrimeve e peizazhit, në përshtatje edhe me psikologjinë e fëmijëve e të rinjve.

Proza kuteliane dallohet për lidhjen e saj të gjallë me traditën gojore, përrallën, legjendën e sidomos me baladën e Jugut, që ndikuan thellësisht në krijimtarinë e tij. Ky ndikim ndihet në mënyrën e dhënies së personazhit, në formën e shpalosjes së fantazisë e nostalgjisë, në mënyrën e trajtimit të motiveve e detajeve të shumta epike e lirike, të dhënies së botës shpirtërore, të personazheve, në ngjyrat e ndezura dhe tonet e ngrohta, në zhdërvjelltësinë e gjuhës, në humorin dhe ironinë e hollë dhe humanizmin e thellë. Asnjë prozator shqiptar nuk është mbështetur kaq fort te proza e pasur gojore e popullit, te balada e rapsodia. Fryt i përpunimit me mjeshtëri i materialeve folklorike ishte edhe vëllimi "*Tregime të moçme shqiptare*"(1965). Kuteli ka marrë prej këtij thesari popullor epikën legjendare e historike, ciklin e kreshnikëve, baladat e moçme arbëreshe, ngjarje nga Moti i Madh i Skënderbeut, të cilat i ritregon me bukuri e mjeshtëri artistike. Edhe në ato raste, kur balada apo rapsoditë nga vargu i tyre poetik janë ritreguar në prozë, fryma e tyre e përgjithshme, ngjarjet e detajet poetike, karakteristikat e personazheve, elementët mitologjikë, mjedisi ku veprojnë dhe aksionet e konfliktet ringjallin një botë të gjerë të moçme shqiptare.

Është diskutuar shumë nga kritika edhe çështja e ritregimit, rikrijimit kryesisht në vëllimin "*Tregime të moçme shqiptare*". Vetë autori në parathënien e këtij vëllimi ka shkruar: " *Unë i ktheva këngët në prozë që t'ua lehtësoj hë për hë kuptimin fëmijëve, por proza nuk mund ta përfshijë e ta pasqyrojë kurrë poezinë në tërë madhështinë e saj ritmike, mutikore, ndenjësore. Të përpiqesh ta kthesh këngën në tregim është, shpesh, pothuaj e njëjta gjë sikur të mundohesh të futësh qiellin në një shami".*[93]

Tregimet e Kutelit te kjo përmbledhje janë tërë frymëzim. Ai qe mahnitur vetë nga bukuria e poezisë popullore dhe iu fut punës ta konvertonte në prozë, në mënyrë që t'u jepte mundësi lexuesve të vegjël të njihen më herët me disa nga kryeveprat e folklorit.

Qëllimi i tij qe modest. E bënte këtë sakrificë që t'i nxisë fëmijët të lexojnë burimin origjinal, sapo të kapërcejë vështirësitë dialektore.

[93]Po aty, f. 13

Në veprën "*Tregime të moçme shqiptare*" të magjeps e të mahnit gjuha e pastër dhe e pasur, duke të tërhequr me magjinë e vet fjalë pas fjale dhe tregim pas tregimi. Nga ai "skelet" i mbetur i këngëve epike popullore, të cilat e kanë pasuruar me variantet e këngëtarëve të talentuar me ndjeshmëri poetike janë kthyer në një kompozicion me gjeturi të veçantë për secilin tregim, si në portretizimin e personazheve, ashtu dhe ne paraqitjen e ngjarjeve që lidhen me tregimin. Cdo tregim, i shkurtër apo i gjatë, ka një kompozicion – mbarështrim të nevojshëm, që ka fillimin, zhvillimin dhe mbarimin, si ngjarja, ashtu dhe personazhet e tregimit. Ai portretizon luftëtarin dhe heronjtë me të tëra tiparet shpirtërore dhe morale, me virtytet dhe veset e tyre, me dashurinë dhe urrejtjet – me bukuritë e natyrës piktoreske ku ata jetojnë, gjallërojnë, luftojnë dhe vdesin natyrshëm, por edhe tragjikisht apo heroikisht në fusha betejash. Ata kanë gëzimet dhe hidhërimet e tyre si çdo njeri, por gati të gjithë nuk vdesin me krye në jastëk. Ata kanë mençurinë që shfaqin në gjuhën e tyre të thjeshtë e të pasur, si shprehje dhe pasqyrim i mendjes së tyre të shëndoshë.

Mitrush Kuteli e ka pasuruar mjaft gjuhën e epikës sonë popullore. Mund të themi se është dëshmuar si artist i gjuhës sonë, që krijon neologjizma me një fjalor të pasur të shqipes, me një ritëm, me një muzikalitet, që edhe kur lexon në heshtje të tingëllojnë magjishëm fjalë pas fjale dhe tingull pas tingulli.

Proza "Tregime të moçme shqiptare" është aq sugjestive, aq e gjallë, aq tërheqëse, sa të krijon një atmosferë shpirtërore, dhe ti si lexues je një nga personazhet e asaj morie njerëzish të rritur dhe të edukuar, të pajisur me njohuri e aftësi për çdo veprimtari jetësore në një sistem patriakal, ku nuk ka institucione shtetërore.

Kjo trajtë proze e Mitrush Kutelit e bëri mitologjinë shqiptare më të gjallë, më tokësore, më të afërt, më të kapshme dhe më atraktive për brezat e rinj, që ta mbëltojnë veten me cilësitë më të larta njerëzore dhe kombëtare, për mbrojtjen e vendit (atdheut), për mbrojtjen e nderit personal dhe të anëtarëve të familjes.

Ai i mbeti besnik këngës, rapsodisë ose baladës, respekton me rigorozitet ndërtimin kompozicional, ruan radhën e episodeve, personazhet dhe cilësitë e tyre; ai asnjëherë nuk u orvat t'i shtojë diçka mesazhit a idesë që sjell folklori. E megjithatë, konvertimi i tij artistik ka ngjyresën e prozës dhe shijen e poezisë. Me sensin e tij prej prozatori me përvojë të pasur, ai mbush boshllëqet, kapërcimet karakteristike të folklorit, duke i lidhur episodet me logjikën e tregimit, duke ndërhyrë me pasazhe të domosdoshme, aty ku ia diktonte intuita artistike. Pasuria e madhe e gjuhës, e shprehjeve, njohja e mitologjisë dhe e historisë, shpjegimet që bën, dëshmojnë për një punë të kujdesshme e plot pasion.

Siç vlerëson studiuesi ynë Naum Prifti, "*Tregimet e moçme shqiptare" mbetet një nga vëllimet më të mira të përpunimit të trashëgimisë artistike gojore të popullit, e vështirë për t'u arrirë dhe e lakmueshme për t'u kaluar*[94].

[94] Nasho Jorgaqi, "Traditë e re, vepër e re" – DRITA, 3 prill 1988

KREU V

AUTORË TË LETËRSISË BASHKËKOHORE PËR FËMIJË

5.1 Tablo panoramike
5.2 Bedri Dedja – studiuesi e krijuesi shumëplanësh për fëmijë
5.3 Odhise Grillo – humoristi, përrallëtari dhe rikrijuesi
5.4 Petro Marko – romancieri evropian për fëmijë
5.4.1 *Shpella e piratëve* e Petro Markos dhe *Dy vjet pushime* e Zhyl Vernit
5.5 Adelina Mamaqi – poetja e moshës parashkollore dhe të ulët shkollore
5.6 Xhevat Beqaraj – poeti i peizazhit akuarelist
5.7 Gaqo Bushaka – babai i Çufos
5.8 Ferhat Çakërri - kontributi në letërsinë shqipe për fëmijë
5.9 Skënder Hasko – novelisti për fëmijë
5.10 Bardhyl Xhama – shkrimtari i detit
5.11 Tasim Gjokutaj – mjeshtri i vargut humoristik
5.12 Astrit Bishqemi – studiuesi, romancieri dhe prozatori fantastiko- shkencor
5.13 Xhahid Bushati – liriku i fëmijëve
5.14 Ferit Lamaj - fabulisti konçiz e tërë humor për fëmijë
5.15 Viktor Canosinaj – një zë i veçantë në prozën për fëmijë e të rinj
5.16 Disa veçori të krijimtarisë për fëmijë të poetit Bardhosh Gaçe
5.17 Andrea Petromilo - shkrimtari i plagëve të emigracionit
5.18 Vilhelme Vranari – idealizuesja e historisë së lashtë të popullit tonë
5.19 Fabulisti Pëllumb Velo

5.1 Vështrim panoramik

Letërsia moderne shqipe për fëmijë e të rinj u karakterizua nga arritjet të dukshme, duke krijuar dalëngadalë profilin e saj si degë më vete e letërsisë shqipe. U zgjerua dukshëm numri i shkrimtarëve, por edhe numri i veprave të botuara. Nga preokupimi folklorik, mënyra tradicionale e këngëtimit, u zhvillua edhe artikulimi modern i vjershave, i poemave, tregimeve, novelave e romaneve tona për fëmijë.

Le të ndalemi pak në këtë prodhim letrar sipas tipologjisë së tij.

Poezia: Dukuri pas Çlirimit është fakti që poezia nisi të lëvrohet më shumë nga gjinitë e tjera.

Për një kohë të gjatë, kur novela e romani nuk kishin lindur ende, asaj iu desh të luftonte pothuajse e vetme në frontin e gjerë të letërsisë për fëmijë. Autorët e parë që dolën me vëllime më vete ishin: Selman Vaqarri *Vjershat e një pionieri* (1947), Zihni Sako *Vjersha për të vegjël* (1949), Drago Siliqi *Zgjimi i pranverës* (1950), Luan Qafëzezi *Fluturo pëllumb i paqes* (1951), Spiro Çomorra *Një tufë vjershash* (1952) dhe *Shkolla jonë* (1954), Odhise Grillo *Shtatë ngjyrat* (1955); përmendim më tej vëllimet e shënuara: Dhimitër Pasko *Pylli i gështjenjave* (1958), Kol Jakova *Kopsht i*

lulëzuar (1958), Bedri Dedja *Numrat* (1959), Qamil Guranjaku *Xixëllonjat e vogla* (1959) etj.

Këtë traditë e çuan më tej në vitet ’70-’90 poetët Xhevat Beqaraj, Adelina Mamaqi, Ramadan Pasmaçiu, Bekim Harxhi, Tasim Gjokutaj, Ferhat Çakërri, Pandeli Koci etj. Këta sollën tematika të larmishme, këndvështrim original, figuracion të pasur, përdorim me sukses të detajit artistik, që është kaq i pëlqyeshëm nga lexuesi i vogël. *Pavarësisht nga arritjet e poezisë për fëmijë, studiuesja Klara Kodra*[95] *analizon disa nga të metat e saj, siç janë: didaktizmi dhe karakteri përshkrues; mostrajtimi sa duhet i larmisë së kontradiktave që karakterizon realitetin tonë; heronj e personazhe të zbehtë, që ngjasin me njëri-tjetrin dhe që shpesh veprojnë sipas dëshirës së autorit dhe jo sipas logjikës së brendshme të karakterit të tyre; janë ende të pakta vjershat për natyrën, të cilat duhet të lidhen më tepër edhe me pasqyrimin e punës ndërtimtare të njeriut tonë të ri.*

Krahas poetëve për fëmijë një ndihmesë të veçantë në zhvillimin e letërsisë shqipe për fëmijë dhe të rinj në vitet ’80 dhanë dhe shumë autorë që vinin nga letërsia për të rritur: Xhevahir Spahiu, Moikom Zeqo, Llambro Ruci etj. Këta ishin poetë të afirmuar dhe sollën në poezinë për fëmijë tema e këndvështrime të reja, figuracion të pasur, sidomos metafora, detaje e mbresa interesante të vjela nga jeta etj.

Më tej në poezinë për fëmijë hynë edhe poetë të tjerë të talentuar, të cilët ecën me traditat më të mira dhe i çojnë më përpara ato dhe premtojnë në të ardhmen. Për shembull, përmendim: Hamdi Meçen, Ferit Lamajn, Xhahid Bushatin, Bardhosh Gaçen etj.

Poezia, mbetet lloji më i parapëlqyer në letërsinë për fëmijë, sipas grupmoshave të caktuara. Një varg individualitetesh kanë dhënë e japin ndihmesën e tyre në zhvillimin e mëtejshëm të saj përsa i përket mjeshtërisë artistike. Veçanërisht arritje kemi në poezinë për lexuesit e moshës parashkollore e të moshës së ulët shkollore. Poezia për fëmijë është shkruar përgjithësisht me varg të matur, me rimë e ritëm. Është manifestuar edhe vargu i lirë, i cili në letërsinë bashkëkohore për të rritur gjen dita-ditës masivizëm, kurse në letërsinë për fëmijë kjo dukuri përparon shumë ngadalë.

Tematika e vëllimeve poetike për të vegjëlit ka qenë e gjerë dhe e lidhur ngushtë me problemet e kohës. Tema e afërt me botën e fëmijëve ishte ajo e lodrave. Loja është një ndër efektet më interesante që ka tërhequr vëmendjen e pedagogëve, psikologëve, shkrimtarëve, piktorëve etj. Estetika bashkëkohore e konsideron lojën si teorinë më moderne estetike të shekullit tonë.

Shumë poezi për fëmjë e marrin temën nga jeta e përditshme e vetë fëmijëve në shkollë e jashtë saj. Poezi të tilla janë të pëlqyeshme nga lexuesit, se në to ata gjejnë vetveten dhe janë mjaft edukuese për fëmijët. Një vend të veçantë zënë edhe vjershat që kanë për temë natyrën, një temë të cilës poetët i kanë kënduar herët. Ato edukojnë dashurinë për vendin tonë, sjellin informacion për dukuritë e saj, i mësojnë lexuesit fëmijë si t’i zbulojnë e t’i vlerësojnë bukuritë e saj.

[95] Kodra, Klara. Poezia për fëmijë – pjesë e pandarë e poezisë sonë. Drita, 1977, 10 Korrik.

Poezia humoristike është një tjetër zhanër i preferuar dhe që pëlqehet nga fëmijët. Dihet se humori ka vlera të mëdha për edukimin e argëtimin e fëmijëve, të cilët nga vetë natyra priren drejt së qeshurës.

Udha e zhvillimit të poezisë sonë për fëmijë është e gjatë dhe komplekse. Kjo poezi kurdoherë ka qenë e lidhur me jetën politiko-shoqërore, ekonomike e kulturore të popullit tonë. Edhe në vitet e shndërrimeve demokratike ajo filloi t'u këndonte dukurive të reja që siç shprehet edhe shkrimtari për fëmijë Odhise Grillo: *Letërsia e sotme për fëmijë, më në fund u zhvesh nga ajo pedagogji tejet e rënduar, dhe tejet e mbrapshtë, me elementë moralizues e ngurtësues në jetën e të vegjële* etj[96] .

Gjatë viteve '90 emigruan disa autorë, si: Naum Prifti, Adelina Mamaqi, Ivoni Reso, Ramadan Pasmaçiu, Foto Malo, Themi Bello, Aleksandër Babe, Andrea Petromilo, Petro Çerkezi, Ferdinand Laholli etj. (ndonjëri, si Ramadan Pasmaçiu, Adelina Mamaqi, Andrea Petromilo etj. edhe u kthye më vonë).

Kjo dukuri nuk ishte e re për popullin shqiptar. Ndaj me temën e kurbetit në letërsinë tonë në përgjithësi e në poezi në veçanti , gjinden shumë krijime. Krahas kësaj teme, në këto vëllime zënë vend edhe të tjera për dukuritë e reja të jetës së sotme.

Në anën kualitative të vjershërimit për fëmijë zunë vend larmia tematike, përdorimi i humorit, lodërtimit të vargjeve dhe fantazinë fëminore. Në vjershat dhe poemat e Odhise Grillos ka mjaft vargje të bukura, të thurura duke u mbështetur në motivet popullore.

Në vjershat e Ferhat Çakërrit e Tasim Gjokutaj vihet re prania e humorit, e cila krijon situata humoristike për fëmijët. Në vargun poetik të Adelina Mamaqit, krahas fjalëve të mençura e të urta, ka ngrohtësi e detaje poetike që u mbeten në mëndje fëmijëve për ndijime e perceptime të thella. Bedri Dedja me zotësi përfshin në vargun e tij, tema shoqërore duke vizatuar mjedisin dhe jetën e fëmijëve. Ndërsa Xhevat Beqarajt në botëpërjetimet e veta poetike shpalos peizazhe e mjedise poetike të natyrës shqiptare.

Fabula. Një vend të veçantë në artin poetik për të vegjëlit zë edhe lëvrimi i fabulave në vargje, traditë kjo e krijuar herët nga rilindësit tanë të mëdhenj Naim Frashëri, Andon Zako Çajupi, Papa Kristo Negovani, të cilët krahas dashurisë për mëmëdheun dhe virtytet njerëzore, në vargjet e tyre fshikulluan edhe veset e zakonet e këqia si: gënjeshtra, mëndjemadhësia, përtacia,.

Pas Çlirimit fabula, sidomos ajo origjinale, vazhdoi të kultivohet me sukses nga shumë autorë. Edhe për vetë rolin që luan fabula, ajo është një lloj krijim artistik polivalent në lidhje me lexuesin. Atë e lexojnë me kënaqësi jo vetëm të vegjlit, por edhe të rriturit. Kjo shpjegohet me faktin se fabula ndërtohet me personazhe kafshë dhe aludimi i saj për dukuri shoqërore e bën atë sa konkrete, të thjeshtë, të kapshme, aq dhe abstrakte, të përgjithshme e filozofike në trajtimin e dukurive të jetës. Kështu, për shembull në kohën e diktaturës moniste fabula qe ndoshta një nga llojet letrare pararojë që goditi shumë shfaqje negative të atij sistemi. Le të kujtojmë fabulën e Dritëro Agollit *Kali e gomari*, që stigmatizon injorancën, plogështinë e paaftësinë e njerëzve që ishin në krye të çdo sektori të jetës shoqërore e ekonomike.

[96] Grillo,Odhise: DRITA, 16 korrik 1995.

Fabula në këto vite u lidh ngushtë me realitetin dhe na dha aspekte të ndryshme nga jeta jonë. Ajo u pasurua kësisoj në përmbajtje dhe në formë, gjeti mënyra interesante shprehjeje.

Ndër fabulistët më të suksesshëm përmendim: Nonda Bulka, Spiro Çomora, Dritëro Agolli, Gjikë Kurtiqi. Kulmin e arritit me fabulistin Ferit Lamaj.

Fabula si lloj i shkurtër letrar, lidhet me problemet më universale të jetës, ndaj edhe krijimet e shkrimtarëve tanë në këtë fushë janë të ngjashme me fabulën botërore, personazhet e fabulave tona janë më tepër nga bota shtazore sesa bimore, struktura kompozionale e krijimeve tona fabuleske është në pjesën më të madhe ajo e trashëguar qysh nga Ezopi: parashtrim, konflikt dhe zgjidhja e veprimit. Edhe fabulat tona kanë karakter personifikues e alegorik, vëllim të kufizuar. Moralizimi jepet në fund të krijimit përdoret shumë dialogu, kanë atmosferë satiriko-humoristike etj.

Poema. Një zhvillim të veçantë njohu lëvrimi i poemës për të vegjëlit. Është një lloj letrar i bukur dhe i admirueshëm për lexuesit. Kjo gjini e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, duke qenë se nuk trashëgoi ndonjë traditë letrare nga e kaluara, nisi lëvrimin e saj pas Çlirimit.

Kështu, në fund të viteve ’50 e sidomos gjatë viteve ’60, rendja pas përrallës popullore të vargëzuar ra disi dhe nisën të botohen përralla në vargje, që ishin krijime të vetë autorëve. Tanimë poetët i krijonin vetë fabulat e këtyre poemave-përrallë duke u nisur nga problemet që u diktonte koha e duke i marrë temat nga realiteti. Një botim i tillë qe poema *Orizi i milingonave* (1965) e Adelina Mamaqit, që i fut fëmijët në një botë interesante, në shtëpinë e milingonave. Poema të tjera të këtij lloji janë: *Shkolla e pyllit* (1967) e Bedri Dedjes, që ngre rëndësinë e dashurinë për mësimin. Përmendim gjithashtu edhe *Elefanti dhe milingonat* Xhevat Beqarajt, ku del qartë se i vogli, kur ka të drejtë, e mund të madhin etj.

Përralla në vargje ka patur zhvillim të pandërprerë dhe shumë autorë kanë botuar krijime me vlera të qëndrueshme ideoartistike, si: Tasim Gjokutaj me *Derrkuci që bëri dush*, Xhahid Bushati me *Zogu Verdho*, Ferhat Çakërri me *Pula klloçkë bën vizita* etj.

Te poema- përrallë mund të renditim edhe një nënlloj të saj, që zakonisht e merr lëndën nga baladat apo legjendat e lashta a të vona. Tipike për këtë është poema *Princesha Argjiro* (1958) e Ismail Kadares, një poemë e frymëzuar nga legjendat. Nga legjendat popullore është frymëzuar edhe poeti Odhise Grillo për poemën *Legjenda e një shkëmbi*, ku tregohet për një çoban të ri, i cili, për të mos u dhënë ujë pushtuesve, shndërrohet në shkëmb etj.

Në rrugën për zhvillimin e poemës sonë për fëmijë, një drejtim i ri ishte krijimi i tregimeve në vargje, ku rol kryesor luan fabula, ndërsa vargëzimi i tyre mbetet një element formal. Përmendim autorë të njohur, si: Luan Qafëzezi me *Tregim partizan*, Ramadan Pasmaçiu me *Kasollja* etj.

Në lëvrimin e poemës për fëmijë, vihen re tipare të saj: ai i lëvrimit të poemës së mirëfilltë, si i poemës me subjekt, ashtu edhe asaj mediative. Këtë rrugë e çeli Drago Siliqi, i cili botoi i pari në gjininë e poemës për fëmijë, më 1949, atë me titull *Brigadierja*. Edhe pse ka mjaft elementë socrealistë, u çel udha e poemës me subjekt që u pasua edhe nga autorë të tjerë. Poemat tona të mirëfillta për fëmijë, ashtu si poemat për të rriturit, u ndërtuan mbi bazën e një fabule të përcaktuar mirë, prandaj u

quajtën edhe poema me subjekt. Poema të tilla me subjekt u ndoqën më vonë edhe nga *Erdhi dita jonë* e Aleks Çaçit, *Lart në mal* e Ramadan Pasmaçiut, *Shkronjëzat e arta* e Musa Vyshkës etj.

Në vitet ’70, dalëngadalë vendin e poemës me subjekt po e zinte e ashtuquajtura poemë mediative (ose sintezë), e cila e çoi në lartësi të reja artin poetik të fëmijëve. Kjo erdhi si pasojë e dy faktorëve me rëndësi: si domosdoshmëri në zhvillimin e mëtejshëm të poemës sonë për fëmijë, dhe si ndikim i poemës së të rriturve. Të dyja rrugët janë të pranueshme.

Në poemat mediative ngjarjet nuk përshkruhen të plota qysh nga fillimi e gjer në fund, por nëpërmjet një subjekti disi të copëzuar, jepet një sintezë e tyre, jepen ndjenjat, mendimet dhe veprimet e heroit. Ato u drejtohen zakonisht moshave më të rriturve të 9-vjeçares, por lexohen me ëndje edhe nga të vegjlit. Për zhvillimin e mëtejshëm të poemës mediative një ndihmesë të madhe dhanë disa autorëve që kryesisht merren me poezinë për të rritur, por që ndonjëherë krijojnë edhe për të vegjëlit, si: Ismail Kadare me *Gurgdhëndësit*, Dritëro Agolli me *Poemë për babanë dhe për vete*, Pano Çuko me *Fundi i një legjende të vjetër*, Moisi Zaloshnja me *Deti nën Tomorr*, Bedri Dede me *Artan Borizani dhe çeta e tij*, Adelina Mamaqi me *Zjarret në Drashovicë*, Ramadan Pasmaçiu me *Sa mirë* etj.

Proza në letërsinë shqiptare për fëmijë pas Luftës së Dytë Botërore është një nga gjinitë që ka ecur me hapa të sigurtë e të shpejtë. Arritjet e saj ka qenë jo vetëm sasiore, po edhe cilësore. Krahas skicave, përshkrimeve e tregimeve të shkurtra, në vitet ’70-’90, ajo o pasurua me vepra të prozës së gjatë, novela e romane. Madje filloi të lëvrohet edhe proza artistiko-shkencore.

Në zhvillimin dhe pasurimin e prozës së re për fëmijë kanë dhënë ndihmesë shkrimtarët: Zihni Sako, Teufik Gjyli, Fatmir Gjata, Sterjo Spasse, Dhimitër Shuteriqi, Aleks Çaçi, Nasho Jorgaqi, Petraq Zoto, Naum Prifti, Odhise Grillo, Skënder Hasko me novelat, Bedri Dedja, Gaqo Bushaka, Petraq Qafëzezi me romanet, në të cilat u trajtuan tema e luftës dhe tema e jetës së sotme të fëmijëve. Në prozën artistike shkencore u shquan: Flamur Topi, Astrit Bishqemi, Thanas Qerama, Bardhyl Xhama etj.

Në letërsinë bashkëkohore për fëmijë mjaft shkrimtarë kanë bërë përpjekje të sjellin një fond të pasur të **tregimit** dhe në tërësi të prozës së shkurtër. Periudha e pasçlirimit solli shkallë-shkallë pjekurinë artistike të tregimit. Për vetë natyrën e tij si lloj letrar i shkurtër, tregimi iu përgjigj flakëpër flakë aktualitetit, duke sjellë temën e re, të ashtuquajturin hero pozitiv dhe frymë edukative. Në shekullin XX dhe fillim i shekullit XXI tregimi ka përftuar mjaft vlera të arrira artistike e estetike, duke kapërcyer edhe mangësitë e foshnjërisë së vet, si: skematizimin, moralizimet, përshkrimet e thata dhe mungesën e psikogjisë fëminore.

Ndihmesë të veçantë në zhvillimin e tregimit kanë dhënë shkrimtarët: Dhimitër Shuteriqi, Strerjo Spasse, Nasho Jorgaqi, Odhise Grillo, Gjergj Vlashi, Loni Papa, Petraq Zoto, Aqif Malaj, Gaqo Bushaka, Naum Prifti, Skënder Hasko, Bardhyl Xhama, Astrit Bishqemi, Flamur Topi, Andrea Petromilo etj.

Tipar dallues i tregimeve të tyre është larmia tematike dhe pasqyrim i botës fëminore në përshtatje me moshën dhe psikologjinë e tyre. Tregimi për të vegjlit

paraqitet i thjeshtë, pa shumë zgjatje, me fabul interesante e integruese, plot dinamizëm e ngjyrim artistik, me personazhe të skalitur etj.

Rritja sasiore e tregimit ka sjellë pjekurinë artistike, larminë e stileve, po edhe gjerësinë tematike. Krehas evokimit të luftrave për liri e pavarësi kombëtare, një vend të veçantë në tregime zë dhe tema aktuale, ku gdhenden portretet e personazheve fëmijë, si dhe mjedisi shoqëror i tyre.

Në këtë proçes të zhvillimit të tregimit, tashmë mjaft shkrimtarë kanë formuar edhe individualitetin e tyre krijues. Paverësisht këtyre arritjeve, vlen të theksojmë se në vështrimin e përgjithshëm artistik e estetik, si pjesë e letërsisë socrealiste, tregimi për të vegjlit mbart edhe kufizimet e veta, ku shpesh autorët priren të japin personazhe "ideale", pa të meta, duke mos i motivuar artistikisht.

Novela është një nga gjinitë interesante të letërsisë për fëmijë. Fillesat e saj janë që më 1946, pra shumë më shpejt sesa romani për fëmijë. U desh të kalonte një dhjetëvjeçar me vështirësitë e veta, që ajo të niste rrugën e mbarë e të krijonte një fizionomi me vlera të rralla artistike dhe estetike duke përparuar si në brendi ashtu dhe në formë.

Novela e parë që u botua pas Çlirimit qe ajo e Aleks Çaçit me *Na hoqën çatinë* (1946).

Një ndihmesë në zhvillimin e novelës shqipe kanë dhënë dy shkrimtarë që botuan novela-përrallë të tyre në vitin 1954: Teufik Gjyli me *Kacamisri* dhe Bedri Dedja me *Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit*. Pastaj, më vonë pasojnë dhjetëra novela për fëmijë: *Pushkë në bregdet* e O. Grillos, *Cikoja dhe Beni* e N. Priftit, *Mëngjese lufte* e Dh. Xhuvanit, *Ariu artist* e G. Bushakës, *Një gjeneral kapet rob* e S. Haskos, *Zogu Pup në shtëpinë prej xhami* e A. Mamaqit etj. Me novelën janë marrë disa nga autorët tanë më të mirë të letërsisë për fëmijë, madje ata i janë futur asaj kur kanë qenë në rrugën e pjekurisë.

Ndryshe nga lëvrimi i tregimit për të vegjlit, novela për fëmijë, në rrugën e vet të pasurimit, ka mundur të shmangë didaskalizmin dhe moralizimet. Krahas temës historike, në novelën shqiptare për fëmijë zë vend edhe jeta në shkollë e në familje, marrëdhëniet me njëri-tjetrin, prindërit e mësuesit, si dhe zhvillimet e jetës shqiptare. Krahas novelës me ndërtim klasik u zhvillua edhe novela epistolare, novela-përrallë, novela animalistike, novela fantastiko-shkencore dhe novela e dramatizuar.

Romani për fëmijë luajti një rol të veçantë në pasurimin e prozës së gjatë, duke tërhequr botën fëminore me subjektet, tablo, personazhet dhe përdorimin e mjeteve të larmishme artistike.

Romani ynë për fëmijë është i ri në moshë. Zuri fill vetëm në vitet pas Çlirimit. Përpjekjet e para për të lëvruar prozën e gjatë në letërsinë shqiptare për fëmijë pas Çlirimit janë bërë nga autori i ri Selman Vaqarri në vitin 1947, i cili botoi romanin *Pesë vllazën*, një krijim realist, që i merrte ngjarjet nga jeta e fëmijëve në dy vitet e para të Çlirimit.

Dalëngadalë, në vitet '70-'90 romani po formësohej, me stile nga më të ndryshmet, gjë që dëshmon për origjinalitet e larmi. Tërhoqën vëmendjen e lexuesit mjaft shkrimtarë të mirënjohur, si: Gaqo Bushaka, Bedri Dedja, Sulejman Krasniqi, Rifat

Kukaj, Ymer Elshani, Gjergj Vlashi, Sokol Jakova, Aqif Malaj, Gani Xhafolli, Petro Marko,Viktor Canosinaj, Skënder Hasko, Pandeli Koçi etj etj.

Në romanet e tyre u krijuan një galeri personazhesh fëmijësh të zgjuar e të shkathët, me botë të pasur shpirtërore, të sinqertë e punëtorë. Nëpër romane veprojnë edhe të rriturit, duke krijuar figura mësuesish të përkushtuar në edukimin e brezit të ri, të lidhur ngushtë me nxënësit e prindërit e tyre. Në teknikën e këtij zhanri, autorët kanë dhënë ndihmesë konkrete në strukturën kompozicionale, në shtruarjen dhe gërshetimin e linjave të subjektit etj. Për lexuesit e moshave të vogla përgjithësisht është përdorur një kompozicion i thjeshtë me strukturë lineare. Në romanet që u adresohen fëmijëve të një moshe më të rritur, subjekti është thurur në disa linja, pra me strukturë më të ndërlikuar.

Në tematikën e romanit për fëmijë një vend të veçantë zë shpirti liridashës i shqiptarëve, lashtësia ilire, luftrat dhe bëmat e Skënderbeut, pra tema historike, të cilat kanë ndikuar në edukimin ideoemocional të lexuesve. Vend të rëndësishëm zënë romanet që e marrin temën nga periudha e Luftës Antifashiste, por që shumica e romaneve janë ndërtuar dhe si kronika dhe rrëfehen në vetën e parë, si kujtime të asaj kohe. *Gjithashtu siç thekson Sokol Jakova*[97] *se vëmendja e shkrimtarëve, që janë marrë me romanin për fëmijë, është përqendruar kryesisht në dy aspekte të jetës dhe të veprimtarisë së fëmijëve: në paraqitjen e ngjarjeve të Luftës Nacionalçlirimtare e sidomos të heroikes së saj, ku bie në sy pasqyrimi i kontributit të të vegjëlve në këtë luftë, si dhe në pasqyrimin me ngjyra sa më realiste të jetës e të veprimtarisë së tyre në vitet e Pasçlirimit.*

Tema bashkëkohore në letërsinë tonë për fëmijë është rrahur dhe nga një tjetër tip i prozës së gjatë, nga romani-përrallë. Përmendim këtu serinë e romaneve për aventurat e Çufos të Gaqo Bushakës, ku bëjnë pjesë katër libra: *Çufoja dhe Bubi kaçurrel* (1978), *Pushimet e Çufos* (1983), *Çufoja në shtëpinë e çudirave* (1985) (të tre këta romanë u ribotuan më 1987 me titull *Aventurat e Çufos*) dhe *Filmi i gjeneral Çufos* (1994).

Zhvillim mori dhe romani fantastiko-shkencor, ku në qendër të tyre është bota fantastike e shkencore mbështetur në të rejat e teknikës dhe kuriozitet shkencore që ushqejnë tek femijët njohuri dhe dituri shkencore, krahas vlerave artistike e estetike. Të tillë janë romanet: *Nëpër korridoret e thella të Jonit* (1978) e B. Dedjes, *Lufta për jetën* (1978) e F. Topit, *Ekspedita e kaltër* (1982) e B. Xhamës etj në të cilat me art jepen ngjarje e njohuri shkencore pasurojnë botën e fëmijëve dhe nxitin fantazinë e tyre.

Një zhanër i ri i prozës së gjatë është romani i ritreguar. Meritë në këtë zhanër ka shkrimtari i mirënjohur Odhise Grillo. Në vitin 1987 ai botoi romanin *Historia e Skënderbeut*, rikrijuar sipas poemës klasike të rilindasit të madh Naim Frashëri. Këtë traditë autori do ta vazhdonte edhe me romanet *Lahuta e malësisë*, rikrijuar sipas poemës homerike të Gjergj Fishtës, *Don Kishoti i Mançes* të Servantesit nga letërsia botërore etj.

Në këtë dhjetëvjeçar u botuan romane realiste e fantastike. Romanet realiste trajtuan temën e jetës në vitet e rënda të monizmit. I tillë është romani *Qyteti me tri*

[97] Jakova, Sokol. Në rrugën e zhvillimit të romanit për fëmijë. – Drita, 1976, 11 Janar, f. 3, 14.

kështjella i Bedri Dedes apo edhe të viteve të tranzicionit *Zemër, o bir*! i Astrit Bishqemit.

Në prozën e shkurtër, u zhvillua edhe **përralla e kultivuar** për fëmijë. Relativisht është e re por që zanafillën e vet e ka nga letërsia popullore. Qysh në letërsinë e Rilindjes sonë Kombëtare u bënë përpjekje për kultivimin e përrallës për fëmijë. Gjithashtu këtë traditë e vazhduan: Shkrimtarja Musine Kokalari, doktoresha e parë shqiptare për fëmijë dhe themeluesja e këtij zhanri, me librin e saj *Rreth vatrës* (1944), i cili që përmbledhje përrallash të përpunuara për fëmijë.

Selman Vaqarri me veprën *Njeriu që donte të rrinte i vetëm* (1947). Në vitet ’50 e këtej përralla u bë një nga nënllojet më të lëvruara. Kështu përmendim vëllimin *Përralla popullore mbi kafshët* (1957) e Bedri Dedjes, *Xinxifillua* e Dhimitër Paskos etj.

Gjatë përpunimit, në të shumtën e rasteve, shkrimtarët i zgjeruan subjektet e përrallave, u dhanë frymë aktuale, thelluan anë të veçanta të përmbajtjes shoqërore, i përshatën ato edhe në vargje të bukura, me elemente të reja alegorike e gjuhë të pasur, duke ua shtuar vlerat ideoartistike.

Veç përrallave të mirëfillta, disa autorë përzgjodhën nga pasuria folklorike e popullit tonë edhe fabula dhe legjenda, të cilat i përpunua. Këtë rrugë ndoqën jo vetëm Vehbi Bala, Alqi Kristo, Spiro Çomorra etj, o edhe më të rinjtë, si: Jani Duri, Themi Bello, Hamdi Meçaj etj.

Në vitet ’70-’90 të shekullit XX, përralla e kultivuar për fëmijë njohu zhvillimet e veta, duke krijuar tipe interesante të përrallës me prirje moderniste. Në përrallat e tyre mjaft autorë, si: Bedri Dedja, Naum Prifti, Odhise Grillo, Adelina Mamaqi, Gaqo Bushaka, Gjergj Vlashi, Bardhyl Xhama, Ferhat Çakërri, Astrit Bishqemi, Shpresa Vreto, Ramadan Pasmaçiu, Xhahid Bushati etj, kanë ndërthurur raporte të drejta midis fantastikes dhe reales, duke nxitur tek të vegjëlit fantazinë e imagjinatën si dhe duke i ushqyer me vlera estetike.

Drama. Në letërsinë shqipe për fëmijë, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe rolin që ka luajtur drama. Në fakt, tradita që trashëgoi nga e kaluara është shumë e pakët. Përmendim ndonjë pjesë të shkurtër, të shkruar nga mësuesit patriotë të shkollave të para shqipe, si: Koto Hoxhi, Gjerasim Qiriazi, Petro Nini Luarasi etj ato kishin karakter didaktik dhe përmbajtje të thellë atdhetare. I quanin bashkëfjalime dhe i luanin në ditët e mbylljes së shkollës.

Studiuesi Javer Karalliu, duke treguar historikisht rrugën e zhvillimit të dramaturgjisë për fëmijë, pohon se, para Clirimit, dramaturgjia për fëmijë mbeti spontane, e zbehtë, pa ndonjë zhvillim serioz. porlulëzimin e saj të vrullshëm e shohim pas Clitimit të vendit[98].

Hapat e parë drama i hodhi gjatë Luftës Antifashiste ku u shkruajtën disa pjesë që trajtonin temën e luftës. Nëpërmjet tyre përmendim: *Aeroporti* (1980) i Ismail Kadaresë, *Zani partizani* i Naum Priftit, *Vajza me fjongo të kuqe* e Adelina Mamaqit etj. Dramat me këtë temë i shërbejnë edukimit atdhetar të fëmijëve dhe pëlqehen

[98] Karalliu, Javer. Rrugët e zhvillimit të dramaturgjisë sonë për fëmijë. – Bota e fëmijëve, 1874, nr. 4, f. 63-67.

shumë prej tyre, sepse kanë konflikt të mprehtë e aksion të gjallë. Por nuk u harrua edhe tema e Luftës Antifashiste, me të cilën u shkruan shumë vepra.

Në vitet ’70 tema aktuale u bë edhe më e pranishme në dramaturgjinë tonë për fëmijë. Në këto vite filluan të kapërcehen edhe dobësitë e para të karakterit publicistik e deklarativ. Dramaturgët futen më shumë në botëkuptimin e psikologjinë e fëmijëve si për shembull: Bedri Dedja në pjesën për teatrin e kukullave *Kryengritje në pallat* (1971), ku godet veset e fëmijëve. Në pjesën teatrore *Krahu i thyer* (1978) autoren Shpresa Vreto e shqetëson një problem etik te fëmijët, ai i ndershmërisë që duhet t’i karakterizojë, i ndërgjegjes së pastër.

Një temë tjetër e trajtuar nga dramaturgjia jonë për fëmijë që ka shënuar kulme cilësore është tema historike. Pjesë të tilla teatrore zgjojnë interes te të vegjlit për vetë informacionin e pasur që sjellin. Krahas dramës realiste u kultivua edhe drama fantastike, me elementë përrallorë e fantastikë. Të tilla janë: *Bardho-Bardhoshi* e Zihni Sakos, *Gjyqi i Maçokut* e Bedri Dedjes.

Dramaturgjia për fëmijë u rrit duke shmangur mangësi të tilla, si: skematizmi, melodramatizmi, vizatimi i dobët i personazheve dhe fryma publicistike e saj.

Një kontribut të veçantë në zhvillimin e dramaturgjisë për fëmijë ka dhënë edhe Teatri Kombëtar i Kukullave në Tiranë, i themeluar në dhjetor të vitit 1950. Më vonë u ngritën edhe nëpër rrethe. Kjo i dha nxitje shkrimit të pjesëve tetrore me kukulla.

Në fillim u vunë në skenë disa pjesë të përshtatura, më pas të autorëve tanë, si: *Biçikleta e postierit* e Pandi Stillut, *Dysh në aritmetikë* e Tonin Shirokës, *Bariu dhe partizani i vogël* e Xhavit Sallakut, *Gjysmagjeli* e Moisi Zaloshnjes etj.

Duhet thënë se gjinia e dramës gjatë viteve ’90 pati rënie. Kjo erdhi për vet faktin se shkollat e qëndrat kulturore të fëmijëve nuk i kushtuan më rëndësinë e duhur lëvizjes amatore teatrore. Gjithashtu nuk funksionuan edhe tetrot amatore të kukullave që qenë ngritur nëpër disa qytete kryesore të vendit.

x x x

Letërsia e sotme shqipe për fëmijë e të rinj paraqitet e kompletuar si një nënsistem që zhvillohet në mënyrë të pavarur në kuadër të sistemit të letërsisë së përgjithshme.

Një pjesë e mirë e shkrimtarëve kanë vijuar traditën duke përhapur dije e kulturë. Natyrisht, kjo krijimtari u karakterizua nga arritje të dukshme, duke krijuar profile dhe individualite krijuese.

Përmendim këtu autorë përfaqësues të poezisë dhe prozës moderne shqipe për fëmijë si: Petro Marko, Bedri Dedja,Odhise Grillo, Skënder Hasko, Xhevat Beqaraj, Adelina Mamaqi, Astrit Bishqemi, Gaqo Bushaka, Tasim Gjokutaj, Bardhosh Gaçe, Xhahid Bushati, Ferit Lamaj, Viktor Canosinaj etj.

Le të shohim ndihmesën që kanë dhënë dhe japin disa prej shkrimtarëve dhe studiuesve në fushën e letërsisë për fëmijë e të rinj.

5.2. BEDRI DEDJA (1930-2004) – Studiuesi e krijuesi shumëplanësh për fëmijë

Shkrimtari dhe pedagogu, Profesor Bedri Dedja është një nga figurat më të dalluara dhe të dashura të letërsisë bashkëkohore shqiptare për fëmijë. Këtë e dëshmon numri i madh i veprave të tij letrare për fëmijë, si: përmbledhjet me poezi, tregime, përralla, tregime fantastike-shkencore, novela, romane dhe shume studime[99].

Krijimtaria 50-vjeçare e këtij autori përbën një pasuri të çmuar në letërsinë e sotme për fëmijë, një "bibliotekë" më vete për lexuesit e vegjël dhe një pikë referimi për krijuesit e rinj[100].

Vepra e parë e shkrimtarit Bedri Dedja është novela "*Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit*", botuar në vitin 1954. Një novelë fantastike me subjekt origjinal, ku përshkruhen bëmat e guximshme që kryen heroi në botën e përrallave, ku e çon ëndrra e tij e shqetësuar. Fatbardh Pikaloshi u bë një personazh shumë i njohur në letërsinë për fëmijë të atyre viteve me heroizmat dhe aventurat e tij të çuditshme. Shkrimtari, duke e çuar personazhin e Fatbardh Pikaloshit në botën e përrallave e fut lexuesin në një botë magjike, për të ndërtuar të ardhmen: "*Republikën Demokratike*". Personazhet e tjerë të kësaj novele si: Shtatëpëllëmbëmjekra e Trepëllëmbëtrupi, Katallan Syzjarri etj., janë përftuar nga folklori, i cili ndikon mjaft në karakterizimin e aventurave të personazhit kryesor. Gjithsesi, ai është një personazh që, ndonëse në shumë raste manifeston qëndrime e sjellje të pahijshme ndaj shokëve, prindërve e shkollës, me pendesën dhe reflektimin ndaj këtyre shfaqjeve negative, por edhe me veprimet e tij të guximshme për të shpëtuar të varfrit nga shtypja dhe shfrytëzimi i të pasurve, fiton simpatinë dhe admirimin e lexuesve të vegjël. Siç shihet, heroi i veprës përfaqëson fëmijën e ditëve tona, që mendon, ëndërron dhe vepron në përputhje me kërkesat e moralit bashkëkohor.

---

[99] Bedri Dedja ka lindur në Korçë më 1930. Shkollën fillore e kreu në Shkodër, të mesmen në Durrës, kurse studimet universiteti për pedagogji dhe letërsi për fëmijë i kreu më 1953, në Universitetin e Moskës ku edhe u specializua. Emri dhe vepra e tij zënë fill që nga vitet '50, kur nisi të shkruajë e të botojë letërsi për fëmijë. Deri tani shkrimtari Bedri Dedja ka botuar një numër të madh veprash dhe këtu dë të përmendim vetëm disa nga kjo listë e gjatë si: "Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit", "Përralla popullore mbi kafshët", "Një udhëtim i rrezikshëm", "Shkolla e pyllit", "Kapiteni i shtrëngatës", "Kryengritje në pallat", "Republika e 1100 çudirave", "Beni shkon në malësi me familje e shtëpi", "Nëpër korridoret e thella të Jonit", "Shoku i braktisur", "Përtej portës së shekullit", "Ushtari trim prej plumbi", "Si u rrit një komisar", "Alarmet e qyteti Sdikuisht" etj.
Si dhe veprat me vështrime, artikuj e studime si: "Letërsia për fëmijë për shkollat pedagogjike", "Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë", "Shkrime mbi letërsinë për fëmijë" etj.
Gjithashtu, mund të përmendim dhe kontributin dhe rolin e padiskutueshëm në fushën e përkthimeve, hob ky që shfaqet që në moshë të re. Përmendim këtu përkthimet nga gjuha ruse:
Lev Tolstoi: Tregime dhe përralla për fëmijë (1954), Robi i Kaukazit (1959).
V. Majakovski: Për fëmijët (1954); Lexo, shëtit e fluturo (1958); Ç'është mirë e ç'është keq (1966)
Nikolla Nosov: Tregime (1964), Aventurat e Dinpakut dhe të shokëve të tij (1957)
Mark Tuein: Aventurat e Tom Sojerit (1955)
A.S. Pushkin: Përralla e Peshkatarit dhe e Peshkut (1956)
H.K. Andersen: Përralla (1956)
Maksim Gorki: Jashka; Samovari (1957)
Sharl Pero: Maçoku me çizme
Përralla ruse (1998, përshtatje e shqipërime nga 18 autorë) etj.
Ka qenë një autor me kreativitet kompleks dhe të larmishëm, poet, prozator, dramaturg, përkthyes, gazetar dhe kritik, studiues i historisë së pedagogjisë dhe i historisë shqiptare për fëmijë. Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe fitues i shumë çmimeve letrare.

[100] Nelaj, Milaim; "Profile letrare" – Studime, Tiranë 2008, f. 36

Akademiku Bedri Dedja si një dijetar shumëplanësh është shquar edhe në lëvrimin e përrallës. Shkrimtari aty është një eksplorator që kërkon të gjejë të panjohurën, të zbulojë të paditurën dhe të thotë të pathënën.

Vihet re pirja e autorit në dy rrafshe: në ritregimin e përrallave popullore dhe në krijimin e përrallave origjinale. Veçanërisht në këtë drejtimin e dytë pena e tij shkëlqen. Është nga të parët që theu kornizën e përrallës tradicionale me subjekte nga folklori. Siç vëren Prof. Odhise Grillo, Bedri Dedja i krijoi përrallat krejt ndryshe nga të tjerët. *Ai ka mënyrën e vet të gjetjes së fabulës, të ndërtimit të subjektit, të skalitjes së personazheve, të futjes së problemeve e të frymës së kohës në përrallat e veta, të ndërtimit në mënyrë lodruese të fjalisë e të frazës, të futjes së humorit që është aq i kërkuar nga lexuesit e vegjël etj. Këtu qëndron edhe origjinaliteti i tij që është i papërsëritshëm.*[101]

Përmbledhja "*Përralla njëmbëdhjetëkatëshe*", nxjerr në pah mjeshtërinë artistike të autorit si dhe pasurimin e mëtejshëm të kësaj gjinie letrare kaq të dashur për fëmijët. Kritika i ka vlerësuar ato përralla si krijime më të mira të autorit. Veç vlerave letrare e edukative, në to ndrit galeria e personazheve jetësorë, të cilët përfaqësojnë tipa shoqërorë me veset dhe të mirat e tyre.

Struktura e librit është konceptuar në mënyrë origjinale. Çdo kat është një pistë zhvillimi, ku ndërthuren fabulat, ku zhvillohen subjektet, ku bota jepet me fantazi të ndezur e në zhvillim të vrullshëm. Të njëmbëdhjetë përrallat dallojnë nga njëra-tjetra; pallati është korniza që i bashkon ato dhe që organizon subjektin.

Kritika ka vënë në dukje se në këto përralla autori shkrin në mënyrë harmonike traditën popullore të konceptimit me mjediset dhe kushtet bashkëkohore të veprimit të personazheve.

Janë përralla të cilat të tërheqin për fantazinë e tyre. Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe faktin që gjatësia e krijimeve vjen duke u shkurtuar, nga përralla e parë që zë 12 faqe deri tek e fundit që zë vetëm tri faqe. Patjetër që ky fakt nuk mund të jetë një rastësi, por përkujdesje e autorit për lexuesin e tyre fëmijë, që nuk mund ta përqendrojë gjatë vëmendjen.

Veçanërisht në këto përralla luan rol pozitiv njohja e botës, gjuhës e psikologjisë fëminore dhe mënyra e të treguarit në frymën e përrallave popullore.

Gjithashtu, këto krijime dallohen për temporitmin e lartë të zhvillimit. Si në paradë shfaqen një mori personazhesh, ngjarje e ndodhi të ndryshme që kanë të bëjnë me botën magjike të fëmijëve. Me sy vëzhgues e fantazi të ndezur shkrimtari ka zbuluar çdo detaj, send, personazh që nga historia e miut të fundit të botës e deri tek historia e moshamësve.

Bedri Dedja është një krijues i cili i ka për zemër fëmijët, e njeh shumë mirë botën e tyre, kërkon të japi mjaft informacion me penën e tij. Kështu, për shembull, përmbledhja me përralla dallohet për mjeshtërinë krijuese të autorit. Detaji artistik aty është një element i përfillshëm që e gjen në tërë veprën, që nga toponomastika, emrat e njerëzve, neologjizmat e letrarizimet me efekte etj.

Përmendim këtu: në përralla flitet për një gjuhë të çuditshme të minjve që quhet mijishte (f. 8), apo e pëllumbave – pëllumbisht (f. 22); gjetje të bukura janë edhe: njeriu që humbet emrin si dielli kur vrenjtet koha (f.20), policia zoologjike (f.34),

[101] Grillo, Odhise; "Përralla njëmbëdhjetëkatëshe", të B. Dedjes, (dy fjalë për autorin), Tiranë 1996, f. 4

kryekaposhi, kaposhi pa pendë që i kishte humbur në beteja heroike (f.35), polic pyllor (f.41); shtypet një luan, shteti do të çalojë- shteti çalaman, makina tallaxhije (f. 44) etj.

Apo të lidhjes së situatave jetësore me fantastiken, gjer fragmente nga e përditshmja: *pastaj i dha një kilogram valium dhe të sëmurin e zuri një gjumë elefantësh, që nuk e prishte dot as tërmeti dhjetëballësh...f. 43; do të na falin një pallat me 15 apartamente që t'i japim me qira* (f. 45) etj.

Zgjidhjet dhe qëndrimet jepen në forma të ndryshme e me finesë:

Përralla atje por edhe ne atje. f.33
Përralla pa mbaruar, por ne jemi të gëzuar; f. 38
Përralla na ngjethi mishtë, por e lexuam qetësisht: f.46
Përrallën e tregoi Aleksi dhe Tonit të katit VI i erdhi oreksi; f. 53
O përrallë, mos na harro, herë pas here na kujto! f. 64
Përralla, natën e mirë dhe ti, lapsi im, mos qofsh i vështirë. f. 78

Është e qartë që këto krijime të argëtojnë pa masë. Veç këtyre, autori me zotësi ndërthur elementë të tregimit me ato të përrallës dhe kjo i bën ato të pëlqyeshme e më të asimilueshme nga fëmijët.

Po t'i lexosh e studiosh me vëmendje përrallat e këtij autori: "*Përralla popullore mbi kafshët*"(1957), "*Përralla e tre vëllezërve*" (1958), "*Kallëzimet e gjyshe Pastërtores*" (1960), "*Përrallëzat e Zvicrës*" (2002) etj...në të cilën Bedri Dedja ka thurur me ëndje përrallat magjike duke hyrë lirshëm në botën e fëmijëve. Janë përralla që dallohen jo vetëm në formën dhe strukturën e saj të veçantë, duke e bërë përrallën një krijim vërtet letrar, por edhe në përmbajtjen e saj, pasi ka futur në të elementin fantastik, duke e gërshetuar dhe shkrirë edhe me dukuri të realiteti bashkëkohor.

Në përrallën "*Përralla popullore mbi kafshët*", autori ka përzgjedhur e ripunuar nga ana letrare përrallën e shkurtër dhe kryesisht me kafshë. Ndërsa në përrallën "*Përralla e tre vëllezërve*", të bie në sy përzgjedhja që ka bërë autori: duke u mbështetur në motive popullore dha modelin e një krijimi letrar nisur nga dy subjekte të përrallës popullore të gënjeshtarëve; duke bërë rikrijimin e situatave dhe të dialogëve i zbërthen tablotë e ngjarjet duke i dhënë ato në përmasat e përrallës së kultivuar. Te kjo përrallë paradokset ndjekin njëra-tjetrën, humori buron nga situata komike që fëmijët i lexojnë me shumë ëndje.

Bedri Dedja është një njohës i botës fëminore, i psikologjisë dhe i gjuhës së të vegjëlve. Fantazia dhe humori janë dy çelësat magjikë që depërtuan në ëndrrat, dëshirat dhe botën e pasur të fëmijëve.

xxx

Një ndihmesë të veçantë Profesor Bedri Dedja dha edhe në lëvrimin e poemës për të vegjlit si: "*Numrat*", "*Shkolla e pyllit*", "*Artan borizani dhe çeta e tij*", "*Patoku në plazh*", "*Vera, Geri dhe Driloni*" etj. Një pjesë e poemave të këtij autori priren në ndërtim të tyre mbi elementë përrallorë e fantastikë, ku veprojnë kafshët me botën dhe jetën e tyre. Gjithashtu nëpërmjet tablove, ngjarjeve e personazheve personifikohet jeta njerëzore, përcillen vlera estetike për botën e fëmijëve. Vlera të tilla përcillen në poemën-përrallë "*Shkolla e pyllit"* në të cilën, lexuesit e vegjël, nëpërmjet një fabule

të bukur ku veprojnë personazhe kafshë: ketrat, milingonat, lepurushët, shqiponjat, rosat, harabelat, edukohen me dashurinë për shkollën.

Në fakt, është një poemë-përrallë që u drejtohet shkollarëve të vegjël dhe trajton temën e mësimit. Fabula është interesante. Ngjarjet vendosen në pyll, por në këtë poemë ka mjaft ngjarje e tablo me fantazi, imagjinatë dhe humor. Kështu, gardalina dhe një galë lajmërojnë me trumbetë për lajmin e gëzuar se në pyll u hap një shkollë ku do të mësonin të gjitha kafshët. Subjekti është ndërtuar mbi bazën e konfliktit që lind midis kolektivit të kafshëve të pyllit dhe një lepuri mendjemadh.

Poema ka një vijë subjekti. Është më tepër një mozaik ngjarjesh e tablosh plot fantazi e humor, gjë që i ka dhënë dorë autorit ta përdor imagjinatën jo në gërshetimin e një subjekti, qoftë edhe aventurash, por në vizatimin e situatave të veçanta, prej të cilave rrjedh emocioni dhe morali. Është një poemë spontane dhe e këndshme. Sigurisht që autori u jep kafshëve funksione që janë në përshtatje me natyrën e tyre. Të spikatur janë disa personazhe: *Gardalina* – mësuese e matematikës, *Ariu* – mësues i abetares, *Maçoku* – mësues i vizatimit, *Kanarina* – mësuese e muzikës, *palloi* - rrobaqepës.

Në këtë poemë të gjitha personazhet janë kafshë, por pas tyre jepen raporte njerëzore, janë raportet nxënës-shkollë, ku fëmijët edukohen me dashurinë për punën, shkollën e diturinë dhe për t'u përgatitur për jetën. Por në këtë poemë ideja e rëndësisë së arsimimit të njeriut jepen në dy drejtime: shkolla të jep dije, zanat e profesion, të përgatit e të bën të aftë për jetën; mungesa e saj i kushton rëndë njeriut, si në rastin e lepurit analfabet...

Kjo poemë është shkruar në monokolonë, pa u ndarë në strofa. Vargu është i matur. Përdoret 4-rrokëshi, 8-rrokëshi e 10-rrokëshi; këto dy masat e fundit herë-herë thyhen, duke krijuar variacione e duke i dhënë ngjarjes dinamizëm aty ku duhet.

Në vitin 1997 autori e ripunoi si përrallë në prozë dhe e botoi në përmbledhjen *Republika e 1100 çudirave*.

Në poemën me titull "*Artan borizani dhe çeta e tij",* nëpërmjet elementëve realistë, ngjarjeve e ndodhive nga jeta bashkëkohore e fëmijëve, përshkruhen mesazhe për marrëdhëniet midis fëmijëve, prindërve dhe të moshuarve.

Autori rrëfen për veprimtarinë e gjallë e të gjithanshme të banorëve të vegjël të një pallati në kryeqytet. Ata krijojnë një çetë me fëmijë vullnetarë. Me forma të gjalla pune dhe me veprimtaritë e tyre të guximshme, fëmijët krijojnë një atmosferë të shëndoshë luftarake kundër çdo gjëje, që bëhet pengesë për edukimin e shëndoshë të tyre.

Personazhi Artan është i gjallë e plot kolorit, po ashtu edhe portretizimi i Gentush Qaramanit me tekat e tij. Me gjithë vlerat e veta estetike e edukative, kjo poemë përshkohet nga fryma e kohës.

xxx

Në krijimtarinë e shkrimtarit Bedri Dedja një vend të rëndësishëm zë dhe romani shqiptar për fëmijë. Përmendim këtu: "*Kalamajtë e pallatit tim*", me dy vëllime, i pari i botuar më 1972 dhe i dyti më 1979, si dhe "*Kacamisri rreth globit*" (1993), "*Qyteti me tri kështjella*" (1998).

Vlen të ndalemi këtu te romani "*Kalamajtë e pallatit tim*". Në të pasqyrohen natyrshëm tablo nga jeta e përditshme e fëmijëve, marrëdhëniet e tyre me të rriturit, prindërit dhe mjedisin shoqëror. Autori është treguar shumë i kujdesshëm në kapjen e

temave dhe çështjeve jetësore që prekin fëmijët siç është tema e preferuar e shkollës dhe edukimit, e gërshetuar dhe e shkrirë me elemente të tjerë, si lojërat, ekskursionet në natyrë, aksionet në ndihmë të fshatit. Por në roman dalin në pah dhe mjaft çështje të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me botën e fëmijëve, si për shembull, ajo e emancipimit të gruas, ajo e rrugaçërisë, e luftës kundër veseve të këqija etj. Jo pa qëllim akademiku Bedri Dedja trajton e nxjerr në pah problematika të tilla që prekin shoqërinë tonë, pasi si njeri i fushës së arsimit, kulturës e shkencës, kërkon që ky roman t'u drejtohet jo vetëm fëmijëve por edhe të rriturve.

Shpeshherë prindërit, mësuesit gabojnë... ndaj duhet të mësojnë se çfarë është takti, ç'metoda e punë këmbëngulëse duhet bërë për edukimin e fëmijëve me vlerat morale. Romani shpalos kështu vlera pedagogjike krahas vlerave ideoartistike.

Në roman pasqyrohet dalëngadalë jeta dhe veprimtaria e fëmijëve të një pallati të zakonshëm në kryeqytet. Ngjarjet rrjedhin natyrshëm nëpërmjet veprimit dhe ndodhive të ndryshme. Janë fëmijë të zakonshëm siç mund të shohësh edhe në jetën e përditshme dhe sot, djem e vajza me plot energji, që luajnë, flasin, punojnë me pasion.

Shpalosen një mori figurash fëmijë, gjë e cila i ka dhënë dorë autorit të paraqesë një galeri tipash e personazhesh të ndryshëm, të cilët janë përshkruar me vërtetësi dhe janë marrë nga jeta. Mes dashurisë dhe respektit të fëmijëve për njëri-tjetrin pasqyrohet bota qytetare e tyre.

Përmbajtja, që shtrihet në një numër jo aq të madh faqesh në 25 krerët e kësaj proze, është një pasqyrim me bazë dhe vërtetësi artistike, paraqitur kryesisht përmes një dialogu të natyrshëm dhe përshkrimeve të pakta dhe të goditura të tërë asaj që ka mundur të jetë përditshmëri dhe realitet i një fëmijërie të një kohe, vendi dhe rendi të caktuar shoqëror.

Nëpër faqet e romanit zbulohen këndshëm dhe me dinamikë ngjarje, episode, skema me detaje e imtësi të shumta, duke e bërë tërheqëse romani. Kështu, në fillim të tij njihemi me një banor të ri, që sapo është sistemuar në pallatin ku banojnë fëmijët.

Kalamajtë e pallatit tim dhe unë banojmë në një godinë të re shumëkatëshe të kryeqytetit...

Kërrtau! Prrauuu! Fring!

O tmerr! Imagjinoni! Tamam në këtë çast... një top futbolli fluturoi nga jashtë e drejt e brenda në kuzhinën time... Ky është kulmi i fatkeqësisë!

Sepse, që ky top i pacipë të vijë nga jashtë, nëpërmjet dritares së mbyllur dhe të qëndrojë para këmbëve të mia, ju mund ta merrni me mend se ç'rrugë i është dashur të hapë...

Unë sigurisht, kur pashë xhamin copë-copë, u bëra bishë pylli.[102]

Ai habitet nga lodrat e shumta të fëmijëve, nga zhurma e gazi që ushton në pallat. Të bën përshtypje sesi ai ndonjëherë nervozohet nga sjelljet e tyre, zemërohet nga thyerja e ndonjë xhami, por dalëngadalë fillon që t'i kuptojë, t'u qëndrojë më pranë, pasi ata janë të dashur e të mirë. Ndaj në ndërgjegjen e banorit të ri bëhet një kthesë rrënjësore dhe ai nis e miqësohet shumë me fëmijët e pallatit.

Thyeja e shpeshtë e xhamave bëhet shkak që në frikën e rrëfyesit të hyjnë fëmijët e këtij pallati: Taulanti, Agimi, Sokoli, Genti dhe më pas shoqëria e zgjeruar me: Edlirën, Laurën, Arjanën, Gaztorin, Rudinën, Ajrinën, Lirikën dhe të tjerë, të gjithë fëmijë të moshës parashkollore dhe të ciklit të ulët të fillores, të cilët harrohen në

[102] Dedja, Bedri; "Kalamajtë e pallatit tim", Shkup 2002, f. 10-11

lojëra e vrapime në hapësirën gjithnjë më të ngushtë ndërmjet pallateve, xhamat e të cilëve shpesh kërcasin nga topi i lojës.

Rrëfimi rrjedh natyrshëm, lehtë e bindshëm, saqë duket se shkrimtari nuk është vetëm soditës e rrëfyes, por edhe shok dhe pjesëmarrës në lojërat, shqetësimet, gëzimet dhe brengat e fëmijëve.

Romani "*Kalamajtë e pallatit tim*", është një pasqyrim real i një fëmijërie të një vendi shembull të rendit të ashpër partiak socialist dhe kjo ndjenjë dhe atmosferë është dhënë me vërtetësi artistike, si dokument i një kohe të cilën fëmijët e nesërm vështirë do ta kuptonin pa disa shpjegime të të rriturve.

Autori i skalit me dashuri personazhet duke i bërë të afërt për lexuesin. Këta kalamaj, siç i quan shkrimtari, kanë botën e tyre, hallet e tyre.

Secili personazh ka fizionominë e vet, nuk ngatërrohet me të tjerët duke krijuar individualitetin dhe psikologjinë e vet. Për shembull, lexuesi dëshpërohet me historinë fatkeqe të Sokolit dhe gëzohet me përfundimin e lumtur, kur ai gjen babain e vet, zemërohet dhe e urren figurën e Xhasit, rrugaçit e vjedhësit të ndyrë, që përpiqet ta bëjë si veten edhe Sokolin e vogël, kënaqet me humorin dhe shkathtësinë e Taulantit, Platorit e personazheve të tjerë. Genti, banori i ri i pallatit, Skënder Buna, Drita, Miroshja e vogël zbërthehen nëpërmjet ngjarjeve e ndodhive, që janë përshkruar bukur.

Në roman ka çaste që të emocionojnë, kujtojmë këtu punën e fëmijëve për ngritjen e këndit të lodrave, organizimin e spartakiadës në lojërat midis shkollave, ngjarja me mësuesen e matematikës që u jepte fëmijëve ushtrime pa fund për t'i zgjidhur, grindja e Sokolit me Xhasin, zhdukja e regjistrit të klasës, shpëtimi nga fëmijët i Miroshes së vogël, të cilën duan ta martojnë me mblesëri. Në jetën e tyre, mes shqetësimeve edhe të vegjlit dinë të dallojnë të mirën nga e keqja, e në këtë aspekt, gjithnjë e më tepër ata fitojnë vlera morale e shoqërore.

Krahas lojës, gëzimeve dhe shqetësimeve të kalamajve të lagjes, me vërtetësi janë shtruar edhe disa dukuri dhe probleme të tjera nga jeta e fëmijëve në shkollë dhe në organizatat e tyre, problemet edukative dhe shoqërore të kohës.

Mësuesja e aritmetikës, me qëndrimin e saj të rreptë dhe serioz, është fytyrë që shkakton ftohtësi ndaj mësimit dhe shkollës deri në atë shkallë saqë i bën fëmijët e "bandës së zezë" të vjedhin dhe të djegin regjistrin...

Më në fund erdhi ora e tretë e aritmetikës, zilen e së cilës kalamajtë e pritën si ato kambanat e kishave mesjetare...

Mësuesja e pesëdhjetë problemeve hyri në klasë me fytyrën e ftohtë e të ngrirë si mermer... f.70

... Regjistri i grabitur i klasës ishte bërë shkrumb si Xhordano Brunoja nënë tufën e druve të priftërinjve të mesjetës... f. 81

Në roman kapen edhe disa dukuri dhe probleme që sjell mosha e adoleshencës ose djalërisë.

"Ej, kujdes se po troket djalëria! – paralajmëron shkrimtari. Djalëria nuk është kënetë, po përrua i pastër dhe i rrëmbyeshëm malor!" f. 87

Në faqet e fundit, autori na kthen në vitet e betejës së vërtetë kundër analfabetizmit, kur babai dhe i biri rrinin në një bankë para abetares...

Unë bashkë me çiliminjtë e tjerë të fshatit qëndruam në këmbë prapa grave për të dëgjuar, në atë kohë njëri nga partizanët, ai më i vjetri, më vuri mua dorën në kokë dhe na tha të gjithëve:

A doni të mësoni në shkollë?

Çiliminjtë ulën kokat se nuk dinin ç'të përgjigjeshin, pastaj shikuan njëri-tjetrin dhe ia plasën të qeshurit. E ku dinim ne atëherë se ç'ishte shkolla!
... Pas dy vjetësh në fshat u hap një shkollë fillore, ku të gjithë ne shkuam për të mësuar që të zhdukej analfabetizmi.
Ja ku na doli dhe një fjalë tjetër. Analfabetizmi!
Po ky çfarë është, përbindësh që duhet zhdukur?
... Atë ditë ne po punonim në kopshtin e shkollës. Pas pak mësuesja më dërgoi për të mbushur ujë te burimi i pyllit. Në pyll vura re se zogjtë cicëronin e këndonin të lumtur, pa menduar dhe pa e çarë kokën fare për analfabetizmin. Kjo gjë më çuditi shumë.
Ç'të jetë vallë kjo kuçedër?
Në darkë vendosa të pyes tatën.
Tati im kishte qenë tërë jetën blegtor, pa shkollë, po i zgjuar. Kur e pyeta, ai më vështroi buzagaz dhe më tha:
Më duket se unë jam analfabetizmi... – u kthye nga zjarri për të ndezur çibukun.
Më pas u desh gati një orë që të më mbushej mendja se në fshat kish shumë të tjerë si tata im, që nuk dinin shkrim e këndim. Ja, këta ishin analfabetizmi! Prandaj, që të zhdukej ky, ose prindërit duhet të mbyteshin në lumë, ose të regjistrohen në kurs.
... Tata im ra në kurs me mua... f. 110

Ky roman ka një ndërtim kompozicional që mbështetet në disa linja. Ai është ndarë në kapituj, nënkapituj, ditare, letra në një mënyrë të tillë që lexuesi i vogël t'i perceptojë më mirë ngjarjet.

Stili i romanit është i shkathët, i ngjeshur, interesant. Dialogu është i gjallë, real. Gjuha është e pastër dhe e kuptueshme. Fjalitë janë të shkurtra e koncize. Autori, ka bërë kujdes në pasurimin e fjalorit të fëmijëve me fjalë të reja.

Gjithashtu në krijimtarinë e autorit zë një vend të rëndësishëm edhe veprat fantastiko-shkencore, zhanër ky i parapëlqyer nga Bedri Dedja. Kështu, vepra e fundit "*Presidenti i Planetit të Kuq*", botuar më 2006, pas vdekjes së tij, është një kryqëzim origjinal midis romanit përrallë dhe romanit fantastiko-shkencor. Një roman shënon një hap të mëtejshëm në krijimtarinë për fëmijë dhe njëkohësisht ruan vetitë më të mira të romaneve të tij të mëparshëm si dhe ngre në një stad të ri letërsinë shqiptare për fëmijë të shekullit XXI.

Ky roman është ndarë në dyzet kapituj, me një subjekt interesant; ngjarjet zhvendosen nga Toka në një planet tjetër, te planeti i kuq ose planeti Mars. Ndërmerret një udhëtim interesant i fëmijëve. Lexuesit e vegjël e shohin veten si vizitorë në hapësirat e planetit të kuq, ku sigurisht mësojnë të dhëna shkencore për planetin Mars, zakonet e banorëve të Marsit, përjetojnë natën dhe ditën, njihen me stinët, me klimën, kushtet atmosferike, bimësinë, gjallesat, satelitët dhe sistemin diellor. Bedri Dedja është shkrimtar që e njeh në thellësi botën e fëmijëve, dëshirat dhe kërkesat e tyre. Ai e di shumë mirë se çfarë duan dhe pëlqejnë fëmijët. Ndaj, në këtë roman, ndërthuren fantazia, shkenca, dija, ëndrrat, dëshirat, gjithçka...

Kjo duket që në fillim të romanit, e ngjashme me klishetë që kemi ndeshur në përrallat e vjetra: "*Na ishte njëherë...*"

Nuk ka sesi të mos ndjesh dëshirën dhe pasionin për të lexuar se çfarë do të ndodhë... Me një gjuhë të thjeshtë e të qartë na shpalosen ngjarje që duken sikur vijnë

nga lashtësia, mbushur me mistere dhe që vendosen në kozmos, në bashkëkohësi. Dhe fantazia bën punën e saj, arrin majat më të larta, zbulon dhe zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin e pafund të fëmijëve. Fëmijët mahniten dhe surprizohen nga pritja plot dashuri e ngrohtësi që u bëhet nga Presidenti i Planetit të Kuq, sikur të njiheshin prej kohësh e të ishin miq të vjetër. Ai qëndron në çdo çast pranë tyre, shijon e gëzon me ta bukurinë dhe mrekullitë e këtij planeti të kuq. Personazhet e vegjël lundrojnë në një det plot ngjyra e fantazi ashtu si Saturni që shpalos përpara shkencëtarëve të vegjël ylberin e ngjyrave të tij.

Dukuritë interesante që shpalosen në faqet e romanit i zhysin fëmijët në mendime dhe dëshira për të mësuar dhe për t'u argëtuar sa më shumë. Libri u transmeton fëmijëve dije shkencore e shumë të vërteta për galaktikën tonë. Leximi i ngjarjeve e i ndodhive ngjall shumë emocione, i argëton fëmijët por kërkon edhe një punë mendore për të zbuluar misteret e shumta. *Në fushën e pedagogjisë bashkëkohore synohet drejt hartimit të këtyre librave, që ndërthurin dijen me argëtimin e edukimin*, prandaj, siç vlerëson studiuesja Klara Kodra, *ky libër i psikologut dhe shkrimtarit të madh për fëmijë Bedri Dedja është ideal për të mësuar dhe argëtuar njëkohësisht lexuesit e vegjël.*[103]

Ky roman për vlerat që mbart u drejtohet jo vetëm fëmijëve, por çdo moshë të lexuesve, pasi në këtë libër përcillen mesazhe shumë të forta, që të bëjnë të mendosh e të reflektosh thellë. Kështu shkrimtari transmeton në mënyrë të natyrshme frymën pozitive për të kontribuar secili nga ne për të mirën e vendit, botës sonë dhe mbarë njerëzimit.

Veprat e këtij shkrimtari të papërsëritshëm lexohen me kërshëri nga fëmijët, sepse nxisin tek ata imagjinatën dhe kureshtjen. Nëpërmjet fjalës magjike, autori e vë lexuesin e vogël përballë të papriturës dhe interesantes, detyrës dhe përgjegjësisë për të kërkuar zgjidhje. Nëpërmjet mesazheve të ngrohta, ai nxit tek ata vetëveprimin dhe iniciativën, guximin dhe vullnetin, dashurinë për të bukurën dhe përbuzjen ndaj të shëmtuarës.

Profesor Bedri Dedja ishte dhe mbeti njëri nga miqtë më të mirë e më të dashur të fëmijëve.

5.3 Odhise Grillo – humoristi, përrallëtari dhe rikrijuesi

"Mjeshtri i Madh", Odhise Grillo[104] qe personalitet i kulturës, i letërsisë për fëmijë e të rinj. Ai filloi të botonte në kohën kur letërsia jonë për fëmijë hidhte hapat e

[103] Kodra, Klara; "Romani fantastiko-shkencor i shkrimtarit Bedri Dedja "President i Planetit të Kuq", shkrim në gazetën "Zëri i shqiptarëve", 13 Prill 2013.

[104] Autori Odhise Grillo ka lindur në Vuno të Himarës, në vitin 1933. Shkollën fillore e kreu në fshat, ndërsa ciklin e lartë të shkollës shtatëvjeçare e vazhdoi në Tiranë. Po në kryeqytet mbaroi shkollën e mesme, në gjimnazin "Qemal Stafa", dhe studimet e larta për Gjuhë - Letërsi dhe për gazetari në Fakultetin Histori-Filologji dhe në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike. Me mbarimin e studimeve punoi për disa vjet në revistën "Hosteni" dhe më pas në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", në redaksinë e letërsisë për fëmijë, ku punoi gjersa doli në pension. Së fundi punoi në Shtëpinë Botuese "Toena", si shef i redaksisë për fëmijë dhe të rinj. Grillo është redaktor i mbi 1500 librave të autorëve të ndryshëm. Përveç letërsisë është marrë edhe me publicistikë dhe ka botuar shumë shkrime në organe për të rritur dhe fëmijë si: "Drita", "Nëntori", "Ylli", "Zëri i Rinisë", "Pionieri", "Fatosi", "Yllkat", "Bota e fëmijëve" etj. Ai drejtoi për më shumë se dhjetë vjet Shoqatën Mbarëkombëtare të

parë drejt konsolidimi si degë e veçantë e letërsisë sonë të përgjithshme. Eci në gjurmët e disa autorëve paraardhës që i përkisnin traditës sonë të lavdishme të Rilindjes Kombëtare.

Odhise Grillo është autor i cili ka lëvruar të gjitha gjinitë, të gjitha llojet; vjershën, poemën, fabulën, tregimin, novelën, përrallën, romanin, pjesët teatrale dhe në vitet e mëvonshme është marrë edhe me një lloj letrar që te ne nuk është kultivuar, po që bota e kishte shumë të preferuar, siç është përshtatja për fëmijë e kryeveprave të letërsisë botërore dhe të letërsisë sonë.

Bëri rikrijimin për fëmijë e kryeveprave të letërsisë sonë kombëtare siç janë "*Lahuta e malësisë*", e Gjergj Fishtës ose "*Historia e Skënderbeut*", e Naim Frashërit etj. U hodh dhe te letërsia botërore: *Don Kishoti i Mançës, Epi i Gilgameshit* etj.

Ai themeloi Kolanën e botimeve: "*Legjenda shqiptare*", ku u botuan 27 libra të ilustruara të cilat përmbanin legjenda të përshtatura për fëmijët. Lexuesit e vegjël përmes tyre arrijnë të njihen me ngjarje e personazhe legjendarë e historikë.

Odhise Grillo është autori që ka botuar leksikonin e shkrimtarëve për fëmijë, që nga Kristoforidhi e deri në ditët tona, me mbi 550 autorë, për jetën e veprën e tyre.

Grilloja u shqua si poet që dha poezi dhe poema me vlerë për fëmijët. Gama e temave dhe motiveve të trajtuara nga autori është e gjerë. I kushton rëndësi temës së atdhedashurisë, ku poezitë e realizuara nga janë të shumta. E njohur është poezia "*Kryefjala e fjalëve*":

*"I mora **A**-në **A**tit,*
në të ishte dhe nëna;
*i mora **T**-në **T**okës,*
në të ishte dhe zemra;
*i mora **D**-në **D**etit,*
në të ishte dhe qielli;
*i mora **H**-në **H**ënës,*
në të ishte dhe dielli;
*i mora **E**-në **E**rës,*
në të ishte dhe shiu;
*i mora **U**-në **U**jit,*
në të ishte dhe njeriu…
I lidha të gjitha bashkë
dhe si ylber shkëlqeu
e para kryefjalë
*e fjalëve: **ATDHEU!**".*

Shkrimtarëve për Fëmijë e të Rinj, në fillim si nënkryetar, pastaj për disa vjet kryetar e së fundi si president i kësaj shoqate. Po kështu, ka punuar pedagog i jashtëm, i letërsisë për fëmijë në Universitetin e Tiranës dhe të Elbasanit. Odhise Grillo ka qenë anëtar i disa bordeve të revistave që dalin në Shqipëri, në Kosovë dhe në Shkup e Tetovë. Odhise Grillo mban titullin "Profesor" dhe Mjeshtër i madh". Vjershën e parë e ka botuar në vitin 1947, ndërsa librin e parë "Shtatë ngjyrat", në vitin 1954. Në jetën e gjatë krijuese ai numëron qindra tituj për fëmijë, mes të cilëve, të paharrueshëm për fëmijë janë "Gabimet e Veshkaushit", "Aventurat e maçokut", "Pesëqind grosh", "Një njeri bëhet majmun", "Qau e qeshi Pallaveshi", "Kur njerëzit kishin bisht", "Një zog këndon e qan", " Vuuu gënjeshtra, gërrr paratë", "Tradhti në sarajet Topiase", "Hajduti me çizme", "Dy gomarë këngëtarë", "Mollët magjike", etj. Një numër i madh titujsh të tij është botuar në Kosovë dhe Maqedoni, ndërkohë që shumë prej tyre janë përkthyer edhe në greqisht, maqedonisht, italisht, madje dhe arabisht.

Në kërë rast lirika patriotike për fëmijë është shumë emocionuese dhe e fuqishme; dashuria për prindërit, vendin, tokën, detin, hënën, diellin, puhizën, ylberin, lojërat, përmblidhen me një fjalë simbolike: ATDHEU. Por autori shumë bukur kërkon të përcjellë tek të vegjlit jo vetëm ndjenjën patriotike, por kërkon t'i nxisë dhe të japë informacione të mëtejshme përmes vendeve, njerëzve, ngjarjeve të ndryshme për këtë vend të shenjtë, Atdhe. Krahas temës patriotike, autori një vend me rëndësi i kushton edhe trajtimit të temave dhe motiveve sociale.

Një vlerë të veçantë në vjershat e fabulat e Odhise Grillos përbën humori që i përshkon ato. Me humor fëmija i asimilon më mirë problemet që i parashtrohen në një vepër letrare. Kësisoj, humori është një cilësi që duhet të karakterizojë çdo krijim të letërsisë për fëmijë, qoftë në vargje a në prozë duke u bërë i dashur e i pëlqyeshëm nga lexuesit e moshave të njoma. Përmendim një vjershë të hershme, të viti 1954, që më tej edhe u muzikua e u bë një nga këngët më të hershme e më të pëlqyeshme për fëmijët e mbarë vendit tonë, *Macja le të lahet*. Me humor ajo luftonte bestytnitë e kota:

Mjau-mjau-mjau-mjau!
Një maçok fytyrën lau,
Gjyshja ime kur e pa,
- *Do të bjerë shi!- na tha.*
-

Po këtë humor e gjejmë edhe në vjershat të tjera, si fjalabie *Ergysi e maçoku*:

O maçok mustaqekashtë,
A mësojmë të dy bashkë?
.....
Mjau-mjau e pis-pis-pis,
Librit faqet mos ia gris!
Po ia grise faqet
Nuk të kam më shok

Dhe t'i pres...mustaqet!
Dëgjove, maçok!?

Vetë jeta e fëmijëve është e mbushur plot me çaste humoristike e gazmore, plot skena dëfryese e zbavitëse. Kështu ndodh dhe me vjershat e ciklit të pyetjeve *Pse ashtu e pse kështu*. Ato ndërtohen në formë dialogu. Me naivitetin e tij fëmija pyet dhe xhaxhi poeti i përgjigjet ose anasjelltas.është një bashkëbisedim i ngrohtë e i këndshëm që të fal gaz e të lumturon. Të gjithë e dimë se *pse*-ja është çelësi i botës për voglushët. Këtë qëllim ka patur dhe shkrimtari, të zbulojë dalëngadalë me anë të pyetjeve të gjithë botën duke zgjeruar hotizontin e tyre, si dhe duke i argëtuar. Humori si pasojë e naiviteti fëmijëror ekspozohet zakonisht nëpërmjet dialogëve që fëmijët bëjnë mes tyre ose me objekte të tjera duke lozur (lodra është një cilësi tjetër karakteristikë e botës fëminore). Kështu në vjershën *Pyet Miri*, voglushi kërkon që të dijë përse kalliri i misrit mban goxha mustaqe? Dhe autori i përgjigjet se me të bima mbrohet nga zogjtë, shpon e largon çdo zog që e çuket dhe kërkon t'i grabitë ndonjë kokërr. Poeti Grillo, është njohës i mirë i botës psikologjike të fëmijëve, merr e trajton krijime që kanë në bazë jo vetëm humorin, lojën, informacionin e pasur për botën që na rrethon, por tregohet i kujdesshëm që krijimet e tij të kenë edhe cilësi të tjera

artistike, ngjyrimin e pasur, ritmin e rimën etj. Poeti është mjeshtër në thurjen e vargut. Ai varg është gjithnjë i rregullt, i matur, me rimë e me ritëm, ka muzikalitet. Rimat poeti i zgjedh me kujdes, theksat godasin ritmikisht. Autori përdor vargun tetërrokësh, por sipas moshës së cilës i drejtohet dhe sipas temës e ngjarjes që trajton, nuk mungojnë edhe masat e tjera, nga katër deri te njëmbëdhjetërrokëshi. Madje, shpesh, për t'i dhënë dinamizëm, vargu thyhet:

Po pse sqapi brikrenar
Mjekër mban
Si shkencëtar?

Ose:

Pesë e dy sa bëjnë?
Shtatë...
Qofsh si gjyshi jetëgjatë!

Të larmishme janë edhe strofat në të cilat i organizon vargjet: zakonisht përdoret katrena, po edhe distiku, e më rrallë tercina, pentastiku, sestina etj.

Nga folklori, Odhise Grillo më së shumti e ka shfrytëzuar gjininë e përrallës, si në vargje ashtu dhe prozë. Për këtë flasin veprat: *Shtatë ngjyrat, Do thërras maçokun të të krehë flokun, Kush e ka kapuçin*?.. Por, nuk janë të pakta as veprat që kryesisht janë përralla në prozë, si: *Gabimet e Veshkaushit, Vëllai i Veshkaushit, Shokët e Veshkaushit, Miqtë e Veshkaush Llapushit, Të fala nga një dhelpër, Shtriga që prodhonte gomarë, Hajduti me çizme, Dy gomarë këngëtarë, Mollët magjike* etj. Këto vepra të Grillos dëshmojnë se me sa fuqi krijuese është paraqitur vlera e përgjithshme e përrallës në të gjitha aspektet e saj. Në këtë sigurisht ka ndikuar e vërteta se "*fëmijët për herë të parë marrin kontakt me letërsinë nëpërmjet përrallës, prandaj edhe funksioni i saj si mjet për pasqyrimin e njohjen e realitetit, merr një vlerë të posaçme dhe të rëndësishme.*

Lidhur me rëndësinë e përrallave dhe krijimeve të tjera popullore vetë shkrimtari Odhise K. Grillo thotë:"*…përralla, ashtu si dhe gjëegjëzat, legjendat, këngët e ndonjë lloj tjetër, janë udhëtare. Duke kaluar gojë më gojë e duke u përkthyer, ato kalojnë sa nga një vend në tjetrin dhe i huajnë (huazojnë) elemente, fabula, ngjarje, fantazi etj. njëra – tjetrës."*[105] Ky autor i një numri të madh përrallash për fëmijë, përveç që është marrë me artin e krijimit të përrallave, ka dhënë edhe mendime të çmuara lidhur me krijimin e përrallës. Imazhin e kësaj përvoje autori e shfaq përmbledhjen me përralla *Kur kendon Guguftuja*, ku përfshihen 38 përralla të zgjedhura, magjepëse e plot ndodhi të bukura, të shkruara me ndjenjë e pasion.

Krijuesi i *Picimulit*, maces *Mjaulina*, maçokut *Piso* e shumë e shumë personazheve të tjerë, shfaqet me aventura argëtuese e të çuditshme, që i bëjnë të mëdhenjtë e të vegjëlit të besojnë se ekziston me të vërtetë edhe një botë tjetër, ajo e ëndrrës, e fantastikes ku të gjithë mund të bëhen protagonistë. *Veshllapushi, Veshkaushi, Lulushi, gjahtari Abu-Abu, Qerosi, Xhombo-Xhumba, Guguftuja, Zhik-Zhaku* etj, janë disa nga personazhet fantastikë që kanë aftësinë t'i përfshijnë fëmijët në botën e bukur të magjisë së përrallës. Përmbledhja me përralla dallohet për vlerat edukative të

[105] Odhise K. Grillo, Panoramë letrare – 3 (Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë), Botimet Toena, Tiranë, 2000, fq. 51.

padiskutueshme, stil të veçantë, thjeshtësinë e të rrëfyerit, gjetjet shqipe, duke e bërë të pëlqyeshme dhe njëkohësishtë të dashur për fëmijët. Duke lexuar vëllimin *Kur këndon Guguftuja* ndjen imagjinatën e shkrimtarit, prek botën e tij fantastike, e cila e shpie larg në mendime dhe lexuesi e shikon veten të rrethuar nga personazhet e dashura të përrallave, futet brenda botës së kafshëve dhe ndjen kënaqësinë e mjeshtërisë së të treguarit. Mjaft interesante është dhe përralla *Katër fjalë...magjike* nga përmbledhjë *Shoqata "me lugë në gojë*".

Studiues i pasionuar dhe njohës i mirë i kësaj dege të letërsisë, Grillo, me të drejtë i këshillon shkrimtarët për fëmijë që në veprat e veta "*edhe titujt duhet të jenë të gjetur bukur, intrigues e interesantë që ta tërheqin lexuesin e vogël*". Nëse titulli tek fëmijët nuk do të shfaqë ndjenjën e kuriozitetit atëherë ata do ta kishin të vështirë ta shfletonin.

Edukative është edhe përralla "*Kush e ka kapuçin*", ku edhe lepuri si një mendjemadh, përfundon keq, bie në duart e gjuetarit Ali, por edhe gjuetari Ali, i cili pasi e gjuan lepurin, ia merr lekurën dhe nga ajo ndërton një kapuç të bukur, bëhet mendjemadh dhe vetes së tij i vë lloj – lloj nofkash e epitetesh. Largohet nga shokët dhe gjithmonë lëvdohet pa masë, saqë ata i nevrikos dhe i fillojnë ta urrejnë. Kështu edhe këtij i vjen fundi i lavdisë, kur një ditë një erë e furishme ia merr kapuçin dhe ia humb pa nam e pa nishan.

Kjo përrallë ka personazhe njerëz dhe kafshë: Porosia është se kushdo që të jetë nuk duhet të lëvdohet karshi të tjerëve që mund të jenë më të dobët, më të varfër, më të paditur.

Autori përrallën e ka lënë me fund të hapur:

"*Fëmijë të dashur, shihni në mes tuaj, mos vallë e ka gjetur, kapuçin e tretur, dhe e mban në kokë ndonjë shok i juaj? (1957)*"[106] , pra mendjemëdhenjtë vazhdojnë të jenë afër nesh, mes nesh dhe në rrethin tonë më të gjerë, por përfundimin edhe do ta kenë sikurse personazhet e lartpërmendur.

Interesante paraqitet dhe cikli i përrallave me Personazh Veshkaushin. Aty përfshihen mjaft ngjarje në të cilat gdhenden personazhe të spikatur me indivialitetet e tyre, që lënë gjurmë të thella në fantazinë e fëmijëve. Këto rrëfimeve përrallore mbartin jo vetëm vlera estetike, por edhe vlera edukative, mësimore, si dhe koloritin e një gjuhe të pasur.

5.4 Petro Marko – romancieri evropian për fëmijë

Nuk është e lehtë të shkruash e të flasësh për punën e një autori brilant si Petro Markoja[107]. Shpesh figura e tij u "zbeh" nga regjimet e ndryshme dhe përsëri u ngrit

[106] Odhise K. Grillo, "Pse ashtu e pse kështu", vjersha, poema humoristike, fabula e përralla në vargje, Tiranë, 1998, (3 Përralla në vargje), Kush e ka kapuçin, fq. 70, përralla është e shkruar në vitin 1957.

[107] U lind më 25 nëntor 1913, në Dhërmi të Himarës. Shkrimtar e luftëtar antifashist, romancier me përmasa evropiane. Kryen shkollën tregtare të Vlorës e punon për pak kohë mësues në Dropull. Kalon në Tiranë, ku merret me gazetari. Që në moshën 20 vjeçare, filloi të shkruajë dhe të botojë poezi, tregime dhe publicistikë në gazetat dhe revistat e kohës me ndihmën e E. Koliqit. Nga marsi i vitit 1936, me Vasil Shanton e Asim Vokshin, drejtoi revistën ABC, që pati jetë tepër të shkurtër. Po atë vit, me një grup prej 40 shqiptarësh u nis vullnetar në luftën Civile të Spanjës. Në Madrit bashkë me Skënder Luarasin, botoi vetëm dy numra të revistës në gjuhën shqipe "Vullnetari i lirisë". Më vitin

më madhështor në sytë e lexuesve. Dhe lexuesit e tij janë të shumtë, që nga fëmijët dhe deri te të moshuarit. Kjo për faktin se krijimet e tij ishte të tilla që kuptoheshin lehtë nga çdo lexues dhe çdokush i shijonte dhe kishte ç'të mësonte. Përmendim këtu romanet për fëmijë: "*Shpella e piratëve"*(1964), *"Halimi"(1969), "Fantazma dhe plani 3+4"(1973), "Griva"(1988).*

Të përqendrohemi në këto çështje:

xxx

Romani "*Griva*" është cilësuar si një nga romanet më të bukura për fëmijë. Si në të gjitha krijimet e tij dhe këtu Petro Markoja, na jep një vepër të pasur me ngjarje dhe episode të gërshetuara më së miri me njëra-tjetrën dhe ku ndërthurren ndjenja të thella njerëzore si ajo e dashurisë për vendlindjen, për familjen dhe bashkëfshatarët, dëshira për lirinë e vendit dhe urrejtja ndaj regjimit të huaj, dëshira për të përmbysur gjithçka të keqe. Ngjarjet në roman zhvillohen në periudhën e Zogut dhe pak në atë të pushtimit fashist, në fshatin e lindjes së autorit, në Dhërmi. Pasqyrohen më së miri jeta dhe vuajtjet e bashkëfshatarëve, që detyroheshin të linin familjet e vendin e tyre dhe te emigronin jashtë kufijve për një jetë më të mirë.

Në qendër është një kafshë që i dha shumë kuptim jetës së Jakut dhe familjes së tij, një mushke që e quajnë "Grivë". Më shumë se një kafshe pune, ajo u bë pjestare e familjes, e vuajtjeve dhe e gëzimeve të tyre: *Ardhja e Grivës në familjen tonë ndryshoi atmosferën e rëndë që na detyronte ne fëmijëve të mos qeshnim, të mos loznim e të mos këndonim si të tjerët!...Ajo nuk e kuptonte se ç'gëzim na solli, po unë e vija re me ata sytë e saj të mëdhenj, na shikonte me dhembshuri*"[108].

Duke na i vënë ngjarjet në gojën e Jakut, duket më së miri se autori i ka përjetuar vetë situatat. E gjithë ngjarja zhvillohet dhe përjetohet me sytë e Jakut, një fëmijë i rritur para kohe, ku hallet dhe problemet e detyruan t'i shikonte gjërat ndryshe. Gjithashtu, në roman një vend të veçantë zë dashuria e autorit për vendlindjen, e cila duket dhe në përshkrimet që ai i bën natyrës së fshatit të tij dhe Vlorës: *Duke kaluar me Grivën rrugëve, nuk mund të mos shikoja atë bukuri të rrallë e me ngjyra të ndritura që kishte natyra, e mbuluar me të bardha në lëndina e në ara, kurse këtej, pranë detit dhe në grykën e Cingrit, portokallet shkëlqejnë si diej të vegjël! Mirë thonë burrat kur kthehen nga mërgimi; S'ka vend më të bukur se vendi ynë në të pesë kontinentet!..."*[109]

1937 në Valencia merr pjesë në Kongresin e shkrimtarëve te shquar e përparimtar të botës. Vitet '39-40 i kalon ne Francë. Pasi kthehet në Shqipëri, vazhdon aktivitetin revolucionar. Për këtë arsye, më 1947 punonte si kryeredaktor i gazetës "Bashkimi", arrestohet, kësaj rradhe nga komunistët , burgoset dhe dënohet me pushkatim. Pas tre vjetësh lirohet me ndërhyrjen e miqve të tij. Nuk rreshti së shkruari, autor i romaneve "Hasta la vista", "Qyteti i fundit", "Nata e Ustikës" e i sa e sa romaneve të tjerë të mrekullueshëm për të rritur. Por veprat e tij nuk botoheshin pasi ishin jashtë skemës së realizmit socialist, dhe për vite të tëra atij iu hoq e drejta e botimit. Krahas prozës moderne që na ka dhënë për të rritur, Petro Marko krijoi me dashuri edhe për të vegjëlit. Ai ka meritën se qe nga nismëtarët e prozës së gjatë për fëmijë e të rinj. Është autor i disa romane të suksesshme për fëmijë si; "Shpella e piratëve", (1964), "Halimi"(1969), "Fantazma dhe plani 3+4", "Griva" (1988). Vdiq në Tiranë, më 27 dhjetor 1991.

[108] Petro Marko, "Griva", Tiranë, 1999, f. 9

[109] Po aty, f. 85

Petro Markoja, në këtë roman ka zgjedhur për kryepersonazh dhe narrator njëkohësisht, një djalë 12-vjeçar, Jakun, dhe bashkëudhëtaren e përhershme të tij, në të gjitha ngjarjet, Grivën. Jaku është personazhi më i realizuar në roman por që s'mund të kuptohet i shkëputur nga Griva. Fund e krye, romani i bashkangjit këto personazhe. Lind pyetja, çfarë përfaqëson Griva? – Është një personazh ku bëhet ndërthurja e vuajtjeve, lodhjeve dhe mundimeve me lumturinë, gëzimin, burimin, mjetin për të siguruar bukën, ndaj shpaloset dhe si personazhi më i dashur. Ajo përfaqëson jetën reale të asaj kohe, ku vuajtjet ishin të mëdha, ndërsa gëzimet dhe lumturia, të pakta. Në roman zë vend shprehja figurative, nëpërmjet krahasimeve dhe epiteteve të personazheve, përshkrimeve të mrekullueshme të natyrës dhe bukurive të rralla të bregdetit. Monologët e Jakut janë shumë domethënës dhe plot nënkuptime. Edhe pse autori ka përdorur gjuhën e fëmijës për të qenë sa më afër botës së tyre, përsëri, mesazhet janë kuptimplote. Ky libër është cilësuar nga kritika si romani më i bukur për fëmijë, pasi përcjell një sërë mesazhesh dhe se flet me gjuhën e fëmijës, gjë që e bën shumë të dashur dhe të afërt për lexuesin këtë vepër. Romani veçohet për vlerat artistike, edukative, për pasqyrimin të ndjenjave dhe të botës së fëmijëve duke realizuar një komunikim të përkryer me lexuesit e çdo moshe dhe veçanërisht, fëmijët.

Në përgjithësi romanet për fëmijë të Petro Markos shquhen për realizimin e bukur artistik, për figuracionin e pasur, për fantazinë e ndezur, për shprehjet racionale, për dialogun e gjetur, konçiz, funksional e psikologjik, për mbështetjen në letersinë gojore, si dhe për strukturën e qëlluar kompozicionale. I përmendëm të gjitha këto veçori të krijimtarisë së autorit, pasi shkrimtari di që gjithçka ta shohë nga lartësitë e kohës ku ndodhet.

Ai duket sikur luan me botën e fëmijëve. Dhe me lojën e tyre, ka realizuar me mjeshtëri tipizimin e personazheve. Nëpërmjet simboleve autori zhvillon një pjesë të madhe të veprimeve. Në përshkrimet e bukura ruhet një harmoni e madhe midis mjedisit dhe botës së brendshme të personazheve. Kështu ndodh edhe me romanin *"Fantazma dhe plani 3+4"*. Në të shkrihen një galeri personazhesh, jepen ngjarje nga historia e popullit shqiptar. Fëmijët marrin dhe shumë informacion duke u futur në një botë plot ngjyra e tinguj. Në punën e tij krijuese Petro Marko përdor stil disi të veçantë, mënyrë gazmore në rrëfim, gjuhë të thjeshtë, lodruese, të afërt me atë popullore. Romani të tërheq për aksionin që e karakterizon, për aventurat.

Në rrëfimin e tij, autori përdor si planin real, ashtu dhe atë fantastik. Operon me detaje të goditura, duke u futur në botën e fëmijëve. Romani "*Fantazma dhe plani 3+4",* dëshmon për fantazinë e gjallë, për talentin e autorit, per njohjen e thellë në botën psikologjike të fëmijëve. Ai përdor hiperbolën në të dyja kahet, zmadhim e zvoglim. Nga ana kompozicionale vepra ruan formën e një mozaiku ngjarjesh, ku çdonjëra prej të cilave qëndron fare mirë në mënyrën e pavarur.

Puna krijuese e autorit Petro Marko vazhdon dhe me romanin *"Shpella e piratëve"* i cili meriton vend të veçantë në letërsinë tonë për fëmijë. Një roman i llojit fantastiko-aventuror, pasi zhvillohet në dy rrafshe: real dhe fantastik. *Me anë të gërshetimit të ngjarjeve reale të kohës së sotme, të peripecive të shumta të heronjve, të situatave të papritura e befasuese, të veprimeve të hiperbolizuara që kanë të bëjnë sa me të kaluarën, aq edhe me të sotmen, romani u transmeton të vegjëlve mesazhe*

aktuale me vlera edukative dhe njohëse[110]. Ky roman i edukon të vegjlit me virtytet e shquara të të parëve, me ndjenjën e krenarisë për të kaluarën e lavdishme të popullit tonë. Ai i nxit fëmijët për të kryer vepra të mira, për të qenë të guximshëm, trima, të vendosur e të shkathët në jetë. Në përputhje me frymën e përgjithshme të veprës dhe me kërkesat specifike të llojit të romanit aventuror, gjatë shtjellimit të ngjarjeve të subjektit, autori përdor dendur mjete karakteristike për këtë lloj letrar: intrigën, aventurën, të papriturën, enigmatiken etj., me anën e të cilave krijohet efekti artistik i duhur tek të vegjlit dhe vihet në lëvizje imagjinata e tyre. Me këtë frymë, me anë të hiperbolizimeve të thjeshta, krahasimeve të fuqishme, rrëfimi karakteristik si në përralla, gjuhës së pasur me fjalë të rralla etj., bëhet individualizimi i personazheve historike dhe ngjyrimi i gjallë i ngjarjeve dhe i mjediseve fantastike. Përgjithësisht përshkrimi i ngjarjeve bëhet në mënyrë tërheqëse dhe rrëfimi është i rrjedhshëm. Që në fillim të romanit, ai e nis rrëfimin me Niko Dabon, me peshkatarin më të vjetër të fshatit, që është njeriu i gjallë, njeriu i vërtetë, me virtytet e bregasve. Niko Daboja është patjetër simboli i të gjithë atyre bregasve që e kishin lidhur jetën me detin, prandaj përshkrimi i tij është përshkrimi i botës shpirtërore të bregasve me gjuhën, mendësinë, edukatën, temperamentin, sjelljen dhe kulturën që i karakterizon ata. Një moment tjetër është dialogu që sjell shkrimtari për Niko Dabon me fëmijët, i cili është mjaft emocionues dhe befasues për moshën e tyre.

Një nga pikat kryesore në këtë vepër është marrëdhënia midis brezave: gjysh, atë e bir. Kjo është lidhja më e fortë shqiptare midis tyre. Respektimi është mijëravjeçar dhe ndikimi vazhdon të ruhet në mënyrë të përsosur nga pasardhës. Shpella tregon lashtësinë, vjetërsinë dhe qëndresën e shqiptarëve.

Petro Marko si pak autorë të tjerë, nëpërmjet rrëfimit të tij në *Shpellën e piratëve*, ka shfrytëzuar me mjeshtëri gojëdhënat duke bërë të mundur që të ringjallte tek fëmijët lavdinë shqiptare .

Duke përdorur hiperbolizimet, shkrimtari ka ditur të gërshetojë botën e pasur fantastike me realitetin jetësor. Dialogu, monologu dhe përshkrimet janë të ndërthurur me njëra-tjetrën për të portretizuar te personazhet, individualitetin e mendimet e tyre, por edhe për të nxjerrë në pah traditën e mrekullueshme shqiptare dhe bukuritë e rralla të bregdetit himariot. Kështu, për nga niveli artistik, forca ndikuese, karakteri specifik, ky roman përcjell te të vegjlit vlera të shumta morale, edukative, estetike duke realizuar kështu nje vepër të shquar në letërsinë tonë për fëmijë. Petro Marko ka meritën se qe një nga nismëtarët e prozës së gjatë për fëmijë, këtë e dëshmon më së miri dhe romani "*Shpella e piratëve*". Siç e përcakton studiuesi Ali Aliu, *ky roman sjell një freski dhe gjallëri në prozën tonë për fëmijë*[111].

Krijimtaria për fëmijë e Petro Markos, është një dëshmi e aftësisë së veçantë krijuese të autorit për të qëmtuar me kujdes dukuri, detaje, ngjarje të bazuara në folklor si dhe në veprimtaritë e përditshme të fëmijëve për të nxjerrë në pah një sistem ekuilibrues midis realizmit dhe konkretes psikologjike, midis të vërtetës jetësore dhe të botës, duke u futur thellë në psikologjinë e personazheve, si dhe duke përcjellë emocionalisht tek lexuesi-fëmijë.

[110] Ramazan Çadri, "Letërsia shqipe për fëmijë", Tiranë, 2001, f. 187
[111] Ali Aliu: Nga libri "Katër romane të Petro Markos", 1979- Kërkime, Tiranë, 1990, f. 166

5.4.1. Të përbashkëtat dhe të veçantat në aspektin tematik, gjuhës, stilit midis veprës "Shpella e piratëve" të Petro Markos dhe "Dy vjet pushime" të shkrimtarit francez Zhyl Vern.

Vendet, popujt, kulturat e ndryshme kanë qenë historikisht në një kontakt të përhershëm. Në këtë bashkëjetesë të gjatë kulturore, edhe te letërsia jonë për fëmijë ka ndikuar ajo evropiane. Konkretisht për dy veprat në fjalë themi se kanë pika të përbashkëta. Shkrimtari Petro Marko duke jetuar një pjesë të mirë të jetës së tij jashtë, kishte mundësi që përmes pjesëmarrjes në Luftën e Spanjës dhe në Kongresin e Shkrimtarëve të mbajtur në Barcelonë të takonte personalitete të larta të artit botëror e europian. Pra, ai kishte mundësi të njihej me zhvillimet e letërsisë europiane dhe në këtë mënyrë përvetësoi pikëpamje, ide dhe mënyra të reja pikvështrimi në planin artistik dhe ideoemocional. Ndikime ka pasur, sipas mendimit tonë, edhe në veprën e tij *Shpella e piratëve*, ndikim ky nga shkrimtari francez Zhyl Vern për veprën e tij *Dy vjet pushime.*

Ndalemi konkretisht në të dy veprat:

A. Ngjashmëritë dhe të veçantat në planin tematik, motivor dhe kompozicional

Në romanin e Zhyl Vernit në qendër të tij është një kolektiv fëmijësh, ku më i madhi nuk i ka kaluar të 14-at. Ky kolektiv fëmijësh është prej 15 vetash, dy francezë, një amerikan dhe 12 neozelandeze. Ata vendosën të ndërmarrin një udhëtim mbasi kishin mbaruar vitin shkollor dhe këtë udhëtim do të bënin me anijen "Sllugu".

Si te ky roman, edhe te romani i Petro Markos trajtohet e njëjta ide. Një grup fëmijësh, nuk shkonin më tepër se 5 a 6 veta, vendosën të ndërmerrnin një udhëtim drejt Shpellës së piratëve. Këta fëmijë kishin moshën e fëmijëve të anijes "Sllugu", nuk i kishin kaluar të 14-at dhe me anë të shkathtësisë dhe zgjuarsisë së tyre, përmes një pune te lodhshme arritën të ndërtonin anijen e tyre të cilën e pagëzuan "Delfini i Pionierëve".

Kjo do të shërbente si mjeti i tyre drejt një udhëtimi sa të rrezikshëm aq edhe të bukur, sa intrigues aq edhe mahnitës. Tema pothuajse e përbashkët e të dy romaneve është copëzuar në motive të shumta të cilat së bashku, të mbledhura porsi një mozaik, shpalosin idenë e plotë të veprës.

Ndërsa romani "*Dy vjet pushime*" është strukturuar në një mënyrë të tillë kompozicionale ku shtjellimi i subjektit fillon direkt në pikën e lidhjes, ku tregohet për përleshjet e fëmijëve të ndodhur në anijen "Sllugu" në dallgët e ashpra të Oqeanit Paqësor, pa na treguar me parë se si fillon ngjarja, përse fëmijët ndodheshin në këtë rrezik kaq të madh. Pra direkt, në fillim të romanit bëhet prezantimi i pasojave, jo i shkaqeve iniciuese. Vetëm aty nga faqja 21 bëhet ekspozicioni. Pra shohim që kemi një rend të përmbysur kompozicional dhe kronologjik. Tani gjatë ekzpozicionit, njihemi realisht me këta personazhe fëmijë, me jetën e tyre, me jetesën e tyre në kolegjin Sherman, me emrat, karakteret etj...

Më pas në kapitujt e tjerë 4 deri në 22, rrëfehet zhvillimi normal i ngjarjeve. Ndërsa në kapitujt 23-27, del në plan të parë zbulimi i figurës së Ketit (Katerina), e cila tregon historinë e anijes tregtare dhe përpjekjet e saj për t'u shpëtuar piratëve,

pastaj kemi një ndalim të ngjarjeve dhe kthimi pas në retrospektive përmes historisë së Ketit, vazhdojmë sërish me një kthim pas në kohën kur Evansi tregon historinë e tij si shpëtoi nga piratët, konflikti i piratëve me fëmijët, etj. Ndërsa në tre kapituj e fundit kemi një zgjedhje graduale të problemeve, konflikteve deri te përfundimin e lumtur të fëmijëve kur ata kthehen në atdhe shëndoshë e mirë.

Përsa i përket ndërtimit kompozicional te romani *Shpella e piratëve,* nuk mund të flasim për një rend të përmbysur kompozicional. Sepse qysh në fillim të romanit autori bën lidhjen me personazhet si: Niko Dabon, Loloja, Iliri, Fotoja, Lulja e Jani. Pra kemi një skenë të tillë kompozicionale: fillimi i ngjarjeve (lidhja), vazhdimi i tyre, pika kulminante, zgjidhja ose përfundimi. Në fillim të romanit njihemi me fëmijët, rrëfimi bëhet në vetë të parë nga Iliri, i cili rrëfen ngjarjen nga pikëvështrimi i tij, duke i kaluar në optikën e mprehtë të vëzhgimit. Rrëfehet se si ata kishin parë Niko Dabon në shpellën e piratëve, se si fëmijët ndërtuan një plan të tyre, pastaj tek vazhdimi i ngjarjeve, zbulimin e sekretit të shpellës, kurse tek pika kulmore fëmijët nën udhëheqjen e Lolos, të cilin e pagëzuan Gjon Baba, ndërmarrin një udhëtim të rrezikshëm drejt Shpellës së Piratëve për të zbuluar të fshehtat e saj (trimëritë e Gjonbabës, Gjonbirit e Gjonnipit). Zgjidhja dhe përfundimi kanë të bëjnë me gjetjen e fëmijëve nga marinarët e mbrotjes detare, të cilët i shoqëruan ata në shtëpi bashkë me anijen e tyre. Fundi i lumtur. Fundi dhe mbyllja është e gëzueshme, pozitive në të dy romanet ku fëmijët edhe pse ndërmorën aventura të rrezikshme, edhe pse rreziqet që ata hasnin ishin të mëdha, ata arritën që të kthehen të gjallë dhe shëndoshë e mirë në shtëpitë e tyre.

Përsa u përket dy romaneve në fjalë, themi se ata kanë ngjashmëri në tematikë dhe motive. Pra tema është e njëjtë: trimëria, guximi, shkathtësia, zgjuarsia që duhet treguar në çdo çast të vështirë, në çdo pengese, pavarësisht nga mosha. Pothuajse motivet që trajtohen në të dyja veprat kanë lidhje me përpjekjet e fëmijëve për t'ua dalë mbanë situatave të vështira, kurioziteti i tyre drejt së panjohurës. Apo kur ata rrezikojnë për të zbuluar bukuritë e natyrës, në këtë rast ekspeditat e shumta që bëjnë fëmijët në të dyja veprat, ngjallin kureshtjen dhe fantazinë e fëmijëve. Pothuajse në të dy romanet, në kalimin nga një kapitull tek tjetri, dalin dhe karakteristikat e tyre të veçanta, aftësitë dhe dhuntitë e veçanta të secilit.

B. Analiza e personazheve, gjuhës, stilit në të dy veprat

Ndërsa te romani *Shpella e piratëve* autori i vendos ngjarjet në bregun e detit, në bukurinë e Jonit, në shpellën misterioze të piratëve, e cila ka lënë mbresa të thella në kujtesën e autorit qysh nga fëmijëria, tek romani *Dy vjet pushime* autori i vendos ngjarjet në një ishull të shkretë e të braktisur, ku s'ka këmbë njeriu, ku fëmijët janë të detyruar të bashkëjetojnë me egërsinë e këtij ishulli. Të abandonuar, por duhet theksuar se e përbashkëta e këtyre romaneve është se të dy autorët i kanë ndërtuar rrëfimet e tyre sipas modelit e rrëfimit aventuresk: kjo si pasojë e aventurave të shumta që kalojnë fëmijët duke u ndeshur në një botë të panjohur në shpellën misterioze në rastin e *Shpellës së piratëve* dhe në botën bimore dhe shtazore aq të larmishme të romanit *Dy vjet pushime*.

Në romanin *Shpella e piratëve* strukturimi modelor dhe deri diku përmbajtësor shtjellohet në një gojëdhënë konkrete, ku ngjarjet, tablotë dhe realiteti mbështillen në një tis përrallor. Vetë *Shpella e piratëve* dhe gojëdhëna merren prej autorit vetëm si nxitje, pasi në tablotë, ngjarjet, përshkrimet dhe personazhet pasqyrohet jeta e përditshme e bregdetit shqiptar, fati i njeriut dhe qëndresa e tij. Ky roman është një vepër fantastike, ku fantazia e shkrimtarit ndizet nga e kaluara e popullit tonë, po edhe nga një shpellë në bregdetin Himariot, në brigjet e Jaliskarit të fshatit Dhërmi, vendlindja e autorit, për të cilën kishte dëgjuar gjëra fantastike e magjike qysh kur ishte fëmijë. Shkrimtari vuri në qendër të veprës së vet një detar të regjur në dallgë e vështirësi, të cilin e njihte mirë dhe e skalit me zotësi. Ky ishte Niko Daboja, që e kishte rrezikuar jetën sa e sa herë në det e që kishte humbur edhe një dorë në dyluftim me peshkaqenët. Niko Daboja është patjetër simboli i të gjithë atyre bregasve me gjuhën, mendësinë, edukatën, temperamentin, sjelljen dhe kulturën që i karakterizon.

Edhe tek romani *Dy vjet pushime* ka si baza të rrëfimit, rrëfimin aventuresk, ndonëse këtu nuk mund të flasim për një tis perrallor që vesh veprën, ndoshta vetëvendosja e fëmijëve në një ishull të braktisur, po drejtimi është prej të rrituri, ku veprimet që ndërmarrin për të përballuar rreziqet e shumta, të panumërta. Dhënia e informacionit të dendur lidhur me botën bimore dhe shtazore të ishullit (ku fëmijët duhet të orientohen në maksimum për njohuritë që ata kanë marrë dhe t'i shfrytëzojnë për nevojat e tyre pasuritë e shumta të natyrës). Ndaj për këtë arsye ky roman nga kritika franceze është konsideruar edhe si fantastiko-shkencor. Por aventurat vazhdojnë sidomos ku vihet re spikatja e trimërive të fëmijëve në dyluftimet me piratët. Të gjitha këto nuk duken sikur janë të vërteta, sikur jetojnë në një botë përrallore, në një bote imagjinare, që nxit fantazinë. Padashur ne përfytyrojmë në vizionin tonë, një mori dukurish, ngjarjesh, veprimesh, situatash nga më të çuditshmet dhe sikur bota e ishullit na duket si një xhungël e vërtetë duke na bërë që të përfshihemi edhe ne të rriturit në këtë botë magjike.

Autori Zhyl Vern ndryshe nga Petro Marko nuk ka shfrytëzuar gojëdhënat, legjendat për të iniciuar ngjarjet, por ai ka thurrur aq natyrshem realen, botën e vërtetë me aventurat e jashtëzakonshme të fëmijëve, saqë të krijohet përshtypja e një bote fantastike, një botë e veçuar nga zhvillimet industriale, shoqërore, politike që ndodhin në shoqërinë e zhvilluar, një bote gati primitive, e paprekur, ku kjo botë e pasur me pyje, ujë, kafshë është vënë në dispozicion të fëmijëve dhe mënyra e tyre e veçantë e shfrytëzimit të kësaj natyre, të kësaj bote të egër të lë përshtypje të thella në imagjinatën tonë.

Sikurse te romani *Shpella e piratëve* dhe te romani *Dy vjet pushime* përmes aventurave të 5 fëmijëve apo të 15 fëmijëve të tjerë, ne futemi në botën dhe psikologjinë e fëmijëve dhe arrijmë në përfundimin se të gjithë fëmijët, pavarësisht nga kushtet dhe rrethanat e ndryshme në të cilat ndodhen, ata janë gjithmonë të pushtuar nga dëshira, pasioni dhe etja për të prekur gjëra të pazbuluara, për të eksploruar të mistershmen. Por duhet theksuar se, pavarësisht nga galeria e personazheve që na parakalojnë, të dy romanet janë të pasur me figura fëmijësh në tipare, e karaktere të ndryshme, në individualitete të papërsëritshme. Themi se fëmijët kanë një paraqitje disi skematike të tyre, disi të idealizuar: ata sillen si të rritur, nuk tremben kurrë nga të papriturat dhe vështirësitë e shumta që u dalin përpara, gjithmonë qëndrojnë të buzeqeshur, të qetë dhe pothuajse në raste të rralla frikësohen,

tmerrohen. Por kjo është një paraqitje jo e vërtetë e botës së fëmijëve, sepse ata nuk mund t'i bëjnë ballë në mënyrë burrërore rreziqeve të shumta, që iu dalin përpara.

Të vegjlit kanë nevojë për të rriturit, t'i udhëheqin, t'i mësojnë, t'i drejtojnë sepse është e pamundur që ata të ecin përpara, pasi më i madhi në romanin *Dy vjet pushime* nuk i ka kaluar të 14 –at, që të zgjidhin çdo problem në mënyrë të shkëlqyer, si të përllogaritur, ku në çdo moment ata e kanë zgjidhjen në kokë etj. Përmendim një moment shqetësimin e Ketit për fëmijët...*Katerina që i njihte mirë piratët, mundohej t'u vinte në ndihmë atyre fëmijëve tepër të zgjuar. Megjithëse dhe vetë kishte frikë, nuk e jepte veten para tyre. Ah sikur të ndodhej aty dhe timonieri, Evansi, me ata femijë. Ai do t'i organizonte mjaft mirë fëmijët.*[112]

Marrim raste konkrete për shembull. Te romani *Dy vjet pushime* fëmijët si Donifani, Vebi, Briani, Gordoni etj, arrijnë që të ndërmarrin veprime të shumta në ishull për të zbuluar çdo gjë që mund t'u vinte në ndihmë, pasi kafshët e pyllit janë të rrezikshme, vetë bota e pyllit është e egër. Të bën përshtypje sesi fëmijët arritën që t'i përdorin armët e gjahut ku vrisnin kafshët e mëdhaja e të rrezikshme, tamam si të rritur. Ata s'mund të ishin stërvitur t'i përdornin ato armë. Ose rasti kur ata arritën të përlesheshin me piratët, që ishin vrasës të vërtetë. Në këtë rast fëmijët jo fantastikë do të vdisnin nga frika, s'do të guxonin të hynin në dyluftim me këta njerëz kaq të rrezikshëm.

Në këtë roman spikat figura e Brianit: trim, guximtar dhe me shpirt të sakrificës. Atë e kishin zgjedhur kryetar të fëmijëve, pasi ai ishte inteligjent, i gjithdijshëm, i aftë, t'u bënte ballë momenteve të vështira, ishte i drejtë, mbronte anën e së drejtës. Gordoni ishte si një baba për gjithë fëmijët, jepte këshilla, mendime të zgjuara, përhapte ngrohtësi dhe përkujdesje ndaj të vegjëlve si Servisi, Kostari, duke bërë të mundur që të mos mërziteshin, të ishin të shëndetshëm, të shkathët por edhe të organizonin lojëra të shumta përbrenda shpellës së francezit, sidomos gjatë stinës së dimrit. Ai ishte një parashikues i mirë i stinëve duke thënë se dimri fillon në maj dhe mbaron aty nga shtatori, pra ishte i aftë të parashikonte stinët në një vend të braktisur në një pozitë të kundërt gjeografike nga vendi ku ata jetonin. Pasi fëmijët arritën që ta zgjeronin shpellën e Francezit, ta skiconin atë, filluan të rregullojnë duke ndarë kështu dhoma përkatëse, duke sistemuar plaçkat, objektet, ushqimet që kishin marrë nga anija "Sllugu". Të gjitha këto do t'i bënin nën drejtimin e Gordonit pasi ai ishte një kryetar i zoti, ishte shumë më i shkathët nga të tjerët, arrinte që të bënte inventarët e ushqimeve, të orendive të anijes "Sllugu", duke përcaktuar sasinë e tyre dhe përllogaritjen e ditëve kur do të konsumoheshin. Ai ishte një hartues i shkëlqyer i programit të hollësishëm ditor, kishte në këtë mënyrë fëmijët në kontroll, ku përmes këtij programi duhej: për të zhvilluar mësimet në sallon, të bënin ushtrime fizike në ajer të pastër, ushtrime mendore. Dy herë në javë bëheshin mbledhje për të parë ecurinë e përvetësimit të njohurive të marra nga historia, gjeografia, letërsia etj. Fëmijët sipas Gordonit do të punonin për ndërtimin e gazetës, larjen e rrobave, prerjen e drurëve. Gordoni kishte një zgjuarsi të rrallë, ai kishte njohuri të shumta, nga lëndët e ndryshme në shkollë. Falë këtyre njohurive ai arriti që të zbulonte disa lloje drurësh që i duheshin atij për të jetuar, për t'u ushqyer më mirë. Ai zbuloi bimën e çajit që ta pinin fëmijët kur ishin të ftohur, një lloj bime frutore që e kishte mësuar në botanikë e kur zihej lëshonte një aromë kundërmuese dhe shërbente për të kuruar sëmundje te ndryshme:

[112] Zhyl Vern, "Dy vjet pushime", UEGEN, 2004. f. 118

... Aty midis drurëve vëmendjen ua tërhoqi një lloj druri, lëkura e të cilit përdorej si kanellë. Në atë pjesë të pyllit Gordoni mundi të dallojë bimën e çajit.

- *Jemi që jemi marrim nja dy tufa t'i kemi. Po të na mbarojë çaji, këtu e kemi, vijmë e mbledhim, nuk është larg, -tha Gordoni.*[113]

Briani ishte një fëmijë i shkathët, i zgjuar, nuk ishte nxënës shumë i mirë i klasës në kolegjin "Sherman", por ishte tepër inteligjent, me pak studim ai arriti të dilte mbi të tjerët, por dhe mbi Donifanin që e mbante veten si më të mirin e grupit.

Të dy vëllezërit, Briani dhe Zhaku, ishin francezë, Gordoni amerikan, kurse të tjerët nga Zelanda e Re. Briani, trembëdhjetëvjeçari, ishte djalë i zgjuar dhe mjaft i shkathët, mirëpo nuk mësonte mirë. Për të mbajtur mend të mahniste, një kujtesë e mrekullueshme ajo e tija. Sikur të mësonte fare pak ai me siguri do të dilte i shkëlqyer në mësime. Ndoshta prandaj edhe Donifani e kishte zili.[114]

Ai ishte i sinqertë në lidhje me shokët, nuk kishte cmirë ose egoizëm, nuk e mburrte veten si Donifani, ishte praktik, i pëlqente t'iu vinte në ndihmë shokëve në çastet më të vështira. Kujtojmë këtu episodin kur Donifani u plagos nga Roku në shpatull. Briani i shkoi menjëherë në ndihmë, i erdhi keq duke e ngritur atë dhe duke e çuar në shpellë për ta shëruar. Kujtojmë edhe rastin tjetër kur grupi i përbërë nga Donifani, Vebi, Krosi etj, u përça nga grupi i madh si kundështarë të Brianit dhe vendosi që të ngrejë një kamp në buzë të lumit. Atëherë Briani u shqetësua sepse kishte marrë vesh që në këtë ishull ishte përmbytur një anije dhe ata kishin takuar një grua atje me emrin Keti, e cila u tregoi se piratët Valstani, Roku, Forbiu ndodheshin në ishull dhe kërkonin te vrisnin fëmijët.

Që në titull *Shpella e piratëve* të krijon një lloj frike e jo më të futesh brenda, gjë që fëmijët arrijnë ta realizojnë, ta eksplorojnë dhe të na sjellin të papriturat. Të bën përshtypje dhe mënyra e organizimit të tyre psh, te *Dy vjet pushime* ne habitemi se si këta 15 fëmijë kanë një organizim të shkëlqyer përsa u përket bashkëpunimit dhe bashkëmendimit të veprimeve, të sjellurit në grup. Edhe te 5 fëmijët, Jani, Fotoja, Loloja, Lulja dhe Iliri kanë një organizim perfekt midis tyre. Loloja është kryetari që jep urdhra, vendime të cilët fëmijët t'i zbatojnë; detyrat e gjithsecilit janë të ndara e të përcaktuara qartë.

Pra, themi se nuk kemi një bashkëjetesë të kërcënuar, por një bashkëjetesë mirëkuptimi midis fëmijëve, ku ata arrijnë ta gjejnë gjuhën e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Në rrethana të çuditshme, të cilat me vonë zbulohen, lexuesi njihet me një grup prej 15 fëmijësh të cilët kanë hyrë në anijen "Sllugu" për të bërë një udhëtim. Papritur anijen pa ekuipazh, po vetëm me këta fëmijë të vegjël, e rrëmben stuhia, e ka larguar nga bregu duke e lënë në dallgët e ashpra të oqeanit Paqësor. Në këtë moment ne fillojmë të njihemi me personazhet kryesore: Briani, Gordoni, Mokon. Pas shumë peripecive, stuhia e madhe e hedh anijen në një kënd të humbur, në brigjet e një toke të fshehtë, ku fëmijët gjenden të vetmuar, pa një të rritur që t'i drejtojë përpara të panjohurës, fillojnë të zbërthehen karakteret e personazheve.

Gordoni ishte tip i fëmijës së shkathët e të zgjuar, i cili kërkonte që grupi i fëmijëve të kishte përherë harmoni dhe gjithashtu përpiqej që të shuante konfliktin ndërmjet Brianit dhe Donifanit.

---

[113] Zhyl Vern, "Dy vjet pushime", UEGEN, 2004. f. 71

[114] Po aty, f. 16

Piratët Valstari, Roku, Fobi ndodheshin në ishull dhe kërkonin t'i vrisnin fëmijët.

Në këtë kohë Briani ishte shumë i shqetësuar për Donifanin, Vebin, Krasin që ndodheshin në rrezik dhe shkoi për ta marrë atë nga mjeti i tyre duke e shpëtuar Donifanin nga një rrezik i momentit që iu kanos kur një xhapan i hipi për supe. Për ta shpëtuar Briani ia bëri me shenjë Ëilkasit të punonte me shkathtësi (kishin hallin se i zbulonin piratët) dhe shpejt iu hodh kafshës përsipër duke e goditur në krahë për të shpëtuar Donifanin. Pra këtu tregohet se sado që Donifani e kishte urryer Brianin ngaqë tjetri ishte i shkathët, më praktik, i gjithgjendshëm në situata të rrezikshme, prapë Briani kërkonte t'i vinte në ndihmë. Briani kishte një fuqi të madhe, ai tregoi trimëri të rrallë në momentin kur anija "Sllugu" ndodhej në rrezik kur po përplasej me dallgët e egra. Ai tregoi shkathtësi në drejtimin e saj, në rregullimin e anijes, në rregullimin e trarëve, madje ai, duke kërkuar që të gjente një vend për të lidhur anijen, arriti të rrezikojë aq shumë në det saqë gati e mbyti vorbulla e fuqishme.

Briani ishte i dashur, ai kujdesej për të vegjlit e shpellës kur Gordoni dhe Donifani largoheshin, i pëlqente të bënte udhëtime, ekspedita në pyll duke u ngjitur gjatë kodrës më të lartë për të zbuluar n.q.s toka ku ata banonin ishte ishull apo pjesë e detit. Ai pëlqente të zbulonte lumenjtë, liqenet, drurët e ndryshëm që ndodheshin në pyll. Ishte i zoti në gjueti; kujtojmë këtu të gjithë fëmijët përfshirë edhe Brianin, të cilët shkuan në breg të detit për të vrarë fokat e panumërta që ndodheshin aty në pyll, që me dhjamin e tyre të bënin disa qirinj për të ndriçuar në shpella. Briani theksonte gjatë gjithë kohës se dëshironte të kthehej në shtëpi bashkë me fëmijët. Kështu, ai ishte ndërmarrësi i shumë planeve, njëri nga këto ishte ai për të ndërtuar një balonë që të ngjitej sa më lartë në qiell për të vëzhguar në qoftë se piratët ishin aty apo kishin ikur. Së fundi themi se Briani ishte një djalë i zgjuar, i dashur dhe zemërmirë.

Ndërsa te romani *Shpella e piratëve* kemi 5 personazhe fëmijë, gjithësecili spikat me tiparet e individualitetit të tij. Niko Dabo përfaqëson personazhin e rritur që u tregon këtyre fëmijëve përmes gojëdhënave, episode të ndryshme të jetës shqiptare duke zbavitur kështu kërshërinë dhe kuriozitetin e fëmijëve.

Loloja është një fëmijë i shkathët, i zgjuar, tip organizatori. Ai i ngjan Gordonit pasi merr përsipër që të kujdesej për këta fëmijë në këtë aventure të rrezikshme që kishin marrë. Ai është esmer, ka flokë kaçurrela dhe ta jep përshtypjen e marinarit të thjeshtë, s'i trembet syri asnjëherë përballë vështirësisë dhe pengesave që has gjatë zbulimit të shpellës.

Iliri një fëmijë kureshtar, i shkathët, i ngjan tipit të Brianit; është i mençur, vepron me zgjuarsi dhe trimëri. Lulja është motra e Ilirit. Ajo edhe pse e vogël në moshë ka dëshirë të zbulojë të panjohurën, rrezikun, duke i ndjekur fëmijët hap pas hapi në aventurat e tyre. Jani është një fëmijë kureshtar, por edhe pak frikacak dhe i ndrojtur.

Gjuha në këto dy vepra është e thjeshtë. Petro Marko përshkruan bukuritë e Jonit, shpellën e thepisur, botën detare me peshq të ndryshëm etj. Autori përdor shumë figura letrare për të paraqitur bregun e detit dhe të mirat materiale të kësaj treve:

Kur u gjenda në rrugën e madhe, vura re se s'kishte njeri. Nën ullinj loznin hijet e thella, kurse në pllajat e zhveshura kish nisur të shquhej drita e agimit.

S'kisha parë kurrë një agim të tillë. Në qiell yjet po humbisnin e shkriheshin si kokrrat e sheqerit në ujin e kaltër. Nën mua deti i qetë flinte i madhërishëm. Ç'qetësi dhe bukuri e rrallë! Atje lart Malet e Vetëtimës, si kështjellë shekullore, ngriheshin hierëndë; kurse plazhi përposh si një top basme e bardhë e hapur tej e tej, që nga

kampi i Pushimit të Punëtorëve e deri te kepi i Shpellës së Piratëve, nanurisej lehtë nga pështpëritjet e fjetura të valëve të lodhura....[115]

Autori herë-herë duket si një bujk i mirë që përshkruan agrumet, ullirin, rrushin, fiqtë, por herë-herë edhe si një peshkatar i mirë që i njeh shkëlqyeshëm të gjitha llojet e peshqve, si: sinagridhën, lavrakun, qefullen, kocën, oktapodin, gaforren, peshkaqenin, etj:

...Peshkatari e kishte shtrirë sinagridhën e madhe dhe i binte me majën e thikës në bisht. Luante me të. Ajo hidhej dhe kërcente me fuqi. Ai luante dhe luante me të, pastaj i futi një thikë mu në kafkë. Sinagridha e madhe tundi disa herë bishtin dhe pastaj nuk lëvizi më[116].

Ndërsa Zhyl Vern përshkruan ngjarje e jep informacione të shumta shkencore nga bota e ishullit (veçori tipike e të gjitha veprave të Zhyl Vernit). Veçanërisht tërheqëse janë përshkrimet e natyrës së ishullit, të bimësisë e të botës së tij shtazore. Të pasura janë gjithashtu njohuritë gjeografike të shoqëruara me të dhëna të hollësishme e kuriozitete mbi klimën e dukuri të tjera; që të gjitha dhënë në rrugë artistike që të mos e lodhin lexuesin e vogël.

Fjalitë në të dy veprat janë të thjeshta, të qarta, të shkurtra, dinamike, tërë dramacitet; stili është i rrjedhshëm dhe me një figuracion shumë të pasur. Për të rritur sa më shumë kureshtjen e lexuesve, autori përdor vazhdimisht fjalitë pyetëse: *A do t'u bënte dot ballë dallgëve të tërbuara kjo anije? E ç'do të bënte një anije e vetmuar në mes të oqeanit? Si është e mundur që aty të mos kalonte qoftë edhe një anije e vetme?* (f .18)

Petro Marko edhe pse flet për fëmijë, shprehet figurshëm me anën e metaforave, epiteteve, krahasimeve të ndryshme dhe me një imagjinatë që nuk shter kurrë. Por ai ngre dhe probleme morale, si atë të respektimit të vetvetes nëpërmjet respektimit dhe njohjes së rrënjëve prej të cilave kemi ardhur, sepse në fund të fundit ne duhet të krenohemi për këto rrënjë.

Por dhe mbyllja e romanit është shumë origjinale:

"*Anijet u afruan në breg. Përpara se të zbrisnin, Gjonbaba ynë na pështpëriti:*

- *Nesër, ora 8 takimi te Shpella e Pano Gjinit. Merrni me vete letër e lapsa. Duhet të shkruajmë bashkë gjithë ato që pamë dhe sidomos ato faqe të çuditshme që lexuam në librin e "Historisë së Shpellës"*[117].

5.5 Adelina Mamaqi – poetja e moshës parashkollore dhe të ulët shkollore

Adelina Mamaqi[118] u takon atyre shkrimtarëve të letërsisë sonë për fëmijë që me krijimtarinë e saj prek disa nga temat, çështjet, motivet që është e lidhur bota e

[115] Petro Marko, "Shpella e Piratëve", Tiranë, 1998, f. 12
[116] Po aty, f. 19
[117] Po aty, f. 134
[118] Shkrimtarja për fëmijë u lind në Tiranë më 1939. Aty kreu shkollën fillore, të mesmen, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Punoi shumë vjet në redaksinë për fëmijë të Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", në redaksinë e letërsisë për fëmijë, për të kaluar më vonë si redaktore në revistën "Nëntori", Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve, pastaj mbi njëzet vjet në revistat "Fatosi" e "Pionieri".

fëmijëve. Duket sikur dalëngadalë me perlat e saj zbulon botën magjike të të vegjëlve, aventurat e tyre, dëshirat pa fund, ëndrrat plot jetë.

Për mua – thotë në një intervistë shkrimtarja, *letërsia është një dashuri shumë e madhe, që, pas fëmijëve, nuk e barazoj me asgjë tjetër. Kur nuk shkruaj, përpunoj në tru variante të ndryshme. Letërsia për fëmijë më është bërë magnet, më jep vazhdimisht tema*[119].

Adelina Mamaqi është një shkrimtare me krijimtari të gjerë që e ka sprovuar penën në disa gjini dhe përherë ka pasur kërkesa ndaj veprave të veta, prandaj edhe vlerat edukative e artistike të librave që ka botuar janë të dukshme[120]. Gjithashtu është një shkrimtare që sjell risi në krijimtarinë e saj dhe në letërsinë shqipe për fëmijë.

Adelina Mamaqi është një nga autoret e para femra të kësaj letërsie, me një krijimtari letrare mjaft të pasur. Një krijuese e palodhur, e kujdesshme, që edhe në vitet e Demokracisë është shquar për prodhimtari artistike në sasi e cilësitë.

Gjatë viteve 1991-2002 Adelina u detyrua të marrë rrugën e mërgimit. Edhe pse ishte në mërgim, krijimtaria e saj ishte e pranishme në Shqipëri.

Shkrimtarja Adelina Mamaqi ka shkruar vjersha, tregime e përralla në vargje, poema dhe veprat që ka krijuar dëshmojnë kujdesin dhe lidhjen e ngushtë të saj me fëmijët. Ajo, duke e njohur mirë jetën e të vegjëlve arrin të depërtojë thellë në botën e tyre.

Emri i saj shfaqet para lexuesve në fund të viteve ’50 si e para poete për fëmijë, në botimin e librit me poezi “*Bubi i vogël*” në vitin 1963 duke u bërë kështu një nga krijueset më të dashura e më të njohura për voglushët..

“*Të shkruash për fëmijë kërkon një specifikë të veçantë* – përmend autorja. *Mendohet, se të shkruash për fëmijë është e lehtë. Ka pasur dhe ka shumë grafomanë që thoshin se po shkruanin për fëmijë. Është kollaj të vargëzosh, të bësh bejte. Të shkruash për fëmijë, të hysh në zemrën e lexuesit, që ai të thotë se dua këtë libër, dua librin e këtij shkrimtari, është tepër e vështirë, sepse duhet të dish të futesh në psikologjinë e fëmijës. Gjatë punës sime kanë kaluar shumë gjenerata, ku dhe mendimi i fëmijëve, mënyra se si e konceptojnë jetën ka ndryshuar. Është mjaft e vështirë që një shkrimtar i rritur të futet në psikologjinë e fëmijëve, është mjaft e vështirë. Kjo kërkon: dashuri shumë të madhe, të jesh i komunikueshëm me brezat, të veshësh “rrobën’ e fëmijës, të marrësh vesh gjuhën, të menduarin e tij, si dhe të vëzhgosh fëmijën”*[121].

Kështu, Adelina Mamaqi zë një vend të veçantë në krijimet për fëmijë[122]. Është një

[119] Jerida Kulla, “E dashuruar pas “Eseninit”, Shtator, 2011
[120] Odhise Grillo, “Panoramë letrare”, Tiranë, 1986, fq. 97
[121] Jerida Kulla, “E dashuruar pas “Eseninit”, Shtator, 2011
[122] Vepra të saj të njohura për fëmijë janë:
Prej tyre dhjetë janë me vjersha:
Bubi i vogël (1963),
Bregu i kaltër (1973),
Fishekzjarret (1974),
Kur në dimër bie borë (1975),
Lepurushi me akullore (1976),
Si thoni ju? (1976),
Vjershat e Majlindës (1978),
Një zog gëzimi (1981),
Mësoi Andi shkronje A (1987).

shkrimtare që gjatë gjithë kësaj kohe ka vazhduar të shkruajë, me një numër të pafund librash të botuar dhe të ribotuar, fituese e shumë çmimeve të para dhe dy herë e vlerësuar me Urdhrin "*Naim Frashëri*".

Ajo u ka dhuruar fëmijëve shumë libra. Krijimtaria letrare e Adelinës krahasuar me individualitetet krijuese të së njëjtës periudhë, si dhe ata që erdhën më vonë, qëndron në vlera të spikatura, të dallueshme dhe me tipare të papërsëritshme. Në vjershat e kësaj poeteje ka tematikë të larmishme dhe botë motivore të thellë, vlera edukative e psikologjike. Këtë e dëshmon edhe vëllimi me vjershat për fëmijë "*Fluturo, kërce e rend*", të cilin e koncepton si një shfaqje skenike. Poetja thurr vargje për lodrat dhe gëzimet në përshtatje me moshën dhe psikologjinë e fëmijëve si dhe marrëdheniet e tyre me zogjtë e kafshët. Fëmija nuk është vetëm soditës e ëndërrues por edhe pjesëmarrës.

A e dini ç'ngjau një ditë?
Lamë pyllin dhe shtëpitë,
fluturo, kërce e rend,
te ky libër zumë vend!
……
……
Në çdo faqe, në çdo fletë,
emrin do ta themi vetë![123]

Ndërsa sa u përket poemave, përrallave dhe tregimeve në vargje, shkrimtarja publikoi këta libra:
Orizi i milingonave (1965),
Goni trazovaçi (1967),
Hedhin valle bletët (1973),
Klloçka dhe kotelet (1975),
Milingonza me pushke (1976),
Libri që u bë përrallë (1979),
Kaltëroshi tekanjozi (1979),
Flutura dhe zambakët (1981).
Ndërsa në prozë:
Zogu Pup në shtëpinë prej xhami (novelë, 1982),
Si e gjete folenë, moj dallëndyshe? (përralla, 1985, ribotim 2007).
Si dhe librat e rinj të botuar pas viteve '90 ku krijimtaria e mirëfilltë dhe e re e autores zë pjesën dërrmuese. Përmendim:
Mësoi Andi shkronje A (ribotim në vitin 2001)
Ariu dhe dy karriket (2002)
Xhoi – Toi (2005)
Përrallëzat e shkronjave (2005)
Toçi dhe Poçi (2006)
Kaltëroshi tekanjozi (2007)
Lodërzat e alfabetit (2007)
Katër motrat stinë: fenomenet atmosferike dhe dukuritë gjeografike (2007)
Vëllaçkoja sa një lajthi (2007)
101 gjëegjëzat (2007)
Sa shtëpi ka dielli?(2008)
Fluturo, kërce e rend (1998, 2008)
Pinguini Ping Ping Pi (2009)
Si të blesh një ylber (2011)
Pemët u përkasin të gjithëve (2011), etj.
[123] Adelina Mamaqi, "Fluturo, kërce e rend", Tiranë, 1998, f. 1

Poetja gërsheton me zotësi tematikat në krijimet e saj, ku fëmijët marrin informacione të ndryshme mbi jetën e kafshëve dhe shpendëve të ndryshme. Rrëfimin, autorja e bën në vetën e parë, në formë përshkrimi apo dialogu. Personazhet e këtyre vjershave flasin për cilësitë e veset e veta, për raportin e tyre ndaj fëmijëve të tjerë.

Ndërsa ligjërimi në formë dialogu bëhet kryesisht kur kemi të bëjmë me personazhet të cilët janë të dëmshëm për njeriun, si për shembull;

Mizë, mizë,
bëz, bëz, bëëz!
Shpejt, me ik
Prej shtëpisë,
Se ushqimet
M'i bën pis!

(Miza)

Për shumicën e kafshëve autorja shkruan me dashuri. Krijon për pulën që bën vezët dhe zogjtë e saj, për harabelin që u dhuron këngë fëmijëve: *çdo mëngjes, dimër, verë/ zëri im ju zgjon përherë/ në dritare ju qëndroj/ këngën time ju dhuroj*....; apo për dallëndyshet bishtgërshërë aq të dashura për fëmijët, të cilat dhe gjyshet i krahasojnë fëmijët me to:

Dhe juve, bebusha
Të mirka, të urta,
Të dashurat gjyshe
Ju thonë: Dallëndyshe!

Në vjershat e saj, fëmijët marrin shumë informacion: për fluturën, xixëllonjën, bletën, pëllumbin, lepurin, peshkun, kalin, luanin, majmunin, etj. Autorja i di mirë të fshehtat e botës së fëmijëve, dëshirat e tyre dhe këtë ajo e pasqyron kaq bukur me këto vjershërime lodruese.

Në opusin cilësor, rrezaton veçanërisht opusi letrar i botuar pas viteve '90, opus që numëron afro 21 vepra letrare të cilat u adresohen disa grupmoshave të lexuesve të vegjël, parashkollor dhe shkollorë. Përmendim këtu kolanën e re të veprave të saj, me titull "*Kopshti im i bukur*", ku në përmbajtje përfshihen mjaft libra të rinj me vjershëza, përrallëza, tregime si dhuratë për lexuesit e vegjël. Në këtë kolanë autorja ka përfshirë midis të tjerëve, edhe këta libra: "*Hopla, hopla, unë po rritem", "Vëllaçkoja sa një lajthi", "Arushi sheh një ëndërr", "Unë ylberin mbaj në duar", "Kaltëroshi, tekanjosi*", të cilat janë shumë tërheqëse për fëmijët. Në këtë kolanë janë shpalosur shumë nga vjershat më të mira ndër vite, madje edhe të ripunuara me dashuri dhe ngrohtësi për të vegjlit. Nga krijimtaria e gjerë dhe e bukur e Adelinës, veçojmë përmbledhjen me vjersha "*Mësoi Adi gërmën A*", ribotim i vitit 2001.

Vjershat e poetes janë të sinqerta, të ngrohta, me vargje që rimojnë e tingëllojnë bukur, duke përcjellë kështu kënaqësi të veçantë estetike te fëmijët. Përmendim këtu vjershën që i jep titullin vëllimit "*Mesoi Adi shkronjen A",* e cila i kushtohet shkronjës së parë të alfabetit tonë dhe që për ta mbetet shkonja më e dashur: *Adi i vogël ka mësuar/ shkronjën A për ta lexuar/ Se me A fillon Adushi/ Akullorja dhe arushi.*

Vargjet që i thur Adelina, bartin efekte të forta edukative dhe karakterizohen me porosi të thella ideore dhe edukative, janë si të thuash, një bashkëbisedim i saj me

fëmijët. Këtë e vërë re qoftë edhe në vjershën e parë të vëllimit "*Kur gëzojnë nënat".* Në opusin letrar të shkrimtares figura e nënës del e shumëllojshme; në rastin tonë, vargjet jane me rimë, plot gjallëri e gëzim*: Neve na mbush zemrat/ zëri i saj i bukur/ kur gëzojnë nënat/ jemi më të lumtur*.

Adelina, si një lexuese e mirë e dëshirave, mendimeve, botës së fëmijëve është quajtur edhe *ambasadore e fshehtësive poetike të fëmijëve*.[124] Kështu autorja, duke njohur këtë botë magjike të të vegjëlve, trajton tema e detaje nga jeta e përditshme duke synuar edukimin e tyre. Struktura e krijimeve është e thjeshtë. Shumica e tyre ndërtuar me strofa katërvargëshe, me vargje të rrjedhshme, që rimojnë me njëra-tjetrën dhe mbahen mend lehtë nga femijet. Poezitë jane rrëfime të bukura, me plot përshkrime e me personazhe qoftë nga fëmijët, qoftë nga bota e florës dhe e faunës.

Në përmbledhjet poetike të Adelina Mamaqit vihet re edhe një veçori tjetër që e bën të dallueshme dhe të pëlqyeshme tek fëmijët: humori. Për shembull:

Vjen në shkollë i hallakatur
sytë pa larë mezi i hap,
shpesh çorapet
ia sheh mbathur
njërën mbarë
e tjetrën prap! [125]

Ndërsa në vjershën tjetër, autorja përmes një humori të lehtë e të këndshëm, përcjell këto vargje:

Ke një goxha mjekër,
Je një çik e egër.
Ke edhe një kec,
porsi karkalec[126]

Le të ndalemi pak tek libri "*Goni trazovaçi"* ku autorja vë në qendër një fëmijë të klasës së parë. Në këtë vëllim të shkrimtares janë përmbledhur dy poema dhe njëzet e një poezi, ku fëmijët ndeshen me personazhet e tyre të dashur, si psh aventurat e Goni trazovaçit.

Ja, këtu në lagjen tonë,
Ka plot vajza edhe djem;
Por për një që quhet Goni,
Një tregim sot do t'ju them.

Eja njiheni në daçi,
Këtë djalë moshatar.
Quhet Goni trazovaçi
Dhe mëson në klasë të parë.

[124] Shukrije Rama, "Shpirti plor rubinë" (studime), Prishtinë, 2007. F. 35
[125] Adelina Mamaqi, "Si thoni Ju?" Tiranë, 1976. f. 50
[126] Adelina Mamaqi, "Fluturo, kërce dhe rend", Tiranë, 1998. f. 25

Gjatë leximit të rrëfimit për Gonin, shokun e tyre që e ndeshin kudo, në lagje, në oborrin e shkollës, në klasë, fëmijët gjejnë veten dhe botën e tyre të aventurave. Veçoria që e bën aq të pëlqyeshme për lexuesit e vegjël këtë poemë është humori, i cili përshkon tërë krijimin.

Ky humor kryesisht buron nga situatat në të cilat e vendos autorja protagonistin e saj, Goni trazovaçin.

Në poemën *Hedhin valle bletët* shkrimtarja për fëmijë Adelina Mamaqi përcjell për lexuesit një botë të veçantë për bletët. Ajo i njeh kaq mirë jetën e këtyre kandrave, saqë fëmijve u lind dëshira t'u ngjajnë bletëve, të kenë vullnet për punë dhe pastërti si ato...

Përveç informacioneve të ndryshme që marrin, ata mësojnë shumë fjalë të reja. Do të mësojnë mjaft shprehje frazeologjike e fjalë të urta.

Ky libër, krahas të tjerave, do të na e pasurojë gjuhën me shumë fjalë dhe shprehje të reja e të bukura, sepse këtu kemi një burim të shëndoshë dhe të kulluar nga i cili mund të shuajmë etjen, të freskohemi dhe kënaqim shpirtin[127].

Autorja ka dëshirë të madhe të luaj me fëmijët, me dëshirat e tyre, ndaj në poezitë e saj shohim që çdo fëmijë mund ta gjejë veten. Kështu ndodh dhe me personazhin vajzë tek *Vjershat e Majlindës*. Në qendër të çdo vjershe është vënë i njejti personazh, vogëlushja Majlindë. Çdo fëmijë mund ta vërë emrin e vet në vjershë dhe, në vend që të thotë *Jam Majlinda/ a nuk ngjaj si lule fushe?, të deklamojë: Jam Albana*... duke e bërë kështu lexuesen vetë heroinë të librit dhe kjo zgjon imagjinatën dhe dëshirat e fëmijëve.

Veç vargjeve kjo autore i është drejtuar dhe prozës. Fryt i kësaj pune janë shumë tregime të botuara në organet periodike të fëmijëve, si; *Fatosi*, *Pionieri* e Yllkat. Përmendim novelën "***Zogu Pup në shtëpinë prej xhami***" dhe vëllimin me përralla *Si e gjete folenë, moj dallëndyshe*?, i cili qe vlerësuar edhe me çmim të parë në konkursin kombëtar të letërsisë për fëmijë. Dhe ne do të ndalemi pikërisht në këtë vepër. Kush tjetër mund të shkruajë më bukur për fëmijët, ëndrrat, botën dhe fantazinë e tyre përveçse një shkrimtare, një femër, një nëne!

Dhe Adelina, në hyrje të përrallëzave u drejton një letër:

Të dashur voglushe,
E di që ju pëlqejnë përrallat. A t'ju them një të fshehtë? Edhe mua më pëlqejnë shumë.
I kërkoj kudo: në pyll, në mal, në det, brenda në shtëpi...I kërkoj te pemët, te valët...edhe te lodrat tuaja![128]

Përsëritja e pjesëzave përkedhëlëse, fjalët onomatopeike, dialogët e gjallë, figurat e shumta letrare janë disa nga veçantitë e krijimeve të saja. Ajo e kupton mirë këtë botë, njëjtësohet me lexuesit duke u përcjellë atyre vlera dhe dije për gjithçka i rrethon. Ky vëllim është ndarë në 17 përrallëza të vogla, të ndryshme, që flasin për botën e kafshëve dhe zogjve si; *Farëzat e luleshtrydhes, Molusku mburracak, Bishti i dhelprës së kuqe, etj*.

Pikërisht në këtë vëllim ka shumë njohuri interesante që përcillen tek lexuesi fëmijë në formën e përrallëzave që janë aq të pëlqyera për ta. Duke qenë se ky libër ka përmbajtje shkencore, fare mirë mund të quhet një *enciklopedi artistike*. Gjuha që ka përdorur autorja është e bukur, e thjeshtë dhe e përshtatshme. Dialogu e bën të gjallë

[127] Fejzi Bojku, në pasthënien e vëllimit "Goni trazovaçi", Shkup, 2002, fq. 57
[128] Adelina Mamaqi, "Si e gjete folenë moj dallëndyshe", Tiranë, 2007, f. 3

këtë përrallëz, personifikimi është përdorur shumë bukur në bisedën e dallëndyshes me diellin por edhe me fëmijët (përralla që i jep titullin përmbledhjes). Këtu fëmijët mësojnë mbi jetën e dallëndysheve, mënyrën se si ato çelin zoçkat e tyre, shtegtimin dhe se si ato ndërtojnë foletë. Foleja është vendi ku nis jeta.

Veç dijeve shkencore, përrallat e saj përmbajnë edhe vlera edukuese për lexuesit e vegjël. Për shembull, në përrallën për balenat jepet një mesazh moral, ai i dashurisë së nënës për bijën e vet. Apo tek përralla *Pelikani i verbër,* jepet kujdesi dhe dashuria për shokun në nevojë. Gjithashtu autorja jep informacion për botën bimore në përrallën *Farërat e luleshtrydhes*, ku u tregohet fëmijëve se si përhapen farat e shumë bimëve në vende të ndryshme dhe t'i duan dhe t' i mbrojnë zogjtë. Apo te *Bleta dhe trendafili* ku autorja jep shumë informacion mbi bletët. Ato janë punëtore dhe të dobishme për njerëzit. Bletët na japin mjaltin që është ilaç për njeriun.

Në përgjithësi përrallat jane thurur bukur, subjektet janë të thjeshta dhe interesante. Dhe përmbajnë shumë mesazhe.

Autorja në një intervistë thekson se: *në librat që ka shkruar nga viti 2000 e këtej, ka patur edhe ndonjë ribotim. Por mund të quhen të mirëfillta, mbasi thuajse i ka shkruar përsëri, duke i sjellë në kohë e në hapësirë, me këndvështrimin, formimin, konceptimin dhe botëkuptimin e lexuesit të vogël të shekullit të ri. Për shembull, kur u ribotua "Orizi i milingonave", milingonat e këtij botimi, jetojnë e veprojnë në kushte diametralikisht të ndryshme nga ato të botimit të parë, kushte që ky lexues i njeh dhe e zbavit*.[129]

Te poema-përrallë "***Orizi i milingonave"***, autorja e ka marrë nismën nga një lloj bari, që nxjerr kokrra të rrumbullakta, të bardha si oriz. Ajo i fut fëmijët në një botë interesante, në shtëpinë e milingonave, të cilat e ndërtojnë dhe e mbrojnë me djersën e përbashkët që derdhin. Është shkruar me një gjuhë të ngrohtë e të rrjedhshme, me elemente të folklorit duke i edukuar të vegjlit me ndjenjën e punës dhe të syçeltërsisë. Fabula e bukur përrallore është marrë nga bota faunike, nga bota e gjallesave, e cila është shumë e dashur dhe interesante për fëmijët. Veç shtëpisë së milingonave, autorja tregohet shumë e kujdesshme në zgjedhjen e personazheve.

Për shembull, tek mulliri ku bluajnë drithërat kandrrat, mullixhi është një brumbull, kurse ata që vijnë për të bluar janë pleshti, karkaleci, gjinkallat, milingonat. Poema përshkohet nga një humor i lehtë e i këndshëm që mbështet në folklor. Ky jepet jo vetëm me shprehjet dhe fjalorin e përdorur, por edhe në vlerësimin e portretizimin e personazheve. Gjithashtu në këtë poeme të bie në sy edhe një veçanti tjetër e kësaj autoreje, përdorimi i onomatopesë, efektet dhe humorin që krijon me përsëritjen e vargjeve të fundit, me aliteracionin (*përsëritjen e zanoreve u, e,a).* Onomatopeja *vu e vu e vu*! riprodhon zhurmërimën që bën mielli kur del poshtë gurit të mullirit. Apo onomatopeja *hop e hop e hop* – kërcimin e karkalecit e të pleshtit. Janë të gjitha këto mjete artistike, të cilat autorja i përdor me mjeshtëri për të krijuar efektin që dëshiron, duke na futur pakuptuar në botën fantastike të mullirit dhe na bën ta përjetojmë me emocion gjithçka. Adelina u transmeton fëmijëve emocione, njohuri dhe përfytyrime nga bota e sendeve dhe e kafshëve;

[129] Mamaqi, Adelina; Gazeta Nacional, 4 shtator 2011, f. 3

Eni, bija, të punojmë
- foli Nëna milingonë,
këtë radhe ta ndërtojmë
më të fort'shtëpinë tonë.[130]

Shkrimtarja për fëmijë arrin me shumë sukses të gërshetojë realen me fantastiken, sidomos kur ndërthuret bota e kafshëve me atë njerëzore. Gjithashtu me shumë lehtësi arrin të pasqyrojë jetën dhe botën me gjithë problematikat e jetës së përditshme.

Në vëllimin me poezi "***Pinguini Ping Ping Pi"*** *(2009),* titulli lidhet me një kafshë jo fort të njohur për shqiptarët dhe jo shumë e përmendur në përralla, pra pinguini. Autorja sjell dhe një informacion të ri për fëmijët, i njeh me një shpend, ndoshta të palexuar ose të parë vetëm nëpër filma vizatimore. Titulli është tërheqës dhe ka muzikalitet për shkak të përsëritjes katër herë të tingullit P. Vjershat jane të shkurtra, me disa strofa, përgjithësisht deri në tre ose katër vargërshe, duke bërë kështu që fëmijët t'i mësojnë dhe t'i mbajnë mend lehtë. Gjuha është e thjeshtë dhe e kuptueshme, gërshetuar bukur me dialogun, rimën, metaforën dhe pasthirrmën.

Përgjithësisht vjershat dhe përrallat me kafshë janë vërtet të dashura për fëmijët. Ato kanë funksion njohës, ndërkohë që përcjellin dhe mesazhe. Në rastin tonë, prania e pinguinit nuk është e rastësishme. Në brendësi gjënden disa poezi kushtuar kësaj kafshe të rrallë që rritet në vendet polare:

Larg, në pol s'di se si,
Pinguini Ping Ping Pi,
Na i gjen një pale ski!

Pa i mbath shpejt e shpejt,
përmbi akull "fiiiu" rreshqet,
por... na bije....bishtpërpjetë!..

Dhe zë qan me "ih!...ih!...iii!
- O i vogli Ping Ping Pi,
asnjë në këtë botë,
pa mësuar, s'bëhet dot![131]

Kjo poezi është e shkurtër, e ndërtuar me tre strofa, dy prej të cilave janë tre vargëshe dhe strofa e fundit me katër vargje. Rima është e njëpasnjëshme. Vargu ka muzikalitet, në vargun e dytë kemi përsëritje të shkronjës p (aliteracioni). Në strofën e dytë, vargjet fillojnë me shkronjën P dhe kemi përdorim të pasthirrmave. Vjersha na njeh me pinguinët që jetojnë në Pol, pra në zonat e ftohta dhe të largëta duke shoqëruar me lojën e Pinguinit dhe mesazhin që përcjell kjo vjershë: Asgjë në këtë botë, pa mësuar s'bëhet dot. Ndërsa në poezinë *Mami Hënë*;

Mami Hënë shëtit çdo natë,
yjet, fëmijët që ka,
veshur me mantel të artë,
Të mahnitshëm ata janë!

[130] Mamaqi, Adelina "Orizi i milingonave", Tiranë, 1978, f. 3
[131] Adelina Mamaqi, "Piguini Ping Ping Pi", Tiranë, 2007, f. 2

Yjet flenë…s'i sheh askush,
sepse gjyshja Ditë, me radhë,
i mbulon si vogëlushë,
Me kuvertëzë të bardhë...

...Fle dhe mami Hënë vetë,
E mbuluar nën kuvertë...

Në qendër të kësaj poezie janë dukuritë atmosferike që janë shpjeguar e zbukuruar me penën dhe talentin e autores. Poezia është me katër strofa, me rimë të njëpasnjëshme, janë përdorur epitete si *të mahnitshme, e artë,* apo metaforat e bukura: Hëna është ngritur, është krahasuar me Mamanë, që sheh gjithçka prej së largu dhe kujdeset për yjet, për fëmijët. Me anë të metaforës, vjen në dukje i gjithë proçesi astronomik që ndodh: hëna nuk fle, por gjatë ditës i lë vendin diellit, yjet nuk flenë, por gjatë ditës nuk duken sepse drita e ditës i mbulon ata, si një gjyshe që i vesh me kuvertën e bardhë, siç shprehet autorja.

Adelina Mamaqi, është një shkrimtare që e di shumë mirë se çfarë pëlqejnë fëmijët, ndaj, argëtimin, moralen dhe informacionin e përcjell me mjeshtëri, duke krijuar në mënyrë perfekte komunikimin me lexuesin e saj aq të dashur. Përmes vargjeve autorja shqetësohet, loton, beson, ëndërron, gëzohet dhe emocionet me personazhet e saj. Sepse personazhin e ka të shtrenjtë! E rrëfen bukur atë, po aq sa krijimin e saj në tërësi. Duke bërë kështu që të lexohen me ëndje dhe dëshirë.

Ndalemi pak tek libri me poezi "***Xhoi- Toi***", i cili që nga titulli duket mjaft argëtues. Në këtë përmbledhje autorja ka pasqyruar temat, subjektet, fantazinë, fjalorin interesant dhe të veçantë të voglushëve, ëndrrat, dëshirat, lojën. Mozaiku i vjershave ka për temë fëmijërinë dhe lojën si shoqëruese të saj. Këto poezi si: *Xhoi-Toi, Kush ta fali emrin?, Yll, o yll i vogël!!, Xhoi do një... vjershë.*

Xhois, e vogla, porsi lulet,
Vjen pranë meje, do të ulet.

Cicëron si dallëndyshe:
A ke preher ti, moj gjyshe?

Zemra ime, kam posi,
A të ulem e të rri?

Xhois ulet, buzëqesh:
- Gjyshe, thuajmë një vjershë!

Zemër, sa te duash ti,
Gjithë librin tim të ri![132]

[132] Adelina Mamaqi, "Xhoi- Toi", Tirane, 2005, Xhois do një… vjershë, f. 6

Në këtë poezi elementi lodërtar zë një hapësirë të konsiderueshme. Xhoisi, është një personazh, që në këtë libër, ka universin e vet, ka lojën e saj, lojë që i fal gëzim, buzëqeshje e lumturi, kureshtje dhe e zgjon të bëjë pyetje pa fund...

Te vjersha *Lepurush, dhe ti bëj nani!*, realitetin, autorja e percepton me syrin e fëmijës:

Fjeti dielli pas çatisë,
Fjeti zogu i kuvlisë,
Fjeti bubi te divani...
Lepurush, dhe ti bëj nani!

Poezia është e ndërtuar me tri strofa tetërrokëshe. Autorja në këtë rast përdor dhe përsëritjen e fjalës *fjeti* duke krijuar muzikalitet, i cili është dhe karakteristikë e poezisë popullore të ninullave. *Ndaj autorja me krijimet e saj, librat magjike, ka dëshmuar se librat që ajo krijon, mesazhet që përcjell, për të janë si dritaret e shpirtit; janë shkruar për t'i prirë lumturisë së vërtetë të fëmijëve, të ardhmes së tyre.*[133]

Ja, se çfarë na thotë autorja në vjershën "***Një libër i bukur***":

Me dritare i bëjmë shtëpitë
Të kenë ajër e diell e dritë!

Po një libër i bukur, me fletë,
A e di, vogelush, ç'mund të ketë?

Ai ka njëmijë dritare,
Të shikosh gjithë botën e madhe![134]

E mbyllim këtë analizë me këto vargje kaq të ëmbla të saj;

Dhe sot ia dëgjoj zërin e ëmbël,
Dhe sot ia vështroj sytë zjarr.
E desha, o miq, me gjithë zemër,
Mësuesen e klasës së parë.

Ajo më mësoi si të shkruaj
Dy emrat: Atdhe e Nënë,
Këshillat, qortimet e saj,
Ç'mbresa n'shpirt m'kanë lënë!

Ah, ç'gaz kur dëgjoj zën' e ëmbël,
Këshillat e saj kur kujtoj!
E desha, o miq, me gjithë zemër
Dhe s'mundem askurr' ta harroj.
(*Mësonjesa)*[135]

[133] Xhahid Bushati, "Shkrimtari, personazhi, lexuesi i vogël – Marrëdhënie, raporte dhe aspekte të komunikimit artistik në poezinë për fëmijë të Adelina Mamaqit (Studim), Revista OBELISK 134, f. 5
[134] Adelina Mamaqi, Xhoi- Toi, Sa shtëpi ka dielli. f. 30
[135] Adelina Mamaqi, "Ëndrra vashërije" , Prishtinë, 1968, f. 36

Ndërsa studiuesi Faik Shkodra[136] ka theksuar për Adelina Mamaqin: "*Pena e saj vazhdon të shkruajë vepra zhanresh të ndryshme për më shumë se gjysmë shekulli. Adelina është një emër identifikues i letërsisë sonë për të vegjlit, është një zë i ëmbël ashtu siç janë të ëmbël zërat e fatosave tanë, për të cilët poetja solli vargjet më të bukura, më të kristalta dhe me jehonë për ëndrrat, këngët, buzëqeshjet, lotët, gëzimin, shpresat, rriten dhe jetën e tyre".*

Në veprat e saj, shkrimtarja Adelina Mamaqi kërkon që ato të përmbajnë sekretin që hap dyert e botës dhe të shpirtit të lexuesit, të bashkëbisedojë me të thjeshtë, ëmbël, rrjedhshëm, bukur, t'u sensibilizojë ndjenjat njerëzore, të formohen si persona civilë, t'u zgjerojë horizontin e dijes dhe të jenë edukativë, pa moralizuar. Adelina Mamaqi ka një botë, një mendje, një imagjinatë, një fantazi, një fjalor më të veçantë, me të cilin i shkruan veprat për fëmijë.

5.6 Xhevat Beqaraj – poeti i peizazhit akuarelist

Në letërsinë e sotme shqipe, veçanërisht në atë për fëmijë e të rinj, krijimtaria letrare e shkrimtarit Xhevat Beqaraj zë një vend të rëndësishëm dhe e radhit atë në mesin e shkrimtarëve më të mirë të letërsisë sonë për fëmijë. Me krijimtari letrare ka nisur të merret qysh kur ishte nxënës në klasën e gjashtë. "*Sigurisht* – përmend vetë shkrimtari në një intervistë, *që ndikimin e parë e kam pasur nga tekstet shkollore, nga autorët që mësonin në ato vite. Ishin vjersha të cilat unë i mësoja përmendësh, nga Naimi, Çajupi, apo dhe vjersha të tjera. Këto vjersha më futën në botën e tyre, duke më bërë të lëvroja më shumë këtë gjini".* Më pas kur ishte nxënës në shkollën e mesme botoi librin e parë, të titulluar "*Kam një harmonikë*" (vjersha, 1965). Më pas nxorri në dritë përmbledhjet me vjersha: "*Rrugica ime*" (1966) dhe "*Treni ynë*" (1968), "*Shtëpia e Bubit*" (1972), "*Elefanti dhe milingonat*" (poemë, 1974), "*Pse hëna nuk ka fustan*" (1974), "*Tigri i vogël në çajnik*" (1974), "*Unë, dielli dhe retë*" (vjersha, 1979), "*Era vizaton…*" (vjersha e poema, 1984), "*Letrat e vjeshtës*" (vjersha e poema, 1989), "*Nuk qeshin të gjithë*" (vjersha e poema, 2000), "*Çuditë e Eneidës*" (poemë, 2000), "*Rruazat e vesës*" (vjersha e poema, 2006). Dhe një pjesë e mirë e krijimtarisë së shkrimtarit ka në qendër natyrën, qiellin, zogjtë, detin, lumin, shelgjet, plepat e zhveshur që rëndohen nga bora, lotët e borës që marrin një shpresë nga ullinjtë që janë pranë.

Ndër tiparet e poezisë për fëmijë të Xhevat Beqarajt është shpirti poetik novator, spontaniteti dhe bota motivore e pasur, shprehja poetike moderne, të cilat janë ushqyer nga loja dhe fantazia fëminore. Qysh në vëllimet e para poetike: "*Kam një harmonikë*" dhe "*Rrugica ime*", poeti i këndon peizazhit dhe bukurive të natyrës, në këtë mjedis fëmijët ndërtojnë ëndrrat dhe dëshirat e tyre, vizionet për botën dhe mjedisin që i rrethon. Natyrisht, veçantia e këtij autori është peizazhi, pasi tek ai ka lënë mbresa të pashlyeshme natyra e bukur e fshatit të vet (Kut, i Mallakastrës), ndaj mundohet ta fiksojë në vargje. Një kodër, një fushë, një lumë apo një zog, një flutur, një mëz e një viçok janë që të gjithë pjesë të poezisë së tij. Janë kujtime fëmijërie, që autori kërkon t'i ndajë me fëmijët. Ndaj mund të themi që *poezitë e shkrimtarit Xhevat Beqarajt shquhen për vlerat origjinale dhe për forcën e veçantë komunikuese*

[136] Alfred Beka, Letërsi, ese, kritike, Nderohet Adena Mamaqi. fryma.blogspot.com

me të vegjlit, sepse duke i njohur mirë veçoritë e kësaj moshe, autori ka ditur për t'ia përshtatur brendinë dhe formën e krijimeve të veta kërkesave të të vegjëlve dhe mundësive të tyre njohëse e perceptuese[137].

Vjershat e shkrimtarit Xhevat Beqaraj u drejtohen sidomos moshës parashkollore dhe atyre të ulët shkollore. Karakteristikë e këtij poeti është pikërisht gjetja e motiveve e temave, të afërta dhe tërheqëse për botën e fëmijëve. Ky përkushtim i autorit shfaqet në tërë krijimtarinë e tij letrare. Poezitë e tij dallohen për cilësi artistike, rrjedhshmëri e muzikalitet të vargut, për figuracionin e gjetur e origjinal, për ndjenja të ngrohta emocionale. Tematika e trajtuar nga autori është mjaft e gjerë: *atdheu, puna, edukata, kureshtja, peizazhi, loja, shkolla, fauna, koha, njeriu.*

Temën e dashurisë ndaj *atdheut* dhe *punës* për ndërtimit e tij, poeti e trajton me lehtësi. Nëpërmjet gjetjes artistike, harmonikës, që mami ia ka blerë për ditëlindje femijës, përcillen ëmbëlsisht vargjet e dashurisë për atdheun:

Kam një harmonikë
Këndoj me gëzim
Këngën më të bukur
Për atdheun tim[138].

Është e qartë shqetësimi i autorit.

Puna është një aktivitet shumë i preferuar në librat poetikë të poetit Xhevat Beqarajt. Ajo është piknisje themelore për çdo arritje. Një atmosferë pune ndihet më shumë në stinën e pranverës, pasi kjo stinë është kohë e zgjimit të çdo gjallese. Në këtë stinë përtëritet dhe përjeton zgjim edhe trupi i njeriut. Fillon puna në fushë. Bora që shkrihet mbush përroin me ujë e zhurmon. Në kopshte hidhet fara e re. Hapen kanalet për ujitje. Me ardhjen e pranverës, ndjehet dhe gjallëria tek njerëzit që punojnë, ndaj poeti na përcjell vargjet si një këlthitje kolektive e fëmijëve e të rriturve:

O duart puna
Ca na ka vrarë,
po edhe gëzim
ajo na fal[139].

Edukata është një tjetër temë e trajtuar nga ana e autorit. Vetë letërsia për fëmijë në përgjithësi, synon drejt funksionit edukativ, pra kërkon t'i mësojë për të pëlqyer të mirën, të bukurën, të drejtën. Sigurisht që kjo veçori duhet të vijë natyrshëm, pa moralizime të tepruara, nëpërmjet lojës dhe gjithçka që zgjon kërshërinë e fëmijëve dhe që gërshetohet nëpërmjet shprehjes së bukur artistike. Një gjetje e tillë përshkon vjershat e poetit, por ne po ndalemi në vjershën "*Kur vjen dreka*[140]". Kur lexon vargjet e kësaj vjershe, fëmija bie në mendime. Pas ftesës së nënës që të ulet për drekë në tryezë, fëmija pret bukën dhe gjatë gjithë kohës derisa ha, nuk flet asnjë fjalë. Madje nuk nget as macen, e cila sillet vërdallë e të cilën ai e do aq shumë. Mësimi

[137] Çadri, Ramazan. "Letërsia shqipe për fëmijë", Tiranë, 2001, f. 137
[138] Beqaraj, Xhevat. "Kam një harmonikë", Prishtinë, 1999, f. 5
[139] Po aty, f. 22
[140] Po aty, f. 12

është i qartë, se nuk duhet folur derisa hahet. Natyrisht që fëmija e mëson dhe e ngulit në mëndje.

Në mjaft vjersha të poetit Xh. Beqarajt, disa personazhe i karakterizon *kureshtja* e theksuar. Ata duan të mësojnë për çdo gjë që i rrethon, për të gjitha dukuritë e natyrës. Kështu ndodh dhe me vjershën "*Gimi do të dijë*", ku personazhi Gimi, do të dijë çdo gjë, madje të befason me pyetjet që shtron si dhe me imagjinatën e tij. Do të mësojë ç'është rrufeja, kush e shpiku shpatën, si e mbledh bleta mjaltin, a flenë peshqit natën, ç'janë yjet dhe pse zhduken ditën, etj, etj...

Do të dijë ç'dëgjon Gimi
E sheh rreth e qark...
Ndaj dhe mami i mëson
Çdo gjë me durim[141]*...*

Përveç kureshtjes, fëmijët të habisin edhe me fantazinë e tyre, me idetë e çuditshme për botën dhe fenomenet. Kjo duket dhe në tregimet në vargje "*Çuditë e Eneidës*".

Personazh kryesor i këtyre rrëfimeve është Eneida. Që në fillim libri hapet me një imazh fantastik: Enit të vogël qielli i duket det, retë si dallgë, kurse hëna i ngjan në një varkë që lundron qiellit. Dhe fantazia e Enit nuk mbaron këtu; ajo dëshiron t'i zbresë yjet nga qielli dhe t'i bëj gjerdan, por ky meditim i ngjall edhe frikën mos mbetet e verbër nata dhe të qajë pastaj për yjet e vet. Kështu poezia përshkohet nga naiviteti fëminor, ndaj poeti ua prezanton në formën e përgjigjes për të nxitur dhe mësuar njokohësisht fëmijët. Vargjet shpesh zgjojnë kureshtjen e fëmijëve në formë pyetjesh a dëshirash dhe përgjigjja e tyre në vargjet poetike shpreh botpërjetime te thella dhe interesante, ku spikatin detajet poetike: "*Bubi mbyll syçkat mbi putra*", "*ariu fle në shpellë*", "*kukumjaçka rri në zgavër*", "*era lodhet duke bredhur*", "*nata qan për yjet e vet*", "*vetëtimat nëpërka*", "*ylberi që vajzat e duan për fjongo*".

Poeti Xhevat Beqaraj, në natyrën e vjershërimit të tij, shfaqet edhe si një mjeshtër i lirikës së natyrës, i akuareleve poetike". Në vëllimet poetike "*Unë, dielli dhe retë*", "*Letrat e vjeshtës*" si dhe vjersha të tjera, në sytë e fëmijëve poeti pikturon me vargje peizazhe mahnitëse. Stinët dhe pemët i shpirtëzon. Në këto bukuri të peizazhit shqiptar zënë vend edhe fenomene të ndryshme të natyrës: shiu, breshëri, bubullima, ylberi, hëna, dielli, mjegulla, etj.

Peizazhi i Xhevat Beqarajt nuk është vetëm një përshkrim i thjeshtë i natyrës, por është më tepër një përjetim i saj.

Si një piktore e padukshme
Zë ngjyen vjeshta...
Ca flokëkuqe, ca gështenjë,
më tepër flokëverdha.
Ndonjë prej tyre, pa përfillur,
era si me të qarë
këput. Dritares na e sjell
në mësimin e parë.

[141] Beqaraj, Xhevat. "Letrat e vjeshtës", Tiranë 1989, f. 6

Me mend e marrim, atë vjeshta
Na e dërgon si letër
E "Pritmëni, - sikur na shkruan, -
Se do të vij patjetër.[142]

Kështu fëmija, gjethin që vjeshta e këput nga degët dhe e hedh në dritare të shkollës e merr si një letër me të cilën vjeshta paralajmëron ardhjen e saj.

Motivi i *lojës* zë një vend të rëndësishëm në poezinë e Xhevat Beqarajt. Nëpërmjet lojës fëmijët do të mësojnë shumë gjëra interesante që zgjojnë kërshërinë e tyre. Titi e Bubi, te vjersha me të njëjtin titull, janë shokë të pandarë. Titi edhe bukën e ndan me Bubin. Por, kur ai e vë Bubin në djepin e motrës dhe në gojë ia fut thithkën me qumësht, Bubi e copëton thithkën. Ndaj qortimi i bëhet në formën e këshillës nga nëna:

Qeni duhet për zinxhir
Jo për djep e thithkë, bir![143]

Ose në vjershën "*Aeroplanit*" vihet në pah dëshira e fëmijës t'i pushtojë lartësitë, të fluturoj mbi oqean dhe t'i arrijë yjet.

Ne na lë gazin tonë,
Edhe ikën, fluturon,
Plepat puth e retë prek,
Gazi ynë pas e ndjek.
Kur e duam ai zbret,
Se ne vetë e ngritëm, vetë,
Ndaj në krahë edhe mban
Të shënuar emrat tanë.[144]

Aeroplani, i cili është vepër e vetë fëmijëve, ngrihet dhe zbret kur të duan ata, bashkë me gazin dhe emrat e tyre të shënuar në krahët e tij. Poeti heton dhe kap lojën e fëmijëve në të gjitha format e çastet që ajo zhvillohet duke u bërë pjesë e zgjidhje e tyre.

Ndër motivet e dashura të poetit Xhevat Beqaraj është edhe bota e fëmijëve në shkollë. Nuk ka vjersha të cilat do të merreshin në mënyrë më të shtruar më shkollën, me rolin apo funksionin e saj për zhvillimin e fëmijës, me detyrimin e respektimit të rendit aty, apo edhe me ngritjen e mësimit në plan të parë.

Gëzimi i madh i fëmijëve, fillimi i vitit të ri shkollor, është i lidhur me muajin shtator, me kohën kur në natyrë bën hapat e parë vjeshta me pasurinë e saj dhe kur fëmijët sikur lodhen nga pushimet në vapën e nxehtë të verës:

Mir' se vjen, shtator,
Vjeshtëzën ti sjell.
Sa ndien hapin tënd,
Shkollëza na ndjel.

---

[142] Beqaraj, Xhevat. "Letrat e vjeshtës", Tiranë 1989, f. 7
[143] Beqaraj, Xhevat. "Kam një harmonikë". Prishtinë, 1999, f. 16
[144] Po aty, f. 33

Zogjtë shtegtarë
Duken të trishtuar...
Ne të përshëndesim
Me libra në duar.[145]

Sigurisht që shenjë e parë dhe e paharrueshme në jetën e çdo shkollari është zilja e shkollës. Tringëllima e saj ua hap fëmijëve dyert e një jete të re plot gëzime e shqetësime (vjersha "*Zilja*"). Apo shenjë tjetër e pashlyeshme në kujtesën e çdo shkollari është klasa ku zhvillohet mësimi, ambienti ku nxënësi çon jetën me shoqet dhe shokët e vet.

Përveç vjershave me motivin e lojës, argëtimin, shkollën, në shumë të tjera poeti do të shkruajë për *botën e pasur faunale,* e cila bëhet motiv në vjershat e librit "*Treni ynë*", ku fëmijët ndeshen me gjelin, rosakun, bubin, macen etj. Këtu gjejmë edhe shpezët që i vizaton vogëlushi në fletëz vizatimi, kur rri vetëm në shtëpi. Ai komunikon me to dhe çuditet me veprimet e tyre. Por dashurinë dhe kujdesin ndaj zogjve fëmijët më së shpeshti e shprehin me ushqimin që u japin atyre. Voglushi që e ndan bukën jashtë me patokun, kërkon nga ai që t'ia kthejë të mirën me të mirë:

Po ti mëso
Të falenderosh
Dhe gishtin tim
Të mos kafshosh.[146]

Kur lexon vjershat e Xhevat Beqarajt kushtuar zogjve, të bëhet se ata jetojnë kryesisht në sajë të dashurisë dhe të kujdesit të fëmijëve për ta. Kjo bashkëjetesë e fëmijëve dhe zogjve, mirëkuptimi i thellë i tyre shprehen bukur ne vjershën "*Ankohen zogjtë*[147]", ku zogjtë ankohen për borën që ka rënë dhe ka fshehur gjithë krimbat që u shërbenin për ushqim, ndaj i lutin fëmijët të marrin lopatat dhe të qërojnë borën, por edhe të sjellin thërrime buke e kokrra gruri. Këtë të mirë zogjtë premtojnë se do t'ua kthejnë fëmijëve me këngët e tyre në pranverë. E mira, pra, kthehet me të mirë.

Poeti Xhevat Beqaraj edhe *motivin e kohës* preferon ta zbusë pikërisht me mënyrën origjinale. Ai botën nuk e kupton as e merr vetëm si diçka të vetmuar, më vete, por përherë atë e paraqet në bashkëjetesë me qeniet e tjera, madje edhe me gjërat e sendet që na rrethojnë, me fenomenet që ndodhin në ambientin ku jetojmë.

Në poezinë e Xhevat Beqarajt jeta paraqitet në spektrin e saj më të gjerë. Përshkrimet e natyrës bëhen nga prizmi i përjetimit dhe perceptimit poetik të tyre. Poeti spikat shpirtin e gjërave dhe të fenomeneve. Në muajin mars, ta zëmë, ai ndien se dergjet bora e butë nëpër hije malesh, në luftë me motin e muajit.

Ecën dielli – def i artë.
Eh, ç'i qesh fytyra!
Te dëbora veten sheh
Në mijëra pasqyra.[148]

[145] Po aty, f. 19
[146] Beqaraj, Xhevat. "Shtëpia e bubit", Tiranë, 1999, f. 20
[147] Po aty, f. 24
[148] Beqaraj, Xhevat. "Letrat e vjeshtës", Tiranë, 1989, f. 45

Ajo që i bën karakteristike dhe të veçanta përshkrimet e gjërave dhe të fenomeneve nga muaji në muaj është figuracioni që përdoret. P.sh në muajin shkurt, bie fjala, poeti heton rrëqethjen e plepave, bajameve dhe të lofatave; dorën e prillit e vëren duke u ulur butësisht pemëve, prandaj gjethet gjelbërojnë dhe lulet shpërthejnë në to, duke shkundur si shi petla të çdo ngjyre mbushur me aromë, etj, etj.

Në tufëzën e vjershave të poetit spikat edhe raporti midis forcës së njeriut me shtazët më të forta që njihen, si luani, elefanti, pastaj në raport me erën, detin dhe lumin. Për shembull në vjershën "*Deti*":

Eh, ai zien nga zemërimi!
Valët lart, ngre si mal.
Tërbimit të tij aherë
Përpara kush mund t'i dalë?[149]

Dhe pasi thekson fuqinë e jashtëzakonshme të të gjitha këtyre shtazëve, si dhe të lumit, të detit dhe të erës, poeti vë përballë tyre fuqinë e njeriut:

Njeriu tigrin di të zbutë,
E mbyll luanin në kafaz.
Dhe elefantin e mëson
Për të punuar, ta ndjekë pas.[150]

Në këtë shkallëzim të fuqisë, del ajo e vërtetuara qëmoti, se ka të fortë e më të fortë, ose e vërteta tjetër që e thotë përvoja njerëzore, se njeriu është më i fortë se guri dhe është ai që di ta urtësojë edhe erën dhe t'i mbajë në fre edhe valët e detit.

Në përgjithësi vjershat e Xhevat Beqarajt janë të shkruara kryesisht në vetën e parë, si përjetime, vrojtime, apo ndjenja të poetit. Por në të shumtën e rasteve ai është fëmijë, ka hyrë nën lëkurën e tij dhe shpreh po atë botë, po atë imagjinatë të bujshme dhe po ato dëshira dhe ëndrra që kanë fëmijët.

Kur bëjmë fjalë për vlerat artistike të veprës së Xhevat Beqarajt, nuk mund të lëmë pa përmendur gjuhën, e cila duket sikur buron nga dashuria e tij ndaj të vegjëlve. Gjuha është një nga vlerat më të rëndësishme të poezisë së Xhevat Beqarajt. E karakterizon pastërtia, por edhe ëmbëlsia.

Në krijimtarinë letrare për fëmijë të shkrimtarit Xhevat Beqarajt një vend të veçantë zënë edhe një numër ***përrallash në vargje***, të cilat janë ndër krijimat më të bukura të tij. Qysh në vëllimin "*Shtëpia e bubit*", autori ka përfshirë një cikël prej katër përrallash në vargje. Secila nga këto përrallëza fëmijëve u ofron edhe mesazhe të vlefshme për jetën. Në përrallëzat në vargje "*Cen dembeli dhe petullat*", "*Ndërtuan minjtë një shtëpi*", "*Dhelpra e uritur*", "*Ah, sikur...*", gdhenden personazhe e ngjarje, që jo vetëm u mbeten në mendje fëmijëve, por shquhen edhe për një ligjërim poetik të bukur e konçiz. Nëpërmjet tipareve të personazheve, bleta lumturohet me punë; rosa, qeni e gomari ëndërrojnë të ushqehen pa punuar; dhelpra pret verën të thahet lumi e të hajë peshq; Ceni përshkruhet me portretin e përtacit; në përgjithësi përcillen mesazhe e mësime që ndikojnë drejtpërdrejtë në botën e fëmijëve. Përrallëzat në vargje të

[149] Po aty, f. 84
[150] Po aty, f. 86

Xhevat Beqarajt zakonisht janë krijime të shkurtra, me strofa dyvargëshe, katërvargëshe apo edhe me kombinime të tjera strofike.

Në librin "*Nuk qeshin të gjithë*"(2000), përmbledhje me përralla, përfshihen këto krijime: "*Shtrak-shtruk treni mbi shina*", "*Po ku di qeni të lexojë*", "*Nuk qeshin të gjithë*". Aty ka mjaft dialogë të personazheve, përshkrime të kafshëve e shpendëve, rrëfime të gjalla e, mbi të gjitha fabula interesante të thurura me vargje konçize, muzikalitet dhe figuracion të pasur artistik. Gjuha e kafshëve dhe e zogjve në këto përralla në vargje është një botë mjaft interesante që zgjon fantazinë e fëmijëve: treni – çaf, çuf; vagonat- shtrak, shtruk; zogjtë – ci,ci,ci; rosat – rik, rik; patat – ga,ga,ga; derrkuci – kru, kru; macet – mjau, mjau; keci – me, me, me. Sigurisht, përdorimi i onomatopeve i jep gjallëri rrëfimit poetik. Po edhe figura të tjera poetike, si: metafora, krahasime, epitete e paralelizma vizatojnë me sytë e të vegjëlve një botë me imagjinatë të thellë. Për këtë arsye, *ato meritojnë të klasifikohen si poezi të vërteta që, me shtjellimin tërheqës të fabulës dhe me figuracionin e pasur, realizojnë lehtësisht kontaktin emocional të të vegjëlve me protagonistët e këtyre krijimeve, të cilët veprojnë në mjedise sa reale, aq dhe përrallore*[151].

Xhevat Beqarajt përveç përmbledhjeve me vjersha, fëmijëve u fali edhe tre libra me ***përralla të zgjedhura e të shqipëruara*** nga thesari i letërsisë së popujve të ndryshëm të botës: "*Pse hëna nuk ka fustan*?" (1973), "*Tigri i vogël në çajnik*" (1974) si dhe "*Pse qan zogu*" (1982).

Përrallat e këtyre vëllimeve dëshmojnë për mjeshtërinë e shkrimit, për mesazhin që përcjellin. Janë mësime dhe porosi universale për jetën. Si të tilla, ato përjetohen njësoj nga lexuesit e të gjitha moshave. Gjithashtu, duhet të përmendim që këto përralla janë të përshtatshme për të vegjlit, janë të shkurtra, lexohen lehtë e shpejt, janë të qarta si përmbajtje, por edhe poetike me gjuhën që kanë.

Shkrimtari Xhevat Beqarajt është një zë origjinal në poezinë tonë të sotme për fëmijë. Është një shkrimtar që ka rendur më shumë pas cilësisë sesa pas sasisë, ka rendur pas ëndrrave dhe dëshirave të fëmijëve sesa pas moralizimeve. Kjo ka ndodhur ngaqë është njohës i mirë e i thellë i botës së pasur fëmijërore, me të gjitha veçoritë e saj dhe nuk e ka aspak të vështirë të na japë me realizëm, frymëzim e mjeshtëri artistike imtësi dhe detaje nga jeta e tyre. Këtë gjë e vëmë re dhe në librin me vjersha e poema për fëmijë "*Rruazat e vesës*" (2006). Në këtë vëllim poetik spikat pjekuria e plotë artistike që ka arritur autori, perfeksionimin e stilit të tij; në të dallojmë qartë origjinalitetin dhe individualitetin krijues të tij. Metaforat, krahasimet, simbolikat, përgjithësisht mjetet shprehëse në vjershat dhe poemat e këtij vëllimi janë të gjetura me intuitë dhe në përshtatje të plotë me moshën e fëmijëve, duke bërë kështu që të pëlqehen, të kuptohen e të mësohen lehtë nga ata. *Njëherësh, ato i japin poezisë ritëm, intonacion e muzikalitet, e bëjnë atë të rrjedhë lirshëm në shtratin e vet, i japin asaj ngjyrime emocionante e mbreslënëse, e bëjnë që të jetë brilante dhe të lexohet me ëndje e dëshirë nga fëmijët e vegjël*.[152]

Në libër ndeshim edhe poezinë e gjatë me subjekt apo tregimin në vargje, gjë të cilën e ka praktikuar edhe më parë. Kështu, në këtë vëllim janë përfshirë edhe tri poema " të realizuara artistikisht, njëra më bukur se tjetra.

[151] Çadri, Ramazan. "Letërsia shqipe për fëmijë", Tiranë, 2001, f. 144
[152] Nelaj, Milaim; "Profile letrare" (Studime), Tiranë, 2008, f. 147

Karakteristikë e tërë krijimtarisë poetike për fëmijë të Xhevat Beqarajt është bota e pasur motivore, si dhe figuracioni i zgjedhur poetik, të cilat kanë përftuar vlera emocionale. Vargu i tij ka ritëm e rimë, muzikalitet, gjë që e bën rrëfimin e tij artistik të ngrohtë e të afërt për botën e fëmijëve. Ndaj, me të drejtë mund të themi që është poet i shprehjes moderne.

5.7 Gaqo Bushaka – Babai i Çufos

Shkrimtari Gaqo Bushaka[153] është një nga autorët më të suksesshëm në Shqipëri në lëvrimin e përrallës së kultivuar, këtë gjini kaq të dashur për fëmijët, e cila ka luajtur një rol të madh në nxitjen e fantazisë dhe imagjinatës së tyre. Ka shkruar përmbledhjet me përralla: *Në ishullin e dallëndysheve* (1973), *Arushi që kërkonte babanë* 1975, *Përralla u la për nesër* (1993), *Amaneti i dhelprës* (1997), *Zogu në kaushin e akullores* (2004). Gaqo Bushaka është një shkrimtar që zhanrin e përrallës e ka lëvruar edhe në gjini të gjata, në novelën-përrallë *Ariu artist*(1973) dhe romanin përrallë me serinë *Çufoja dhe Bubi kaçurrel*, *Pushimet e Çufos*, *Çufoja në shtëpinë e Çudirave* etj. Mënyrat e krijimit të përrallave të tij janë të ndryshme e me një ndjesi tepër emocionale, gjë që ua transmeton jo vetëm të vegjëlve, po edhe të rriturve.

Përralla e kultivuar për fëmijë luan një rol të madh në nxitjen e fantazisë dhe imagjinatës së të vegjëlve, në edukimin artistik, estetik dhe qytetar. Mjete të tilla artistike si personifikimet e hiperbolat, dialogët me diellin, hënën dhe yjet, apo bashkëbisedimi i kafshëve midis tyre, krijojnë një botë artistike e psikologjike mjaft të dashur për të vegjëlit. Në këtë pasuri letrare për fëmijë një vend të veçantë zë e jashtëzakonshmja, subjekti, situata dhe personazhet e larmishme e interesante si dhe veprimi e dialogu ku zbulohen edhe tiparet e personazheve. Në përrallat e kultivuara rroken tema, motive, personazhe e dukuri të ndryshme që pasqyrojnë botën fantastike të fëmijëve. E veçanta tjetër është se autori në përrallat u largohet skenave të dhunshme, që prekin zemrat e njoma të fëmijëve.

Në librin *Zogu në kaushin e akullores* (përralla të zgjedhura), përmblidhen 70 përralla më të bukura, të shkruara nga Gaqo Bushaka. Harmonia e fantastikes me realen, mbështetja në përrallat popullore, karakteret e spikatura dhe, mbi të gjitha, fryma e theksuar e humorit, e bëjnë këtë vëllim mjaft të dashur për fëmijët.

Përrallat fillojnë pikërisht me *Zogu në kaushin e akullores.* Ngjarjet vendosen në folenë e një plepi në lulishte. Autori na bën kureshtar. Hyrja ka një pikë shqetësimi. Nënës kanarinë i është bërë gjaku ujë. Çfarë ka ndodhur? Ky fillim u tërheq vëmendjen fëmijëve që leximi më tej të bëhet me padurim për të shuar kureshtjen.

Kanarinës së vogël në shtëpi i kanë ardhur hallat dhe tezet, e puthin dhe e qortojnë, por përse?

Kanarina na ishte përpjekur të fluturonte pa i dalë ende puplat. Pranë saj kalon një trumcak i vogël, i cili nuk iu duk më i madh se vetja, dhe kanarinës i mbushet mendja

[153] U lind në fshatin Selckë të Gjirokastrës më 1943. Më 1946 i ati e tërhoqi familjen në Tiranë, ku kreu shkollën 7-vjeçare. Më tej kreu shkollën e Rezervave të punës të Industrisë, ku përfitoi zanatin e elektriçistit, zanat të cilin e ushtroi deri në vitin 1963, kur kreu gjimnazin e mbrëmjes dhe nisi studimet në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1967 u diplomua për gjuhë e letërsi shqipe dhe gazetari. Ka punuar redaktor në revistën "Fatosi", kryeredaktor i "Pionierit". Tregimi i parë i tij, Peshqit e Janit, u botua në "Pionieri" më 1963.

top se edhe ajo mund të fluturonte. Pa diellin që i buzëqeshi dhe u hodh nga foleja në lulishte, zemra i bënte pup...pup...pup...

Doli rrugës dhe hasi mjaft peripeci të ndryshme, si me biçikletën, makinën, qenin, macen. Kanarina përmendi se macja e kishte trembur.

Ndërkohe halla e saj i tregoi se macja ishte armikja e tyre më e vjetër. Shpëton por përsëri has vështirësi, disa fëmijë donin ta kapnin por ajo përfundoi në kaushin e akullores. Autori rrëfen ngjarjen në vetën e parë që lexuesit t'i duket sikur personazhet ndodhen pranë dhe po i rrëfejnë diçka. Për shembull: *Unë mblodha gjithë forcat dhe fluturova ca me tutje, po rashë shpejt..E ku thoni ju? Në një kaush akulloreje*...[154] Pra autori tregon një lidhje të ngushtë me lexuesit e vegjël, u bë pyetje dhe u kthen përgjigje vet.

Akulloreshitësi e kap dhe ua jep djemve. Ata e hipën në plep dhe e vendosën në fole. Tezet e hallat filluan t'i jepnin një barrë këshillash se nuk duhet fluturuar pa ardhur koha. Në këtë përrallë autori transmeton te fëmijët mesazhin se nuk duhet të bëjnë asgjë pa pyetur prindërit, e aq më tepër kur janë të vegjël e u duket vetja si të rritur, përndryshe do ta pësojnë në një farë mënyre si kanarina. Pra, "pësimi bëhet mësim".

Rrëfimi është i pasuruar me figura letrare, veçori kjo që shfaqet te të gjithë krijimet e autorit (psh, dielli buzëqeshi...) Po ashtu shkrimtari përdor shumë onomatopetë si: *mjau mjau, ham ham* Nuk mungojnë edhe frazeologjitë popullore, si: *mishi i bëhet puçra puçra, mendja i mbushet top, zemra i bënte pup pup,* etj.

Në fund të kësaj përralle zogun e vogël nuk e zë gjumi pa u thënë djemve shpëtimtarë "*natën e mirë*". Me këtë mbyllje autori lë të nënkuptojë tek lexuesit e vegjël se duhet të dinë të falenderojnë njerëzit që bëjnë mirësi.

Bota e magjishme e përrallës është e mbushur me personazhe kafshë, që fëmijët i duan aq shumë, bëhen kaq të afërta për lexuesit e vegjël, pasi veprojnë, ndiejnë e sillen si ata.

Përsa i përket onomastikës, këtu kafshët dhe shpendët mbajnë emra të përgjithshëm, si: qeni, macja, kanarina, pra ndryshe nga përrallat e tjera.

Falë kësaj përralle, fëmijët mësojnë se bota jashtë është e rrezikshme, ka njerëz pozitivë dhe negativë dhe ku ka më bukur që fëmijët ta mësojnë këtë nëpërmjet personifikimit të kafshëve e shpendëve...Kjo është bota e tyre.

Gaqo Bushaka nga krijimet popullore shfrytëzon mjeshtërinë e thurrjes me fund të lumtur.

Pas peripecive të shumta kanarina fle e qetë...

Shumë personazhe të tjerë si: *rosa me byzylyk të artë apo ajo zemërake, pelikani e papagajtë, korbi Krrraaa, bariu Rist, derrkucët ngjyrë trëndafili, ketri Tyty, buburrecët me pushkë, këmbëvogla* e shumë përralla të tjera..i kënaqin dhe i zbavisin duke i bërë të pëlqyeshme tek të vegjëlit. Kështu veçori dalluese e këtyre përrallave është se autori përveç rrëfimit magjik në situatat e krijuara mbizotëron dukshëm dialogu mes personazheve, duke mbajtur të gjallë interesin e lexuesit.

Te përralla *Rosa me byrzylyk të artë,* autori e fut direkt lexuesin në veprim që në fillim të krijimit. *Tri herë u sul turravrap dhelpra që ta kapte rosën Garnile, por të trija herët i shpëtoi nga kthetrat, duke i lënë në gojë një shije të hidhur*[155]...

[154] Gaqo Bushaka, "Zogu në kaushin e akullores", Tiranë, 2004, f. 6
[155] Po aty, f. 25

Rosa Ganrile i shpëtoi dhelprës dhe futet në liqen. Ndërkohë shoqeve të saj u tregon për ndodhinë duke u mburrur dhe me përbuzje tall dhelprën. Dhelpra i punon një rreng, blen një byzylyk të artë dhe e var në një pemë. Rosa e merr, e var në qafë e nuk lë shoqet ta prekin.

Rosën Ganrile e merr uria dhe futet në liqen, por nuk mundet të notojë, sepse byrzylyku i artë nuk e lejon; dhelpra qesh dhe fillon e ha peshkun që grumbullonte rosa. Ganrila këtë fakt nuk e duronte dot dhe i kërkon ndihmë shoqes t'i hiqte byrzylykun. Atë e hedhin në liqen dhe të dyja bashkë i thurrin një rreng dinakes. Te peshqit e tjerë vendosin një çark, dinakja kap këmbën dhe ngel e çalë. Por përralla nuk mbaron këtu....Byrzylykun e gëlltiti një peshk i madh, një grua e gjen në barkun e tij.

Siç përmendëm edhe më lart, përrallat e autorit janë edukative dhe në këtë përrallë transmetohet një mesazh domethënës. Se në jetë njerëzit gabojnë por e rëndësishme është që ata ta kuptojnë gabimin e tyre dhe të luftojnë kundër dredhive, kundër pabesive.

Edhe në këtë përrallë nuk mungon dialogu, mënyra e rrëfimit aq rrjedhshëm, me një fjalor të pastër, me figura, si: *kam vënë diellin në qafë*...etj. Me humor goditen të metat dhe dobësitë e personazheve, të cilët hasen shpesh edhe në jetën e përditshme.

Lexuesit e vegjël mësojnë se ku jetojnë rosat, me çfarë ushqehen. Mësojnë se dhelprat gjithmonë do të jenë dinake, mëson se njeriun nuk duhet ta vlerësosh për atë që ka, por për atë që është.

Në përrallën e parë vëmë re se kafshët mbanin emra të përgjithshëm, ndërsa në këtë përrallë atyre u bashkangjitet edhe një emër i përveçëm, si rosa Ganrile...etj.

Onomastikën autori e përdor në mënyra të ndryshme. Nuk mungon kureshtja. Shkrimtari shfrytëzon befasinë artistike..psh kur dhelpra bën planin se si do t'ia punojë rosës, po lexuesi e merr vesh më vonë..pra kjo kureshtje i fut fëmijët në mendime.

Shkrimtari Gaqo Bushaka në kultivimin e përrallës është mbështetur fuqishëm te folklori ynë i pasur. Kështu ndodh që ai të rimarrë një përrallë të njohur, e vendos atë në një situatë tjetër, me ide të re bashkëkohore dhe të pëlqyeshme për fëmijët. E shohim këtë mënyrë krijimi p.sh në përrallën *Turpi i korbit Krrraaa: Në përrallën e moçme, kushedi sa të moçme, thuhet se korbit të ngratë iu sterrosën edhe sytë. I vinte të hante veten, por, meqë vetja nuk hahet, ai krëk këputi një degëz të thatë për të shkoqur zemërimin. Dhelpra, eh, dhelpra e gënjeu me lezet dhe ia përlau djathin. Apo nuk ishte një copë e butë, e shijshme dhe naaa... e madhe*[156].

Korbi e dinte shumë mirë se kush ishte dhelpra, e kishte pësuar dhe më parë. Por ai prapë bie pre dhe dinakja ia rrëmben djathin, megjithëse ai kishte vendosur të mos dëgjonte lëvdatat e dhelprës dinake. Mesazhi që jepet është mjaft i qartë: zemërimi i kotë të lë pa gjë. Emrat onomatopeikë, si korbi Krrraaa, bëhen mjaft të pëlqyeshëm, interesantë dhe tërheqës gjatë leximit të fëmijëve.

Shkrimtari Gaqo Bushaka shquhet edhe për humorin e hollë, për stilin e veçantë të argëtimi jo vetëm me situatat e krijuara, por edhe nga batutat e personazheve kafshë. Përmendim këtu, për shembull, Pelikani dhe papagajtë udhëtojnë së bashku. Që në fillim autori na njeh me personazhet, situatën që krijohet në një vagon treni. Janë

[156] Gaqo Bushaka, "Zogu në kaushin e akullores", Tiranë, 2004, f. 46

pushimet e verës. Bëhet prezantimi i personazheve, pelikani Nike, ndërsa personazheve të tjerë (papagajve) që të mos ngatërrohen u vendos në fanellë numra si sportistëve.

Tani drejt dritares fluturonin ca gjethe. Njëra prej tyre u përplas në xhamin e kabinës. Papagalli nr. 1 nuk duroi dot dhe, sa për të folur, tha:

- *Kushedi përse bien gjethet?*

Të gjithë mblodhën supet. Pelikani ngriti sytë nga libri dhe foli:

- *Që pemët të mos thahen.*

Ndërkohë erdhi fatorinua, një alamet pate. Papagajtë i treguan biletat që mbanin në buzë.

- *Mirë, mirë, - u tha pata, - po do t'ju futen mikrobet në bark; nuk mbahet aty bileta.*

Papagajtë vështruan njëri-tjetrin dhe, të turpëruar, i hoqën biletat nga goja[157].

Dhe në fund autori e mbyll duke ia lënë në dorë fëmijëve përgjigjen...*Kështu thonë, po kush e di tamam të vërtetën, ata nuk e hapnin derën...*

Humori i autorit është tërheqës, i këndshëm, edukativ.

Për shembull, në përrallën *Derrkucët ngjyrë trëndafili*, autori përcjell idenë se fëmijët duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin, si në rastin e derrkucave, ku derrkuci Timo e ndihmon shokun dhe e çon në poliklinikë, te doktor Ariu. Përveç humorit vëmë re se në këtë përrallë përcillet dhe mesazhi që jo vetëm të luajmë dhe të argëtohemi me shokët por dhe t'i ndihmojnë kur të kenë nevojë.

Së fundi Tinoja e mori shokun për krahu dhe rrugicë më rrugicë, që të mos e shikonin të tjerët, e çoi në polikliniken e pyllit.

Doktor ariu e pa Ninon duke i afruar një dritë të vogël te goja. Kroi njëherë zërin "hem...hem...hem..." dhe mori një pince të madhe të nikeluar, që vetëtinte nga drita. Tinoja u tremb e i thirri:

- *Xhaxhi doktor, ai është...*
- *E di, djalë, e di, - tha me zë të butë doktor ariu. – bëtë mirë që e solle shpejt, se, po të ishte vonuar edhe ca, keq do ta kishte punën*[158].

Dhe fundi është me hepiend, i gëzueshëm, si në të gjitha përrallat*: Donte dhe dhjetë minuta që të fillonte shfaqja e cirkut, kur Tinoja dhe Ninoja i zgjatën bitetat portierit. Të dy ishin të pastër, te krehur dhe vërtetë të lumtur.*

Është e qartë që autori në përrallat e tij, personazhet i merr nga fauna dhe flora, të cilat i japin dorë në forcimin e zgjerimin e imagjinatës. Kështu kuptimi i përralles pasurohet, përcillet morali, ideja në edukimin e të vegjëlve. Se, siç thekson akademiku Mark Krasniqi, *Sado të modernizohet bota, ndër shokët më të afërt të fëmijës do të mbesin kafshët. Fëmija shumë më tepër e do dhe e njeh macen se sa helikopterin*[159].

Shkrimtari Gaqo Bushaka zë një vend të nderuar në letërsinë për fëmijë kryesisht në kultivimin e prozës së gjatë realiste, fantastike dhe humoristike. Pikërisht këtu qëndron dhe suksesi i tij. Çdo gjë me masë dhe në përshtatje me moshën e fëmijëve. Autori dallohet për raportin që krijon midis elementit real dhe atij fantastik,

---

[157] Po aty, f. 20

[158] Gaqo Bushaka, "Zogu në kaushin e akullores", Tiranë, 2004, f. 85

[159] Mark Krasniqi, "Mbeshtetje shkencore…" , f.279; cituar sipas Anton Nikë Berishës, "Poezia…", f. 90

përkatësisht midis brendisë reale dhe formës fantastike në serinë "***Aventurat e Çufos"*** dhe novelën-përrallë "***Ariu artist"***.

Këtë element autori e gërsheton bukur, sa me pamjen përrallore e fantastike të personazheve-kafshë, aq dhe me pasqyrimin e realitetit, dukurive, sjelljeve e problemeve të fëmijëve të sotëm. Duket sikur autori ka zbuluar kodin sekret të komunikimit me fëmijët. Është një autor që e njeh shumë mirë botën dhe psikologjinë e fëmijëve. Ndaj nuk ngurron dhe zbulon gjithçka që ka të bëjë me ta. Ndaj veprat e tij i rezistojnë kohës dhe pëlqehen nga fëmijët, pikërisht për këtë ngjashmëri të problemeve, veprimeve të fëmijëve, kuptohet, e personifikuar tek personazhet-kafshë. Shkrimtari Gaqo Bushaka është treguar i kujdeshëm në përcjelljen dhe të kuptuarit e moralit (përmbajtjes së fabulës), duke e rrëfyer nëpërmjet veprimeve dhe veçorive të kafshëve, por edhe të gjallesave të tjera që personifikohen.

Konkretisht në novelën-përrallë "*Ariu artist"*, në qendër janë dy arinj voglushë, Loli e Neli, që përfaqësojnë dy tipa të ndryshëm fëmijësh, të cilët i ndeshim në jetën e përditshme. Loli, një personazh mjaft i dashur dhe i këndshëm për fëmijët është i përkëdheluri i mamit, i plotësohen të gjitha tekat, nuk ka dëshirë të mësojë dhe të shkojë në shkollë.

Ndërsa Neli është një personazh model, që paraqet tipin e nxënësit shembullor, me vullnet, sedër, shok e mik i mirë. shqetësohet për veprimet e Lolit, bën përpjekje për ta ndihmuar dhe për ta nxjerr nga situata.

- Humori është mjaft i pranishëm në novelë, realizohet nëpërmjet dialogut të gjallë, veprimeve të personazheve dhe karaktereve të ndryshme, të cilat të ngjallin emocion e të argëtojnë. Jo pa qëllim e përdorur nga autori ky stil.

- Me një gjuhë të thjeshtë, të pastër e të rrjedhshme, shkrimtari Bushaka mbështet te naiviteti, karakteristik i fëmijëve, duke qenë dhe një njohës i mirë i botës së fëmijëve ka ditur të përzgjedhë ato gjëra pikante që prekin fëmijët, ndaj vjen aq natyrshëm buzëqeshja, kënaqësia, sepse u vjen përshtat veprimeve dhe mendimeve të fëmijëve.

- Gjithashtu, lexuesi merr një informacion të gjerë shkencor për jetën e kafshëve, zakonet dhe karakteristikat natyrore, shumëllojshmërinë dhe të ushqyerit e tyre.

- Në novelë përcillen vlera të padiskutueshme edukative e artistike

- Nëpërmjet personazhit të arushit Loli, Neli e të tjerëve, gjuhës së pasur artistike, ngjarjeve që rrjedhin natyrshëm dhe aq këndshëm në sytë e fëmijëve, autori nuk bën gjë tjetër veçse ndez imagjinatën dhe botën e pasur të tyre, duke nënkuptuar dhe pasqyruar atë në realitetin e përditshëm.

Po ky pasqyrim me vërtetësi e me plasticitet i tipareve të karakterit të fëmijëve të sotëm, i jetës dhe veprimtarisë së tyre personifikohet dhe me personazhin popullor derrkucin Çufo në romanin-përrallë *Aventurat Çufos*. Lexuesit janë ndeshur e kënaqur pa fund me serinë *Çufoja dhe Bubi Kaçurrel, Pushimet e Çufos, Çufoja në Shtëpinë e Çudirave* etj. Kuptohet protagonist është Çufoja. U rrëfen të vegjëlve momente të rëndësishme për jetën e fëmijëve në shkollë, për të mësuar e fituar dituri.

Shkrimtari Bushaka zbulon dalëngadalë aventurat pa fund të Çufos, duke nxitur kureshtjen tek fëmijët, por me mësimin e moralin që në jetë të bëhen të zotë sepse hasen të papriturat e t'i kapërcejnë vështirësitë që u dalin përpara. E gjitha zbulohet para fëmijëve nëpërmjet humorit, lojës, dialogut, veprimeve, ndodhive e të papriturave që i ndodhin Çufos, por edhe personazheve të tjerë si arush Tipi, bubi Kaçurrel, ketri Killo, maçoku Sabo, ariu Zebo, iriqi Gjembo, mësuese Mjelma etj.

Shkrimtari Gaqo Bushaka ka krijuar një personazh sa popullor e të dashur për fëmijët, aq dhe një model që mishëron mjaft tipare të tjera njerëzore, karakteristikë për tipin shoqëror të fëmijës që përfaqëson. Në qendër të serisë personazhet kryesore janë Çufua, Tipi dhe Bubu Kaçurrel.

Çufua, një personazh që nuk e pëlqen shkollën, është gjumash, i duket vetja trim, por gjithmonë bën gabime dhe duhet të gënjej. Partner i tij është dhe arush Tipi. Autori nëpërmjet veprimit, dialogut, gjuhës së pasur e plot humor, përcillen aventurat dhe çapkënllëqet e tyre pa fund.

Personazh tjetër është dhe Bubi Kaçurrel, krenaria e shkollës, është i zgjuar, i urtë, i sjellshëm dhe i dashur.. Në roman vihet re gadishmëria e Bubit për ta nxjerrë nga situatat ngatërrestare që krijon Çufua, por gjithashtu dhe për ta ndihmuar për mësimet si dhe të mbajë fjalën që ka dhënë para klasës. Fëmijët kënaqen me personazhin dhe do ta dëshironin një shok si Bubi.

Seria "*Aventurat e Çufos"* përcjell vlera të shumta artistike, psikologjike, etike, estetike dhe njohëse. Vlera përbën edhe stili i autorit, frazeologjitë dhe gjuha e pasur artistike, humori i hollë dhe aventura.

Të gjitha përrallat e shkrimtarit kanë një qëllim:

- lexuesi i vogël duhet të dëfrehet dhe, njëkohësisht, të marrë mësime edukative dhe të vlefshme për jetën.
- Janë të shkurtra, dinamike dhe të këndshme për moshën që u adresohet.
- Tematikat e përrallave të Gaqo Bushakës janë të gjera, të larmishme dhe që mbulojnë jetën në familje, në shkollë e jashtë saj.
- Përcjellin moral dhe kuptohen lehtë.
- Dialogu është i pranishëm duke e bërë më të gjallë rrëfimin,
- Befasia në përrallë shton kështërinë e lexuesit, duke i bërë tërheqëse dhe zbavitëse

Përrallat e autorit në tërësi ndikojnë në formimin moral të fëmijëve, duke shërbyer si ushqim shpirtëror si dhe duke ndikuar këndshëm me buzëqeshjet, humorin që u fal...

5.8 Ferhat Çakërri - kontributi në letërsinë shqipe për fëmijë

Ferhat Çakërri është një ndër poetët e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj mjaft i njohur me krijimtarinë e tij të pasur. Duke u ndalur ne krijimtarinë e autorit, menjëherë na bie ndër mend vlerësimi i studiuesit Luigi Santucci, ku thekson *rolin e letërsisë për fëmijë dhe e quan letërsi e magjisë dhe e mrekullisë. Të tillë e bëjnë këtë letërsi "gjuha, mënyra e konceptimit, e shtjellimit dhe e të shprehurit, qartësia dhe*

thjeshtësia e mesazheve; loja që është e pranishme e që gërshetohet me anë të humorit të natyrshëm e me një funksion të shumtë. Pikërisht këta përbërës te fëmijët zgjojnë kureshtjen, kënaqësinë, fisnikërimin dhe pasurimin shpirtëror[160]. Zbërthimi i këtij mesazhi është i qartë: për dëfrimin dhe edukimin e fëmijëve përdorim përrallën, gjëzat, këngët e fabulat popullore. Në krijimtarine e Ferhat Çakerrit, mbi 40 vjersha janë bërë këngë-lodra në jetën e fëmijëve shqiptarë, gjë që tregon për shpirtin e thellë poetik dhe komunikimin e drejtpërdrejt të tij me botën dhe psikologjinë e fëmijëve.

Në letërsinë për fëmijë Ferhat Çakërri u shfaq qysh në vitet '60, kur këtë letërsi nisën ta lulëzojnë me shpirtin e tyre poetik autorë të shquar, si: Bedri Dede, Odhise Grillo, Tasim Gjokutaj, Adelina Mamaqi, etj.

xxx

Imagjinata e pasur e Ferhat Çakërrit shpalos botën emocionale, shpirtërore dhe ëndërruese të fëmijëve në shkollë, shoqëri, buzë detit, pranë monumenteve, stinëve të vitit, portreteve të fëmijëve dhe dëshmorëve të Atdheut. Ai, duke e njohur mirë jetën e fëmijëve arrin të depërtojë thellë në lumturinë e tyre.
E thura këngën/ bukur, ngadalë/ flladi e mori/ fëmijëve t'ua falë/. E thura këngën/ zogu e këndoi/ fëmijëve të vegjël/ me vrap ua çoi/. E thura këngën/ si mjalti të ëmbël/ për ju vocërrakë/ e thura me zemër. (*E thura këngën*[161])
Menjëherë e kuptojmë që kemi të bëjmë me përmbledhjen e vjershërimeve të Ferhat Çakërrit në librin antologjik nën titullin *"Ku ta gjej pranverën..."* Në këto poezi pasqyrohet realiteti i shumanshëm i jetës së fëmijëve. Vargu i skalitur herë derdhet me ngjyrat e ylberit e herë dallgëzon me valët e detit, herë del nga përrallat e fëmijërisë e herë bleron mes drurëve të pyjeve mesdhetare. Përmendim këtu vjershën *Dielli ndezi retë*;

Dielli ndezi retë,
i skuqi si shegë,
pastaj si një top,
na u zhyt në det...

Apo tek vjersha *Det, o det i bukur shumë*;

Det, o det i bukur shumë,
ku e gjen atë sapun,
që lan bregun e shkëmbinjtë
me të bardhën shkumë përditë?

Dallëndyshet e kujtimeve të poetit shpesh përshëndesin e përqafojnë pulëbardhat në brigjet e Vlorës;

O ju pulëbardha,
Zogëza të urta,
me pendë të bardha,
me pupla të buta,
.....
.....

[160] Cit. Sipas Anton Nikë Berishës "Poezia për fëmijë e Mark Krasniqit", Prishtinë 2002, f. 58
[161] Ferhat Çakërri, "Ku ta gjej pranverën", Tiranë, 2007, f.12

O ju pulëbardha,
që kridhni në det,
shigjetë seç ngrihi,
ku ndizen rrufetë.

(Pulëbardha)

Gjyshja dhe nëna mëkojnë në vargun e poetit një dashuri të rrallë njerëzore;

Gjyshja ime ka shumë xhepa
Në fustan dhe te xhaketa,
plotpërplot gjithmonë i mban,
sikur është ndonjë dyqan...
Për çdo ditë na fton pranë,
ç'ka në xhepa i shpërndan...
Dhe kur xhepat zbrasur rrinë,
vijnë era trëndelinë!...

Bukuria e vargut në këtë vjershë kapërcen imagjinatën e fëmijëve për gjyshet e tyre të mira, të cilat mendojnë vetëm për ta, se si t'i kënaqin nipërit dhe mbesat e tyre. Ato mezi presin që t'i gostitin vogëlushët me gjëra të mira si: karamele, çokollata, bajame, arra, biskota etj, prandaj xhepat e gjysheve janë përherë plot.

Këto motive e detaje poetike paraqiten nga poeti në mënyrë të figurshme, me metafora, krahasime e përgjithësime poetike, si një lojë në jetën fëminore. Shkolla përherë është vatra e dashur e diturive:

Ku e kanë folenë dhjetat,
që të shkoj e të mbush xhepat?
Pastaj t'i vë në fletore,
të jem nxënëse shembullore?
Dhjetat, bijë, e kanë folenë
Ku mësojnë abecenë.
Po ta gjesh nuk është e lehtë,
Duhet mund e duhet djersë!

(Ku e kanë folenë dhjetat?)

Ndërsa liria dhe flijimi për Atdheun mbartin një botë universale:

Nënat ndezën yjet,
të ndriçonin pyjet,
të kalonin trimat
porsi vetëtimat.
Nënat mblodhën yjet,
i vunë mbi krye,
yje partizani
na u mbush vatani!

(Nënat ndezën yjet)

Krijimtaria e Ferhat Çakërrit është e larmishme dhe plot ngjyra e tinguj, ç'ka ngjall gëzim e lumturi në botën e fëmijëve.

Breza janë rritur dhe edukuar me krijimet e mrekullueshme të tij. Përmendim këtu dhe realizimin e vëllimit *Ku ta gjej pranverën....* Plot 143 vjersha, te ndare sipas cikleve; *Xhepat e gjyshes, Nënat ndezën yjet, Ku ta gjej pranverën..,Deti më hedh valë...*, *U ngrit një balonë, ku je fshehur lepur ti?.* Në mjaft poezi të këtij poeti gjenden tema, motive, ngjarje e fenomene interesante.

Poeti, njohës i thellë i vargut dhe muzës popullore, ka shfrytëzuar me mjeshtri traditën folklorike të trevës së Vlorës.

xxx

Në krijimtarinë shkrimtarit për fëmijë Ferhat Çakëri një vend të rëndësishëm zënë përrallat. Kështu ndodh dhe me librin "***Arlini dhe e Bukura e Dheut***"(2001). E ndarë në pesë pjesë: *Aventurat e Arlinit, Mbretëria e nëntokës, Mrekullitë e mbretërisë, Ëndrra e parë, Ëndrra e dytë*, ku secila prej tyre përfshin një ëndërr, sepse gjithë përralla është një ëndërr që përfshin ëndrra të tjera ndaj dhe ngjarja bëhet edhe më e bukur. Formati hyrës, nis me formën klishe të përrallave *Na ishte njëherë.. Një herë e një kohë më parë…* Përralla tregohet në vetën e parë, nga bukuroshi Arlin, si një aventurë me mrekullitë e saj imagjinare. Arlini, personazhi kryesor i përrallës, ishte shumë i bukur dhe nëna e tij kishte shumë merak për djalin: *Na ishte dikur, kohë më parë, një vogëlush i bukur si yll, me emrin Arlin. Bukuria e tij kishte marrë dhenë... Një bukuri e tillë as nuk ishte parë e as nuk ishte dëgjuar ndonjëherë...*[162] Arlini bie në gjumë të thellë dhe ëndërron sikur rrëzohet në humnerë, dhe atje ndeshet me çudira nga më të ndryshme. Autori ka përdorur një gjetje interesante, një flutur që kthehet herë si Zanë, e herë si e Bukura e Dheut. Arlini përballet në luftra të ndryshme, ku u mbrohet nga Zana. Siç mund ta kuptojmë, në këto luftime virtuale shfaqet dhe trimëria e tij kundrejt bajlozit të zi. Dhe kështu, ëndrra përfundon, Arlini zgjohet nga nëna e tij dhe e kupton se ishte thjesht në një ëndërr të çuditshme. Në këtë përrallë të bie në sy dhe një nga veçoritë e këtyre përrallave, përshkrimi i peizazhit natyror deri në detaje, si: *Nëpër lëndinën e mbushur me lule të bukura dhe me barin deri në gjunjë, flutura ulej e ngrihej nëpër lule, duke rrahur lehtë krahët ngjyra-ngjyra...Dukej se u bënte veri gonxheve të porsaçelura*. Gjithashtu me një stil të veçantë, autori përshkruan edhe figurën e njeriut të shëmtuar e negativ *si kukudh, që ta shpif. Ishte i veshur me një pelerinë të zezë. Kishte dy sy të dalë nga zgavrat, si topa pingpongu apo si të gaforreve, të ndezur zjarr. Me një gojë sa një kamare, nga dilnin disa dhëmbë kërcënues, të mprehtë si të miut.*

Kjo përrallë përshfaq mendime dhe ndjenja të bukura, sepse gjithçka në këtë udhëtim aventuror të Arlinit ka dorën e fantazisë. Ëndrra e Arlinit është e lidhur me ëndrrat e fëmijëve, me imagjinatën, kureshtjen dhe dashurinë për të mësuar gjithë dituritë e kësaj bote.

Në këtë krijim të bie në sy humori i cili shoqëron aventurat e parsonazhit, Arlinit: *Tek ne kush këput një lule, ndërshkohet me tre kamxhikë gjarpri në kurriz, shyqyr që nuk e këputa, se do të haja tre kamxhikë gjarpri në kurriz, sa do më dukej prifti*

[162] Ferhat Çakërri, "Arlini dhe e Bukura e Dheut", Tiranë, 2001, f. 3

gomar, Dhe do të lëngoja dhjetë ditë në shtrat, Kurse ligjet te ne janë të buta dhe elastike, trëndafili i kuq ma bënte me sy, që t'i merrja erë. [163]

Ferhat Çakërri është një shkrimtar që e njeh mirë botën e fëmijëve, ndaj në përrallat e tij përcjell shumë informacion mbi llojet e luleve duke filluar nga mbreti i luleve, trëndafili, karafili, manushaqja, zambaku, lulemimoza etj. Një lule e veçantë, tërheq vëmendjen, lulja e zemrës quhej. Një lule e kuqe në formën e zemrës, apo lulja lotuese, që qan dhe i dredh lotët pika-pika si vesë. Autori luan, thurr kurorë me to, duke hedhur dhe valle dhe zbukuruar përrallat e tij: *Lulet morën një valle të kapura dora-dore, domethënë gjethe më gjethe*. Kësisoj, autori i mëson fëmijët t'i duan dhe të kujdesen për to.

Gjithashtu, në përrallë nuk ka sesi të mos bjerë në sy dhe pershkrimi e bukuria e Zanës: *hija u kthye në një Zanë të bukur, si e pikuar nga qielli, aq e bukur ishte sa t'i prisje kokën... me një nishan si petale trëndafili në faqen e djathtë, ishte veshur me një fustan të bardhë nusërie dhe me një kurorë të artë në kokë, që ia kalonte Miss Botës, buzëqeshi si një trëndafil me vesë, duke formuar në të dy faqet dy gropa që ia shtuan edhe më shumë hijeshinë*... Krahasimet zënë vendin qëndror në përshkrimin e figurës së Zanës. Por edhe në përshkrimin e portretit të Arlinit nuk mungojnë detajet dhe krahasimet e tipareve të djaloshit bukurosh, *me sy të bukur si të sorkadheve, me trupin si selvi, me hundën si qiri dhe flokët e argjendtë si rrezet e diellit, edhe guximtar. Këto cilësi i kishte trashëguar nga Gjergj Aranitasi, sepse ishte stërnipi i tij*...

Një element tërheqës për fëmijët është dhe dialogu, i cili zë vendin kryesor në aventuën e Arlinit dhe e bën më të këndshme përrallën.

Vëmendje dhe interes të veçantë për fëmijët kanë tërhequr edhe vjershat që i kanë marrë motivet nga përrallat dhe fabulat popullore. Te këto krijime në vargje, karakteristikë është mendimi i mprehtë dhe mjeshtëria artistike e poetit, aktualizimi i tyre në jetën e fëmijëve, si dhe përcjellja e mjaft vlerave edukative dhe estetike.

Përmbledhja "***Pula klloçkë bën vizita"***, e klasifikuar përrallë në vargje, ka një ndërtim interesant. Ndërtimi i vargut në mënyrë alegorike, ku veprojnë e flasin kafshët e shpendët, bëjnë të mundur të realizojnë më së miri një komunikim të gjallë e aktiv me fëmijët, duke nxjerrë në pah stigmatizimin e veseve e dobësive të njeriut e të jetës shoqërore. Kjo përmbledhje ka si kryepersonazh pulën klloçkë dhe tregon për bëmat dhe aventurat e saj. Autori ka marrë një personazh të dashur për fëmijët, një nënë zogjsh, që fëmijët e kanë aq qejf. Ndaj lexuesit apo dëgjuesit e moshës parashkollore, të cilëve u adresohet krijimi, i presin gojëhapur bëmat e saj. Pra, me ngjarjet a ndodhitë e poemës-përrallë, poeti realizon artistikisht një botë joreale për kafshët, që bëhet reale në sytë e fëmijëve. Në këtë vepër letrare për fëmijë, autori përdor me mjeshtri dialogun midis personazheve kafshë, ku zbulon botën e tyre, duke ngjallur tek lexuesit e vegjël ndjenja e emocione. Bisedat e Pulës klloçkë, Bletës, Palloit, Lejlekut, Iriqit, Ariut, Derrkucit etj, nxjerrin në pah dhe tiparet e tyre duke i bërë personazhe interesantë që e tërheqin fëmijën. Ky krijim është i mbushur me plot kafshë, shpendë e kandrra të ndryshme. Dhe vogëlushi merr informacion mbi botën e këtyre qënieve, zgjeron dijet e veta, si për mënyrën e jetesës, ashtu edhe për atë të ushqimit dhe natyrës së këtyre kafshëve e shpendëve. Njeh miqtë dhe armiqtë e tyre, luftën për mbijetesë. Por të gjitha këto janë dhënë në mënyrë tërheqëse, me një fabul

[163] Po aty, f. 21

që të gëzon e të bën të qeshësh. Pikërisht ky humor përbën vlerë në krijimet për fëmijë të Ferhat Çakërrit. Krijimet e këtij vëllimi janë në monokolonë. Vargu është i matur, tetërrokësh, herë gjashtërrokësh dhe herë këto masa gërshetohen. Rimat janë të puthura.

Siç e ka theksuar kritika jonë, *Ferhat Çakerri ka një varg lodrues e të këndshëm për fëmijët.*[164]. Veçori e krijimtarisë së tij poetike është mbështetja në folklor. Veç kësaj ai është një vëzhgues i kujdesshëm i botës fëminore, i lodrave e i këngëve që këndojnë të vegjëlit e sotëm. Dhe prej tyre ka marrë mënyrën e të thururit, detajet interesante. Ndaj vargjet e tij kanë tingëllimë, rimë e ritëm, kërcehen e këndohen nga fëmijët. Në krijimtarinë e tij poetike ky poet shpalos ëndrrat dhe botën e fëmijëve me një vizion të ylbertë.

Një vend të rëndësishëm në krijimet e autorit zënë dhe gjëegjëzat të botuara në shtypin letrar për fëmijë, si dhe në vëllimet: *Mendo pak se do ta gjesh, Unë pyes e ju përgjigjeni, Gjëegjëza* etj., në të cilat, në mënyrë metaforike, ai vë në lëvizje imagjinatën e fëmijëve për të zbërthyer enigmat e tyre. Në mjaft gjëegjëza të bukura, fëmijët ushtrojnë logjikën dhe fantazinë e tyre për të njohur natyrën dhe objektet e ndryshme, për t'i vlerësuar ato e për të mbajtur qëndrim ndaj tyre. Kështu, gjëegjëzat, në vargun e poetit bëhen lodra të bukura poetike që përcjellin edhe humor te fëmijët.

Ato veç rëndësisë që kanë për të ushtuar të menduarit e të vegjëlve, kanë edhe vlera njohëse e edukative.

Në krijimtarinë letrare për fëmijë të Ferhat Çakërrit përfshihen edhe librat me tregime, përmendim këtu "***E fshehta e kalasë***" (novelë e tregime, 1984). Është një libër që përcjell njohuri historike në formë artistike, siç jemi mësuar tashmë me krijimet e autorit. Ky libër mbart në vetvete një të fshëhtë që i mbetet në dorë lexuesit të vogël ta zbulojë. Libri është ndërtuar në dy pjesë; pjesa e parë është novela e cila rrëfen të fshehtën e kalasë dhe pjesa e dytë është e përbërë nga tetë tregime. Në pjesën e parë flitet për misterin që fsheh kalaja nën ujë. Me mjeshtëri autori përshkruan bukuritë e Vlorës dhe kaltërsinë e detit. Në novelë përshkruhet edhe aventura e tre shokëve të ngushtë: Artani, Agroni e Iliri. Secili nga këta tre personazhe i vesh me karakteristika të ndryshme, jo të njëjta: Iliri, një djalë i zgjuar e gazmor, vinte me trup të drejtë si plepi (krahasime që përdor autori), sy të gjallë e të qeshur dhe flokë të zinj si pendët e korbit, ishte një nxënës mesatar. Ndërsa Artani e Agroni ishin të shkëlqyer në matematikë e fizikë. Këtu, autori vlerëson rëndësinë e shkollës. Ajo në asnjë mënyrë nuk duhet të lënë pas dore, pasi është mëma e dijes, është e vetmja që na hap rrugët e vështira dhe të gjata të jetës, na bën më të qytetëruar e më të kulturuar.

Pjesa e dytë e librit është e përbërë nga tema të ndryshme. Trajton tema të jetës së përditshme, jetën e fëmijëve dhe lojërat e tyre, tema për shoqërinë, punën, duke përcjellë tek ata vlera edukative. I mësojnë lexuesit se ç'është e drejtë apo e gabuar në jet, se e vërteta shpërblehet gjithmonë, ndërsa gënjeshtra ndërshkohet. Pa harruar vlerat historike që paraqet vepra. Një element tjetër që e bën të pëlqyeshme është dhe përdorimi i dialogut, gjuha e pastër dhe e kuptueshme, fjalitë janë të shkurtra e konçize.

[164] Astrit Bishqemi, "Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë", Elbasan, 2001, f. 354

Me veprat e tij autori ka bërë përpjekje edhe për pasurimin e fjalorit të fëmijës me fjalë të reja. Ferhat Çakërri kërkon të përhapë dijen tek lexuesit e vegjël dhe këtë gjë e bën me anë të mikut më të mirë dhe të dashur, librit. Ky vëllim me novela e tregime ka arritur t'i rezistojë kohës. Sidomos krijimet poetike të këtij autori mbahen gjatë në mëndje, pasi muzikaliteti i vargut të tij, botëpërjetimet e thella, gjuha artistike e lodruese, humori, bota përrallore dhe ëndërrimtare janë mbresëlënëse.

5.9 Skënder Hasko – novelisti për fëmijë

Shkrimtari Skënder Hasko[165] është emër i njohur në letërsinë shqipe, kryesisht në atë për fëmijë. Ka një veprimtari të gjerë në fushën e krijimtarisë letrare. Eshtë poet, përralltar, tregimtar, novelist, romancier, dramaturg.

Skënder Hasko sjell me mjaft mjeshtëri copëza jete që nisin nga fëmijëria e tij e hershme në fshat e deri në ditët tona. Për fëmijë ka botuar disa libra, si: *Një gjeneral kapet rob* (novelë), *Çudirat dhe e fshehta e Zamirit* (novelë), *Dinakja me vesh të shpuar*... (përralla), *Ndodhitë e Çaço Gabimit* (tregime humoristike) etj.

Një nga cilësitë që e karakterizon stilin e këtij autori është humori që fëmijët e pëlqejnë shumë .

Kjo veçori duket që në titujt e disa krijimeve: *Një gjeneral kapet rob, Faqemolla mundi Hundëpinokun, Qeshin kafshët shtëpiake* etj. Shkrimtari ka lëvruar të gjitha llojet e zhanret e humorit e të satirës për fëmijë: vjersha humoristike, tregime, përralla, rrëfenja, novela, novela-përrallë, romane, pjesë teatrale për fëmijë e për kukulla etj. Me humor autori ka përshkuar sidomos temat e ditës nga jeta e fëmijëve. E tillë është novela *Një gjeneral kapet rob*, që e merr temën nga lojërat e fëmijëve. Kurse përmbledhja *Me litar të botës mos hyr në pus* ndërtohet mbi bazën e fjalëve të urta popullore.

Humorin shkrimtari e përdor si në krijimet realiste, ashtu edhe në ato fantastike, të cilat i vendos ngjarjet në mjediset e kafshëve e të shpendëve.

Nga folklori autori ka marrë edhe mënyrën e gërshetimit të prozës me vargje humoristike e satirike. Dhe këtë humor shkrimtari e përdor si në krijimet realiste, ashtu edhe në ato fantastike.

[165] Skënder Hasko u lind në Dukat të Vlorës më 2 mars 1936 – ndërroi jetë në Tiranë më 4 shkurt 2013. Shkollën 7-vjeçare e mbaroi në Tragjas të Vlorës, pastaj Liceun Artistik "Jordan Misja" për aktor. Ka punuar mësues në fshatin e lindjes, mekanik në Kuçovë dhe aktor në estradën profesioniste të Beratit. Pasi mbaroi Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike, dhe u diplomua për gazetari, punoi gazetar-redaktor në revistën satiro-humoristike "Hosteni", pastaj shef i redaksisë së botimeve "Teatër-Estradë" në Shtëpinë Qendrore të Krijimtarisë Popullore, më vonë kryeredaktor në revistën për fëmijë "Pionieri" dhe, së fundi, drejtor i Teatrit Kombëtar të Fëmijëve, deri sa doli në pension. Sikurse shihet, Skënderi jo vetëm ka kaluar të gjitha shkallët e shkollimit, por ka provuar edhe shumë profesione. Ka filluar të krijojë qysh në shkollën 7-vjeçare.

Xxx

Skënder Hasko ka treguar kujdes në kapjen e temave nga jeta e përditshme e fëmijëve. Kështu ndodh në librin me tregime për fëmijë "Maçoku i katrahurës", tregimet e të cilit që në nëntitull të librit cilësohen si *tregime me pakëz bisht*...

Në këtë vëllim spikasin gjuha e thellë, stili i rrjedhshëm, thjeshtësia e të rrëfyerit, gjetjet të cilat e bëjnë këtë libër të veçantë, mjaft interesant dhe të lexueshëm... Këto tregime japin mesazhe mjaft të fuqishme dhe shkaktojnë kënaqësi në botën e fëmijëve.

Duke lexuar vëllimin "*Maçoku i katrahurës*" ndjen imagjinatën e shkrimtarit, prek botën e tij fantastike, e cila të shpie larg në mendime dhe lexuesi e shikon veten të rrethuar nga personazhe interesante. Autori futet brenda botes së fëmijëve dhe me psikologjinë e tij gjen rrugët e arsyetimit, përthith vlerat e edukimit dhe ndjen kënaqësinë e mjeshtërisë së të treguarit.

Skënder Hasko i çon fëmijët nga një episod në tjetrin, i bënë ata që të jetojnë me personazhet e tij të bukur dhe ta njohin natyrën ku jetojmë me të gjithë madhështinë e saj.

Tregimet e Skënder Haskos janë episode që ndodhin mes njerëzve, mes fëmijëve në shkollë, në autobus, në shtëpi, në rruge e kudo.

Në tregimin *Grindjet në dyqan* lexuesi do të mësojë për respektimin e më të mëdhenjëve, por edhe ata të respektojnë fëmijët. Janë fenomene që ngjasin në jetën e përditëshme të njerëzve.

Djaloshi në rastin kur po blinte sheqer e ndjeu se po gabonte duke tentuar të blinte pa radhë dhe u detyrua të shkonte në fund të rreshtit e të zinte radhë duke kërkuar falje për këtë zotërisë. Në rastin kur po blinte bukë, zotëria në fjalë kërkonte të blinte pa mbajtur radhë, jo vetëm që nuk e përfilli radhën dhe njerëzit që ishin aty, por edhe e ofendoi djaloshin, kur ky i fundit guxoi t'ia vinte në dukje këtë fakt.

- *Paah, ç'fëmijë! – tha ai duke shtrëmbëruar buzët, mori bukën dhe iku.*

Po unë, nuk kisha të drejtë të thosha: "Paah, çfarë burri!?" Ec e gjeje! [166]

Ndërsa në tregimin *Vendi te stoli* shkrimtari Skënder Hasko na flet për marrëdhëniet shoqërore midis fëmijëve, për zënkat që duhen zgjidhur me mirëkuptim.

- *Çohu!*
- *Pse? – pyeti Alketa pak e çuditur.*
- *Se më ke zënë vendin, - iu përgjigj Albana me tonin e mëparshëm.*
- *Oh, ç'na the! Sikur ka emrin tënd ky vend…*
- *Timin ka! – gati u nxeh Albana.*
- *Pse, moj, kush ta ka lënë vendin te stoli i shkollës ty, mami apo babi?! – e talli Alketa.*
- *Unë isha ulur këtu. Kur u ngrita unë ti ma zure. Çohu! – foli Albana me zë të lartë dhe e skuqur në fytyrë.*[167]

Nxënësit në shkolla, sipas shkrimtarit, duhet të respektojnë njëri-tjetrin. Toleranca në këtë rast, është ajo që ka vlera më shumë sepse zënkat dhe mosmarrëveshjet në jetën shoqërore bëhen shkas për prishjen e harmonisë.

Në tregimin *Hë, se shkon Skerdi* autori përshkruan shumë bukur për kryerjen e detyrave në familje. Dembelizmi është një sëmundje që përfshin shumë njerëz dhe

[166] Skënder Hasko, "Maçoku i katrahurës", Tiranë, 2000, f. 31
[167] Po aty, f. 39

sidomos fëmijë, të cilët përtojnë të kryejnë ato punë apo detyra që u caktojnë prindërit. Ndarja e punëve në mënyrë të barabartë është një detyrim që rrjedh nga bashkëjetesa në familje, edukata dhe kultura e gjithsecilit. Ka fëmijë që vërtetë janë të papërtuar, por kjo nuk thotë se duhet shfrytëzuar gatishmëria e tyre në kurriz të dembelizmit të të tjerëve.

Mami nuk e zgjat më tej. I drejtohet përsëri Skerdit:

- *Shko merre edhe bukën, të keqen mami, se këtyre u janë tharë!...*
- *Mirë, mami, ika, po… këtyre kur do t'ju "njomen"? - tallet Skerdi.*
  Këtu e mbaroi tregimin vëllai i Skerdit. Unë u çudita me ato që dëgjova.
  E gjeni dot pse u çudita?![168]

Janë prindërit, vetë, që duhet t'i ndajnë detyrat në shtëpi dhe t'i përfshijnë të gjithë në kryerjen e tyre.

Nga tregimi *Lela, lëre lojën* fëmijët do të mësojnë për shfrytëzimin e kohës së lirë dhe mirëkuptimin me prindërit. Autori na sjell në qendër të vëmendjes një skenë loje të fëmijëve të një pallati. Ashtu siç mund t'u ketë ndodhur të gjithëve gjatë moshës së fëmijërisë, ka një mospërputhje midis dëshirave të fëmijëve për të luajtur dhe prindërve për të kufizuar kohën e dëfrimit. Vërtet fëmijët kanë botën e tyre, pasionet e tyre për të luajtur, por loja dhe dëfrimet e tyre kanë një kohe të caktuar dhe duhet të jetë e programuar. Kërkohet ndërhyrja e prindërve për t'i frenuar me mirëkuptim dhe kujdes.

Lëviznim e hidheshim si kecat në lëndinë. Qeshnim e bërtisnim "Kape! Prite!" Mua m'u dogj shoqja, Lela.

Ndërkohë u dëgjua zëri i mamasë së Lelës, që po fliste nga dritarja e katit të katërt:

- *Lelaaa!*
- *Urdhëro, mami! – u përgjigj Lela.*
- *Lëre lojën dhe eja, se do të shkojmë te tezja!*
- *Unë dua të loz me shoqet, moj mami, - tha si me të lutur Lela.*
- *Hajde e lëri shoqet, se lozin vet ato!...Eja! – ngriti tonin mamaja e saj*.[169]

Vrulli i moshës në këtë tregim na tregon se sa shumë kujdes duhet treguar nga prindërit për të kuptuar botën e fëmijëve, çka i shërben mirëedukimit të tyre.

Duke lexuar me kujdes tregimet, fëmijët do të mësojnë që nuk duhet të gënjejnë kurrë.

Për shembull tregimi *Pse më gënjeve?!* bën fjalë për gënjeshtrën ku personazhi me emrin Gjergji e gënjen mamin se do të luajë me shokët. Në fakt ai po mëson biçikletën. Dhe autori i mëson fëmijët që mirë është që ata të jenë të mbikeqyrur nga prindërit kur janë në fazën fillestare të të mësuarit për shembull në rastin tonë të biçikletës, pasi çdo pakujdesi çon në pasoja të paparashikueshme.

Ndërsa në tregimin *Zemërimi i teto Ritës* autori na sjell përpara një situatë të vërtetë, ku prindërit bëhen shkaktarë të edukimit të gabuar të fëmijëve të tyre. Bledari nuk ka asnjë faj që Renata shkoi në shkollë pa bërë detyrat. Në këtë rast gabimin e ka teto Rita, mamaja e Renatës, e cila në këtë rast e nxit të bijën që të kopjojë detyrat dhe të mos e vrasë mëndjen për t'i bërë vetë ato. Të njëjtin gabim bën dhe mamaja e Bledarit që e ngarkon të birin me përgjegjësi dhe kjo për të mos prishur miqësinë. Dhe, në këtë rast, shkrimtari nuk do ta zgjidhë dilemën, por do t'ia lërë në dorë lexuesit të vogël.

---

[168] Po aty, f. 45

[169] Skënder Hasko, " Maçoku i katrahurës", Tiranë, 2000, f. 49

Unë vrisja mëndjen: "Ore, kush është në gabim në këtë mes?"[170]

Tregimet, siç shihet, kanë qëllim të mirëfilltë edukativ, shquhen për karakterin e tyre pedagogjik, gjuhën e pasur e shpesh me humor e figuracion. Në këtë kuptim, kemi të bëjmë me një vepër letrare me vlera ideoartistike.

Në tregimin *Fletorja e detyrave* shkrimtari na përcjell një situatë ku nxënësit në shtëpi neglizhojnë për të bërë detyrat që u ka ngarkuar mësuesja. Rasti në fjalë është një dialog midis motrës korrekte Valbona dhe vëllait neglizhent Gentianit. E keqja më e madhe është tek Gentiani, i cili mirë që po u shkon radhën detyrave të shtëpisë, por nuk lë të qetë as motrën e tij Valbonën, e cila është e rregullt dhe kërkon që detyrat e shtëpisë t'i bëjë pastër dhe me kujdes.

- *E, moj, ç'i qëndis ashtu, si qëndismat e këllëfit të jastëkut të gjyshes!...Detyra shtëpie janë, se mos do i ruash për tërë jetën…Sa për t'i parë mësuesja, pastaj s'vlejnë më.*
- *Si nuk vlejnë?! Pse, kot jepen detyrat e shtëpisë?*
- *Kot jo, po sa për t'u ushtruar. Ndaj quhen edhe "ushtrime".*
- *Oj! Meqënëse quhen "ushtrime" duhen shkarravitur si të të vijë mbarë? – i tha Valbona. – Mësuesja na ka thënë se detyrat e shtëpisë të ndihmojnë jo vetëm për të përvetësuar mësimet, por edhe për të kalitur vullnetin, edhe për të qenë sistematik.*[171]

Shkrimtari Skënder Hasko në tregimin e tij *Maçoku i katrahurës* na përcjell skenat e një rrëmuje në orën e mësimit, kur nga poshtë bankave na del një maçok duke shkaktuar ilaritet dhe potere në klasë. Ora e mësimit prishet, mësuesja e ul në vend Elenën pa i vënë notë, maçoku i vërsulet klasës duke çjerrë me thonj një nga nxënesit. Ndërkohë maçoku ishte i Damianit, i cili e kishte sjellë jo pa qëllim në klasë, por për të prishur orën e mësimit. Gonia ose Kuqoja që ishte shok i Damianit e merr përsipër fajin, duke i deklaruar mësueses dhe gjithë klasës, se maçokun e kishte sjellë ai. Prishja e orës së mësimit nga ana e Damianit është një faj që duhet ndëshkuar dhe Gonia nuk bëri aspak mirë që mori përsipër gabimin e shokut.

Ne e dinim që maçoku ishte i Damianit dhe në klasë nuk e kishte sjellë Kuqoja, po Damiani, ndaj diskutonim ashtu. Tani e kemi lënë të bëjmë një debat tjetër për këtë punë, domethënë bëri apo s'bëri mirë Kuqoja?... Donte të mbronte shokun, apo ngaqë mësuesen e letërsisë e kishte teze ishte i bindur se s'do t'i bënin gjë, përveç ndonje shkulie veshi?...
Eh, si janë të ngatërruara këto punë...[172]

Mësuesja reagoi duke e dënuar veprimin e Gones, pasi ajo e dinte që ai nuk kishte mace në shtëpi, por mori përsipër fajin e Damjanit për ta nxjerrë atë nga situata.

Duke përfunduar themi se ky libër nuk është shkruar vetëm për nxënësit, por edhe për mësuesit dhe prindërit. Për nxënësit karakteristikë në këto tregime pedagogjike është se në fund të pjesëve nuk jepet zgjidhje të gatshme. Shtrohet problemi, zhvillohen ngjarjet, krijohen shqetësimet, arrihet ndonjëherë deri në mosmarreveshje dhe pastaj tregimi mbetet disi i papërfunduar, me fund të hapur. Dhe kjo, jo pa qëllim, për të nxitur lexuesit në biseda e diskutime, për të gjetur një a disa zgjidhje.

---

[170] Po aty, f. 15
[171] Skënder Hasko, "Maçoku i katrahurës", Tiranë, 2000, f.28
[172] Po aty, f. 37

Në disa tregime, shkrimtari ka treguar kujdes në zgjidhjen e disa problemeve të marrëdhënieve të prindërve me fëmijët, të qëndrimit të vëllezërve ndaj motrave, apo kryerjes së detyrave familjare, të veseve të fëmijëve etj, për të cilat prindërit kanë përgjegjësinë e tyre në edukimin e fëmijëve.

Në përgjithësi, tregimet janë shkruar thjesht e qartë, me gjuhë të kuptueshme e fabula të zbërthyera. *Subjekti i tyre është i thjeshtë, ndërkohë ato përshkruhen nga ide dhe mendime plot urtësi e mençuri, të vjela me intuitë e shije të hollë nga autori, në themel të të cilave është filozofia e urtë dhe e çmuar e popullit. Tematika e tyre është e larmishme dhe interesante, e gërshetuar edhe me elementë të folklorit dhe e përshkruar vende-vende edhe nga një humor i këndshëm*[173]. Janë tregime që mund të lexohen nga të gjithë nxënësit e shkollës nëntëvjeçare, lidhur me specifikën e problematikës.

Në këto tregime, sikurse dhe në përrallat, vjershat dhe romanet, shkrimtari Skënder Hasko shkruan me dashuri për fëmijët. Ai ka punuar mësues në fshatin e lindjes, ka qenë gazetar-redaktor në revistën satiro-humoristike "Hosteni", pastaj shef i redaksisë së botimeve "Teatër-Estradë" në Shtëpinë Qendrore të Krijimtarisë Popullore, më vonë kryeredaktor në revistën për fëmijë "Pionieri" dhe, së fundi, drejtor i Teatrit Kombëtar të Fëmijëve, deri sa doli në pension. Kjo tregon më së miri për përvojën e jashtëzakonshme krijuese të këtij shkrimtari.

5.10 Bardhyl Xhama – shkrimtari i detit

Në veprat e tij[174] ka personazhe dhe emra të çuditshëm si: *peshku elektrik, peshku gjel, peshku balerinë, peshku akrep, kali i detit, dhelpra e detit, derri i detit,* apo dhe të tjerë më të njohur, si: *ujku, elefanti, gjirafa, lepuri, pelikani, macja, etj*. Lexuesve fëmijë këto u pëlqejnë shumë. Autori ka luajtur bukur me to duke i personigikuar, duke i bërë sendet e kafshët të flasin, të veprojnë.

---

[173] Milaim Nelaj, "Profile letrare" - STUDIME, Tiranë, 2008, f. 97

[174] Ka lindur në Fterrë të Sarandës më 13 qershor 1933. Arsimin fillor e kreu në vendin e lindjes. Shkollën e mesme pedagogjike e përfundoi në Gjirokastër në vitin 1953. Ka punuar në arsim në rrethet Gjirokastër, Sarandë e Delvinë mësues e drejtor shkolle tetëvjeçare e gjimnaz. Gjatë kësaj periudhe kryen studimet me korrespondencë në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë. Pasi u diplomua, jetoi dhe punoi në Tiranë në gazetën "Mësuesi", në Shtëpinë Botuese të Librit Shkollor si dhe në Institutin e Studimeve Pedagogjike. Ka botuar libra artistikë për fëmijë, romane, novela, vëllime me përralla, vëllime me rrëfenja etj. Mban titullin "Mësues i Merituar" dhe ka marrë "Çmimin e Karrierës" në letërsinë për fëmijë.
Ka botuar këta libra artistikë për fëmijë e të rinj:
1. Përrallat e detit, 1975 (përralla).
2. Zhytësit e vegjël të thellësive, 1977 (novelë).
3. Ekspedita e Kaltër, l980 (roman fantastiko-shkencor).
4. Zjarrfikësi i pyllit, 1987 (përralla).
5. Tërfili me katër fletë, 1989 (novelë e përralla).
6. Pse qau delfini ?, 1996 (50 rrëfenja).
7. Në kthetrat e Piratit, 1997 (roman).
8. Lejleku me akullore, 1998 (përralla).
9. Djaloshi që kapte rrufetë, 2000 (60 rrëfenja).
10. Djali me tre brirë, 2002 (përralla).
11. Tre vëllezërit (novele për filloren), 2003
12. Barut në vend të bukës (rrëfenjëza), 2004
13. Arratisje nga kafazi (përralla e rrëfenja), 2007
14. Pëllumbi me fjongo të kuqe (60 rrëfenja) 2007

Bardhyl Xhama, i përket brezit të dytë të shkrimtarëve të letërsisë së re për fëmijë, të cilët, me krijimtarinë e tyre të spikatur, i ngritën më lart e i konsoliduan themelet që vunë paraardhësit e tyre: Qamil Guranjaku, Teufik Gjyli, Spiro Çomora, Zihni Sako, Moisi Zaloshnja, Bedri Dedja etj., duke qenë bashkëkohës e bashkëpunëtor me autorë të njohur të këtij brezi, si: Odhise Grillo, Dionis Bubani, Xhevat Beqaraj, Skënder Hasko, Adelina Mamaqi, Bekim Harxhi, Petraq Zoto etj.

Krijimtaria letrare e këtij autori zë fill në moshën e shkollës së mesme, teksa shkruante e botonte krijimet e para letrare në gazetën "Pionieri". Në vitin 1975, me botimin e përmbledhjes "*Përrallat e detit*", duke u prezantuar si prozator fantastiko-shkencor, gjini të cilën do ta lëvronte edhe më pas, me libra të tjerë me përralla, tregime, rrëfenja, novela dhe romane, këtë gjini do të kishte për zemër, aty do të gjente më mirë veten e do të ishte më i suksesshëm gjatë viteve. Puna e shkrimtarit ka qenë e lidhur me shkollën, pra me fëmijët dhe të rinjtë. Puna si mësues dhe shkrimtar e ka ndihmuar të njohi mirë botën dhe psikologjinë e të vegjëlve. Momentet e bukura të fëmijërisë në mjedisin e fshatit Fterrë, në afërsi të Jonit, do të ndikonin tek shkrimtari në krijimet e tij.

Një nga momentet e tjera të rëndësishme në jetën e tij shkruan *(*Faik Islamaj në intervistën me Bardhyl Xhamën, botuar në gazetën *"Ndryshe",* 8 janar 2009 *("Shkrimtari i detit, zhytës e peshkatar në tre kontinente") ka qenë pasioni i tij për detin dhe njohja konkretisht e botës së nunujshme, për botën e larmishme, për faunën e florën, për peshqit e kafshët e rrezikshme, për misteret e detit, për ngjyrën, kripshmërinë, për lëvizjet e rrymave detare e shumë e shumë kuriozitete të tjera që janë bërë pjesë e librave të tij*.

Është e vërtetë që në disa nga librat, sidomos në krijimtarinë fantastiko-shkencore, por edhe në librat me perralla e rrefenja, ka mjaft të dhëna shkencore. Kështu në tre librat e njëpasnjëshëm: "***Përrallat e detit***" (*përralla,* 1975), "***Zhytësit e vegjël*"** (*novelë,* 1977), "***Ekspedita e kaltër***" (*roman fantastiko-shkencor,* 1980) ngërthejnë temën e detit, një temë mjaft e dashur për fëmijët, e cila zgjon kërshërinë dhe fantazinë e tyre mbi të fshehtat, misteret, bimësinë dhe gjallesat e shumta të tij. Ndaj, me të drejtë, kolegët dhe kritika e kohës e kanë quajtur Bardhyl Xhamën "shkrimtari i detit". Bardhyl Xhama ka dhënë një ndihmesë të veçantë në fushën e përrallës. Librat e tij pasurojnë botën e brendshme shpirtërore të fëmijëve, duke i mbushur me dashurinë për të mirën, për njeriun, për kafshët e natyrën.

Përrallat e Bardhyl Xhames kanë nivel artistik e gjuhësor dhe janë me karakter edukativ e shkencor. Ato janë thurur në mënyrë të tillë që të fitojë e mira ndaj së keqes.

Përrallat janë shkruar për moshën e nxënësve të shkollës fillore. Ato janë të kuptueshme nga fëmijët. Për vëllimin "*Përrallat e detit*" po citoj vlerësimin e bërë nga studiuesi i letërsisë për fëmijë Milaim Nela**j** ku shkruan: "*Nëpër rreshtat e librit të parë, lexuesi i vogël, nga njëra përrallë tek tjetra, përthithet tërësisht nga të fshehtat e botës nënujore, njihet me jetën, llojet dhe karakteristikat e kafshëve dhe peshqëve të detit,*[175].

[175] Milaim Nelaj, Gazeta "Telegraf", Prill 2010

Në këtë vëllim janë përmbledhur nëntë përralla mbi jetën interesante të kafshëve dhe të peshqve të botës së nënujshme, të deteve e oqeaneve. Vëllimi tjetër "***Zjarrfikësi i pyllit***" përmban njëmbëdhjetë përralla. Vlera të mirëfillta artistike e gjuhësore përcjellin mesazhe edukative. Personazhet kryesore që zotërojnë këtu janë kafshë**,** si ujku, elefanti, gjirafa, lepuri, pelikani, macja etj. Përmes bëmave dhe instinkteve të tyre shtjellohen ide morale, fshikullohen veset e këqija, si gënjeshtra, grykësia, mendjemadhësia, mendjelehtësia etj. Në tërësi**,** vëllimi është një ndihmesë me vlerë në lëvrimin e përrallës në letërsinë për fëmijë. Edhe në përrallat e tjera si; **"**Lejleku me akullore" , "Djali me tre brirë", "Tre vëllezërit", autori ka zgjedhur tema interesante e zbavitëse, me karakter shoqëror e shkencor, sidomos për boten e kafshëve e të shpendëve.

Nxënësit lexojnë me ëndje bëmat e maçokut me dorashka, të grerëzës e bretkosës, të breshkës që hipi në lis, të papagallit llafazan, të elefantit zjarrfikës, të miushit që lidhi kungullin në bisht, të lejlekut me akullore etj.

Në disa përralla e rrëfenja personazhet janë njerëz, fëmijë apo të rritur, që të befasojnë me bëmat e tyre. Si dhe në disa botime të tjera, autori është mbështetur fuqimisht në fjalët e urta të popullit tonë. Krijimet janë zbërthim artistik i mençurisë së tij, që rrjedh natyrshëm përmes zhvillimit të ngjarjeve e veprimeve të personazheve kafshë e njerëz. Luftohen vese të tilla si mendjemadhësia, lakmia, mashtrimi, dembelizmi, mosmirënjohja etj.

Përrallat e rrëfenjat janë shkruar për nxënësit e shkollës fillore dhe pëlqehen prej tyre sepse:

- të gjithë emrat e peshqve, pa asnjë përjashtim, nuk janë të shpikur nga autori, por realë. Në detet tona ka banorë me emra të tillë.
- disa nga fabulat e përrallave, ngjarjet dhe episodet që përshkruhen, janë bazuar jo vetëm në instinktet e llojeve të peshqve, por edhe në emrat e tyre..
- përshkrimi i peshqve e i kafshëve të detit, madhësia, ngjyra etj., përgjithësisht, janë bërë me saktësi. Shumica e"personazheve" të përrallave janë edhe banorë të deteve Jon e Adriatik.
- në libër jepen të dhëna të shkurtra për disa nga llojet e peshqve që janë "personazhe" të përrallave.
- përrallat janë në përshtatje me moshën e nxënësve që u adresohet.
- tituj e tyre zbërthejnë kuptueshëm çdo kapitull të përrallës.
- siç e ka vlerësuar dhe kritika**,** autori ka shfrytëzuar me aftësi të rrallë, me shkathtësi e talent të vërtetë mjetet shprehëse të folklorit, ka gërshetuar realen me fantastiken, konkreten me figurativen, idealen me realen, logjiken me emocionalen. Rrëfimi rrjedh lirshëm, është dinamik e konciz. Bukuritë e përrallës nuk qëndrojnë vetëm në ngjarjet fantastike e tërheqëse, në gërshetimin e të zakonshmes me mbinjerëzoren, të dramës me lirizmin, por sidomos vlerë të veçantë kanë idetë, mësimet që burojnë natyrshëm përmes indit të rrëfimit dhe jo si shtojca moralizuese.

Bardhyl Xhama është shkrimtar që e parapëlqen përrallën. Ai është njohës i botës fëminore, i psikologjisë dhe i gjuhës së të vegjëlve. Kjo e bën të veçantë atë në llojin e vet. Kështu në "***Tërfili me katër fletë***" (1989), ka arritur të na japë një novelë të arrirë, me të papritura e aventura sa reale aq dhe fantastike. Ngjarjet shtjellohen në dhjetë kapituj me tituj të veçantë. Kjo e bën novelën më të kapshme për fëmijët. Fabula e saj ngërthen dhjetë rrëfime. Personazhi kryesor i kësaj novele-përrallë është Gjeka. Të

gjitha ngjarjet që rrjedhin në mënyrë lineare lidhen me të. Personazhet e saj (vëllezërit Gjoka, Gjika dhe Gjeka), në rrugën e mundimshme për të gjetur lumturinë (tërfilin me katër fletë), ndeshen me vështirësi dhe rreziqe të mëdha (me kusarët, gjarprin me dy kokë, kuçedrën, vampirët etj.). Dy të parët largohen nga rruga e nisur, por përfundojnë si lypës, kurse i treti, Gjeka, duke u bashkuar në misionin e tij me Cinxon e vogël, shokun e tij besnik, i kapërcen ato me durim, guxim e zgjuarsi. Me ndihmën e njerëzve të mirë, bujqëve dhe muratorëve të mençur e punëtorë gëzon frytet e punës, madje bëhet edhe një luftëtar trim për mbrojtjen e trojeve të atdheut nga sulmi i armiqve, sepse "fati i atdheut është fati im", - thotë ai, - dhe e gjen lumturinë. Biografia e tij artistike përkon me heronjtë e përrallave tona popullore. Si i njëjti model, ai mbart tipare e cilësi që shfaqen gjatë udhës së tij (udhë e vështirë e plot peripeci) në kërkim të lumturisë së vërtetë. Janë plot episode lirike, dramatike, të shkruara me frymëzim që na sjellin në reliev mençurinë, trimërinë, ndershmërinë, zgjuarsinë, këmbënguljen e triumfin e protagonistit kryesor, Gjekës ndaj forcave regresive, forca që kërkojnë mjerimin e njerëzve dhe zvetënimin, vyshkjen e ëndrrave të jetës. Gjeka me vendosmërinë e tij gjen çelësin e zbërthimit të së vërtetës të simbolikës së Tërfilit me katër fletë, simbolikë që e zbërthen plaku përmes fjalëve të tij, të cilët përbëjnë dhe mesazhin e veprës: "E ç'kërkon të gjesh tjetër, mor bir? E ku ka tërfil me katër fletë?! Autori ka shfrytëzuar me mjeshtëri elementet e folklorit, sidomos të përrallës, ka ditur të mbledhë si bleta nektarin e krijimtarisë popullore, si dhe të gërshetojë natyrshëm realen me fantastiken, njerëzoren me mbinjerëzoren. Me aftësi e fantazi krijuese ka bërë gjetjet e duhura dhe ka mundur të përzgjedhë detaje, dukuri e fakte të tilla interesante, që përçojnë emocione dhe kanë ndikim të ndjeshëm te lexuesit e vegjël.

Profesor Doktor Jakup Mato jep edhe këto vlerësime për vlerat ideoartistike të novelës, botuar në vend të parathënies: "*… kjo është një novelë shumë interesante, shkruar mjaft bukur nga një penë e talentuar. Ajo lexohet me dëshirë jo vetëm nga të vegjlit, por dhe nga të rriturit…".*

Shkrimtari Bardhyl Xhama ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme edhe në novelën për fëmijë. Kështu novela "**Zhytësit e vegjël të thellësive**" shquhet për tematikë të veçantë. Tema që trajtohet është mjaft tërheqëse për fëmijët. Zhytësit e vegjël të brigjeve të Jonit na jepen në këtë novelë jo vetëm si gjurmues të florës e të faunës së larmishme, por dhe si peshkatarë të aftë në gjuetinë me pushkë sportive thellësive të detit. Përmes leximit të novelës nxënësit do të mësojnë për shoqërinë e miqësinë e fëmijëve, për guximin e tyre në aventurat e zhytjes e të peshkimit nën ujë, për përleshjet me kafshë të rrezikshme të detit, për dukuri interesante e mistere të thellësive, për llojet e bimëve e të peshqve të brigjeve të Jonit etj. Shumica e ndodhive të përshkruara në novelë janë të vërteta. Ato bazohen në përvojën e vetë autorit dhe të shokëve të tij si zhytës e peshkatarë amatorë**,** të cilët futeshin në thellësitë e detit me pajime të sajuara vetë e pa bombola oksigjeni. Kjo i bën ngjarjet më të besueshme, më tërheqëse dhe më të kuptueshme për lexuesit e vegjël. Në vlerësimin e bërë nga studiuesi i letërsisë për fëmijë *Milaim Nelaj* për këtë novelë, theksohet se lexuesit *njihen me faunën dhe florën e larmishme nënujore. Por më tepër atë e intrigon përleshja e zhytësve me kafshët e rrezikshme të detit, skena këto drithëruese e plot ankth, por që përfundojnë me gëzimin e fitores, të realizuara me art e mjeshtri nga autori"*[176].

[176] Milaim Nelaj, Gazeta"Telegraf", Prill 2010

Bardhyl Xhama është autor i dy romaneve fantastiko-shkencor për fëmijë: "**Ekspedita e Kaltër**", botuar në vitin 1980 dhe romani "**Në kthetrat e Piratit" (**1997).

Romani "*Ekspedita e Kaltër*", ka vlera artistike, gjuhësore e shkencore dhe nxit së tepërmi fantazinë e fëmijëve. Ngjarjet vendosen në Sarandë, ku një grup fëmijësh nisin një ekspedite në detet Jon dhe Adriatik me synimin për të ndërtuar maketin e një hidrocentrali në Kanalin e Otrantos, që do të punojë me energjinë e "Lumenjve pa brigje" e që përshkojnë faktikisht këto dy dete. Për këtë ata zhyten me mjetet e të ardhmes në detet Jon dhe Adriatik, zbulojnë të fshehtat e tyre, vizitojnë laboratorë në taban të detit e uzina lundruese që nxjerrin minerale të rralla e te dobishme, ndeshen me vështirësitë e natyrës, me kafshët e detit, sulmohen nga anijet pirate, kryejnë prova e eksperimente të shumta, gjer sa arrijnë qëllimin.

Romani shpalos zgjuarsinë e aftësinë e fëmijëve, guximin e trimërinë, shoqërinë e miqësinë, shpirtin kërkues e krijues, vendosmërinë për të realizuar detyrën**.** Romani ka vlera njohese. Ai sjell informacion mbi dukuri te ndryshme qe kane lidhje me detin dhe energjine e ujit te tij.

Gjithashtu romani eshtë i ngjeshur me të dhëna shkencore për detet Jon e Adriatik dhe për bregdetin tonë, aq sa mund të quhet edhe si një enciklopedi e vogël. Me vlerë është fakti që disa nga parashikimet fantastike në romanin e botuar 26 vjet më parë, sot janë bërë realitet, ose janë vënë në rrugën e zgjidhjes. Pra, fëmijët jo vetëm zgjerojnë horizontin gjuhësor, letrar e shkencor, por u ndizet dëshira e kureshtja që të parashikojnë e, pse jo, të përgatiten për të ardhmen e vendit.

Ne një nga vlerësimet e studimit për krijimtarinë e ketij autori, pedagogu e shkrimtari Xhahid Bushati shkruan: *"Vepra Ekspedita e Kaltër plotëson më tej portretin e shkrimtarit...Vepra përmendet jo vetëm si arritje e autorit, por dhe si arritje e vetë zhanrit, çel një rrugë të re shikimi në zbulimin e mistereve të detit, sjell informacion të ri e të pa njohur shkencor...Kë to janë skenat më të bukura, më mahnitëse, më poetike, sa reale aq dhe fantastike, që vetëm Bardhyl Xhama i njeh me shpirt dhe me talentin e tij prej prozatori i pikturoi si një artist i vërtetë, gjë që veprës i dhanë vlera të veçanta, me një poetikë të papërsëritshme, gjë që dhe sot të jep kënaqësi për ta lexuar"*[177].

Përveç vlerave artistike që bartin ngjarjet dhe skenat intriguese, romani të tërheq edhe për anën fantastike të tij, e cila, pa dyshim, ngjall kureshtjen e fëmijëve, si dhe për informacionin e pasur shkencor që ofron për lexuesin. Të tre këto elemente, që janë karakteristikë e romaneve fantastiko-shkencorë, spikatin dukshëm në këtë vepër dhe janë ndërthurur natyrshëm, në funksion të realizimit të idesë dhe misionit të saj.

Ndërsa romani tjetër "**Në kthetrat e Piratit" (**1997), "Pirati" i përshkruar në këtë roman, nuk është personazh i shekujve të shkuar, por një "Pirat" i ditëve tona. Ai ka braktisur shkollën dhe, duke qenë më i madh në moshë e në bëma, tërheq në rrugën e krimit nxënësin mbetës e rrëmujaxhi Besnik Bregu, që, gjithashtu, braktis shkollën nën ndikimin e "kapos" më të rritur.

Ngjarjet e romanit, sa reale aq dhe të fantazuara, vendosen në bregdetin e Sarandës në vitet 1988-1989. Shumica e ngjarjeve jane reale – thotë vetë autori (botuar në gazetën Ballkan, në korrik 2010). Po marrim, për shembull, rastin e përleshjes me

[177] Sejdo Harka, Gazeta "Ballkan", Korrik 2010

oktapodin. *Më ka ndodhur mua realisht. U zhyta dhe gjuajta me pistoletë një oktapod të madh. Ai, i plagosur, me shigjetën në trup, rrëshqiti në një të çarë shkëmbore. Unë e ndoqa pas, me zhytje dhe e mbërtheva me dorën e majtë. Por ai, me disa nga këmbët thithëse si venduza u mbërthye për shkëmbi e me disa mbërtheu dorën time. Pra, më gozhdoi në fund të detit, kur mua, pa bombola gazi, po më mbarohej fryma. Hoqa në çast thikën që e mbaja gjithmonë në brez dhe i preva oktapodit të tri këmbët të ngjitura për shkëmbi, u mbështeta në taban të detit dhe u dhashë lopatëzave me sa fuqi që më kishin mbetur. Dola në sipërfaqe i mekur dhe u shtriva në shpinë të çlodhesha. Shoku që më shoqëronte më erdhi në ndihmë. Oktapodi me pesë këmbë qëndronte ende i ngjitur në krahun tim. Ma shqiti me forcë dhe atëherë vumë re se dora ime qe mbushur me njolla të kuqe dhe ndonjë bulëz gjaku nga thithkat e oktapodit.*

Romani ka vlera të spikatura ideoartistike. Kompozicioni është i qartë dhe i thjeshtë, gjuha është koncize, e zgjedhur, e pasur me fjalë të rralla, me frazeologji e të folme të figurshme, ka përshkrime të bukura të natyrës, sidomos të detit, ka analiza të mirëfillta psikologjike të botës së brendshme të personazheve, dialogjet janë të goditura, personazhet kryesore janë skicuar mirë etj.

Në roman, edhe pse disi më shkarazi, përshkruhet dhe jeta në familje, në shkollë e në shoqëri e personazheve kryesore. Pra, ngjarjet kanë një sfond, në një vend dhe në një kohë të caktuar, konkretisht në fund të viteve tetëdhjetë. Romani ka edhe vlera njohëse, veçanërisht për bregdetin e Sarandës, për kafshët e peshqit, për gjuetinë e nënujshme, për mënyrën e jetesës për kohën etj.

Ndaj vlerësojmë që romani ka një tingëllim aktual dhe ndikim të fuqishëm edukativ për nxënësit e klasave të larta të shkollës nëntëvjeçare, të cilëve u adresohet. Ai të tërheq, gjithashtu, për gjuhën letrare të pasur me frazeologji, me fjalë të urta e të rralla të popullit, si dhe për përshkrimet e gjalla e me kolorit të natyrës, sidomos të bregdetit, ku zhvillohen ngjarjet:

"*Bregu ishte i përthyer, tërë zgavra e shpella. Labirintet që formoheshin, ngushticat e strehimet natyrore sikur ishin krijuar enkas për fshehjen dhe kullotjen e gjallesave të detit. Pak më tej fillonte "qilimi" i leshterikëve, me ndonjë shkëmb të veçuar midis tyre, që dukej sikur kishte rënë nga qielli… Leshterikët e gjelbër, si një tantelë e qëndisur përfund "fustanit" të detit, formonin një kontrast ngjyrash midis kaltërsisë dhe pllakave të bardha. Natyra përreth merrte kështu pamjen e një pikture"*[178]. Fundi i romanit mendojmë se është origjinal dhe jashtë skemave të zakonshme. Besnik Bregu, edhe pse i penduar që u fut në rrugën e krimit, nuk arrin ende të bëjë kallëzimin në organet përkatëse dhe kjo sepse Pirati e ka nuhatur se po hetohet për arrestim dhe arratiset me not nga brigjet e Ksamilit për në ishullin e Korfuzit. *Njëkohësisht, romani shquhet për portretizimin fizik e moral të personazheve, për pasqyrimin me vërtetësi e realizëm të botës dhe psikologjisë së tyre, për dialogjet e zhdërvjellëta e, mbi të gjitha, për konceptimin origjinal të kompozicionit të veprës dhe shtjellimin e ngjarjeve*[179].

Ndalemi në një moment tjetër, pikërisht në lëvrimin e një zhanri të shkurtër prozaik, atë të rrëfenjave, ku do të thoshim se autori ka gjetur veten. Temat janë kryesisht nga gurra e pashtershme popullore.

[178]Bardhyl Xhama, "Në kthetrat e piratit", Tiranë, 2001, f. 79-80
[179]Milaim Nelaj,Gazeta "Telegraf", 8 prill 2010

Përmendim konkretisht përmbledhjet me tituj figurativë dhe impresionues: "*Pse qau delfini*" (1996), "*Djaloshi që kapte rrufetë*" (2000), "*Djali me tre brirë"* (2002), "*Arratisja nga kafazi*" (2007), "*Pëllumbi me fjongo të kuqe*" (2008). Ato shquhen për origjinalitetin dhe të veçantën e tyre, për motivet dhe gjetjet e goditura, për finesën në të konceptuarit dhe të shkruarit e tyre, për moralin e shëndoshë që bartin dhe mesazhet edukuese që përcjellin. Janë copëza të shkurtra letrare, në thelbin e të cilave qëndrojnë fjalë të urta të popullit tonë ose fjalë të mençura të njerëzve të mëdhenj të botës.

Tematika e rrëfenjave të këtij autori është shumë e gjerë dhe e larmishme. Në morinë e tyre do të veçonim per shembull librin për fëmijë "**Pse qau delfini**?" ku rrëfenjat shquhen për vlera artistike, gjuhësore e morale**.** Janë shkruar me një gjuhë të pasur, të thjeshtë e të kuptueshme, me fraza të shkurtra e fabula të goditura e tërheqëse për fëmijët. Secila rrëfenjë është shtrirë në një deri dy faqe, bashkë me ilustrimin. Të tilla janë rrëfenjat: "*Humbe gjuhën, je i humbur", "Fati i trimit", "Barut në vend të bukës",* etj. Një grup rrëfenjash trajtojnë probleme morale , dënojnë vese të këqija, si mendjemadhësinë, mendjelehtësinë, mashtrimin, vjedhjen, të qenit frikacak etj., vlerësojnë faljen e gjakut, dashurinë prindërore, mikpritjen etj. Përmendim rrëfenjat : "*Mjaltë nga mjalti", "Tri frikët", "Degët bëjnë faj, trungjet qajnë","Falja e gjakut*" etj. Rrëfenjat për vlerën e diturisë, për mësimin e librin, për përvojën e mirë jetësore etj., përbejnë grupin e tretë. Të tilla përmendim : "*Ç'ke në tru s'ti marrin dot", "Djali me tre brirë", "Sytë e mendjes", "Provë e vështirë", "Qorr me sytë çelë*" etj. Në fabulën e rrëfenjës "*Provë e vështirë*", plaku që të provojë zgjuarsinë e djemve, u jep nga një grusht para dhe u thotë t'i blejnë mend. I pari kthehet duarbosh, i dyti blen tru bagëtie, ndërsa i treti libra... Në grupin e katërt futen rrëfenjat për vlerën e punës, për të mirat që sjell ajo dhe për respektin ndaj punës së ndershme**.** Rrëfenja të tilla janë : "*Vreshtari","Sa shatin dhe copën", "Syri frikacak e krahu trim", "Dembeli dhe hieja", "Sekreti i pemëtarit*" etj. Një grup tjetër rrëfenjash trajtojnë jetën intime të fëmijëve**,** siç kuptohet dhe nga titujt e disa prej tyre, si: "*Gishti i lidhur*", "*Jeta qan për gaforren*", "*Keta lajmëron urgjencën*", "*Qengji që s'hante pastërmanë*", "*Valbona me mustaqe*", "*Pse qau delfini*?" etj. Karakteristikë pozitive është se mjaft nga rrëfenjat janë shkruar me humor të këndshëm e të kapshëm nga fëmijët. Ato të bëjnë të mendosh duke qeshur.

Krijimet e shkrimtarit Bardhyl Xhama pëlqehen nga fëmijët dhe kanë qenë kurdoherë të mirëpritura, qoftë për fabulat e goditura që ngërthejnë ato, qoftë për subjektet interesante që shtjellojnë, qoftë për rrjedhshmërinë e rrëfimit, përmes një gjuhe të pastër letrare, bazuar në standardin e saj, qoftë për figuracionin letrar të përshtatshëm për moshën e tyre.

Për të gjitha këto, ashtu siç është shprehur edhe shkrimtari Dritëro Agolli, "*Bardhyl Xhama ka dhënë një kontribut të shquar në lëmin e letërsisë për fëmijë, që nga libri i parë "Përrallat e detit" e deri te libri i fundit, dhe me librat e tij ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndezjen e fantazisë së fëmijëve".*

5.11 Tasim Gjokutaj (1944 – 1998) – mjeshtri i vargut humoristik

Poeti i njohur Tasim Gjokutaj[180], në krijimtarinë e vet poetike për fëmijë zë një vend të merituar në lëvrimin e poezisë në përgjithësi e veçanërisht në lëvrimin e poezisë e të poemës humoristike, të përrallave në vargje e të poemave. E njihte thellë botën ëndërrimtare të fëmijëve dhe sigurisht që puna e tij do të skaliste me gërma, personazhe, ngjarje, veprime që lidhen me botën, lodrat dhe gëzimet e tyre.

Kishte një mënyrë të veçantë të të shkruarit, kërkonte që siç thoshte dhe vetë: *se s'ka gjë më të mirë se të shikosh një fëmijë, i cili, duke lexuar një libër, buzëqesh, qesh apo shpërthen në shatërvane të qeshurash.*[181]

Puna e tij si mësues i dha mundësi t'i njohte më nga afër fëmijët dhe si rrjedhojë të krijojë lidhje të ngushta fizike e shpirtërore. Gjithçka që kishte të bënte me ta, ai i hodhi në letër, duke u bërë kështu krijuesi dhe miku më i mirë i tyre me vjershat dhe poemat humoristike.

Krijimtaria e tij letrare është e pasur dhe e larmishme. Ajo shpaloset me njëzet e dy libra poetikë të botuar ndër vite. Në pjesën më të madhe të krijimtarisë së vet për fëmijë, përfshin motive, tema e detaje poetike, që mbartin humor, duke nxitur tek të vegjlit të qeshurat dhe të përqeshurat që është në natyrën e tyre.

Letërsia për fëmijë pothuaj që në fillimet e saj, për të ndikuar te lexuesit e vegjël ka përdorur dy rrugë: "bëni kështu" dhe rrugën "mos bëni kështu", e para duke propaganduar shembullin pozitiv, e dyta duke kritikuar shembullin negativ. Krijimet humoristike mbështeten tek e dyta. Vënë në shënjestër veset. "Veset" kryesore të fëmijëve janë tekat.[182]

Dhe, shkrimtari ynë mblodhi e studioi me përkujdesje dhe përkushtim dëshirat, lojërat, tekat, botën, natyrën dhe i përfshiu në krijimtarinë e tij të larmishme, kryesisht vjersha, vjersha humoristike, përralla në vargje, poema dhe poema humoristike.

---

[180] Krijimet letrare të poetit, kanë mbetur një pasuri e vyer në fondin e letërsisë për fëmijë; ato e nisin rrugën e tyre që në vitin 1969 e pasohen me: "Do ndërtojmë hidroçentral" (poemë- përrallë, 1969), "Buzëqesh Mentori" (vjersha, 1972), "Dhelpra dhe Baloshi" (përrallë në vargje, 1973), "Keci që s'bëri detyrat" (poemë-përrallë, 1975), "Dita e pare" (vjersha, 1976), "Kush e hëngri akulloren" (poemë humoristike, 1977), "Bleta lulet i ka xhan" (vjersha, 1977), "Familja dhe hekurudha" (vjersha, 1977), "Në fshatin tonë malor" (poemth, 1977), "A e dini ç'tha Artani?" (vjersha, 1978), "Qajnë sorrat në një ferrë" (vjersha, 1978), "Luftë me aspirina" (poemë, 1979), "Keci me katër këpucë" (poemë-përrallë, 1980), "Derrkuci që bëri dush" (poemë humoristike, 1981), "Bisedë me një dallëndyshe" (vjersha e poema, 1983), "Bisedë me mbesën" (poema, 1983), "Ç'ëndrra thurin kalamajtë"(poema, 1984), "Alo, të vijë mamaja" (poemë humoristike, 1985), "Obobo, i ziu ç'bëra" (poemë, 1988), "Vët kopan" (poemë-përrallë, 1990), "S'duron iriqi një gjilpërë" (vjersha, 1990), "Ku ta gjej daullen gjyshi" (vjersha, 1995), "Kush e hëngri akulloren?" (përmbledhje kryesore e veprës, 1997), "Vajza që u bë bletë" (përrrallë në vargje, 2000).
Në krijimtarinë e vet Tasim Gjokutaj i është drejtuar dhe skenës së fëmijëve, për të cilën ka shkruar shumë pjesë për kukullat, disa librete estradën për fëmijët e të rriturit, por edhe tekste këngësh që janë kompozuar e kanë marrë edhe çmime në festivale të ndryshme. Më pas Tasim Gjokutaj dha leksione për letërsinë për fëmijë në Universitetin "Eqerem Çabej", ku ndihmoi edhe për zbulimin e përparimin e talenteve në fushën e letërsisë për fëmijë e të rritur, një pjesë e të cilëve sot janë shkrimtarë të njohur. Gjatë vjetëve që punoi pedagog Tasim Gjokutaj u mor edhe me punë shkencore, frut i të cilave janë dy librat me leksione e studime: "Lirikat e dasmës gjirokastrite" dhe "Letërsia për fëmijë-1", për të cilat mori edhe titullin "Doktor i shkencave filologjike."

[181] Gjokutaj, Tasim; "Kush e hëngri akulloren", Tiranë, 1997, f. 4

[182] Po aty, f. 5

Ne do të ndalemi pikërisht në botimin e përmbledhjes kryesore të veprës "*Kush e hëngri akulloren*", një poemë humoristike e botuar në vitin 1997.

Në mjaft vjersha të shkrimtarit Tasim Gjokutaj, të bie në sy ndërtimi i vargjeve sipas traditës së lodërtimeve të të vegjëlve në lodrat e tyre gazmore, ku shfaqin dhe zgjuarsinë. Vjersha "*Bleta lulet i ka xhan*", "*Bisedë me një dallëndyshe*", *Ç'ke harruar moj Aulonë*?", "*Pse po qajnë retë*", etj, etj...janë të thjeshta e plot muzikalitet. Kanë ritëm e rrjedhshmëri, pa ndonjë ngarkesë, e si rrjedhojë mësohen lehtë. Për shembull në vjershën "*Ç'ke harruar moj Aulonë*?":

Sot, kur shkonim për në shkollë,
Pse u ktheve si veri?
Ç'ke harruar moj Aulonë,
Ç'ke harruar në shtëpi?

A mos vallë shishen me bojë,
A mos penën në kuti?
Ç'ke harruar, moj Aulon,
Që u ktheve si veri?

Thotë Aulona e gëzuar:
- *Asnjë gjë s'kisha harruar,*
As fletoren, penën, shishen,
Po kur ika, s'putha gjyshen.

Apo në vjershën tjetër "*Bisedë me një dallëndyshe*":

- Dallëndyshe
Gushëbardhë,
Çerdhen ku e ngrite vallë?
- Në një vend të bukur shumë,
Në një mal ngritur mbi lumë.

-Sa mirë" Çerdhen e ke ngritë
Jo mbi mal, po mbi digë.

Kut të vijë lumi te diga,
Do të mbushet vendi drita,
Do burojë drita këtu,
Hej, çdo shohin zogjtë e tu!
Dallëndyshja q'atë çast
Shkoi në çerdhe gjithë gaz,
U tha zogjve gushëbardhë:
-Rritni krahët sa më parë,
Që të nisni fluturimin
Ditën e inagurimit![183]

[183] Po aty, f. 17

Të gjitha këto tregojnë për përvojën krijuese të poetit, i cili si vëzhgues i hollë i jetës së fëmijëve, zbulon botën e pasur shpirtërore të tyre.

Tasim Gjokutaj na shfaqet edhe si poet i humorit për fëmijë, cilësi karakteristike individuale në krijimtarinë e tij. Një pjesë e mirë e vjershave të tij kanë karakter humoristik. Janë kaq të dashura për fëmijët, kaq gazmore, të ëmbla, saqë vargjet mësohen e mbahen mend lehtë për një kohë të gjatë. Janë vargje të gëzueshme siç është dhe botë e tyre. Është e thjeshtë por njëkohësisht dhe e vështirë që të godasësh tekat e fëmijëve me pambuk. E ka filluar punën me titujt e vjershave humoristike: "*Leci dhe klloçka*", "*Qeshi gjeli ki, ki , ki...*", "*A e dini ç'ngjau*?", "*Ç'më ndodhi me një shkronjë*", "*Çupa që hante me naze*", "*Sikur të gënjenim të gjithë si ti*", "*Ku ta gjej daullen gjyshi?*!", "*Hunda dhe shamia,* etj, etj...

Në vargjet e vjershës "*Hunda dhe shamia*", nëpërmjet një kujtimi nga fëminia, poeti shpalos botën fëminore dhe psikologjinë e saj duke përcjellë edhe vlerat edukative:

Kur ishim të vegjël,
Një shoku im,
Mëngjes për mëngjes
Harronte shaminë.

Sa herë kollitej
Apo tështinte,
Me mëngë të xhaketës,
Turinjtë i fshinte.

Një ditë në klasë
Mësuesja e pa
Dhe buzagaz
E qetë i tha:

Ç'paske bërë kështu,
More djalë i mbarë,
Shaminë e ke lënë,
Hundën e ke marrë.

Po harrove prapë,
Të marrësh shami,
Shkule edhe hundën,
Lëre në shtëpi!...

Që nga ajo ditë,
Ndodhi një çudi:
Dhe pse kish një hundë,
Merrte dy shami![184]

Vjersha humoristike "*Ku ta gjejë daullen gjyshi*?!", bën fjalë për një djalë tekanjoz e që ia mbath nga tryeza e bukës, e ndjekin mamaja dhe gjyshja me pjatë në dorë nëpër kuzhinë e në ballkon...

[184] Po aty, f. 45

Kini parë a s'kini parë,
Në pallat kemi një djalë.

Prindërit halli i ka zënë,
Se bën naze në të ngrënë.

Në kuzhinë e në ballkon
E ndjekin me pjatë në dorë.

- *Qejfin mamit mos ia prish,*
Ha t'u bëfsha një thelë mish!

- *Unë s'e ha thelën e mishit,*
po s'i ra daulles gjyshi!

Skuqet gjyshi, kokën tund,
Merr legenin, një bastun.

Që t'i bëhet qejfi Benit,
I bie gjyshi...legenit!

Pra autori ka ndërtuar një situatë plot me humor, ku gjetja nga autori është pikërisht një tekë e fëmijës për të ngrënë. Autori nuk u bën moral lexuesve. Ose më mirë të themi: u bën moral, por pa rënë në moralizim. Vjersha nuk godet vetëm fëmijët si Beni, por edhe disa prej mamave të cilat u plotësojnë tekat dhe i vështirësojnë më shumë situatat. Dhe këtu del në pah një cilësi tjetër e krijimeve të poetit: ato veprojnë në të dyja krahët: për fëmijët tekanjosë, si dhe për të rriturit, të afërmit e tyre. Autori e shpreh edhe vetë këtë gjë: *Kam pasë dëshirë që këto krijime, sigurisht po t' u pëlqenin, t'i lexonin në radhë të parë prindëri*t...[185]

Në krijimtarinë e vetë poetike për fëmijë poeti Tasim Gjokutaj përherë bëri përpjekje për të hyrë sa më thellë në botën poetike të të vegjëlve, në natyrën dhe shpirtin e tyre gazmor. Shpesh vargjet e tij poetike duken një bashkëbisedim me fëmijët. Kështu ndodh dhe me vargjet e vjershës "*Ç'më ndodhi me nje shkonjë*", ku poeti duke shfrytëzuar elementët artistik të këngës-lojë, ndërton një poezi humoristike me detaje të fuqishme poetike:

Me rrëmujë detyrat
I bëri Besniku,
La fletoren hapur,
Dhe në lojë iku.

E mora fletore,
Bobo, ç'të lexoj,
Në çdo fjalë të shkruar
Mungon nga një shkronjë.

Për një d-ë

[185] Po aty, f. 5

Që ti s'e vë,
Fjala derë
Bëhet erë
Dhe shtëpia
Ngel pa derë...

Për një m-ë
Që ti s'e vë,
Fjala mik
Bëhet ik...

(Ç'bën kështu,
More Besnik,
A i thuhet
Mikut ik?!)

Sytë e Nikut
Mbushen lotë...
Do të flasë,
Por çfarë të thotë?!

Poeti Tasim Gjokutaj ka lëvruar me sukses, në disa nga librat e tij dhe poemën-përrallë, një zhanër mjaft i preferuar nga fëmijët e vegjël. Përmendim këtu: "*Do ndërtojmë hidroçentral*", "*Dhelpra dhe Baloshi*", "*Derrkuci që bëri...dush*", "*Keci që s'bëri detyrat*", "*Keci me katër këpucë*", "*Obob, i ziu ç'bëra*", "*Vët kopan*", etj. Në to trajtohen motive e subjekte mjaft interesante nga jeta e fëmijëve dhe bota e kafshëve. Ato janë thurur me shije e mjeshtëri artistike përmes vargjeve të goditura, me një gjuhë të thjeshtë e fjalor të pasur, si dhe me shume figura letrare dhe personazhe të njohur për botën e tyre. Përcillen mesazhe që i ndihmojnë të vegjlit për të fisnikëruar shpirtin e tyre.

Kështu përmendim përrallën në vargje "*Vajza që u bë bletë*", poeti ka shfrytëzuar subjektin e një legjende të Labërisë, ku vizatohen portretet e nënës, tri vajzave të saj dhe lajmëtarit. Krahas sakrificës së nënës për të rritur e martuar vajzat, nëpërmjet dialogëve poetikë zbërthehen edhe karakteret e tyre, si dhe ndjenja e dashurisë deri në vetmohim.

Përralla në vargje "*Derrkuci që bëri...dush"* trajton me humor temën e pastërtisë për prashkollorët. Problemi është shoqëror, por i transplatuar në botën e kafshëve. Autori ka bërë gjetje të bukur përsa i përket personazhit tonë, Derrkucit, të cilin ditën e parë të shkollës mama Dosa e vesh të pastër e të bukur dhe e dërgon në shkollë, po ai zhgërryhet e llangoset në pellgun me llucë.

Ish dikur
E ish njëherë
Një Derrkuc,
Një Dosë,
Një Derr.

Ky Derrkuci
Na u rrit,
Ndaj i blenë
Prindërit një ditë:
Një kalem,
Një Abetare,
Fletore
Të reja fare,
Çantë, kostum,
Këpucë, këmishë...
(Lum Derrkuci që i kish!)

Çdo gjë gati ia kanë marrë,
Se do shkojë
Në klasë të parë.
Pra, fëmijë, përralla jonë
Zuri fill më një shtator.

Ec e ec,
Shoku Derrkuc,
Na shikon
Një pellg me llucë.

Nuk mendohet,
Hiç s'e zgjat,
Me gjithë çantë
Këlltumb në baltë.

Tra, la, la
E tri, li, li...
Se sa ndenji,
Nuk e di.

Për ta larë Derrkucin vihet elefanti, i cili vepron sipas natyrës së vet: me hundën e gjatë thith ujë dhe e vërvit furishëm. Poemën e bën të këndshme sidomos humori. Gjatë leximit të poemës argëtohesh me situatat që krijohen, të paptriturat apo befasia që përdor autori. Në poemë vihet re dhe përdorimi i onomatopesë, figurë mjaft i pëlqyeshëm nga fëmijët. Përmendim këtu: *çu-çu-çu e çi-çi-çi, këlltumb në baltë, pllaq e plluq, gër-gër bëri stomaku, dup-dup-dup kalon në fshat,* etj.

Ndërsa në përrallën "*Keci që s'bëri detyrat*", Tasim Gjokutaj synon të edukojë tek të vegjlit vullnetin, por edhe dashurinë për prindërit, mësimet, si dhe sinqeritetin. Subjekti i kësaj përralle në vergje i përshtatet veçorive psikologjike të fëmijëve. Me një realizëm të thellë, autori përshkruan prapësitë e fëmijëve në sytë e të vegjëlve.

Poema humoristike "*Kush e hëngri akulloren*", që i jep edhe titullin përmbledhjes, përshkrohet në mënyrë artistike nga humori dhe dashuria e arushit për nënën e tij. Arushi shkon në ëmbëltoren e pyllit dhe blen dy akullore: për vete dhe për mamanë.

Na ish në pyll
Një ëmbëltore,
Bënte shurup
Dhe akullore
Me manaferra,
Me copa bore;
...Eh, sa të mira!...
Të gjithë që vinin,
Buzët lëpinin...

- *Teta, m'i jepni*
Ju kësaj radhe
Një kaq të vogël,
Një kaaaaaaq të madhe!

Dhe arushi e pret mamanë ne dritare me akulloren që ia ka marrë. Veç, duke pritur, e zë gjumi nën rrezet e ngrohta të diellit dhe ëndërron...

Më tej humorin e sjell befasia, e papritura: kaushi është bosh! Së fundi, humori rrjedh nga naiviteti i Arushit të vogël, i cili nuk e kupton se kush e ka ngrënë akulloren.

Dhe, autori përdor mbylljen enigmë për të gjetur fajtorin, e vë lexuesin në mendime.

Xhaxhi dielli,
Që nga qielli,
Buzëqesh,
Na e bën me sy...
Mos di gjë
Për akulloren?
Ndoshta edhe di...

Autori duket sikur po bashkëbisedon me fëmijët dhe nën petkun e Arushit ka kërkuar mendimin e tyre se ç'të bëjë me akulloren ngaqë mami është në punë:

Hë, fëmijë, thoni,
Ç'të bëj më?

Si më thatë,
"Haje vetë"?!
Kjo s'më duket
Hiç e drejtë.

Në poemë vëmë re përdorimin me mjeshtëri të thurjes së vargjeve nga ana e autorit. Ato rrjedhin si një muzikë e bukur nga rimat e theksat e rregullt ritmikë. Për ta shkathtësuar veprimin, për ta bërë më dinamik atë, autori e thyen shpesh vargun tetërrokësh, madje edhe e kombinon me gjashtërrokshin.

Në krijimet e autorit zënë vend edhe vjershat me karakter zbavitës apo, siç i quajmë shpesh, "gjëegjëza", nëpërmjet të cilave autori synon që, krahas emocioneve e kënaqësive estetike që u përcjell fëmijëve, të nxitë e të zhvillojë fantazinë e imagjinatën e tyre, si dhe t'u zgjojë interesin dhe kërshërinë.

Krijimi poetik "*Kush e hëngri akulloren*" i poetit Tasim Gjokutaj hyn ndër veprat më të mira të poemës sonë për fëmijë.

Krijimtaria poetike për fëmijë e Tasim Gjokutajt është shquar për ndërtimin e fabulave dhe gjetjeve interesante, për humorin e hollë e shpotitës, për vargun melodioz, për mbështetjen në gurrën popullore të trevave të Jugut, për komunikim të lirshëm e bashkëbisedim të ngrohtë e të drejtpërdrejtë me fëmijët.

5.12 Astrit Bishqemi – studiuesi, romancieri dhe prozatori fantastiko-shkencor

1. Me të vërtetë të entuziazmon krijimtaria letrare e shkencore e pedagogut, studiuesit dhe shkrimtarit Astrit Bishqemi[186]. Autor i një sërë librash (10 romane, 11

[186] Astrit BISHQEMI u lind në Elbasan më 1943. Pas shkollës së mesme pedagogjike, vazhdoi për matematikë-fizikë në Institutin Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës dhe mandej studimet e larta për gjuhë e letërsi në qytetin e lindjes. Në Universitetin e Tiranës mbrojti doktoraturën me temë "Teoria dhe historia e letërsisë për fëmijë e të rinj". Ka shërbyer arsimtar në shkolla të ndryshme tetëvjeçare e të mesme të rrethit të vet, në Librazhd, në Peqin e në Elbasan dhe redaktor i gazetës lokale "Shkumbini". Që nga viti 1981 (fillimisht pedagog i jashtëm, më tej efektiv), jep leksionet e lëndës së letërsisë për fëmijë në Universitetin "A. Xhuvani" - Elbasan. Është autor e bashkautor në disa tekste të shkollës nëntëvjeçare dhe të lartë. Mban titujt Mësues i Merituar dhe Profesor i Asociuar. Në qershor 2009, nga Ministria e Kulturës dhe Sektori Shqiptar i IBBY-t u nderua me çmimin e karrierës "Orët" për "punë të përkushtuar në studimin e letërsisë shqipe për fëmijë dhe si krijues i afirmuar".
Vjershën e parë e botoi te "Fatosi" më 1959; më tej iu përkushtua tërësisht krijimtarisë letrare për fëmijë, duke publikuar:
I. Novela:
- Gjoksshkëmbi (fantastiko-shkencore) – NAIM FRASHËRI, T.1972
- Tregim për nënën trimëreshë – NAIM FRASHËRI, T.1974
- Përtej oborrit diellor (fantastiko-shkencore) – NAIM FRASHËRI, T.1978
- Partizani fotograf – NAIM FRASHËRI, T.1980
- Një verë plot ngjarje – NAIM FRASHËRI, T.1981
- Kur çelnin livarëzat e arrës – NAIM FRASHËRI, T.1984
- Epitafi dinak – gazeta FJALA E LIRË, Elb.1994
- Burgu i qelqtë - ONUFRI, Elb.1995
- Doriu i luftërave - ONUFRI, Elb.1996
- Zezona e qumështit - SEJKO, Elb.1996
- Për një gotë çaj - SEJKO, Elb.2004

II. Vëllime me tregime e përralla:
- Detyra – NAIM FRASHËRI, T.1974
- Çelësi i depos – NAIM FRASHËRI, T.1976
- Gëzofi i Tokës (fantastiko-shkencore) – NAIM FRASHËRI, T.1977
- Kallëzimet e kokërrzave të breshërit (tregim shkencor) – NAIM FRASHËRI, T.1978
- Fidani i dardhës – NAIM FRASHËRI, T.1978
- Drugdhendësi i vogël – NAIM FRASHËRI, T.1978

novela, 21 vëllime me tregime e përralla, si dhe disa shqipërime librash për fëmijë nga italishtja e frëngjishtja) spikat për një punë të jashtëzakonshme.

Qysh në librin e parë " *Gjoksshkëmbi*", një novelë fantastike tepër interesante e ngjizur edhe me material shkencor, autori shfaq prirjet e tij për zhanrin fantastiko-shkencor, që do të bëhet fusha më e parapëlqyer e tij, duke na dhuruar krijime në

- Libri i grisur – NAIM FRASHËRI, T.1984
- Trimëria – NAIM FRASHËRI, T.1985
- Dhëmbët e ujkut – SEJKO, Elb.1996
- Kur nisa rrugën e shkrimeve – ONUFRI, T.1997
- Thesi i gjallë – TOENA, T.1998
- Gjyshër e nipër - SEJKO, Elb.2001
- Si ia hodhëm kompjuterit - SEJKO, Elb.2002
- Papuçe për princ Pison - SEJKO, Elb.2003
- Shtëpiza ime (përralla e kallëzime diturake) - SILVER, Elb.2003
- Maçoku me celular (Një pëllëmbë me përralla) – ERIK, T.2004
- Kallëzimet e Kaltrit - SEJKO, Elb.2006
- Mali i Vashës – JONALDA, T.2012
- Djali i zgjuar dhe vajza e bukur - RAMA GRAF, Elb. 2013
- Përralla elbasani 1 – JONALDA, T.2013
- Përralla elbasani 2 - RAMA GRAF, Elb. 2013

III. Romane:

- Me vështrimin lart – NAIM FRASHËRI, T.1986
- Udhëtim i jashtëzakonshëm (fantastiko-shkencor) – NAIM FRASHËRI, T.1987
- Zemër, o bir! - FLESH, T.2000
- Fustanet e dallëndysheve - SEJKO, Elb.2003
- Kronikë me tank - SEJKO, Elb.2004
- Klik: Rrapatushët 1 (Rrapatushë prej allçini dhe prej së vërteti) - EXTRA, T.2007
- Klik: Rrapatushët 2 (Endje nëpër botë) - EXTRA, T.2007
- Klik: Rrapatushët 3 (Hidhemi në të shtatën) - EXTRA, T.2007
- Klik: Rrapatushët 4 (Fillime dhe... maja) - EXTRA, T.2007
- Si u rrit një poet – SILVER, ELB. 2011

IV. Përkthime (nga gjuhët italiane e franceze), përshtatje etj.:

- Ali Baba dhe dyzet hajdutët (ritregim) - ONUFRI, Elb.1993
- Xhani Rodari: Pinoku dinak – KRISTOFORIDHI, Elb.[1993]
- Xhani Rodari: Xhelsominoja në vendin e gënjeshtarëve(roman) - SEJKO, Elb.2002
- Leit Sauervein: Indiani i vogël Hyshte - SEJKO, Elb.[2002]
- Zhak Deval: Misteri i Oqeanorit - SEJKO, Elb.[2002]
- Marie- Helene Deval: Fëmija egërsirë - SEJKO, Elb.[2002]
- Maria Markone: Anija kozmike e Alekut (roman) - SILVER, Elb.2003
- Daniel Defo: Robinsoni (përkthyer nga Lumo Skëndo, sjellë në gjuhën e sotme) – SEJKO, Elb.2005
- Zhyl Vern: Aventurat e kapiten Haterasit (përshtatur për fëmijë) – DY LINDJE..., Elb. 2007
- Xhonatan Suift: Udhëtimet e Guliverit (përshtatur për fëmijë) – DY LINDJE..., T.2007

V. Studime në fushën e letërsisë për fëmijë:

- Gazmore 300 e ca... buzëqeshje sa? - TOENA, T.1996
- Nga ditari i një shkrimtari për fëmijë - SEJKO, Elb.2005
- Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë - SEJKO, Elb.1997 (e ripunuar: SEJKO, Elb.2004)
- Eja, ta lexojmë bashkë një vjershë! (komentar) – "ELBASANI 2000", T.1998
- Letërsia botërore për fëmijë - SILVER ,Elb.1999 (e ripunuar: SEJKO, Elb.2006)
- Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë - SEJKO, Elb.2001 (e ripunuar: DY LINDJE…, T.2008)
- Vlera të anatemuara… (Gjurmime e studime) – SEJKO, Elb.2005
- Autorë e tekste letrare, probleme e vlera… – SEJKO, Elb.2007
- Autorë të letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj (lexikon) – DY LINDJE..., T.2009
- Tragave te letersise...(Gjurmime e studime) - RAMA GRAF, Elbasan, 2011

zhanre të ndryshme, si: tregime, përralla, novela e romane. Kjo krijimtari që ka ngjallur mjaft interes tek lexuesit e vegjël për vlerat që ka.

Në novelën fantastiko-shkencore "*Përtej oborrit diellor"*, autori të dhënat shkencore i ka organizuar bukur në një fabul tërheqëse. Megjithatë, duhet të theksojmë se edhe saktësia shkencore në dhënien e njohurive, si dhe në përshkrimin e fakteve dhe fenomeneve nga fusha të ndryshme të shkencave të natyrës, përbëjnë meritë për autorin.

Çfarë vëmë re tjetër në krijimtarinë e autorit përsa i përket stilit, gjuhës, temave që trajton, vlerave artistike duke iu përshtatur moshave që u adresohet?

Tema e fenomeneve natyrore, që i ndeshim në jetën e përditshme, i drejtohet një lexuesi pak më të vogël, atij të shkollës sonë fillore; temë të tillë ka për shembull tregimi shkencor "*Kallëzimet e kokërave të breshërit"* (1978). Në atë krijim hidhet dritë mbi dukurinë e qarkullimit të ujit në natyrë. Mëson se si formohet vesa, bryma, mjegulla, reja, shiu, dëbora, breshëri, ylberi, nga se shkaktohet bubullima. Shkrimtari ka treguar artistikisht për qarkullimin e ujit në natyrë, për gjendjet e ndryshme të tij (të ngurtë, të lëngët, të gaztë), për rëndësinë që ka uji për jetën e bimëve, të kafshëve, të njerëzve dhe të gjithë organizmave të tjera të gjalla.

Vlerë në këtë krijim ka gjuha me të cilën komunikon me lexuesin e gjerë. Figurative dhe e thjeshtë për t'u kuptuar. Subjekti i krijimeve vjen natyrshëm e krejtësisht i besueshem, plot lëng jetësor.

Nga gjinitë e shkutëra të zhanrit artistik fantastiko-shkencor, me kohë, falë përvojës që fitoi, autori u hodh edhe në gjini më të gjata, në atë të novelës e të romanit fantastiko-shkencor. Në romanin "*Udhëtim i jashtëzakonshëm*", botuar në 1987, autori tenton të trajtojë një temë paksa ireale. Shpikja dhe lëvizja nën koren e tokës së një automjeti, i cili udhëton nëpër galerinë që hap vetë me mjete tepër të sofistikuara e që njerëzimi ende nuk i njeh, është vënë në qendër të këtij libri. Autori përveç njohurive gjeodezike, na shpjegon e na hap horizonte edhe për ndërtimin e automjeteve të tillë të fuqishme që mund të marrin përsipër operacione të tilla. Fabula e romanit është e shkathët, plot aksion e befasi, me fantazi të ndezur.

Edhe këtu, merita e parë e romanit është informacioni i pasur shkencor, i cili jepet si pakuptuar, nëpërmjet narracionit artistik. Shkrimtari, me një logjikë të besueshme, arrin të krijojë para lexuesit imazhe të bukura e plot kërshëri shkencore.

Meritë e dytë e romanit mendojmë se qëndron në dhënien e disa karaktereve njerëzorë të apasionuar me shkencën, e këtyre njerëzve të guximshëm, vullnetfortë, të sakrificës, të papërkulshëm. Dhe të gjitha këto janë shumë frymëzuese për brezin e ri, u edukojnë lexuesve fëmijë dashurinë për shkencën dhe cilësi të tjera admiruese të karakterit të tyre, që është në formim e sipër.

Përsa i përket gjuhës së përdorur në këtë roman bie në sy thjeshtësia, dialogët e shkathët e plot ngarkesë emocionale. Edhe emrat e personazheve janë të gjetur. Kjo bën që libri të lexohet me ëndje nga të gjithë grupmoshat.

Romani " *Udhëtim i jashtëzakonshëm*" i botuar në fund të viteve '80, është vlerësuar nga kritika letrare e asaj kohe dhe ka njohur disa ribotime. Gjithë këta elemente: gërshetimi i logjikes dhe saktësisë shkencore, të së tashmes me të ardhmen, reales me fantastiken, paralelizmi midis relitetit konkret e atij fantastiko-shkencor, të gjitha këto krijojnë momente artistike tërheqëse që të emocionojnë dhe, pa dyshim, që mbeten gjatë në kujtesën e lexuesit. Pra, përveç vlerave njohëse shkencore, romani ka

edhe vlera edukative, edukon tek fëmijët pasionin për shkencën dhe teknikën, guximin, dashurinë, nxit fantazinë e mendimit shkencor dhe zgjeron horizontin.

2.

Veçanti e autorit Astrit Bishqemi përsa i përket spektrit tematik e motivor është jeta e fëmijëve, loja dhe ëndrrat e tyre, bota e pasur e faunës dhe florës, atdheu dhe puna për ndërtimin e tij, peizazhet e bukura plot jetë të natyrës.

Novela satirike "*Burgu i qelqtë"* është ngritur mbi një gjetje artistike origjinale, mbi një fakt tepër të thjeshtë e interesant. Në novelë ka mjaft situata komike, që e zbavisin lexuesin dhe e bëjnë të qeshë. Gjithashtu, novela shquhet për fabulën dinamike, gjuhën artistike, për aksionin e dialogun e shkathët.

Autori ka ditur t'i përshtatet mirë psikologjisë së fëmijëve duke u mbështetur tek humori që, siç na mëson edhe psikologjia, është kërkesë e domosdoshme e botës së të vegjëlve. Kështu në librin me tregime "*Thesi i gjallë",* disi i veçantë në llojin e vet, pasi në të autori ka përmbledhur tregime që janë ndërtuar mbi fakte reale nga jeta e njerëzve të shquar të shkencës, artit ekulturës, të huaj e vendës, që nga lashtësia e deri në ditët tona. Libri është tërheqës e interesant. Duke dhënë me art copa jete njerëzish të shquar, autori na ka pasqyruar jo vetëm pasionin e pakufishëm të këtyre njerëzve për shkencën e kulturën, vullnetin e hekurt për punë, po edhe botën e tyre shpirtërore, të pasur e humane. Të gjitha tregimet janë shkruar me ndjenjë, me fjalor e figuracion të pasur, ndaj vëllimi lexohet me endje jo vetëm nga të vegjëlit, po edhe nga të rriturit. "*Thesi i gjallë"* është cilësuar *libri më i mirë në prozë* për vitin '98 në konkursin e shpallur nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë.

Duke qenë një krijues ambicioz, autori na ka dhënë edhe një vepër model të karakterit epistolar. E kemi fjalën për romanin "*Klik: Rrapatushët*", që bazohet mbi letërkëmbimet, nëpërmjet e-maileve, këtij elementi tejet bashkëkohor. Ai roman më së shumti u ngjan ca veprave të letërsisë botërore me autorë të njohur si Azis Nesini e ndonjë tjetër, por në vetvete ajo vepër mbetet origjinale dhe risuese. Romani mbart jo vetëm realizëm por edhe vërtetësi jetësore.

"*Klik: Rrapatushët*" është një simfoni me fjalë dhe brenda kësaj simfonie derdhen mesazhe të mëdha, lehtësisht të kuptueshme, që kanë të bëjnë me probleme aktuale e universale, si dashuria për atdheun, për njerëzit, për kafshët e shpendët, për ruajtjen e gjuhës si shprehje e identitetit, për parapëlqimin e së bukurës kudo ku ajo shpërfaqet, për dashurinë dhe zgjerimin e horizontit të dijeve, duke përdorur jo vetëm librin, rrëfimet e ndryshme, por edhe burime të tjera si kompjuteri.

Romani "*Klik: Rrapatushët*" përveç origjinalitetit në kompozicion, shquhet edhe për gjuhë e leksik të pasur, që janë karakteristike për Astrit Bishqemin (kujtojmë këtu përdorimin e dialektalizmave të qëmtuara nga autori si një vjelës i kujdesshëm te tregimi për Kostandin Kristoforidhin që përfshihet në atë roman). Fjalitë që përdor autori janë të shkurtra, të ngjeshura, dinamike e rrjedhëse. Kompozitat e fjalëve përdoren me shumë sukses. Stili i këtij romani është i veçantë, në dallim me romanet e tjerë të tij, çka përbën padyshim një vlerë stilistike të shkrimtarit.

3.

Shkrimtari dhe studiuesi Astrit Bishqemi ka dhënë një ndihmesë të çmueshme edhe në fushën e studimeve të letërsisë për fëmijë. Le të ndalemi kalimthi në disa nga këto vepra studimore.

Së pari, përmendim tekstin *"Hyrje në teorinë e letërsise për fëmijë"* (Tiranë, 1997; e ripunuar ne 2004). Me këtë studim serioz autori hyn me kompetencë në sekretet e krijimtarisë për fëmijë, gjë që përbën një ndihmë shumë të rëndësishme në teorinë e kësaj letërsie.

Por "bibla" e këtij studiuesi mendojmë se është teksti "*Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj*" (Tiranë, 2001, 2004, e ripunuar 2008), e cila është bërë tanimë pronë e studentëve, e pedagogëve dhe e shkrimtarëve të letërsisë për fëmijë. Kjo vepër mendojmë që është rezultat i një pune të gjatë hulumtuese. Studiuesi nga Kosova, Dr. Xhevat Syla, e vlerëson "*Një studim voluminoz me vlerë*". Ndërsa Prof. Dr. Klara Kodra vlerëson: *"Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj" e studiuesit Astrit Bishqemi, përbën një hap jo të vogël përpara për afirmimin e kësaj dege të rëndësishme të letërsisë shqiptare me një dinjitet të barabartë artistik me letërsinë për të rritur, për t'i dhënë kësaj Hirusheje të letërsisë shqiptare vendin e saj të merituar si princeshë në krah të motrës së vet të madhe, letërsisë për të rritur.*

Astrit Bishqemi aty shtron edhe problemin e periodizimit të kësaj letërsie. Edhe pse ai e merr atë si problem të hapur, në studimin e tij mbështetet në periodizimin që ka bërë akademiku Bedri Dedja, të cilin ai e konsideron më të plotë dhe shkencërisht më të argumentuar. Mbi këtë bazë (duke bërë edhe ndërhyrje të veta), autori e koncepton shtrirjen e kësaj letërsie në katër periudha e kaptina kryesore:

1) Burimet e letërsisë shqiptare për fëmijë, folklori për të vegjlit;
2) Letërsia e shkruar didaktike-fetare për fëmijë;
3) Letërsia e shkruar artistike për fëmijë në filllimet e saj;
4) Letërsia moderne shqiptare për fëmijë.

Gjithashtu, në këtë vepër nga autori janë bërë përpjekje për unifikimin e letërsisë për fëmijë që krijohet brenda kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë me letërsinë shqipe për fëmijë të krijuar në trojet e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi e në Diasporë.

Në këtë vëllim është bërë gërshetimi sipas dy kritereve: a) mbi bazën e kapitujve gjinorë – tematikë; b) mbi bazën e kapitujve monografikë të autorëve të shquar.

Për secilën gjini është dhënë një përshkrim i shkurtër, si dhe janë renditur disa arritje, të meta e dobësi.

Në këtë tekst është bërë nje seleksionim e një përzgjedhje e veprave të shkruara në periudha të ndryshme kohore. Është patur parasysh karakteri rivlerësues për disa autorë e vepra të shkruara gjatë kohës së Monizmit. Janë paraqitur dhe janë marrë në analizë ato vepra që i mbijetuan kohës dhe janë çmuar për vlerat e tyre të mirëfillta letrare. Libri përmbyllet me shtojcën ku jepen të dhënat për autorët dhe veprat e vlerësuara në konkurset kombëtare, me bibliografinë dhe me treguesin alfabetik të bibliografisë së autorëve.

Studimet e Prof. Bishqemit vazhdojnë me tekstin universitar *"Historia e letërsisë botërore për fëmijë"*, 1999 (i ripunuar: 2006), i pari libër i botuar te ne në përmasa kaq të gjera për letërsinë botërore për fëmijë, si dhe botimin në vitin 2009 të fjalorit enciklopedik *"Autorë të letërsisë shqiptare për fëmijë dhe të rinj*"(1886-2009).

Profesor Astriti, një studies kaq këmbëgulës, me vullnet punon dhe na sjell studime të tjera me vlerë. Kështu përmendimme librin me gjurmime e studime në fushën e letërsisë për fëmijë me titull "*Vlera të anatemuara"* . Siç e thekson dhe vetë autori në parafjalën e këtij vëllimi, aty janë përmbledhur disa gjurmime e studime, kryesisht rreth letërsisë për fëmijë e të rinj, por edhe më gjerë, duke përfshirë artikuj rreth disa autorëve dhe përkthyesve të anatemuar e të përndjekur prej sistemit monist,

vlera këto që i kanë munguar letërsisë sonë për fëmijë. Autori i ka vendosur sipas kriterit kronologjik të botimit të tyre studimet e përmbledhura në këtë antologji. Në këtë vëllim ka studime për figura poetësh e shkrimtarësh të persekutuar nga regjimi komunist, si monografia *"Herezia artistike e poetit Genc Leka"* apo "*Një dorëshkrim i harruar"*, monografi për përkthyesin Osman Bishqemi dhe poezitë e Hajnes të përkthyera prej tij. Studimi "*Pionierja e përpunimit artistik të folklorit për fëmijë"* bën fjalë për Musine Kokalarin, kurse *"Ndihmesa e Sulejman Harrit në letërsinë didaktike për fëmijë"* është një monografi për Mësuesin e Popullit Sulë Harri. Rezultat hulumtimesh të pasionuara janë edhe studime të tilla, si: *"Kur fliste shqip Robinson Kruzo", "Receptimi ne shqip i romanit "Zemer" te Edmond de Amiçis", "Ferenc Molnar: Djemte e rruges Pal", "Perrallat e Engleskës*" etj.

Një punë tjetër studimore voluminoze dhe serioze paraqitet dhe në leksikonin "*Autorë të letërsisë shqipare për fëmije dhe të rinj"* (1886 - 2009), i cili përmban rreth 830 autorë librash artistikë për fëmijë që nga viti 1886 gjer në vitin 2009. Në hyrje të këtij fjalori autori përcakton edhe përparësitë e leksikonit, ku rëndësi marrin:

- botimi i librave për fëmijë dhe të rinj për çdo autor, duke lënë jashtë botimet për të rriturit;
- pasurimi i leksikonit me shkrimtarët e anatemuar nga Monizmi të cilët nuk janë përmendur në asnjërin prej leksikoneve të mëparshme;
- ndihmesa që kanë dhënë shkrimtarët në pasurimin e bibliotekës së lexuesve të moshave të reja me shqipërime nga letërsia botërore për fëmijë e të rinj;
- për çdo libër është shënuar në kllapa edhe zhanri letrar të cilit i përket: vjersha, poema, përralla, tregime, novelë, roman, pjesë teatrore etj,;
- veç zhanrit dhe vitit të botimit, shënohet edhe shtëpia botuese dhe qytetin ku ndodhet ajo;
- veç autorëve për fëmijë, në leksikon janë përfshirë edhe studiuesit kryesorë të kësaj fushe;
- në këtë leksikon rëndësi të veçantë i është kushtuar botimit të parë të secilës vepër, vitit kur libri artistik ka parë dritën e botimit dhe ka qarkulluar. Këtu është patur kujdes edhe në ribotimet e përpunuara, ato me titull të ndryshuar, qofshin këto të bëra nga e njëjta shtëpi botuese ose nga një tjetër.

Ky leksikon sot përmbledh një informacion të pasur e të gjerë, pra ka karakter informues dhe u vjen në ndihmë mësuesve të ciklit të ulët dhe atyre të letërsisë të arsimit bazë e të mesëm, studentëve, studiuesve të letërsisë për fëmijë e të rinj, shkrimtarëve e më gjerë.

Së fundi, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe vëllimin tjetër "*Tragave të letërsisë"* të studiuesit në fjalë, ku janë përmbledhur disa gjurmime e studime në fushën e letërsisë për fëmijë e më gjerë. Shkrimtari dhe studiuesi për fëmijë Astrit Bishqemi aty na tregon edhe njëherë se si krijues, i është dashur që t'i njohë kolegët e tij të penës, të hulumtojë rreth jetes dhe krijimtarisë së tyre, botimeve në prozë apo në poezi qofshin ato, dhe këtë ai e ka arritur me një vullnet dhe disiplinë të fortë.

Duke përfunduar themi se shkrimtari dhe studiuesi Astrit Bishqemi ka dhënë një ndihmesë të veçantë për letërsinë shqipe për fëmijë dhe të rinj, si me vepra letrare, ashtu dhe me vepra studimore e kritike, të cilat u vijnë në ndihmë nxënësve, studentëve, mësuesve, pedagogëve dhe studiuesve të ardhshëm të letërsisë sonë për

fëmijë. Numri kaq i madh i titujve të librave, por edhe vëllimi e cilësia e tyre, flasin më së miri për përkushtimin e devotshëm kësaj fushe të krijimtarisë letrare.

5.13 Xhahid Bushati – liriku i fëmijëve

Në letërsinë e sotme për fëmijë e të rinj, krijimtaria letrare e shkrimtarit Xhahid Bushatit zë një vend të rëndësishëm, sepse u përgjigjet kërkesave dhe psikologjisë së fëmijëve. Ai ka lëvruar me sukses disa gjini letrare për fëmijë, duke botuar shumë libra në prozë e poezi për të vegjlit[187].

Në fillim ai është shfaqur si prozator në vitin 1976 me librin e parë "*Dita e parë e dëborës"* (skica e tregime). Më tej do të prezantohet edhe si poet me vëllimet poetike "*Kush e zgjoi këngën e zogut"* dhe "*Kush t'i solli yjet, hënën?"*.

Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe gjininë shumë të pëlqyeshme të këtij krijuesi, përrallën, të cilën e ka trajtuar jo vetëm në prozë, por edhe në poezi. Është një autor që ka punuar shumë vite mësues dhe si rrjedhojë i ka njohur më nga afër fëmijët, botën, ëndrrat, dëshirat e tyre. Kjo i ka dhënë dorë shkrimtarit të trajtojë tema të ndryshme, të prekshme për ta, t'iu përgjigjet disa kërkesave të tyre.

Krijimtaria e Xhahid Bushatit për të vegjlit, e frymëzuar nga motive dhe subjekte interesante, i japin asaj origjinalitetin dhe freskinë e nevojshme. Përmendim këtu vëllimin e parë të tij me poezi "*Hyni në çadrën time"*. Në të trajtohen tema të larmishme: për kafshët, për punën, për prindërit, për luftën. Janë poezi që lidhen me lodrat e fëmijëve dhe që të ngacmojnë fantazinë. Për shembull, te vjersha që i jep

---

[187] U lind në Shkodër më 17 maj 1953, ku kreu edhe shkollën tetëvjeçare, të mesmen industriale dhe në vitin 1976 mbaroi studimet e larta në Universitetin "Luigj Gurakuqi", në fakultetin gjuhë shqipe-letërsi. Punoi ca kohë mësues në fshatra. Punon në Radio-Shkodra, gazetar në emisionet artistike, gjithashtu ka dhënë leksionet e letërsisë për fëmijë si pedagog i jashtëm në Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës.

Dita e parë e dëborës (skica e tregime, 1976)
Hyni në çadrën time, (vjersha, 1978)
Kush i hengri manaferrat (përralla, 1986)
Ndihmojeni Arushin e vogël (përrallë me figura për fëmijët e kopshteve, 1986)
Kush e zgjoi këngën e zogut? (vjersha, 1987)
Kush t'i solli yjet, hënën? (vjersha,1989)
Përralla e babit tim (përralla,, 1994)
Historitë e arushit, ketrushit dhe xixëllonjës së vogël (përralla në vargje, 1995)
Djali i vogël sa një kokërr arre (përralla sipas motiveve popullore, 1996)
Historia e kallzës së vogël flokartë (novelë-përrallë, 1996)
Loti i pyllit (përralla, 1997)
Shshshsh.., se zogjtë po bëjnë gjumë, (vjersha, 2008)
Dredhia e gjinkallës, (përralla, 2000)
Maço, Maçoku mbeti gojëhapurt, (përralla, 2001)
Historia e tre pëllumbave, (tregime, 2002)
Porosia e Diellit, (vjersha, 2003)
Gabimi i Diellit, (përralla, 2004)
Historia e zogut Verdho, (përrallë në vargje, 2006)
Çuditë e rrezes lodërtare **(**Vjersha, 2007
Si u bë fole kapelja e gjyshit (vjersha, 2008)
Historia e Gjëmbit dhe e Gjëmbaçit, (përralla, 2008)
Plaku,zogu dhe bastuni, (poemë, 2010)
Katër pyetje Erës**...** Poezi, 2010

titullin librit, vlerësohet ndjenja e solidaritetit dhe e ndihmës për shoku-shokun. Këtë veçori artistike e shikon jo vetëm në vargje apo krijime të veçanta, por në tërë krijimtarinë e këtij poeti.

Në disa poezi, shkrimtari trajton me kujdes dhe temën për kafshët e pyllit, për të cilat fëmija ka kërshëri të madhe. E veçanta e këtij autori është se me pak vargje, përcjell dhe moralin:

Një ari, një ari,
do të laget nëpër shi.
Por ka pylli miq të mirë,
shihni ketrin sa vrapon.
-Ju u lagët, xhaxhi Ari!
-Dhe me çadër e mbulon.

Apo në vjershat e tjera si "*Shshsht, se zogjtë po bëjnë gjumë!":*

Hënëverdhëza la shtëpinë,
tani pyll:- Natën e mirë!
Vetë nëna rri këndon:
- *Fli, o bir, ti, fli, o bir!*

Veç dy gjethe bisedojnë,
Fësh, fësh, fësh po bëjnë zhurmë,
i dëgjon dhe u thotë Hëna:
- *Shshsht, se zogjtë po bëjnë gjumë!*

Apo në vjershën tjetër "*Në liqen rri pa orar"*:

Dielli ecte dalëngadalë,
ish i lodhur, gjumë i vinte,
me një rosë fort u çudit
nga liqeni pse nuk ikte.

- *Kaloi ora, - foli Dielli,-*
Shko moj rosë, shko në shtëpi,
nuk harroj, prapë do të zgjoj
të vish nesër përsëri…

- *Mak- mak- mak, - u përgjigj rosa,-*
Diell, o diell rrezear,
Nga mëngjësi gjer në mbrëmje
Në liqen rri pa orar...

Gjithashtu autori përdor me shkathtësi lloje të ndryshme vargjesh. Jo vetëm 8-rrokëshin si në vjershat e mësipërme, po edhe 6- rrokëshin. Ja vjersha *Era lotët ia pushon*, e ndërtuar me këtë masë:

Ylli, ende fle,
Hënën, e zu gjumi...

Reja nis e qan,
sepse ngjyrën humbi...

-Mos qaj!- i tha era
(vu-vu, buçet fort).
Lotët ia ndalon
Edhe e bën zog...

Janë vargje lodruese, argëtuese dhe me rimë të zgjedhur. Po me këtë masë ndërtohet vjersha *"O yll":*

-O yll! – i tha zogu.
Pse nuk vjen në pyll?
Ndrit edhe shëtit,
Pyllin e bën dritë!

-Zog, do vij në pyll,
Por nuk mund të fle,
Çerdhen lart në qiell
S'e ndërroj me asgjë…

Apo vjersha tjetër *"O zog"!*

-O zog! – i tha ylli.
Fli xhan, mos më prit,
Qiellit udhëtoj,
Natës i fal dritë!

Kur ti zgjohesh, zog,
Unë atëherë fle,
Por ti fluturo,
Më gjen te një re.

Kësisoj, vargjet e këtij poeti dallohen për stilin e veçantë, për shprehjet me gjuhë të bukur letrare, tërë ngjyrime poetike e fjalor të pasur, të cilat kanë bërë që këto krijime te jenë mjaft tërheqëse, emocionale dhe mbresëlënëse te lexuesit e vegjël.

Veçoritë artistike të poezisë së Xhahid Bushatit shpërfaqen natyrshëm edhe në disa përralla në vargje. Kështu, në një vjershë, autori krijon një bisedë që zhvillohet nëpërmjet voglushit me hënën, me yjet, me diellin, apo trajton miqësinë e fëmijës me zogun:

1. - Hënëz, a po vjen?
- Qielli vetëm s'rri.
Vogëlushi i mirë
Syçkat mbyll dhe fli!

2. - Diell, o rrezear,
Lart në qiell ku rri,
Lodërza ke vallë,

Me shokë luan ti?

3. Eri shkon në shkollë
Plot gaz e dëshirë,
Pas e ndjek një zog
Si një mik mirë.

Në këto vjersha duket sikur autori po lodron me fëmijët. Në raste të tjera, ai kallëzon shtruar, në vetë të tretë:

Kur pylli e udhët
Janë në errësirë,
Nga shtëpia del
Xixëllonjë e mirë…

Si yll i ngjan natës,
si një ëndërr ngjan,
bredh në hapësira,
në shpirt dritën mban...
(Ku e mban dritën xixëllonja?)

Po kështu dhe kur fëmijët gëzojnë kur bie bora e parë. Ja si e shpreh autori gëzimin e tyre *Bie, bie borë e parë/ flokë-flokë dalngadalë/Zbardhon pemë, zbardhon çati/ rrugë, oborre dhe shtëpi. Pa përtuar përmbi mure/ bën vargmale pa mbarim/ në kuzhinë portokalli/ i gëzuar krahët shtrin*.

Studiuesi Xhevat Syla ka theksuar *se shkrimtari Xhahid Bushati është një rrëfimtar i mrekullueshëm i përrallave, duke e ndierë të gjallë në shpirt çdo gjë me krijimin e tij*[188].

Por në përgjithësi përrallat e tij kanë vlera edukative dhe njohëse. Ato u hapin horizont lexuesve të vegjël, duke i çuar jashtë në natyrë, në mes të kafshëve, shpendëve e insekteve, që janë qëniet më të dashura për ta[189].

Si në përralla, ashtu dhe në poezi poeti kujdeset për vargun që ai të mos jetë i thatë, po të ketë veshje artistike, të jetë i shkurtër, të ketë rimë, ritëm e muzikalitet. Në vargjet e tij përgjithësisht përdor gjashtërrokshin, edhe ndonjë varg tjetër më të shkurtër. Këto janë vargje që pëlqehen nga lexuesi i vogël, janë vargje lodruese, që mësohen lehtë përmendsh.

Le të ndalemi tek disa nga të veçantat ose karakteristikat e përrallave që autori e parapëlqen.

Poeti synon që në krijimete tij të përcjelli informacion në mënyrë të kujdesshëm, duke iu përgjigjur moshës. Ky është një element mjaft i rëndësishëm në përrallat e autorit duke i bërë të pëlqyeshme si me fabulën tërheqëse ashtu dhe me gjuhën lodruese e fëminore. Kështu për shembull ngjet në përmbledhjen me përralla "*Përrallat e babit tim*" (1994), që u drejtohet lexuesve të moshës së ulët shkollore, voglushëve 6-9 vjeç, krijime këto që janë shumë të rëndësishme dhe të përshtatshme për këtë moshë. Element tjetër mjaft i rëndësishëm në përrallat e autorit është skalitja e personazheve, të botës njerëzore por edhe nga ajo shtazore, e kafshëve dhe e

[188] Xhevat Syla, "Kuvendim poetik", Prishtinë, 2010, f. 316
[189] Astrit Bishqemi, "Histori e Letërsisë Shqiptare për Fëmijë" Elbasan, 2004, f. 687

shpenëve. Kështu ndodh për shembull, te përralla *Guri i çmuar, Pepushi dhe verdhushi, Këmbëngulja e zogut të vogël* etj.

Sikundër në vjershat, edhe në përralla, veçori është konçiziteti. Në pak vargje autori mundohet të japë gjithçka, pra nuk zgjatet shumë, nuk e lodh fëmijën. Cilësi tjetër është mbështetja në gjuhën e gjallë të vogëlushëve.

Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe librin me përralla (në prozë) *Maço Maçoku mbeti gojëhapur*, botuar në vitin 2001. Janë gjithsej nëntë përralla. Që na befasojnë me aftësinë dhe zotësinë profesionale të autorit në kultivimin e kësaj gjinie sa të lashtë, aq dhe të pranishme në krijimet e shkrimtarëve për fëmijë[190].

Ngjarjet e këtyre përrallave janë marrë nga jeta e kafshëve dhe e shpendëve me personazhe të shumta, botë kjo e dashur për fëmijët. Autori të magjeps me bëmat dhe aventurat e çuditshme të personazheve të tij simpatikë, me skenat intriguese që improvizon me to, me dialogët dhe të folurën e tyre karakteristike. Fëmijët mrekullohen me rrëfimin, fabulën, emrat e personazheve, që bëhen kaq të dashura për ta. Ata lumturohen kur dëgjojnë në këto përralla të flasin kafshët nën tinguj onomatopeikë: Ki-ri-ki – në e lafshëkuqit Gjel Kokoshi dhe ko-ko-ko – në e Cikaleshës pulë trimoshe; kri-kri – në e ketrushit; ia-ia-ai –në e kërriçit Qamo; ciu-ciu- në e dallëndyshes sqepverdhë Semi; mjau-mjau – në e Maço Maçokut që luajnë e argëtohen pa fund. Intersant është figura e Maçokut te *Maço Maçoku mbeti gojëhapur*: "*Shikonte i habitur zogjtë që tashmë ishin rritur dhe fluturonin lart në qiellin e kaltër. Zbriti nga pema dhe hyri përsëri në shtëpi. Kësaj here i lodhur, i mërzitur e i uritur më shumë se kurrë. Në sytë e tij të blertë, edhe ajo shpresë dinake e shumëpritur nuk jetonte më, ishte shuar përgjithnjë"*. Pra, përralla flet për një ngjarje të caktuar, ashtu si do të mund të ketë ndodhur por vlerësimin, në janë veprime të mira apo të këqija, e rrjedhimisht edhe mësimet që dalin nga ato, mbetet ta nxjerrë vetë lexuesi.

Nëpër rreshtat e librit vërejmë që autori ka individualizuar me mjeshtëri dhe vërtetësi çdo personazh, duke i veshur artistikisht me epitete, metafora e figura të tjera letrare: *Gojën e kishte si lule, kurse shtatin lis të njomë*. Pastaj krahasimin: *zemra i rrihte si këngë bilbili e si këngë dallëndysheje*, apo me metaforat- *kodrina syblertë, yjet syzjarrtë* etj. Në këtë mënyrë, ai ia ka arritur të krijojë më së miri portretin e tyre fizik dhe atë moral. Ndaj përrallat e Xhahid Bushatit lexohen dhe dëgjohen me ëndje. Ato i bën të tilla gjuha e pastër, e qartë dhe me figuracion të pasur e të zgjedhur.

Struktura dhe forma artistike e krijimeve të Xhahidit, si në poezi, ashtu edhe në prozë, i shëmbëllejnë një arkitekture letrare karakteristike për stilin dhe individualitetin artistik të autorit, ku elementët e tyre gërshetohen e shkrihen më së miri me përmbajtjen, tamam si instrumentet muzikore të një orkestre të akorduar mirë, duke na dhënë një "sinfoni" me mjaft muzikalitet[191].

[190] Milaim Nelaj, "Profile letrare" (studime), Tiranë, 2008, f. 142
[191] Milaim Nelaj, "Profile letrare" (studime), Tiranë, 2008, f. 143

5.14 Ferit Lamaj - fabulisti konçiz e tërë humor për fëmijë

Më ka rrëmbyer fabula që herët. Humbisja pas Ezopit e Fedrit, La Fontenit e Krillovit, Triluses, Naimit, Santorit e Çajupit. Fabula është magjike. Të ngjizet në shpirt. Të pushton. Të josh me përjetësine e saj.
(Autori)

Ferit Lamaj[192] spikat si një autor origjinal dhe i suksesshëm ndër fabulistët shqiptarë.

Duke lexuar fabulat e tij ndjen një kënaqësi estetike, vë buzën në gaz nga rrëkëzat e humorit, ironisë dhe sarkazmës për shumë gjëra, që na bëjnë të qeshim e të

[192] U lind në Korçë më 6 janar 1955. Kreu studimet e larta për gjuhë-letërsi shqipe në Tiranë. Lamaj është një nga fabulistët më të mirë shqiptarë.
Disa nga titujt e librave:
Në verë dhe në dimër (1977)
Zemërqeshur (1981)
Lepuri që bën shaka (1985)
Kush e hëngri mjaltin (1988)
Gjelkokoshi zgjon derrkucin (1989)
Bilbili dhe gjinkalla (1990)
Fabula (1992)
Mjau, mjau! (1994)
Ham, ham! (1994)
Ki, ki, ki! (1995)
201 fabula (1995)
Dhelpra doganiere (1995)
Ka, ka, ka! (1996)
Mak, mak! (1996)
Dhelpra e Trojës (1996)
Kafshët flasin (1997)
Bubi, beci dhe kaleci (1997)
Viçi dhe kërrici (1998)
Ngriva, shkriva (1998)
1111 fabula (1999)
Papagalli pinguin (2000)
Derri, derri… (2000)
201 Kryefabula (2000)
Derri me tri këmbë (2001)
Fabula erotike (2002)
Gërvisht e gërvisht (2003)
Mikrofabula (2004)
Lakuriqi lakuriq (2005)
Fabula të zgjedhura (2005)
Miss Dhia (2005)
Dhelpra e Trojës (2006)
Mbreti xhuxh (2007)
Dhelpra e Trojës (2008)
Dhelpra dhe fiqtë (2008)
Derri me tri këmbë (2008)
Mjeshtër Pinoku (2008)
Dhelpra e Trojës (2009)
Gici dhe polici (2009)
Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi (2010)

argëtohemi, veçori kjo që e bën autorin të dashur jo vetëm për të vegjëlit, por edhe për ne të rriturit.

Me letërsi ai nisi të merrej qysh kur ishte nxënës në shkollën e mesme dhe krijimet e para në fushën e humorit e të satirës dhe të letërsisë për fëmijë i botoi në gazetat e revistat e kohës.

Për fëmijë ka botuar disa libra poetikë, si: *Tosi me fustan* (poemë humoristike), *Gjelkokoshi zgjon derrkucin* (fabula), *Teli dembeli* (poemë humoristike)...etj.

Fabulat e tij janë plot me të papritura e paradokse, të shkruara shkathët e natyrshëm. Ato shquhen nga konçiziteti dhe mençuria e batutave, duke iu larguar moralizimit të hapur e banal, nga i cili ndonjëherë vuajnë edhe fabulistët e shquar. *Ndër to, nuk mund të mos vësh re edhe frymën popullore dhe kombëtare të përrallave e rrëfimeve të popullit tonë, përmes personazhit - kafshë. Jo vetëm kaq. Në fabulat e Ferit Lamajt ndihet edhe kultura, edhe ajo esencë që është përftuar e nxjerrë qysh nga Ezopi e La Fonteni, Krillovi e Trilusa dhe deri te autorët bashkëkohës*[193]. Sigurisht duke iu kthyer historisë së fabulës shqiptare, natyrshëm është vënë re edhe ndikimi i hershëm në të nga fabulistët më me emër të kohërave. Fabula që vinte e krijuar ose e përshtatur nga Naimi, Çajupi, Ndre Mjeda etj, fabula që në traditën e të cilëve u zhvillua nga Nonda Bulka, Spiro Çomorra e ndonjë tjetër. Dhe fabula, ajo vjershë e shkurtër epiko-lirike ose me karakter alegorik e satirik tashmë duket disi e rrallë në krahasim me lëvrimin e poezisë në përgjithësi. Këtë ndikim e shohim dhe tek Ferit Lamaj, i cili është përkushtuar tërësisht fabulës, me seriozitetin e një krijuesi që ka pretendime ndaj vetes dhe ndaj krijuesit. Nisur nga sa më sipër, me të drejtë Odhise Grillo vlerëson, se "*Ferit Lamaj është Ezopi i fabulës së sotme shqiptare...*"[194]

Tek fabulat e tij vihet re një punë e kujdesshme si në sasi ashtu dhe në cilësi. Kështu, në vitin 1995 fabulat i përmblodhi në një vëllim më vete, të cilën e titulloi *201 fabula*. Në vitin pasues numri i këtyre fabulave gati u trefishua (arriti në 555) në vëllimin *Dhelpra e Trojës*, kurse në vitin 1999 numri dyfishohet rishtazi dhe botohet në titullin *1111 fabula*. Në vitin 2007 numri i fabulave të këtij autori përsëri njeh një dyfishim tjetër, duke arritur shifrën 2500.

Tiparet artistike të ravijëzuara në përmbledhjet e para tani kanë marrë formë të plotë në krijimtarinë e shkrimtarit, dhe këtu mendojmë se qëndron veçoria dalluese dhe suksesi i tij duke na sjellë fabula cilësore që përcjellin mesazhe të vërteta filozofike dhe që shquhen për lakonizmin e mençurinë sarkastike, për konçizitetin dhe artin befasues.

Cilat janë disa nga veçoritë e fabulave për fëmijë të këtij autori?

Fabulisti Ferit Lamaj i ka për zemër fëmijët. Këtë gjë e ka treguar me fabulat e tij kushtuar fëmijëve duke i pasqyruar mjaft mirë me rolin e tij si baba, shok, shkencëtar me zgjidhjet e situatave duke e ndihmuar lexuesin me informacione te shumta, me batuta përmbyllëse që të befasojnë dhe të bëjnë të buzëqeshësh, të mendohesh dhe në fund të argëtohesh.

[193] Ferit Lamaj, "Dhelpra e Trojës", parathënia e Dritëro Agollit, Tiranë, 1996, f. 3
[194] Po aty, pasthënia e Odhise Grillo,"Ezopi shqiptar", f. 32

Ndalemi tek përmbledhja me fabula "*Dhelpra e Trojës*", ku Ferit Lamaj, ashtu si në gjithë krijimtarinë e vet, edhe në këtë libër trajton tema korente dhe përcjell mesazhe që zbulojnë aspekte e probleme të jetës së përditshme. Krahas stigmatizimit të kotësisë e mendjemadhësisë, si dhe veseve të tjera qesharake të jetës, fabulat e këtij vëllimi rrahin probleme të "ngjërimit" politik, të trajtuara përmes metaforave dhe analogjive të spikatura. Përmendim këtu fabulat: "*Vilat", "Arushi, mizat dhe maçoku", "Dy kotelet dhe lapsi"," Iriqi dhe kërmilli"*, etj.

Në përgjithësi në fabulat e tij kafshët kanë funksione në lidhje me njerëzit. Në të morali dhe satira zënë vendin kryesor. Kështu në fabulat: "*Dora dhe këmba"*, "*Dora dhe barku"*, autori shpreh qartë gjendjen ekonomike të vendit tonë. Autori ka vënë në lojë pushtetin:

Keni parë, s'keni parë,
Në rrugicë e trotuar
Dora zgjatet, lyp lëmoshë.
Eh, të rrosh a të mos rrosh!

Po shfryn barku: - S'të vjen zor,
Ngele lypëse, moj e gjorë?!

Ia vesh dora sy ndër sy:
- Lyp për vete, lyp për ty...[195]
(Dora dhe barku)

Qahej dora: - Ç'm'u desh mua
Të bëj nder e të jap hua!
Po ti, këmbë, ç'më rri, ç'pret,
Mos pandeh, borxhi vjen vetë?!

Ia kthen këmba: - Dreq o punë,
Ti e jep e...ta marr unë![196]
(Dora dhe këmba)

Apo në fabulën tjetër "*Dhelpra, ariu dhe arixhiu"*, autori me anë të personifikimit të kafshëve jep realitetin shqiptar. Sot disa njerëz me pushtet pasurohen në kurrizin e njerëzve të thjeshtë.

Tej, në shesh kërcen ariu
Lidhur pas një arixhiu.

Pa ç'u mblodhën kafshë, shpesë;
Kush pak qumësht, kush një vezë...

Arixhiut trastat dëng,
Prej gëzimit merr një këngë.

[195] Ferit Lamaj, "Dhelpra e Trojës", UEGEN, 2005, f. 11
[196] Po aty, f. 14

Ja, dhe dhelpra bishtin loz:
- Kush kërcen, kush bëhet...Bos!

Ndërsa në fabulën tjetër "*Ariu dhe Dhelpra*", autori fikson këto kafshë, ariun, dhelprën, kërriçin, gomarin për të realizuar qëllimin e tij goditës.

-E pandehur, të kanë parë
Drejt kotecit duke ngarë,
Një kërriç e një gomar.
Me një fjalë, dy dëshmitarë...
Çdo na thuash më në fund.

-S'e mohoj, është e vërtetë
Që më panë ata dy vetë.
Mirëpo unë, po më latë,
Do t'ju sjell mu në gjykatë
Nja dyqind që s'më kanë parë...
Apo jo, zoti gjyqtar?![197]

Kështu, në fabulën *Dhelpra e Trojës*, autori si një mjeshtër i fjalës, vargun fabulesk e përcjell me anë të personazhit-kafshë, në rastin tonë të dhelprës, që simbolizon dinakërinë – veçori karakteristike e njerëzve servilë, dinakë, që bëjnë çdo gjë për t'ia arritur qëllimin.

Një ditë kali takon dhelprën:
- Rroftë e qoftë dinakëria!
Me dredhira e shtyn jetën,
Për këtë flet lashtësia.

Ia pret dhelpra: - Pa kyç gojën,
Kur përmend kohën e vjetër.
Kafsha që mashtroi Trojën
Ishte kalë, s'ishte dhelpër!

- Eh, vërtet ishte një kalë,
Që trojanët i gënjeu.
Porse ky a s'kishte dalë
Nga një dhelpër, Odiseu?![198]
(Dhelpra e Trojës)

Fabulat e tij kanë gjallëri. Tematika dhe problematika në këto fabula janë dukuritë më themelore të jetës politike shoqërore. Subjektin e fabulave ia frymëzon koha që po

[197] Ferit Lamaj, "Dhelpra e Trojës", UEGEN, 2005, f. 2
[198] Po aty, f. 20

kalojmë, pabesia, tradhëtia, vuajtja, mizëria dhe dashuria. Fabula e Feritit është magjike dhe është e shkruar për të gjitha moshat, e gërshetuar me humorin e hollë dhe elegant.

Libri tjetër me përralla për fëmijë "*Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi"* (2010) është një përmbledhje me 162 fabula interesante. Në këtë libër gjallojnë personazhe, si dhelpra, bretkosa, nëpërka, mushkonja, miza, morri, etj., që tashmë jemi mësuar t'i shohim në krijimtarinë e autorit, botë faunike që pëlqehen shumë nga fëmijët.

Te Ferit Lamaj gjen vëzhguesin e thellë e kërkues; tematikën e larmishme e të mprehtë. *Autori të befason me kapjen dhe shtruarjen drejt e me sens humoristik e satirik të temave të larmishme e të mprehta të shoqërisë sonë demokratike, po edhe të temave të së shkuarës e të së ardhmes*[199]. Këto tema fabulisti Ferit Lamaj i jep me satirë e humor të hollë e domethënës nëpërmjet gjetjeve interesante e kuptimplotë. Përmendim këtu fabulën *Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi*;

Gjysh Ezopi përsëri
E gjen dhelprën nën hardhi,
Teksa zgjatej pak nga pak
Për një vesh, për një bistak.

Flet Ezopi: - Ke një jetë,
Kot sfilitesh, moj e shkretë!

Këtë herë dhelpra "hop"
Seç kërcen përmbi Ezop,
(kish në gjak dinakërinë),
S'voli një, por krejt hardhinë...[200]

Kur e lexon fabulën argëtohesh me personazhin e dhelprës, gjetje kjo interesante nga ana e autorit. Lexuesi e njeh dhe e ka dëgjuar dhe më parë këtë personazh,e njohur për bëmat e saj çudibërëse, me lajkat dhe dinakërinë e saj për të arritur qëllimin, ndaj autori e thekson: (kish në gjak dinakërinë), s'voli një, por krejt hardhinë.

Fabulisti Ferit Lamaj di ku thumbon, ku gudulis e ku qëllon fuqishëm. Ja si shprehet autori në fabulat e tij:

Bleta mjaltë shet në treg,
Kilogrami një mijë lekë.

-Çmim i thekur! – llap një derr,-
Ma jep qumësht këtë herë...[201]

(Qumësht blete)

Ose:

Na fut hundët ku të mundë:
Mu në sy, në vesh, në hund..[202].

(Mushkonja)

[199] Astrit Bishqemi, "Histori e letërsise shqiptare për fëmijë e të rinj", Elbasan, 2008, f. 638
[200] Ferit Lamaj, "Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi", Tiranë, 2010, f. 2
[201] Ferit Lamaj, "Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi", Tiranë, 2010, f. 38
[202] Po aty, f. 6

Ose:

Elefanti te një shpellë
Noçkën shtriu, tutje thellë.

-Ç'torrollak, - tha një gamile,-
Shet fildish e blen...fosile![203]

(Speleolog elefanti)

Apo në fabulën tjetër:

Peshkaqeni është në rrjet,
Jo me grep, u dashka rrjetë...[204]

(Mafia)

Ferit Lamaj në fabulat e veta nuk qëllon me top mushkonjën e me saçme elefantin, por bën të kundërtën. Se ai është aq konçiz në krijimet e veta, të cilat kanë pak vargje e shumë kuptim, sa habitesh. Në fabulat e tij nanurit ritmi e rimat, muzikaliteti e përdorimi mjeshtëror e i larmishëm i vargut, strofës, etj. Mes fabulave të Lamajt fshihen e fshikullohen dallkaukët e servilët, rrufjanët e maskarenjtë e kësaj kohe të trazuar e të tejmbushur me strese. Kështu, shumicën e fabulave të veta e ndërton me pak vargje: 4,6,8,12. Ja si e damkos ai servilin me mjeshtëri të lartë në katër vargje:

Që prej shekujsh rron e thëna:
"Qengji i urtë pi dy nëna",
Por nuk dini më të renë:
"Pi servili gjithë kopenë!"[205]

(Një thënie e re)

Ferit Lamaj shquhet për mençurinë, veçanërisht në batutat përmbyllëse, që janë kurora e fabulës. Në fabulën *Lëngu i mishit* autori të befason me batutat që krijohen midis dialogut të lugës dhe lëngut:

I tha luga: - More lëng,
Kot së koti mos shit mend!

Lëngu s'foli llafe boshe:
- Jam lëng mishi, jo lëng groshe...[206]

Fabulisti Ferit Lamaj është padyshim zëri më virtuoz i fabulës shqipe. Siç e vlerëson akademiku Bedri Dedja, *është privilegj për letërsine e sotme shqiptare dhe, sidomos atë për fëmijë, që i ka ardhur një talent i fuqishëm, Ferit Lamaj. Ta transplatosh realitetin e jetës në art me figura përrallore duhet mjeshtëri e rrallë dhe këtë mjeshtëri fabulisti Lamaj, si një filozof i kohës, e zotëron më së miri*[207].

[203] Po aty, f. 36
[204] Po aty, f. 29
[205] Ferit Lamaj, "Mikrofabula", Tiranë, 2003, f. 5
[206] Ferit Lamaj, "Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi", Tiranë, 2010, f. 57
[207] Bedri Dedja, vlerësim për fabulistin Ferit Lamaj

5.15 Shkrimtari Viktor Canosinaj[208] -Një zë i veçantë në prozën për fëmijë dhe të rinj

Është një shkrimtar që ka lëvruar në gjininë e prozës dhe kryesisht në prozën e gjatë. Romanet për fëmijë dhe të rinj i përkasin moshave 9 -16 vjeç dhe kanë tematikë të gjerë e problematikë të larmishme përsa u përket temave bashkëkohore. Këto tema e probleme që bëhen lëndë edhe për romanet e tij, autori mundohet t'i vështrojë e t'i trajtojë me syrin e fëmijëve dhe të të rinjve. Është një shkrimtar që duhet përgëzuar sa për romanet e shumtë që u ka dhuruar lexuesve fëmijë, aq dhe për cilësinë e krijimit.

Kështu "***Biri i erës***", i llojit fantazi dhe aventurë, është libër që ka pasur sukses dhe vazhdon të mbetet një ndër më të lexuar të autorit. Romani shtjellon fatin e një kali të rritur në liri, që bie rob te njerëzit, të cilët e shesin dhe e shfrytëzojnë gjatë gjithë jetës, për punë dhe për luftë. Kali njeh mizoritë njerëzore, sidomos ato të luftës. Ëndrra e madhe e lirisë e çon kalin me emrin Biri i Erës drejt arratisë bashkë me shokët e një cirku shetitës, ku ai punonte prej disa vjetësh. Mesazhi që përçon te lexuesi ky roman është i qartë: Çdokush duhet të luftojë në jetë për të qenë i lirë. Ja një fragment i librit: *Diku, patjeter do te gjendet nje vend i lire, mendoi Biri i Eres duke marre rrugen per t'u kthyer te shoket e cirkut. Edhe po nuk u gjet, ne do te luftojme perseri per lirine tone, deri ne frymen e fundit. Erdhem te lire ne kete bote dhe te lire duhet te vdesim...*[209]

Ndërsa romani "***Ata kërkonin lumturinë***", është i llojit të problemeve shoqërore, i gërshetuar me aventurë. U botua në vitin 1997 dhe pati një sukses të menjëhershëm. Ai ka njohur disa ribotime nëpër vite dhe mbetet një nga romanet më të lexuar të autorit Viktor Canosinaj.

Është historia e një grupi fëmijësh shqiptarë që ikin në Itali fshehurazi, në kërkim të një jete më të mirë dhe atje ndeshen me një sërë ngjarjesh që as nuk i kishin çuar nëpër mend, si shfrytëzimi i fëmijëve për lypje dhe prostitucion, trafikimi i tyre etj. Miqësia e ngushtë me njëri-tjetrin bën që ata të mbeten të bashkuar dhe në fund të vendosin për t'u kthyer përsëri në shtëpi.

Nuk mund të lëmë pa përmendur romanin aq të dashur për fëmijë dhe të rinj sot "***Meriyll***". U botua në vitin 2000. Roman i llojit të problemeve shoqërore. Që në rreshtat e parë ndeshemi me Meriyllin, e cila qëndron e ulur pranë nënës së saj të

---

[208] Shkrimtari Viktor Canosinaj lindi në vitin 1960 në Durrës. Fëmijërinë dhe rininë i kaloi në qytetin e Durrësit. Pas studimeve universitare ne Gjuhë - Letërsi, punoi mësues letërsie, gazetar dhe përkthyes. Në vitet '70 publikonte poezi dhe vjersha të shkurtra. Ndërsa në fillim të viteve '80 botoi librin e tij të parë për fëmijë, duke ndjekur me botimin e tij të parë për të rritur në vitin 1989. Viktor Canosinaj e nisi aktivitetin letrar në moshë të re, duke botuar vjersha e tregime. Libri i tij i parë, një novelë për fëmijë, u botua në vitin 1981. Në vitin 1984 u pasua nga një roman me temë historike po për fëmijë. Pas një ndërprerjeje prej disa vitesh, Viktor Canosinaj i rikthehet përsëri letërsisë, kryesisht në romanin për të rritur dhe për fëmijë. Ai boton disa romane për të rritur dhe rreth 20 libra për fëmijë e të rinj, duke u bërë brenda pak viteve një nga autorët më të lexuar në vend. Tani drejton shtëpinë botuese "*Dyrrah*". Viktor Canosinaj është gjithashtu autor i studimit " *Nga Liza te Harri Poteri*", kushtuar letërsisë për fëmijë. Ai ka përkthyer nga anglishtja dhe italishtja letërsi për fëmijë dhe të rritur. Ndërsa për fëmijë e të rinj ka përshtatur romanin "*Don Kishoti i Mançës*". Po ashtu, shkrimtarin e ndeshim hera-herës edhe si përkthyes: përmendim këtu shqipërime (nga anglishtja): nga autori Juri Orlev: *Egërsia nën krevatin tim* (roman1998), nga Elvin B. Uajt: *Mrekullia e Sharlotës* [roman i përshtatur 2007], nga Xhon Raskin: Mbreti i lumit të artë – 2007, nga Lyman Frank Baum: *Magjistari i Ozit* – 2007, nga Ferenc Molnar: *Ushtari i lavdishëm Nemeçek* – 2008, ("Djemtë e rrugës Pal", përkthim nga italishtja).

[209] Viktor, Canosinaj, "Biri i erës", Tiranë, 2006, f. 107

sëmurë. Romani fillon me ngjarjen e dhimbshme të vdekjes së nëns së Meriyllit. Fatkeqësia që godet Meriyllin të bën të ndjesh dhembushuri për këtë personazh. Meriyll është vetëm 13 vjeçe dhe supet e saj të brishtë do të duhet të mbajnë peshën e humbjes së njeriut më të shtrenjtë, nënës, pikërisht në momentet kur ajo do të kishte më shumë nevojë për të...

Vajza ende e parritur do të duhet të zbatojë amanetin e nënës, të kujdeset për vëllain dhe motrën e vogël. E sikur të gjitha këto të mos mjaftonin, vuajtjes së saj i shtohet edhe babai, i cili gjen ngushëllimin tek alkoli. Sa shumë durim, forcë dhe besim do t'i duhet Meriyllit t' i kapërcejë të gjitha këto... Duke pasur brenda vetes mirësinë, virtytet edhe njëkohësisht duke qenë e ndihmuar edhe nga miku i saj më mirë, Sidriti, ajo arrin t'i kapërcejë e t'ia dalë mbanë.

Motivi që përshkon këtë roman është sa i dhimbshëm, aq dhe real i jetës së përditshme, sa dinamik aq dhe intrigues për vetë faktin se si rrjedhin dhe zgjidhen ngjarjet. Problemet sociale, shoqërore dhe kurthet që u ngre realiteti adoleshentëve, si shoqëria e keqe, droga, janë pasqyruar e konceptuar më së mirë në roman, duke vënë përballë personazhin e Meriyllit dhe të Sidritit, si një forcë kundërshtuese, si një shembull për t'u ndjekur nga të rinjtë.

Mesazhi që përcjell ky roman është mjaft domethënës dhe me një forcë të madhe jetësore, ku fatkeqësitë, varfëria, kurthet e jetës nuk duhet të mposhtin, por gjithsecili duhet të gjejë forcën brenda shpirtit, brenda vetes, për të dhënë zgjidhje dhe për të gjetur më të mirën.

Në roman çdo personazh është ndërtuar për të përcjellë e realizuar mesazhe dhe elemente jetësore mjaft të rëndësishme për çdo adoleshent.

Personazhi kryesor, Meriyll, është një figurë mjaft e arrirë, tek e cila çdo vajzë adoleshente mund të gjejë veten. Karakteristikat dhe virtytet e saj paraqesin një model i cili duhet të frymëzojë jetën e një adoleshenteje. Sidritit, gjithashtu, është shembull i shpirtit fisnik, një djalë, i cili edhe pse i ka të gjitha nga jeta, nuk ngurron të ndihmojë shoqen e tij duke iu bërë krah në vuajtjet e saj. Përballë këtyre dy personazheve që reflektojnë mirësi kemi Klarën, një personazh negativ, mendjelehtë që joshet nga vogëlsirat pa shpirt, objektet, e nëpërmjet saj autori përcjell anët e errta që mund të paraqiten në jetën e një të riu kur gënjehet lehtë. Dhe që këtej përcillet një mesazh mjaft i rëndësishëm: *Mos kërko të arrish lehtë të mirat e jetës, duke zgjedhur rrugën e gabuar. Ato arrihen veç me punë e mund*. Përballë kësaj vjen i qartë dhe i fortë mesazhi që përçoi Meriyll tek të rinjtë adoleshentë: *Gjej forcën, ki durim, ec drejt në rrugën tënde të jetës, pa hequr vëmendjen nga gjërat që kanë vërtet vlerë në jetë*.

Gjithashtu nëpërmjet figurës së plotësuar të Sidritit, shkrimtari Viktor Canosinaj përcjell mesazhin: *Ji fisnik, shpirtgjerë, edhe pse jeta është treguar e mirë me ty, Jepi dorën atij që ka nevojë për të, Mëso dhe ji i palodhur sepse kështu lehtësohet mendja dhe shpirti*. Në sajë të mbështetjes së Sidit, vajza me emrin Meriyll arrin t'ia dalë mbanë dhe të shpëtojë nga trafikimi.

Në personazhin e gjyshes, përcillet dashuria e dhembshuria e të urtave gjyshe, si një ilaç i pakrahasueshëm në kohën e duhur, për të lehtësuar dhimbjet që jeta të sjell herë pas here.

Me teta Bardhën, shoqen e mamasë së Meriyllit, pasqyrohet dëshira për të ndihmuar. Dora e ngrohtë dhe e butë, e cila të jepet në momentet kur ti ndjen se po fundosesh.

Babai i Meriyllit paraqet tablonë e prindit që humbet rrugën prej dëshpërimit, por e gjen dhe e rimerr përsëri atë, me anë të ndihmës që i jepet nga njerëzit që e duan.

Nëpërmjet këtij personazhi, autori përcjell këtë mesazh: *Mos u mposht prej dëshpërimit, kërko rrugën e duhur dhe luaj rolin që të kërkon jeta*.

Ndërsa babai i Sidritit, na vjen si shëmbëlltyrë e urtësisë, thjeshtësisë, zotësisë, virtyte që e përmbushin portretin e një prindi të dhembsur. E kundërta ndodh me mamanë e Sidritit, ku autori ndalet dhe përcjell këtë mesazh të fuqishëm: *Mirëqënia nuk duhet t'i bëjë njerëzit t'i gjykojnë keq, që nuk janë në një nivel me ta*.

Nëpërmjet figurës së mësueses kujdestare të Merit, paraqitet mësuesja e mirë, e dashur që ka dëshirën t'i mirëkuptojë nxënësit e saj.

Mësuesja i hodhi krahun dhe u mundua ta qetësonte...Kishin rënë shirat e parë të vjeshtës dhe gropat e shumta qenë mbushur me ujë. Nga gërrmimet dhe ndërtimet e reja, asfalti i mbetur pothuaj qe mbuluar nga balta. Megjithatë, ajo rrugë iu duk Merit më e dashur se kurrë. Ishte rruga e shtëpisë.[210]

Përballë figurës së modeluar më së miri të mësuese kujdestare, na paraqitet një portret i vrazhdë, mendjemadh e arrogant, e mësueses së anglishtes, e cila përcillet nëpërmjet rolit të saj, si një demaskim për të gjithë mësuesit e tillë.

Mozaiku i personazheve bën që të ketë dinamikë, larmi dhe elemente jetësorë të pasura. Të gjitha këto bëjnë që lexuesi të vihet përballë karaktereve dhe situatave të ndryshme. Gjuha e përdorur në roman është e thjeshtë, mjaft e qartë për moshën e lexuesit që i dedikohet dhe rrjedh fluide edhe nëpërmjet dialogëve të shumtë midis personazheve, që e bën romanin të këndshëm dhe të realizuar. Dinamika e ndodhive e bën lexuesin të ndihet i tërhequr prej tyre, për të marrë vesh rrjedhën e ngjarjes. Ky roman përcjell vlera njohëse, edukative, udhërrëfyese për moshën e adoleshencës, që është në një fazë kritike të zhvillimit të të rinjve.

Paraqitja reale e ngjarjeve, koherenca e problematikës, dhënia e konfliktit në disa linja: mirëqënia kundrejt varfërisë, rruga e lehtë e gabuar kundrejt rrugës së vështirë, por të ndershme, bëjnë që lexuesi të reflektojë me optimizëm mbi fenomenet jetësore që ndodhin përreth tij.

Një temë tjetër e prekshme në ditët e sotme është edhe trajtimi i problemit tragjik të gjakmarrjes dhe të ngujimit të fëmijëve ne novelen ***Lulet e përgjakura të 7 Marsit***, e botuar në vitin 2001. Në qendër është një djalë 12-vjeçar, i cili detyrohet të ngujohet për shkak të gjakmarrjes, ndërkohë që i ati është larguar drejt Greqisë në emigracion. Gjakmarrësit janë familja e një shoku klase të djalit të ngujuar. Gjakmarrja eshte nje ndër plagët më të hershme të Shqipërisë. Ajo është si një oqean, i cili gllabëron pa mëshirë çdokënd sido-kurdo të lëvizë nëpër të.

Viktor Canosinaj është shkrimtar i periudhës së letërsisë në vitet e tranzicionit, ndaj është e kuptueshme që trajton probleme aktuale të shoqërisë sonë në tranzicion dhe si bosht kryesor ka problemin e edukimit të brezit të ri, probleme të edukimit të fëmijëve në familje, në shkollë e kudo. Kështu ndodh dhe me romanin ***Monstrat e Rrugës së Mimozave***, i cili të tërheq nga titulli misterioz e i frikshëm, por edhe për vlerat që përcjell. Në fakt, shkrimtari nuk na e rrëfen menjëherë fabulën e ngjarjes, por, ka vendosur që ngjarjet të zbulohen përmes veprimit, duke bërë që tensioni i situatave të ndryshme të vijë duke u rritur. E strukturuar si mozaik, pjesët e tregimit zbërthehen përmes personazheve që janë skalituar aq bukur nga shkrimtari, saqë në përshkrimin dhe veprimet e tyre të nxit përfytyrimin ku secili nga fëmijët gjen veten, kuptohet me problemet e moshës. Në qendër të romanit është një fëmijë i zgjuar e

[210] Viktor Canosinaj, "Meriyll", Tiranë, 2006, f. 214

harrakat, pa përkrahje sipas botës dhe mendimit të tij. Njerëzit që e rrethojnë, prindërit, mësuesit, nuk e kuptojnë. Romani nis që në fillim me personazhin Andi Tomorrica, i cili papritur kthehet në një hero të vërtetë. Dhe telashet nuk kanë të sosur: problemet që hasen në familje, komunikimi dhe reagimi i prindërve, situatat e ndryshme, i ashpërsojnë më shumë kontradiktat me Andin.

Autori futet shumë në botën e brendshme të fëmijëve, sidomos të atyre të lënë pas dore nga prindër, të cilët janë të marrosur nga paraja dhe bota materialiste duke harruar gjënë më të shtrenjtë, fëmijët. Janë fëmijë që kanë nevojë për ngrohtësi, mbështetje, komunikim dhe dashuri. Janë fëmijë që kanë nevojë për lojërat dhe çapkënllëqet e tyre. Ky fëmijë, Andi, mbetet i zhgënjyer nga të rriturit që e rrethojnë, i pëlqen bota e tij. *Ai ishte i zhgënjyer nga të rriturit që e rrethonin. Ata nuk e kuptonin. Nxënësi im ishte në kërkim të vetvetes. Ai donte të ishte vetevetja, gjë që për shumë fëmijë shpesh është shumë e vështirë, sidomos në vendin tonë ku prindërve akoma u pëlqen vetëm të japin mend e të urdhërojnë*.[211] Prindërit kishin plane të tjera për djalin e tyre, dëshira që Andi nuk i pëlqente. Është një fëmijë krejt i zakonshëm, 12-vjeçar, nuk do të shtiret e të llastohet nga prindërit. Duan ta bëjnë muzikant, violinçelist. Kjo situatë e bën Andin një fëmijë të mbrapshtë dhe të pasjellshëm në situata të caktuara, por në thelb, është një djalë zemërmirë dhe ka dëshirat e tij. Djalit i pëlqejnë kafshët, qentë, ëndërron të bëhet pilot. Jul Çezari, qeni i tij, ndryshe i thërrisnin Gjeneral, bëhet miku më i mirë i tij.

Romani nxjerr në dritë disa probleme të shoqërisë sonë. Ajo që është më e rëndësishmja dhe që përshkon romanin fund e krye, marrëdhënia prindër-fëmijë. Dhe kjo jo vetëm në familjen e Andit, por edhe në familjen e shoqes së tij moshatare Dea, vajzë "e persekutuar" nga prindërit, të cilët e detyrojnë të mësojë me kurse tri-katër gjuhë njëherësh. Të dy, të mërzitur e në shenjë proteste, ia mbathin nga familjet e tyre për disa ditë, në plazhin e Durrësit. Ndërkohë prindërit shqetësohen. Reagojnë dhe bëhen më të arsyeshëm, i dëgjojnë fëmijët e tyre.

Tensioni i ngjarjes vjen duke u rritur. Situata vështirësohet. Andin e rrëmbejnë kriminelët. Vihet re përpjekja e shokëve të tij Madlit, Deas dhe qenit të tij besnik Gjeneralit, i cili jep dhe jetën për mikun e tij. Rrëmbyesit i kërkojnë para të madhe të atit, Gjergjit. Me ndërhyrjen e policisë dhe me veprimin e vetë fëmijëve, aksioni i tyre dështon. Duket si një skenar filmi, me aksione të njëpasnjshme e që të tërheqin. Stili i shkrimtarit është i shkathët. Mjeshtëria e autorit të bie në sy në disa drejtime. Ligjërimi i romanit bëhet në vetën e tretë, me kapituj që renditen me numra. Kapitulli i parë na përshkruan menjëherë një episod interesant, një aksion që të intrigon, të hedh grepin, të mban të lidhur e të bën të mos e lëshosh më tej librin nga dora. Duke thyer kompozicionin klasik, ekspozicioni jepet në faqen 26, jo në ligjërimin e autorit, por në vetën e parë, nga teto Meli, e punësuara në familjen Tomorica, një person shumë i dashur për Andin (i dukej si gjyshja e tij). Këto ndërkallje të herëpashershme (Tregon teto Meli, tregon Dea, tregon mësuesja e gjuhë-leximit...etj) janë pikërisht gjetje për të na dhënë edhe më mirë, në vetën e parë, përjetimin e çasteve. Por, në roman vihet re dialogu i shkathët dhe një gjuhë e pastër.

Një aspekt i veçantë në roman dhe që zë vend të rëndësishëm është dhe paraqitja dhe pozicionimi në shoqëri i figurës së mësuesit. Në roman, mësuesit e kanë marrë me sy të keq Andin (mësuesja e matematikës, apo ajo e kursit të frëngjishtes të Deas), i

[211] Viktor Canosinaj, "Monstrat e Rrugës së Mimozave", Tiranë, 2006, f. 65

flasin me inat, nganjëherë dhe me përbuzje Këtu autori nxjerr në pah problemet e arsimit dhe gjithë stafit pedagogjik, që të sillen më mirë, më ngrohtë, t'i bëjnë për vete (sepse janë fëmijë), t' i përkrahin dhe t' i kthejnë në rrugë të mbarë e të drejtë.

Shkrimtari prek edhe një temë tjetër, diskriminimin racial, shoku më i mirë i Andit, gabeli Madli. Në fakt, gjuha në roman përdoret edhe si mjet individualizimi i personazheve. Duke e prekur këtë temë, autori i edukon ata me dashurinë për njëri-tjetrin. Në roman vihen re dhe momente të bukura të humorit, situata që krijon Andi si në klasë ashtu dhe në festën e viti të ri, apo në ditëlindjen e Deas. Një vend me rëndësi në roman zë dhe marrëdhënia e Andit me qenin e tij, Gjeneralin. Kafshët janë të dashura, të kënaqin me lojërat e tyre, plotësojnë boshllëqet e fëmijëve, si në rastin tonë të Andit, ndaj prindërit nuk duhet ta shikojnë këtë një marrëdhënie të çuditshme, por t'i inkurajojnë fëmijët e t'i duan dhe ata kafshët. Një moment tjetër i rëndësishëm dhe i prekshëm është dhe marrëdhënia shoqërore që ka Andi me Dean në roman. Prindërit e shohin si një fantazëm, me frikë apo mosbesim këtë lidhje shoqërore. Duket sikur kanë gjetur veten, për shkak dhe të vetë probleme të ngjashme që kanë me familjet e tyre. Por nga ana e autorit, kjo lidhje jepet shumë bukur në botën e fëmijëve, shëtitjet e bukura në rrugën e Mimozave me qentë e tyre, ditëlindja e bukur e Deas, apo dhe momentin kur Dea shkon për të shpëtuar Andin. Mesazhi është i qartë: Fëmijët duhet lënë të lirë, të mos i ndrydhim ndjenjat dhe dëshirat e tyre. Duke lexuar librin, kush nuk do të donte një vëlla, një shok si Andi, kjo është mjeshtëria, thjeshtësia e të shkruarit. *U desh kohë ta njihja. Nuk ishte nga ata fëmijë që janë të lexueshëm që në pamjen e parë, kishte botën e tij, ku, për të hyrë, duhet të zbuloje fillimisht kodin sekret* (f. 64). *Portreti i tij fizik e moral është skalitur nga autori me mjaft dashuri, ngrohtësi e mjeshtëri artistike, duke e bërë atë një personazh të këndshëm e të admirueshëm për fëmijët.*[212] Dhe këtë autori e realizon shumë bukur, duke i lënë personazhet të veprojnë dhe të prezantohen vetë, ndërsa lexuesi e kupton mesazhin dhe reagon vetë.

Romanin e bën më tërheqës edhe Gjenerali, qeni i Andit. Është një gjetje nga ana e autorit, pra "monstra" tjetër dhe kjo duket dhe në përshkrimin që i është bërë: *Gazetari u tërhoq mbrapsht. Kurrë në jetën e tij nuk kishte parë qen të atillë. Ishte një krijesë e rrallë, që kushedi nga duhej të kishte ardhur. Kishte një trup gjigand, gjoks të gjerë, një ngjyrë të zezë në gri, qime të shkurtëra e të rralla si të një qilimi tepër të përdorur. Koka e tij ishte tmerrësisht e madhe. Gjithçka në atë kokë ishte e varur; veshët llapush si degë palme, faqet, mjekra, madje edhe vetullat. Pa folur për turirin dhe gushën, që i binte palë-palë deri në gjoks si gushë elefanti. Goja nuk merrej vesh ku ishte. Dalloheshin vetëm disa dhëmbë të llahtarshëm që dilnin jashtë, ndonëse nofullat ishin të mbyllura si kapakë e një valixheje.*

–Ç'është kjo monstër?! – iu drejtua gazetari shoku të tij (f. 6). Dhe në fund ky "monstër" kthehet në një shpëtimtar: *Arma u ngrit. Gjenerali bëri një hap para, mblodhi të gjitha forcat, lehu njëherë kërcënueshëm, pastaj u lëshua drejt fytyrës së përgjakur të rrëmbyesit. Arma u zbras. Ai ndjeu në gjoks një therje të fortë dhe sytë iu errën. Megjithatë, arriti ta rrëzonte përtokë dhe t'i mbërthente me dhëmbë krahun ku mbante revolen* (f. 152). Nuk ka se si të mos prekesh nga një situatë e tillë, një qen që shpëton të zotin. Sigurisht të bie në sy heroizmi i këtij qeni të çuditshëm, në të cilën autori e përshkruan me një rrëfim fantastik dhe emocionues, duke e bërë të dashur në sytë e në mendjen e fëmijëve.

[212] Milaim Nelaj, "Profile letrare"(Studime), Tiranë, 2008, f. 135

Shkrimtari Viktor Canosinaj ka krijuar tashmë stilin dhe individualitetin e tij krijues me vepra të shumta, të shkruara për fëmijë e të rinj[213]. Për tematikën e larmishme që trajton shkrimtari na shfaqet gjithnjë e më tepër shkrimtar i adoleshencës, për vetë problemet që shfaq kjo moshë delikate dhe që natyrisht është pjesë e shoqërisë. Është një shkrimtar që përcjell vlera artistike, edukative e pedagogjike, duke qenë në qendër të vëmendjes dhe një mesazh i mirë për edukimin, mbështetjen e edukimit të brezit të ri.

5.16 Disa veçori të krijimtarisë për fëmijë të poetit Bardhosh Gaçe

Në letërsinë e sotme shqipe, veçanërisht në atë për fëmijë e të rinj, krijimtaria letrare e shkrimtarit Bardhosh Gaçe zë një vend të rëndësishëm, për vlerat ideoartistike dhe për forcën komunikuese me të vegjlit. Shkrimtarin vlonjat e frymëzon shpirti kombëtar, deti dhe brigjet e Vlorës, fëmijëria e vet, si dhe lodrat e gëzimet e fëmijëve të mbarë Atdheut. Duke i njohur mirë veçoritë e kësaj moshe, autori bën një punë të kujdesshme për t'ia përshtatur brendinë dhe formën e krijimeve të veta kërkesave të të vegjëlve dhe mundësive të tyre njohëse e perceptuese. Një ndër temat që autori parapëlqen është padyshim ajo historike. Autori arrin t'i përjetësojë aq

[213] Përmendim novela, tregime, perralla:
- *Koha na rriti* (novelë) - 1981
- Mikjon (novelë) - 1998
- Lulet e përgjakura të 7 marsit (novelë) - 1998,2001
- *Piratja sybojëqielli (novelë) - 2004*
- *Foleja e madhe (*përralla e tregime*) - 2004*
- *Gjenerali prej bore (*tregime e përralla*) - 2006*
- *Lisi dhe milingona (përrallë e tregime) - 2010*

Romane:
Përmbi dallgë e zjarre -(1984,2004)
Biri i erës - (1996)
Ata kërkonin lumturinë - (1997)
Ikja e pëllumbave - (1998)
Në rruge - (1999)
Lamtumirë, guacka ime! - (1999)
Ëndrra të mëdha - (1999)
Meriyll - (2000)
Të gjithë tulipanët e botës – (2000)
Cirku i heronjve – (2001)
Monstrat e Rrugës së Mimozave - (2002)
Qeni milioner - (2003)
Ëndrrat e anijes me vela - (2004)
Zemra në pëllëmbë të dorës - (2005)
Aventurat në ishullin lundrues - (2006)
Vite blu - (2006)
Thesari - (2007)
Një dashuri sa dy oqeane -(2007)
Bormal – (2009)
Princi diellor – (2009)
Shqipërime (nga anglishtja):
Juri Orlev: *Egërsia nën krevatin tim* (roman) - !998
Elvin B. Uajt: *Mrekullia e Sharlotës* [roman i përshtatur] – 2007
Xhon Raskin: Mbreti i lumit të artë – 2007
Lyman Frank Baum: *Magjistari i Ozit* – 2007
Ferenc Molnar: *Ushtari i lavdishëm Nemeçek* – 2008, ("Djemtë e rrugës Pal", përkthim nga italishtja).

bukur në vjersha datat, vendet historike, dëshmorët tanë. Nga kjo gjë kuptojmë që autorin e frymëzon shpirti kombëtar, ai kërkon t'u mësojë fëmijëve për historinë e kombit tonë e t'i bëjë ata të ndihen krenar që janë shqiptar.

Ndryshe nga autorët e tjerë që në fillim të librit vendosin parathënien, Bardhosh Gaçe ka zgjedhur në vend të saj një vjershë ku në qendër janë fëmijët e xhaxhi poetit.

Lumi im s'fle, është një vëllim me vjershat e tij, ku autori trajton tematika të larmishme. Libri ndahet në katër pjesë:

Ku e ka shqipja folenë, Qyteti i flamurit, Zilja e shkollës dhe Besniku thurr një këngë.

Kësisoj këtu ndërthurren tema e atdhedashurisë, e shkollës, e natyrës, kafshëve, bimëve dhe gjithçka që i rrethon.

Pjesa e parë *Ku e ka shqipja folenë,* përbëhet nga 21 vjersha ku tema që mbizotëron është ajo historike. Autori kërkon t'u përcjellë fëmijëve informacione që kanë lidhje me vendet historike. Ai ka ndërthurrur historinë që nga Ismail Qemali, që i dha pavarësinë Shqipërisë deri tek Naim Frashëri një ndër autorët që ka dhënë një ndihmesë të madhe në letërsinë shqipe. Gjithashtu në këtë pjesë autori i njeh fëmijët me traditat e zakonet shqiptare, me kulturën tonë.

Në pjesën e dytë *Qyteti i flamurit* përfshihen 25 vjersha. Autori gërsheton me mjeshtëri bukurinë dhe historinë e Vlorës. Në qendër të kësaj pjese është tema historike- gjeografike, ku vlerat edukative që transmetohen janë mjaft të dukshme. Në disa vjersha personazhe janë vetë fëmijët. Mesazhi që arrin të transmetojë autori në këtë pjese është i qartë dhe i kuptueshëm. Ai i njeh me Vlorën e flamurit. Aty arrin të përshkruajë bukuritë e kësaj perle, me detin, natyrën e ajrin e pastër që na ofron, historinë e trashëgiminë që na kanë lënë të parët.

Pjesa e tretë *Zilja e shkollës* është e përbërë nga 15 vjersha ku tema kryesore është shkolla. Ai është burimi i dijes, jo vetëm vendi ku mësojmë, pasi aty kuptojmë edhe vlerat e miqësisë e të shoqërisë. Në këtë pjesë autori ka thurrur vjersha të ndryshme për fëmijët dhe për autorët që kanë shkruar për ta, si Odhise Grillo e Ferhat Çakërri, dy shkrimtarë që kanë dhënë ndihmesë të madhe në letërsinë shqiptare për fëmijë. Vlerat edukative: ta duam shkollën, shokët e shoqet, mësuesit tanë sepse që janë modeli të cilin duhet të ndjekim.

Pjesa e katërt *Besniku thur një këngë* është pjesa më e madhe: në përbërjen e saj janë 56 vjersha. Autori bën ndërthurrjen e të gjitha temave, duke filluar që nga ajo historike, shoqërore, atdhetare. Ai edukon dashurinë për natyrën, kafshët e bimët. Me mjeshtëri përshkruan ardhjen e stinëve duke bërë dhe paralelizëm se çfarë përfitojmë nga këto stinë. Si në çdo libër tjetër, autori nuk lë pa i kushtuar poezi edhe vajzës së tij, Ketit, por jo vetëm asaj; në këtë pjesë shohim shumë vjersha ku në qendër janë fëmijët. Autorin e frymëzon dashuria e madhe për fëmijët por edhe kujtimet e fëmijërisë së vet. Mesazhi që përcillet në këtë pjesë është i dukshëm sepse ai trajton tema të jetës së përditshme. Vjershat nga ana e ndërthurrjes janë të qarta dhe të thjeshta. Autori është një mjeshtër i metaforës, krahasimit, ritmit dhe i rimës. Vjershat e tij jane të mbushura me dashuri e me ndjenjën e patriotizmit, nostalgjisë së fëmjërisë gjë që të bën të afeksionohesh që në momentin e parë të leximit.

Për përmbledhjen poetike *Lumi im s'fle* studiuesi Odhise Grillo vlerëson *përpjekjet e mëdha të poetit për të futur në poezi edhe frymën bashkëkohore që krijohet sot në*

botë. Poeti duke njohur mirë botën e psikologjinë fëmijërore, na jep në poezinë e tij për të vegjël vargje që shpalosin ndjenja e mendime poetike, që i bëjnë fëmijët të meditojnë dhe të përjetojnë çaste të bukura, të edukohen e të frymëzohen në jetën e tyre[214].

Ndërsa shkrimtari Skënder Hasko thekson: *Vërtet ai thotë Lumi im s'fle gjumë, por "lumi" i poezive të tij ecën qetësisht e paqësisht në shtratin e vet, dukeie joshur lexuesit "të freskohen në ujin e tij të pastër", në muzën e tij poetike të poetit që këndon pambarim për ta*[215].

Poeti nga Vlora shkruan edhe për Kosovën.

Është e dukshme tema atdhetare në vjershërimet e tij. Kjo përcillet mjaft bukur në përmbledhjen me vjersha *Gugatin pëllumbat në Prishtinë*. Dashuria dhe dhimbja për Kosovën nuk ka lënë të qetë autorin tonë, i cili ka nje dashuri të veçantë për fëmijët dhe të rinjtë e Kosovës. Përmbledhja është e ndarë në tri cikle: *Ku është dëbora e Llapit, Gjyshi dhe lahuta* dhe *Ku e pashë Kosovën*. Vjershat e tij i përshkon një ndjenjë e fuqishme dashurie, dhimbje dhe krenarie e shkrimtarit për Kosovën. Me vargjet e tij, ai i këndon natyrës, qyteteve të Kosovës, fëmijëve kosovarë, ëndrrave dhe dëshirave të tyre.

Shkruajnë në qiell edhe gugatin
Emrin që i ndez ëndrrat tona,
Fjalën që s'vdes kurrë në buzë:
- *E bukura, e shtrenjta, Kosova!*[216]

(Gugatin pëllumbat mbi Prishtinë)

Poeti është krenar dhe optimist. Ai u mëson fëmijëve për figura të shquara të historisë sonë të lavdishme, si: Skënderbeu, Mic Sokoli, Idriz Seferi, Ismail Qemali, Isa Boletini, Azem e Shote Galica, Hasan Prishtina e të tjerë duke i bërë të dashura dhe të gjalla në sytë e fëmijëve.

Poeti për fëmijë Bardhosh Gaçe, duke njohur thellë botën fëminore, natyrën e tyre ëndërrimtare, lodruese e emocionale, ka shfrytëzuar me mjeshtëri traditën folklorike, muzikalitetin e vargjeve, urtësinë e filozofinë jetësore, e nga ana tjetër, duke njohur thellë edhe poezinë moderne që krijohet sot për fëmijë në vende të ndryshme europiane, ka bërë përpjekje të reflektojë këtë kulturë të gjerë poetike bashkëkohore.

Me degë mimoze në buzë, në dorë,
Pranvera erdhi e bukura stinë,
letër i shkroi Baba Dimrit të gjorë,
që udhëve tretej larg në humbëtirë.

Një letër e mbushur me lule e fletë,
me këngë zogjsh, flutura çapkëne,
e di, do të kthehesh pas vjeshtës së tretë
tani jam vetë zonjë në këto vende[217].

[214] Bardhosh Gaçe, "Lumi im s'fle", Tiranë ,2005, f. 139
[215] Bardhosh Gaçe, "Pranvera i shkruan letër Baba Dimrit", Tiranë, 2006, "Mendime mbi poezinë e Bardhosh Gaçes", hulumtim nga Skënder Hasko, f. 85
[216] Bardhosh Gaçe, "Gugatin pëllumbat mbi Prishtinë", Tiranë, 1997, f. 57
[217] Bardhosh Gaçe, "Pranvera i shkruan letër Baba Dimrit", Tiranë, 2006, f. 27

Është një poezi e shkëputur nga përmbledhja me poezi me te njëjtin titull *Pranvera i shkruan letër Baba Dimrit*. Kjo përmbledhje është ndarë në tri cikle: 1. *Kë do më shumë nëna 2. Në ditëlindjen e Besnikut 3. Mbrëmje vere në Ulqin.*

Në poezitë e këtij vëllimi të bie në sy tematika e gjerë, mendimi i qartë, gjuha e zgjedhur dhe e pastër, e pasur me mjete shprehëse poetike. Metaforat e krahasimet e goditura, si dhe imazhet poetike i bëjnë ato të dashura për lexuesit e vegjël. Bardhosh Gaçe e përjeton jetën e fëmijëve si një poet aktiv, duke arritur të përcjellë vargje të ëmbla, të bukura, me vlera të veçanta artistike dhe estetike për lexuesit e vegjël:

Zërat e fëmijëve
Në vargjet e mia
Si pëllumba gugatin!
Në Sheshin e Flamurit
Përqafojnë Monumentin
Në ajër krahët rrahin.

Qyteti i Flamurit
Zgjohet në mëngjese
Nga puthja e diellit.
Njëzet e tetë Nëntori
Zbret kodrave me ullinj
Me vetëtima qiellit![218]

(*Qyteti i Flamurit*)

Duke i lexuar ato vjersha të krijohet menjëherë bindja se ke të bësh me një autor me përvojë dhe që e njeh mirë botën e fëmijëve.

Ja dhe vargjet e një krijimi tjetër poetik të tij me titull *Në sytë e fëmijëve:*

Në shekuj shqiptari luftoi
Për pakëz Dritë dhe Liri.
Fytyrën e Atdheut shikoj
Në lulet që mbani ju fëmijë.

O sy të mbushur me dritë
Tek ju shikon sot Atdheun,
Si nesër mbi gjithë kaltërsitë
Do fluturoni me dashuri Skënderbeu![219]

Kjo është një vjershë e shkëputur nga përmbledhja *Në kopështin e ëndrrave* apo në kopshtin e metaforave siç e quan Lirim Deda. Ky libër me vjersha u botua në vitin 2009. Në libër janë 53 poezi.

Kur rri pranë detit
Brigjesh këndon vala,
Këngët përshëndetin
Tufat me pulëbardha.

[218] Po aty, f. 42
[219] Bardhosh Gaçe, "Në kopshtin e ëndrrave", Vlorë, 2009, f. 37

Unë me grep peshkoj
Varkat rrjetat heshin,
Vjen mëngjesi i purpurt
Valët më përkëdhelin.[220]
(Sa vite)

Në poezinë për fëmijë të Gaçes imagjinata fluturon vrullshëm dhe, ku moderniteti i artit të tij ushqehet në traditën tonë të pasur poetike. Talenti i tij sjell vargje të freskëta, të pasura me fantazi të thellë, brenda të cilave shpërthejnë ëndrrat dhe dëshirat e fëmijëve, bota e tyre intime me një gjuhë të pasur artistike. Ndaj, me të drejtë kritika jonë, në hyrje të librit, i përcakton këto vjersha *si një kopësht me ëndrra vogëlushësh*…

Ky autor, tashmë ka krijuar një individualitet të spikatur poetik, duke u bërë kështu një nga poetët e dashur për fëmijë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni, Itali e Kanada, ku është botuar krijimtaria e tij.

Në poemthin *Gjyshja dhe mbesa,* autori kërkon të përcjëllë tek të vegjlit, brezat e rinj, edukimin atdhetar duke evokuar të kaluarën me personazhe historikë e mitologjikë të njohur:

Gjyshe, më trego një përrallë,
Mbesa i lutej për çdo natë.
Përrallë për detin me valë
Që brigjet i rreh me shpatë!
Dhe fisi i zogjve s'u tremb
Dhjetë vjet me bajlozin luftoi,
Me sqepët- shpata mbi shkëmb
Qëndroi trimërisht dhe fitoi[221]*...*

Në morinë e vargjeve të poetit shquajmë 6, 8, 10 dhe12 rrokëshin. Strofat janë katërvargëshe dhe rrallë (si te poezitë: *Lejlekët, Në ditëlindjen e Vivianës, Letër gjyshit prej mërgimit, Poetja e vogël Liri)* shfaqet distiku. Trevargëshi përdoret rrallë.

Bardhosh Gaçe është edhe një studiues i vëmendëshëm i letërsisë shqipe për fëmijë. Artikujt dhe studimet e tij për zhvillimin e romanit për fëmijë, marrëdhëniet e poezisë popullore me poezinë e kultivuar për fëmijë, apo portretet poetike e artistike të disa prej autorëve më në zë të kësaj letërsie, tregojnë për kontributin e tij në fushën e mendimit kritik e letrar.

Kontributi i vyer në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj është i veçantë edhe në një aspekt tjetër, në botimin e tekstit *Letërsia shqipe për fëmijë*, në faqet e së cilit autori ka sintetizuar këtë pasuri të artit tonë letrar, duke i dhënë vendin që i takon në tablonë e letërsisë sonë të përgjithshme.

[220] Po aty, f. 40
[221] Po aty, f. 66

5.17 Andrea Petromilo - shkrimtari i plagëve të emigracionit

Andrea Petromilo[222], një autor shumëplanësh, prozator e publicist, shkrimtar i afirmuar për fëmijë i cili ka lëvruar disa gjini letrare: tregimin, dramën, fabulën, gjëzat, novelën, radio-dramatizimin, skenarin e filmit vizatimor, dhe dokumentar, skicën dhe portretin letrar.

Në se do të ndalemi tek përrallat për fëmijë, Petromilo na shfaqet si një shkrimtar i cili zotëron dukshëm elementët e saj. Ka gjetur çelësin magjik për t'u shfaqur para fëmijëve, duke i rrëfyer përrallat në mënyrë mjaft tërheqëse, si dhe duke parapërgatitur me kujdes të veçantë skenën ku do të rrëfejë. Përmendim këtu përrallat, si: *Si u mbyll kënga në kafaz, Bleta dhe lulecfaka, Ndodhia e peshkut pikakuq, Retë inatçore dhe fusha pjellore, Bufi që donte të bëhej piktor*...etj. Ndër elementët më të parapëlqyer, janë ato të traditës së përrallës shqiptare, të legjendës së lashtë, me të gjitha veçoritë e saj të njohura. Edhe simbolika, edhe fushëveprimi, janë të lidhura ngushtë me mjedisin përrallor dhe mesazhi është i qartë, edukues në të mirë të formimit fëminor.[223]

Ndërsa, në rast se do të ndalemi tek fabulat në prozë, shkrimtari Petromilo zë një vend të rëndësishëm në këtë gjini, kaq të pëlqyeshme jo vetëm tek fëmijët, por edhe tek të rriturit, duke përcjellë vlera edukative dhe artistike.

- Fabulat e tij shtrihen në trevat e fabulës klasike, me elementët e saj bazë.
- Fabulat e tij rrëfimore janë bashkëkohore pasi mbartin mesazhin e ditës.
- Veçori tjetër është se shkrimtari trajton dhe zbërthen me kujdes e stil krijimin. Pasi e ka trajtuar lëndën fabulore në mëndjen e vet, kërkon elementët bazë të saj, simbolikën e përshtatshme, e cila është përherë në lidhje natyrore të simboleve, pa distanca të largëta,.
- Mesazhin e fabulës e përcjell natyrshëm, pa sforcime.
- Gjuha që përdor shkrimtari është tërësisht fëminore, e qëmtuar kujdesshëm, duke rrëfyer kështu edhe kulturën e tij letrare dhe përvojën e vet, të fituar ndër vite.

Fabulat e shkrimtarit Andrea Petromilo janë të pëlqyeshme, pasi në to përcillen mençuri dhe vlera për të gjitha moshat. *Fabulat e Andreas përherë i kam krahasuar me atë burimin e ujit, i cili, duke dashur të mbetet përherë i pastër, nis rrugimin e vet të tatëpjetës, me mendimin se do të udhëtojë gjatë në shpatijen e malit dhe se nuk kërkon as të bëhet përrua zhurmues, as lumë i turbullt. Ai kërkon të ruajë pastërtinë e vetvetes. Ky është një mesazh që mbart vlera në letërsi*.[224]

Gjithashtu në krijimtarinë e shkrimtarit[225] një vend të rëndësishëm zënë dhe *gjëegjëzat.*

---

[222] Andrea Petromilo ka lindur në fshatin Palasë të bregdetit, rrethi i Vlorës më 1949, ku kreu dhe shkollën shtatëvjeçare. Të mesmen e vazhdoi në Vlorë, ndërsa studimet e larta- për bujqësi. Mbaroi më pas kursin pasuniversitar për dramaturgji. Në vitet e Demikracisë emigroi në Greqi dhe u kthye në përsëri. Ka bashkëpunuar me revistat "Pionieri", "Fatosi", "Yllkat" si dhe me gazetën "Shekulli", gazetën e përjavshme "Drita", me revistën periodike "Universi i librit shqiptar". Në vitin 2000 punon për një periudhë të shkurtër si kryeredaktor i gazetës "Zëri i emigrantit". Në vitin 2003-2004 boton revistën për fëmijë (redaktor dhe kryeredaktor), "Valëza e kaltër". Në vitin 1980 pranohet kandidat e më pas anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

[223] Iliaz Bombaj, "Veçoritë e përrallës, fabulës dhe gjëegjëzës", Gazeta Athina, Shkurt ,2011, f. 23

[224] Po aty, f. 23

[225] Ka botuar këto librë për fëmijë:

Ky zhanër letrar e ka nisur udhën e vet me misionin argëtues. Duke e patur burimin tek njerëzit e thjeshtë, gjithnjë me motivin argëtues, gjëza u përfshi në lëmin e gjinisë folklorike. Për gjetjen e tyre nisin e rrokullisen në mendjen e fëmijëve njëmijë e një objekte, fenomene, duke i parë në këndvështrime nga më të ndryshme, anën fizike të tyre, përmbajtjen, gjëndjen etj. Sigurisht ky krijim nxit që të krijosh enigmën për cilësi të veçanta për objekte e dukuri të ndryshme: për syrin, gojën, hundën, mjetet e punës, fenomenet e natyrës, mjetet e jetesës, kafshët, insektet.

Për shembull: *Njëra bri e tjetra dhëmb/ ngjitur rrinë, si siamezë/ s' punojnë tok, por veç e veç* (kazma), *Dy vëllezër/ ndarë jetë e mot/ qajnë e qajnë/ s'pushojnë dot...* (Brigjet e lumit), *Ç'është një depo larushe mbushur/ plot me rruaza të kuqe*? (Shega), *Për veshi e kap/ dhe në buzë e puth/ pak nga pak e than/ një liqen të tërë* (Filxhani i kafesë)[226]. Figuracioni artistik tek gjëzat jepet përmes metaforës, epitetit, krahasimit.

Veçori e autorit në lëvrimin e këtij zhanri është se gjëzat dallohen për origjinaliteti e tyre, japin informacion nga fusha e bujqësisë, blegtorisë. Ato janë konçize, jo prozaike, enigma mbartet për t'u përpunuar. Duket sikur luan me to dhe në mes tyre gjejmë gjëza me vlera njohëse, edukative, me të fshehta.

Shkrimtari Andrea Petromilo ka tërhequr vëmendjen e lexuesve të vegjël me përmbledhjen me tregime "***Qielli i murrëtyer i së dielës***", botuar në vitin 2000 në Tiranë.

Në të ka përzgjedhur me kujdes njëmbëdhjetë tregime, të cilët rrahin tema shoqërore, nga e kaluara por edhe nga ditët tona, duke guxuar të sjellë e të trajtojë tema interesante, prekëse, sociale, tema të përditshmërisë që me mjeshtëri i paraqet të veçanta e gati-gati novatore.

Fabulat janë intriguese, zbërthen personazhe a karaktere të cilët reflektojnë mesazhe të rëndësishme...

Menjëherë, sa fillon e i lexon tregimet, të tërheqin e të mbajnë të gozhduar para librit. Të shtyn kureshtja se çfarë do të ndodhi me personazhin,p.sh me Fati Çavellën, në tregimin *Dhe ishte ende dimër*. Nuk ke se si të mos indinjohesh përballë fatit të këtyre njerëzve, të cilët për arsye ekonomike emigruan rrugëve të Europës...për një jetë më të mirë.

Është e qartë se autori ka depërtuar thellë në plagët që ka kaluar shoqëria jonë në tranzicion e në emigracion. Me syrin vëzhgues, autori na paraqet gjëndjen e vështirë të familjes Çavella, përpjekjet e tyre për t'u mbijetuar kushteve të vështira...*Atje larg, në atdheun e tyre, ata kishin një shtëpi të mrekullueshme, vërtetë e vogël, vetëm një*

Ishim bërë trima (tregime, 1987)
Bufi që donte të bëhej piktor (përralla, 1988, 2003)
Si u bëra trim (tregime, 1996, 2003)
Si u mbyll kënga në kafaz (përralla, 1997)
Një yll nga qielli (tregime, 1997)
Trak e truk (gjëegjëza, 1997)
Kush e gjen (gjëegjëza, 1998)
Kohë rebele (roman, 1999)
Qielli i murrëtyer i së djelës (tregime, 2000)
Gjimnazja e shthurur (tregime, 2002)
Pranverë pa xixëllonja (tregime, 2002)
Një e vërtetë si në përrallë (novelë-përrallë, 2005)
Shqiponja dhe brumbulli (fabula [në prozë], 2006)
Vajzë që pushtoi qiellin (roman, 2007)
Është zog a s'është zog (gjëza, 2007
Vajza me bluzën ngjyrë manushaqe (tregime, 2011)

[226] Andrea Petromilo, "Kush e gjen? Gjëza, Tiranë, 1998, f. 24

dhomë e një kuzhinë, me një holl të ngushtë, me ballkonin që shikon nga jugu, por ishte e bardhë, e bardhë, plot dritë e me ajër të pastër. Kurse kjo këtu kundërmon erë myk; muret janë veshur me nje shtresë të zezë në jeshile të errët dhe e rëndon kaq shumë ajrin sa të merr frymën.[227]

Autori, herë-herë depërton në psikologjinë e personazhit, Fatit, duke e vendosur në situata të ndryshme. Ai vuan. Vuan nga gjëndja e krijuar në shtëpi, është ftohtë, prindërit vetëm punojnë, nuk i hyn asgjë në sy...*asgjë nuk i pëlqente këtu: as deti, as qielli me atë hirësimin e përhershëm, as rrugët e zhurmshme, as ajri mbytës nga gazrat e mjeteve të panumërta, as...as...*[228]

Shqetësimet vijnë duke u rritur. Rrëfimi i shkrimtarit e bën tregimin dramatik... Fati takon dy shqiptar, të cilët e detyrojnë që të lyp në fanare, atje ku ndalojnë makinat. Por zemra të rreh fort kur autori bën një mbyllje tragjike të personazhit, duke shfaqur hapur problemet dhe dukuritë ekonomike-sociale të kohës...të pazgjithshme për shoqërinë. *Fati Çavella dergjej në asfalt, pa ndenja, i gjakosur. Pastaj... një sirenë e vazhdueshme çponte hapësirën e murrëtyer qiellore të atij qyteti të madh. Dhe ishte ende dimër... shponte.*[229]

Me nota dhimbjeje, autori trajton problemet aktuale që prekin sot, të rinjtë, që bien pre e drogës dhe shoqërisë së gabuar. Kështu ndodh me tregimin *Kur pikonin yjet në qiell*. Ky tregim mbart mesazhe të forta. Përcjell me nota realiste dhimbjen që pikon në zemrën e çdo njeriu kur përballet me këtë fenomen social. Këtë autori e bën me përshkrimin që i bën personazhit, Robit, ku fundi është i hidhur... *Dhe gjithçka, mos vallë nisi atë natë kur pikonin yjet? Nuk e di. Mbase po, mbasje jo. Por mua ajo natë do të më mbetej përherë në mëndje, si një natë e bukur, por me një bukuri që mbështjell gënjeshtrën, që mbjell vdekjen, që rrëzon yjet nga qielli. Vallë, ajo natë ishte vërtet e tillë, e mahnitshme? Apo ishte një ëndërr, ku bukuritë rrëmbejnë mendjen e çlirët të fëmijëve? Dhe qysh atëherë s'do t'u besoja më kurrë bukurive, madje as bukurive mahnitëse.*

Ndërsa në tregimin *Dorini*, shkrimtari përshkruan me një gjuhë të thjeshtë e të pasur.

Në fshat kish tre ditë që binte dëborë. Çdo gjë zbardhonte: edhe mali i Papadhisë, edhe kodrat përreth, edhe fusha, siç quheshin ngastrat që shtriheshin përgjatë luginës, në të dy krahët e lumit të Buronjës...ditën e katërt moti u hap. Nga qielli krejt i kaltër, reflektoi dritë e qashtër, gjë që e bëri atë bardhësi të gjithëpushtetshme verbuese, marramendëse. Autori nëpërmjet personazhit të Dorinit i nxit fëmijët dhe u jep mjaft informacion për tarracat, teodolitin, dylbitë, etj. Gjithashtu në tregim del në pah edhe mirësia e djalit ndaj dy burrave, për mikpritjen e shqiptarit. *Këto fjalë i bënë burrat të vinin buzën në gaz, ata shikonin Dorinin si vraponte tatëpjetë. Ai hidhej si kaproll. Secili nga gjeometrat mendonte për atë djalë, që u kishte bërë një ftesë të çlirët. Te fjalët e tij panë diçka të mirë, të pastër si borë e pashkelur... Dhe sa e madhërishme kur trashëgohet brez pas brezi!...*

Në disa tregime, si *Një vajzë e çuditshme, Trëndafilit që nuk i binin petalet, Kur frynte tramundana, Ato ditë me shira*, të bie në sy se veçori kryesore e tyre është pasqyrimi me forcë të veçantë artistike i botës së pasur të fëmijëve, i psikologjisë së tyre shoqërore dhe i interesave të gjëra të moshës. Gjithashtu, në këto tregime del në pah paraqitja me realizëm e karaktereve tipike të fëmijëve, motivimi i sjelljeve dhe i

[227] Andrea Petromilo, Qielli i murrëtyer i së dielës, Tiranë, 2000, f. 3
[228] Po aty, f. 6
[229] Po aty, f. 21

veprimeve të personazheve, evoluimi i botës së brendshme dhe interesat e reja shoqërore të fëmijëve, veçori këto që dallojnë në prozën për fëmijë e të rinj të shkrimtarit Andrea Petromilo.

Përshkrime të tilla realiste shfaqet edhe në tregimin *Qielli i murrëtyer i së dielës*, krijim ky i pasur me paraqitje të veprimeve apo portretit të jashtëm të personazheve, me figura e mjete shprehëse letrare: *Faslliu ishte bërë meit në fytyrë dhe duart, dy duar të holla, të zbërdhyllta si dy cipenj plepi të zhvoshkur nga lëkura, të vendosura mbi tavolinë, i dridheshin si të një epileptiku. Gishtërinjtë të tendosur, përcillnin deri në skaje gjëndjen e tij nervoze, duke dhënë përshtypjen se aty mbi tavolinë ishin shtrirë dy këmbë pule të prera, si ekzemplarë të një metamorfoze tepër të rrallë, ku rudimentet ishin zgjatur dhe askush s'do ta besonte po të mos ishin ekspozuar*.[230]

Apo në rastin tjetër ku del në pah gjëndja e personazhit: *Kostë Dhimua i kaloi pëllëmbën mbi flokë. Duhej të fliste me djalin. Nuk duhej ta linte shpirtin e tij të trandej. Çdo pjesë e kurmit të tij fërgëllon si një gjethëz mani që maja e saj çiket në një vijëz uji. Sa e dëmton kjo gjëndje një fëmijë!*

Andrea Petromilo tregon kujdes dhe i gërsheton bukur e ëmbël gjëndjet e ndryshme të personazheve, duke u futur në thellësi të botës së brendshme e të psikologjisë, veprimeve, ndjenjave e mendimeve të tyre, në situata të ndryshme, saqë na përcjell emocione të forta. Dhembja e përshkon tërë tregimin: Kostë Dhimua, një njeri i thjeshtë që po rrit gjashtë fëmijë të urtë e të patrazuar, se...”*Zeher i ishte bërë shpirti, por asnjëherë s'e hapi gojën të thoshte një fjalë të keqe”.*

Ëndrra për të patur një dhomë ku Harrilla të mësojë për t'u bërë artist, nuk u realizua. Faslliu, një personazh i realizuar me mjeshtëri, vishet me anët më negative e të errta të atyre njerëzve që dëmtojnë shoqërinë...[*Faslliu, si anëtar i këshillit për atë zonë, një ditë të mirë, ia behu para derës. I krekosur, duke sjellë nëpër gishtërinj një zinxhir ngjyrë floriri...*
Faslliu liliput ishte bërë gjigand...]

Duhet theksuar se në përmbledhjen me tregime *Qielli i murrëtyer i së dielës*, të bie në sy dhe përdorimi nga ana e autorit të mjaft shprehjeve të goditura dhe me figuracion, për shembull: *Fjala “baba” sa herë belbëzohej nëpër buzët e tij, humbiste si guri në hon* (I biri, f. 54), *Fjalën e kap në ajër si skifteri gjahun* (I biri, f. 55), *Frika të ul kurrizin, të detyron të futesh në strofkullën tënde, si breshka në guackën kitinor, e duke kujtuar se kështu i shpëton të keqes* (Grushti, f. 31), *Trëndafilin nuk e mposht dimri, të ftohtit e hidhur, po Taqon, Taqon, përse po e thyen ky dimër i jetës!* (Trëndafilit që nuk i bienin petalet, f. 124), *Sepse fjalën e shpërndan era dhe e fut në çdo skutë* (Një emër i bukur, f. 131), *Ky t'i pritka drutë me një sëpatë. Gjuhën brisk e paska, pemë të ngarkuar e paska mendjen* (Një emër i bukur, f. 138).

Shkrimtari Andrea Petromilo nëpëmjet subjekteve tërheqëse dhe gjuhës së pasur ka sjellë krijime me vlera artistike të veçanta. Ka realizuar më së mirë rolin e tij si shkrimtar i formuar dhe me një përvojë për t'u patur zili. Për vlerat që ai përcjell, kontributin, këmbënguljen dhe përkushtimin ndaj trajtimit të temave pikante e të përditshme shkrimtari Andrea Petromilo zë një vend të rëndësishën në prozën për fëmijë dhe të rinj.

[230] Po aty, f. 74

5.18 Vilhelme Vranari – idealizuesja e historisë së lashtë të popullit tonë

Në letërsinë e sotme shqipe, veçanërisht në atë për fëmijë, krijimtaria letrare e shkrimtares Vilhelme Vranari zë një vend të veçantë. Lëvron thuajse në të gjitha gjinitë letrare, por vend kryesor zë proza[231].

Aktivitetin letrar e ka nisur qysh në bankat e shkollës, por realitet u bë vetëm pas rënies së Diktaturës. Filloi të botojë më 1996 në libra me fabula. Në vlerësimin që ka bërë Prof. Odhise Grillo për krijimtarinë e autores ka theksuar: " *...Fabulat e saj kanë temë të larmishme, që i bëjnë jehonë problemeve të ditës edhe pse në qendër të tyre janë kafshët e shpendët etj...E veçanta e krijimtarisë së saj për fëmijë, është se ka një gërshetim të fabulës klasike të La Fontenit apo të Ezopit me fabulën bashkëkohore moderne, duke futur elemente të ri didaktik.*"

Në ato fabula, spikat psikologjia, gjetjet poetike dhe bota e fëmijëve, e cila përmblidhet me personazhet e dashura të fëmijëve, me botën bimore dhe shtazore. Me kujdes të veçantë autorja ndërthurr elementët edukative, edukimi qytetar i fëmijëve.

Shkrimtarja Vilhelme Vranari është e veçantë në stilin e saj. Preferon t'i shkruajë fabulat ndryshe nga ato me të cilat jemi mësuar. Krijimet e saj tingëllojnë si prozë poetike.

Autorja ka shumë për zemër edhe përrallën, gjini kaq të dashur për fëmijë. Preferon personazhe, ngjarje, vende nga më të çuditshmet, krijon e trillon, luan me personazhet, me emrat e tyre...i fut fëmijët në një botë imagjinare. Në përrallat e saj, autorja prezantohet me një emër mjaft të dashur, "Nëna Vili". Si mësimdhënëse, si nënë, si gjyshe e dashur dhe si një person që vërtetë mundet, Nëna Vili, vërtetë ka se çfarë t'u rrëfejë dhe t'u ofrojë fëmijëve. Ajo ka gjetur bukur edhe personazhin e saj të quajtur Princesha Bianka (Princesha Bi), shqiptarja e vogël që jeton në emigracion, së cilës me shumë dashuri, ajo i rrëfen përrallat.

Tek të dy ciklet e librave "***Kuçedra dhe Dragoi***" dhe "**Gjiganti dhe Xhuxhi**", gjenden krijime që me gjithë mend ofrojnë tek fëmijët kënaqësinë e të lexuarit, zhvillimin e imagjinatës dhe të memories historike të fëmijëve për vendin e të parëve, vendlindjen e stërgjyshave, gjyshave dhe prindërve. Të dy vëllimet që në formë imagjinare, shtjellojnë historinë e lavdishme të popullit shqiptar, shkojnë edhe më tej, në historikun e të parëve tanë ilirë.

Libri i parë përfshin tri përralla dhe një tregim, në përputhje me veçoritë psiko-fizike të moshës së lexuesve mbi 9 vjeç. Në krijime gjen episode historike lidhur me përpjekjet e ilirëve, punët, zakonet e tyre dhe zhvillimin e zejtarisë. E veçanta e këtij libri është fakti se ka një gjuhë të pasur letrare: "*Fëmjë të mirë, këto janë përrallat e*

---

[231] **Libra për fëmijë të botuara:**
- 10 fabula - fabula
- Bëmat e Dhelprës –fabula, 2002
- Ne jemi lulet e jetës –fabula, 2003
- Amanti i Arbërisë – roman fantastiko-historik, 2003
- Vogëlushja Bianka dhe kafshët e saj - përralla , 2008
- E dini se ç'emër kam?! -fabula e gjëegjëza, 2008

*Përrallat e vendit blu- cikël përrallash:
- Kuçedra dhe Dragoi, libri parë -2010 libri i dytë,
- Gjigandi dhe Xhuxhi, libri i dytë, 2011

bukura të vendit tuaj, që dikur quhej Iliri. Atdheun tonë të mrekullueshëm në këto përralla unë e kam quajtur "Vendi Blu". Nuk ka vend më të bukur në botë se Shqipëria jonë."- Kështu u drejtohet autorja fëmijëve shqiptarë.

Libri i dytë përmbledh 5 përralla, që përbëjnë ciklin "*Përrallat e vendit Blu*". Në ndërtimin e të gjitha krijimeve, autorja është bazuar në historinë e popullit tonë, dhe kërkon të përcjellë dashurinë për atdheun e të parëve tanë ilirë, për gjuhën e bukur shqipe. Në faqet e librit fëmijët do të ndeshen me personazhe mistike, si me: Dragoin e maleve, me kalin Pegaso, Sirenat, Shenjtorin Yllion, Hyjneshat apo Perëndeshat. Do të njihen me Lubinë e pangopur me emrin Llufa apo Lubia e Detit, Gjiganti, Shtriga, e të tjerë personazhe.

Cilat janë vlerat që spikaten në këto përralla?

- Në mënyrën e ndërtimit strukturo-didaktik, kemi të bëjmë me një letërsi bashkëkohore për të vegjëlit.

- Në to lexuesve u rritet dëshirën që t'u ngjasojnë personazheve pozitivë që i duan dhe të urrejnë personazhet negativë dhe keqbërës.

- Autorja vë në lëvizje mendimin logjik të lexuesve, fantazinë e tyre.

Romani fantastiko-historik për fëmijë "*Amanti i Arbërisë*"

Romani me titull "*Amanti i Arbërisë*[232]", për fëmijë të moshave mbi 10 vjeç, një libër sa historik dhe po aq atdhetar, sa real dhe po aq fantastik. Ai është një udhëtim imagjinar i një fëmije, Amantit, që mban emrin e qytetit të lashtë, Amanties. Djali i vogël është trashëgimtar i mbretit Ilir, që është vrarë pabesisht nga të huajt. Fëmijës i lind një ide për të bashkuar shqiptarët që janë të ndarë e të përçarë. Në këtë mënyrë ai nis një rrugë të gjatë, të panjohur dhe shumë të vështirë, duke pasur parasysh udhëzimet apo porositë e gjyshes së tij.

Gjatë udhëtimit të Amantit dalin në pah bukuritë e vendit tonë, historia e lavdishme dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri, emra të njohur ilirë, të cilët kanë drejtuar dhe udhëhequr popullin shqiptar. Përveç kësaj lexuesi do të mrekullohet me përshkrimin dhe informacionet që përcjell autorja që në fillim të romanit: *Gryka e shpellës dilte në një qafë mali, ku në të majtë niste lugina ndërmalore e ku derdheshin ujërat e kristalta nëpër një ujëvarë. Në të dy anët e luginës hijeshonin makjet që nuk njohin stinë. Ato gjelbëronin midis bardhësisë së maleve dhe kaltërsisë së ujit. Një tablo mahnitëse e piktores dhe skulptores* natyrë (61) etj, etj.

Shkrimtarja Vilhelme Vranari përshkruan me një stil të veçantë dhe dashuri të madhe bukuritë e vendit tonë. Gërsheton ngjarjet e ndryshme historike me informacionet mbi dukuri të ndryshme. Dhe këtë gjë ajo e bën mjaft lehtë e ëmbël.

Në roman personazhi kryesor Amanti kalon shumë peripeci, ai ishte rritur jetim, pa kujdesin prindëror, duke njohur vuajtjen, dhimbjen, skamjen dhe urinë. Ai u rrit dhe u edukua nga fjalët e urta të gjyshes së tij të ëmbël. Edhe pas vdekjes së saj, do t' i

[232] Vilhelme Vranari, "Amanti i Arbërisë", Tiranë, 2003.

qëndronte pranë, ta ndihmonte dhe ta këshillonte djalin: - *Njeriu pa tokë, është i vdekur. Toka është shpirti i tij. Mbill ullinj kudo, Amant, se nuk ka pasuri më të shenjtë, biro* (f. 18).

Gjithashtu në roman përcillen dhe mjaft këshilla e thënie të cilat ndikojnë në edukimin e fëmijëve dhe njohjen e tyre me këtë pasuri leksikore dhe frazeologjike të popullit shqiptar.

Thjeshtësinë dhe bukurinë e rrëfimit ia shton edhe krahasimi që bën autorja mbi bukurinë e vashës shqiptare. I krahason me hyjneshën Diona. Përmendim princeshën molose... *Ajo ishte e bukur si zanë mali. Me sy të kaltër si valët e detit të Arbërisë; me lëkurën e bardhë si bora e maleve tona hijerëndë dhe me faqet e përskuqura si lindjet dhe perëndimet e diellit. Vetëm hyjnitë mund të krahasohen me këtë bukuri të rrallë. Ajo vashëz e rritur me erën e malit dhe ujin e burimeve...* (f. 33). Apo krahasimi me Hyjninë e Butrintit, Dea. *Hijeshi të veçantë i jepnin sytë blu, si Joni i thellë. Veshja e saj ishte e kaltër si qielli pa re i vendit të tij ndërsa mjedisi përreth ishte i blertë, si malet hijerënda të asaj toke të përgjakur* (f. 49).

5.19 Fabulisti Pëllumb Velo[233]

Krijimi i parë është i vitit 1962, fabula "*Dhia dhe keci*"'. Muzë kjo që nuk u nda kurrë pavarësisht se autori ka trokitur vonë në portat e letërsisë, për shkak të rrethanave të jetës së vet. Ka botuar libra për fëmijë dhe të rinj duke kristalizuar dhe stilin e tij individual në fushën e fabulave. Fabulat e tij i drejtohen jo vetëm fëmijëve por edhe të rriturve. Kjo duket në pasurinë e fabulave të përmbledhura në vëllimet *Dhelpra dhe gjahtari*, *Kunadhja zyrtare*, *Skilja e lagunës*, si dhe fabulave të zgjedhura për nxënësit e shkollave - *Fabulisti dhe gjallesat*.

Në përgjithësi krijimet e Pellumb Velos janë të thjeshta, shumë njerëzore dhe kanë jo vetëm vlerë morale, por edhe letrare.

Cilat janë disa nga veçoritë e fabulave të këtij autori?

Në përmbledhjen me fabula ***Dhelpra dhe gjahtari,*** të bie në sy gama e gjerë e tematikës si dhe lidhja e saj me problemet e shumta të ditës që po has shoqëria jonë sot.

Gjithashtu autori dallohet për stilin e tij origjinal të krijimit të fabulave.

---

[233] Pëllumb Velo u lind më 2 shkurt 1945 në Bishan të Vlorës. Qysh në rininë e hershme është marrë me pikturë dhe letërsi dhe me vonë me gazetari. Ka adhuruar si prozën dhe poezinë, por në veçanti fabulën. Përmendim këtu:
- Zëri i nënës më thërret (vjersha, 2002)
- Mall për vendlindjen (vjersha, 2003)
- Dhelpra dhe gjahtari (fabula, 2006)
- Kunadhja zyrtare (fabula, 2007)
- Skilja e lagunës (fabula, 2008)
- Fabulisti dhe gjallesat-1 (fabula, 2008)
- Fabulisti dhe gjallesat-2 (fabula, 2009)
- Fabula të zgjedhura, 2009
- Kur merr zjarr e digjet pylli (fabula, 2008)
- Fabulisti dhe gjallesat- 3 (fabula të zgjedhura për programin mësimor të shkollës 9-vjeçare, 2011)
- Skilja dhe qukapiku (fabula, 2012)

Dikur, korba pendëzezë,
Turli sapunësh ka marrë.
Dëshirë e shpresë iu ndez,
Ngjyrën e zezë për të larë.

Kur e pa që nuk ndryshoi
Cop'e çik e bën pasqyrën
Hyn sapuni ta qetësoi:
- *Unë heq lyrën dhe jo ngjyrën![234]*

(Korba dhe sapuni)

Në vargun e fabulave të tij ka vetëm shqetësim, dhimbje për problemet që kalon vendi. Janë kafshët që flasin me gjuhën e njerëzve dhe që sjellin modele njerëzish apo fenomene shoqërore të goditura në shenjë. Përmbledhja me fabula *Kunadhja zyrtare* është e mbushur me probleme dhe ide interesante nga jeta e përditshme. Autori përdor një terapi të pasur artistike, duke filluar nga gjuha e pastër dhe e bukur, nga larmia e personazheve që përfaqësojnë botën shtazore. Nuk mungon as alegoria e nënkuptimi si një mjet elegant i përdorur artistikisht. Po ashtu, satira, sarkazma, ironia, krahasimet, antitezat, kontrastet e metaforat, si edhe dialogu, që autori e ka zgjedhur për të fshikulluar ligësitë shoqërore.

Ky libër me fabula është ndjenjë, emocion, madje dhe habi, pasi fabula e Pellumb Velos ka një këndvështrim filozofik. Fabulisti ia ka dalë të përcjellë bukur tek lexuesi mesazhe njerëzore që mbartin jo vetëm vlera morale, por edhe vlera letrare.

Edhe në librin me fabula ***Skilja e lagunës*** tematika e fabulave është e larmishme. Ato trajtojnë kryesisht fenomene sociale. Kanë ngjashmëri me fabulat e Ezopit, La Fontenit, por ndryshojnë prej tyre sepse kafshët, sendet dhe fenomenet, veprojnë në rrethanat dhe kushtet aktuale të ekonomisë së tregut dhe të dukurive e problematikës që ka shoqëria jonë e sotme.

Fabulisti Gjike Kurtiqi shprehet:*... se ajo që të bën përshtypje kur lexon fabulën e Pellumb Velos është jo vetëm përmbajtja e saj dhe morali që sjell, por mbi të gjitha cilësia artistike e krijimit, është gjuha e pastër me figura të goditura dhe fjalë të zgjedhura nga një fjalor gjuhësor i pasur që i japin fabulës veçorinë dhe bukurinë e saj dhe e bëjnë të dallohet nga fabula e krijuesve të tjerë*[235].

Përmendim një nga fabulat, *Ujku dhe majmuni*:

I pangren' ujku qëkuri,
Një majmun desh të vriste,
Ndaj poshtë pemes vend zuri,
Urtë e butë e ftoi të zbriste:

- *Eja posht' o mik i vjetër,*
  Mik e shok si asnjë tjetër...

Majmuni, hazer xhevap:
- *Kur u bë helmi sheqer?*
  Ti në tokë je një kasap,
  Unë mbi pemë një xhongler[236]*...*

[234] Pëllumb Velo, "Dhelpra dhe gjahtari", Vlorë, 2006, f. 10
[235] Pëllumb Velo, "Skilja e lagunës", Vlore, 2008, në parathënie e librit me fabula, f. 3
[236] Pëllumb Velo, "Skilja e lagunës", Vlorë, 2008, f. 13

Shkrimtari dhe studiuesi Bardhosh Gaçe[237] në parafjalën e kësaj përmbledhje me fabula thekson se vargu poetik i këtij autori përcjell emocione e ndijime nëpërmjet personazheve kafshë që nënkuptojmë natyrshëm marrëdhëniet midis njerëzve. Në arkitekturen e fabulave të veta, Pëllumb Velo është gjithnjë në kërkim të detajeve, ngjarjeve e personazheve që krijojnë një larmi të motiveve që përcjellin mençuri, urtësi, filozofi, mesazhe për kohën dhe jetën. Fabulat e Pëllumb Velos janë të thurrura me një mendim të qartë poetik, të thjeshta e të kuptueshme nga të gjitha moshat e sidomos prej nxënësve të shkollave, tek të cilët ato përcjellin mësime e vlera artistike, estetike, morale e etike, duke luajtur një rol të jashtëzakonshëm në edukimin e tyre.

Fabula të tilla si ”*Ferra dhe shalqiri*”, ”*Dreri, derri dhe kali*”, ”*Druvari dhe shkrepësja”, ”Dreri dhe palloi”, ”Bleta dhe dreri”,* janë jo vetëm të arrira artistikisht, por edhe denoncuese të veseve dhe problemeve shoqërore.

Në fakt autori për burim e frymëzim ka thesarin e popullit, që përfaqëson. Në çdo varg e rresht, ndien kënaqësi prej bukurisë poetike, qesh e ngazëllehesh prej urtësisë profetike, mëson prej shprehjeve filozofike. Ja si shprehet ai në fabulën *Pela dhe sorrka;*

Pela sorrkën pyet tek shkojnë:
-I urt', i sert', ku ndryshojmë?

Një e qeshur përshkon sorrkën,
Teksa flet e sodit mbrëmjen:
-I serti përdor forcën,
I urti përdor mendjen[238]*...*

Në vëllimin me fabula, "*Kur merr zjarr e digjet pylli*" autori të mahnit me përshkrimin dhe motivet e larmishme që përcjell. Ai shkruan shkurt dhe godet fort. Ja si shprehet vetë në hyrje të librit:

Tek ky libër që botoj
Veset ashpër kritikoj.
Për fëmijë', jet' e Atdhe,
Dashurisë i heq fre…

Pëllumb Velo në fabula shquhet për origjinalitetin dhe mjeshtërinë. Ka humor të hollë dhe ngacmues, të zgjuar e me kulturë, vjen për lexuesit e çdo moshe i qartë, me individualitetin e tij krijues. Ai fton në artin e tij kafshët tradicionale të fabulës: dhelprën, ujkun, qenin, korbin, sorrën, derrin, gomarin, kalin.....por edhe sendet që janë më të përdorshme nga njeriu, ose pjesë e trupit apo të jetës së tij si: këmba, këpuca, libri, fyelli, etj. E krijon fabulën brenda familjes së kafshëve apo të njeriut.

[237] Pëllumb Velo, "Fabulisti dhe gjallesat 1", në parathënien e përmbledhjes me fabula, Vlorë, 2008, f. 3

[238] Pëllumb Velo, "Skilja e lagunës", Vlorë, 2012, f. 62

PËRFUNDIME

Letërsia për fëmijë e të rinj, tashmë ka krijuar një bibliotekë të tërë dhe pasuritë e saj letrare dhe estetike kanë përcjellë tek fëmijët vlera argëtuese, morale, edukative.

Kjo letërsi gjenezën e saj e ka, si e gjithë letërsia e kultivuar, te folklori popullor, te folklori për të vegjlit, te krijimet e tilla sikundër janë: përrallat, legjendat, këngët popullore për të vegjlit, këngët-lodra, këngët e motmotit, gjëegjëzat dhe këngët e ndryshme lirike. Krijuesit tanë të letërsisë së kultivuar, duke u mbështetur në to, nga foklori nuk kopjuan mekanikisht tema, fabula për krijime të tyre, nuk u ndikuan nga pasazhe të jashtme, por synuan shpirtin popullor të krijimtarisë, ndjeshmërinë artistike, mënyrën e këngëtimit, magjinë e rrëfimit.

Letërsia për fëmijë traditën e vet e formësoi si letërsi didaktike me frymë moralizuese. Pjesët didaktiko-fetare për fëmijë nisin që nga vepra "*Doktrina e Krishterë*" e Lekë Matrëngës (1592), që shërbente për mësimin e fesë te fëmijët e fshatrave arbëreshe. Në të ndodhet vjersha "Kënga e përshpirtshme", e cila u drejtohej jo vetëm fëmijëve, por edhe të rriturve. Më tej lindi dhe u zhvillua një letërsi e tërë e shkruar didaskalike për fëmijë, e cila përmbledh tekstet shkollore dhe abetaret, ku u botuan krijimet e para për të vegjël (tregime e vjersha), pra embrionet e letërsisë artistike për fëmijë. Për këtë arsye, në fillimet e saja letërsia e mirëfilltë artistike për fëmijë nuk mund të shkëputet nga letërsia didaktike-fetare dhe ajo shkollore-mësimore.

Në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare, ashtu si letërsia e të rriturve, edhe letërsia për fëmijë njohu një nga zhvillimet më të ndritura të saj. Mjaft autorë, personalitete të shquara, artin e tyre e vunë në shërbim për të vegjlit. Kjo pasuri letrare për fëmijë bën pjesë në traditën romantike të letërsisë sonë, e cila ka tiparet e veta, ka porosinë e saj kryesisht për nevojat e zgjimit kombëtar dhe arsimit shqip. Pjesa më e madhe e krijimeve të kësaj letërsie, si: vjersha, tregime, fabula, përralla, copëza letrare-shkencore, janë shkruar posaçërisht për t'u përfshirë në tekste për shkollat e para shqipe. Të tilla janë pothuajse të gjitha krijimet për fëmijë të Kostandin Kristoforidhit, të Naim Frashërit, të Sami Frashërit, të Papa Kristo Negovani, etj.

Midis tyre ka patur mjaft krijime të tjera të shkruara posaçërisht për fëmijët, jashtë kuadrit të teksteve shkollore, që ata të edukohen artistikisht dhe moralisht. Në këtë këndvështrim përfshihen krijime të mirëfillta letrare dhe artistike siç është vëllimi "*Vjersha për mësonjëtoret e para*" i Naim Frashërit, si dhe dy përmbledhjet "*E këndimit të çunave këndonjëtoreja*" po të këtij autori, të cilat, megjithëse lidhen përsëri me shkollën, i konsiderojmë si librat e parë artistikë jashtëshkollorë. Në këtë periudhë kemi edhe përkthime e përshtatje të fabulave të Ezopit dhe fabulistëve të tjerë nga Anton Santori e më vonë nga Çajupi etj.; novela "*I vogli Donat Argjendi*" i P.K.Negovanit etj..

Letërsia për fëmijë e Rilindjes Kombëtare shënoi një hap cilësor; ajo u zhvillua si një letërsi artistike në gjini të shkurtra e, megjithatë, ajo nuk mundi të fitonte tiparet e një dege të pavarur në trungun e letërsisë së përgjithshme.

Kostandin Kristoforidhi zë vendin e parë në historinë e lëvrimit të gjuhës shqipe, po edhe të letërsisë artistike për fëmijë (me vjershën "*Ylli i vogël lart në qiell*", përrallëzën "*Dy dhitë*" apo tregimin e gjatë "*Gjahu i malësorëve*").

Një nga tiparet e tjera të kësaj tradite letrare për fëmijë është se rilindësit tanë treguan që kultivimi i letërsisë për fëmijë ishte një mision i madh e i rëndësishëm shoqëror, pedagogjik, artistik dhe kombëtar, letërsi e cila duhej lëvruar për të zhvilluar dhe qytetëruar brezin e ri të Shqipërisë. Ndër ta ishin: Kostandin Kristoforidhi-babai i gjuhës shqipe, Naum Veqilharxhi-polemist dhe themelues i abetares shqipe; Naim Frashëri- poeti ynë Kombëtar i Rilindjes, Sami Frashëri me mendje enciklopedike, Çajupi – përshtatësi më i talentuar i fabulave të La Fontenit, fabula të cilat, si na thotë vetë me një vjershë origjinale në faqen e parë të librit në fjalë, ua adresoi fëmijëve, brezit të ri. Me të tillë kulturë ishin edhe autorë të tjerë pasues të letërsisë shqipe për fëmijë, si: Gjerasim Qiriazi, Papa Kristo Negovani, Anton Xanoni, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Asdreni etj.

I njëjti proçes vazhdon edhe pas shpalljes së Pavarësisë, pra, në gjysmën e parë të shekullit XX. Këtu shquajmë punën e mirë të abetareve e të këndimeve të Anton Xanonit e të Ndre Mjedës, Luigj Gurakuqit e Asdrenit dhe theksohet se jashtë këtyre teksteve, letërsia jonë për fëmijë nuk njohu botime te veçanta artistike. Por, siç konstaton studiuesi Tasim Gjokutaj, në këtë kohë *"pati më tepër lexime për fëmijë sesa letërsi të mirëfilltë për fëmijë"*. Të kësaj periudhe theksohen si shumë të rëndësishme për zhvillimin e letërsisë sonë për fëmijë edhe disa vepra të përkthyera të letërsisë botërore për fëmijë, si romani *"Zemër"* i Edmondo De Amiçisit, romani *"Njeriu i padukshëm*" i Ralf Kolfordit, *"Robinson Kruzo"* i Daniel Defosë, *"Princi i lumtur dhe përralla të tjera"* i Oskar Uajlldit, *"Liza në botën e çudirave"* i Ljuis Kerollit etj.

Pothuajse fryma e Rilindjes sonë Kombëtare vijoi deri në fillim të viteve '30 të shekullit XX me daljen në dritë të revistës së parë për të vegjlit "*Vatra e rinisë*", e cila nisi botimin në shkurt të 1933-shit. Letërsinë për fëmijë e pasuroi mjaft lëvrimi i prozës së disa shkrimtarëve të mirënjohur, të cilat u botuan në rubrikat e saj, si: Milto Sotir Gurra,Vasil Xhaçka, Ilo Mitkë Qafëzezi etj.

Duke patur parasysh të gjitha këto, studiuesi Prof. Akademik Bedri Dedja, në Vitet e Demokracisë, duke iu shmangur kriterit politizues, shtroi tezën se pikërisht në vitet 1920 dhe në fillim të viteve '30 letërsia jonë për fëmijë kalon nga romantizmi i Rilindjes në realizëm. Në këto vite dolën gazeta e revista të posaçme për fëmijë, përkthehen disa nga kryeveprat e letërsisë botërore për fëmijë, në këto vite shfaqet talenti elegant i përrallëtares për fëmijë Musine Kokalari, botohen prozat e mrekullueshme të Migjenit, që shërbyen si leximeve për fëmijë. E pra, në këto vite duhet t'i kërkojmë edhe fillimet e letërsisë shqiptare moderne për fëmijë (gaz. "Mësuesi", 26 janar 2000).

Më tej krijimtaria për fëmijë u karakterizua nga arritje të dukshme, duke krijuar profile dhe individualitete krijuesish. Autorë përfaqësues të poezisë dhe prozës moderne shqipe për fëmijë prezantohen shkrimtarët e poetët: Bedri Dedja, Odhise Grillo, Petro Marko, Adelina Mamaqi, Bardhyl Xhama, Skënder Hasko, Gaqo Bushaka, Astrit Bishqemi, Bardhosh Gaçe, Xhahid Bushati, Ferit Lamaj, Viktor Canosinaj etj.

Një vend të rëndësishëm zë dhe krijimtaria e mirëfilltë letrare për fëmijë e prozatorit Mitrush Kuteli. Asnjë prozator tjetër shqiptar nuk është mbështetur kaq fort te proza e pasur gojore e popullit, te balada e rapsodia, ku fryt i përpunimit me mjeshtëri i materialeve folklorike është vëllimi *"Tregime të moçme shqiptare"*.

Por metoda socrealiste bëri që te veprat letrare për fëmijë në plan të parë të vlerësoheshin jo vlerat e tekstit letrar, jo vlerat letrare, loja e humori, kënaqësia estetike që të jep një krijim letrar, por ato jashtëletrare: vlerat pedagogjike, partishmëria, ideologjia e politika, vlerat morale e ato edukuese. Vetëm tranzicioni demokratik ngriti në piedestal funksionin argëtues që ka një vepër për fëmijë, duke lënë mënjanë apo duke e renditur ndër të fundit funksionin edukues të një teksti letrar, në poezi apo në prozë qoftë ai.

Patjetër që këtu duhet të veprojë metoda e seleksionimit dhe e rivlerësimit, për autorët si dhe për vepra të veçanta të tyre, për të ndërtuar një hierarki tjetër autorësh e veprash letrare në fushën e letërsinë për fëmijë.

Mund të paraqitnim edhe njëfarë tipologjizimi për lloje të ndryshme të krijimtarisë për fëmijë.

Kësisoj, **poezia** për fëmijë në udhën e saj të gjatë, ka qenë e lidhur me jetën politiko-shoqërore, ekonomiko e kulturore të popullit tonë. Nga poezia didaktike-moralizuese e Rilindjes, nga poezia romantike e asaj periudhe kaluam në romantizëm-realizëm nga fundi i viteve '30 dhe në fillim të viteve '40 të shekullit të kaluar. Të njejtët autorë akorduan tone realiste të jetës. Zuri vend tema e luftës antifashiste. Mori vrull poezia sociale pas Çlirimit të vendit. Poetët u mbështetën në folklor dhe i ripunuan vlerat kulminante të poezisë gojore. Dashuria për vendlindjen e për atdheun qe një nga temat më të rrahura. Dominante në poezinë e viteve '50 është poezia me tematikë nga jeta e përditshme e fëmijëve. Bota bimore e shtazore është e dashur për fëmijët, ndaj shumë vjersha kanë ngritur poetët tanë për këtë temë. Poezia humoristike ka vlera të mëdha, po ecja e saj qe e ngadaltë. Arritje evropiane mund të themi se në gjininë e poezisë ka fabula për fëmijë e poetit Ferit Lamaj. Dobësi e poezisë sonë qe deklaratizmi dhe uniformizmi.

Poema qe një zhanër pa tradita në letërsinë tonë për fëmijë. Ndaj poetët tanë fillimisht nisën të merrnin nga folklori përralla, legjenda, gojëdhëna e ndodhi interesante e t'i vargëzonin ato, të formonin të ashtuquajturat poema-përrallë (*Gjysmagjeli* i M. Zaloshnjes, *Cironka e artë* e Zihni Sakos, *Dhitë e egra* e Kolë Jakovës, *Princesha Argjiro* e Kadaresë etj). Më tej fabula e këtyre poemëve filloi të fantazohet nga vetë poetët (*Orizi i milingonave* e Adelina Mamaqit, *Shkolla e pyllit* e Bedri Dedjes, *Ariu fotograf* i Bekim Harxhit). Një drejtim i ri qe krijimi i tregimeve në vargje (*Shpendi* i Alqi Kristos, *Kasollja* e Ramadan Pasmaçiut etj). Vonë filloi të lëvrohet poema e mirëfilltë, qoftë ajo me subjekt (*Letër nga fqinji* e Shevqet Musarait, *Brigadierja* e Drago Siliqit etj) apo ajo meditative (*Muzeu i armëve* i Kadaresë, *Legjenda e gjoseve* e Odhise Grillos, *Shkronjëzat e arta* e Musa Vyshkës etj.). Poema humoristike arriti disa kulme me Tasim Gjokutën (Obobo, i ziu ç'bëra!; *Derrkuci që bëri dush; Kush e hëngri akulloren* etj).

Proza për fëmijë është një nga gjinitë qe ka ecur me hapa të shpejtë. Arritjet në zharin e **tregimit** janë sa sasiore aq edhe cilësore. Mosha e tij është mbi njëshekullore, që nga *Gjahu i malësorëve* i Kristoforidhit. Ndihmesë të mirë dhanë për të shkrimtarët: Qamil Guranjaku, Zihni Sako, Tefik Gjyli, Fatmir Gjata, Dhimitër Shuteriqi. Më tej nivel ky zhanër arriti me tregimet e Nasho Jorgaqit, Naum Priftit,

Petraq Zotos. Tema e luftës zuri vendin kryesor në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore. Pas saj u shqua tregimi me temë aktuale me autorë Shpresa Vreto, Bedri Dedja etj. Tema e jetës së kafshëve u trajtua nga autorë të tillë, si Petraq Zoto. Madje u lëvrua edhe zhanri fantastiko-shkencor nga autorët Flamur Topi, Thanas Qerama etj. Si dobësi do të themi se tregimi i ashtuquajtur "për pionierë" (ndryshe nga poezia për këtë moshë) ka patur arritje, kurse ai për moshat e vogla ("yllka" e "fatosa", siç emërtoheshin) është më i pakët në sasi dhe lë për të dëshiruar në nivel artistik. Dobësi e përgjithshme e tregimit është skematizmi, nga ana tjetër, moralizimi. Siç vinte në dukje Dritero Agolli, me ato tregime i kemi bërë lexuesit fëmijë robotë morali dhe të ndrydhur. Në shumë tregime të asj kohe lëvrijnë personazhe fëmijë që veprojnë e gjykojnë si të ishin të rritur, pra mungon psikologjia fëminore.

Novela për fëmijë e hodhi hapin e parë që me agimin e shekullit të kaluar me veprën *I vogli Donat Argjendi* të Negovanit. Pas saj pati një heshtje të gjatë dhe u zgjua më 1953 me librin "*Na hoqën çatinë*" të Aleks Çacit. Nismëtarët qenë novelat-përralla (si tek poema): *Kacamicri* i Tofik Gjylit, *Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit* e Bedri Dedjes etj. Më vonë dolën dhjetëra novela për fëmijë me autorë: Naum Prifti, Dhimitër Xhuvani, Gaqo Bushaka, Skënder Hasko etj etj. Ndryshe nga tregimi, novela jonë u ka shpëtuar disa të metave, si didaskalizmit e moralizimeve të thata, vënies në qendër të motos "pësimi bëhet mësim" etj.

Romani për fëmijë është i ri në moshë. Në të mungon trashëgimia nga e kaluara. Në vitin 1962 është Selman Vaqari ai që me *Debatikun* shënon zanafillën e këtij zhanri të prozës së gjatë. Po Petro Markoja qe ai që i dha vulën cilësore me veprat "*Shpella e piratëve*" (1964), "*Fantazma dhe plani tre plus katër", " Halimi"*. Romanmet tona për fëmijë kanë rrahur më së shumti temën historike dhe të luftës antifashiste (*Pushka top Bajram Curri* i Sulejman Krasniqit, *Skalitësi i lirisë* i Xhevat Malltezit, *Shpatat nuk u ndryshkën* i Virgjil Muçit, *Bonjakët* i Petraq Qafëzezit etj.). Me temë nga jeta e përditshme janë romane të tillë si: *Udhëve të fëmijërisë* i Ramadan Pasmaçiut, të Migjenit të Idriz Ponarit etj. Seria e romaneve përrallore është shumë e pranishme, duke filluar që me *Kalin fluturues* të Petraq Zotos e duke vazhduar me serinë për *Çufon* të Gaqo Bushakës. Vënd zë edhe romani fantastiko-shkencor, si ai me teme nga mjeksia të autorit Flamur Topi (*Lufta për jetën, Gren Peace – Vdekja e detit*), nga fizika të autorëve Astrit Bishqemi (*Udhëtim i jashtëzakonshëm*) e Bardhyl Xhama (*Ekspedita e kaltër*) etj

Një zhanër i ri i prozës së gjatë është edhe romani i ritreguar të cilin e lëvroi Odhise Grilloja me *Historia e Skënderbeut* të ritreguar sipas Naim Frashërit, *Lahuta e Malësisë,* sipas Gjergj Fishtës etj.

Dobësi e prozës së gjatë është konceptimi si për të rritur i shumë romaneve për fëmijë. Shpesh mungon konflikti dhe romani ktheheht në një tregim historik bëmash pa vlerë figurative. Gjithashtu, nuk ka gjetje kompozicionale dhe subjekti njejtësohet me fabulën.

Në vitet e Demokracisë letërsia jonë për fëmijë po njeh nivele të reja artistike. Ajo po zhvishet nga pedagogjia e rënduar, nga elementet moralizuese e ngurtësuese në jetën e të vegjelve. Edhe nga ajo urrejtje e egër klasore, nga euforia e dashurisë për partinë e për udhëheqësin, nga euforia se ne jemi vendi më i lumtur në botë etj etj. Prioritet po i jepet ndjenjave humanitare, imagjinatës e fantazisë, lodrës e humorit në krijimet tona artistike. Prioritet po i jepet vlerave artistike e estetike të tekstit letrar.

Në vitet e Demokracisë po bëhen përpjekje për ta unifikuar letërsinë shqipe për fëmijë të popullit shqiptar, për të ingranuar në të edhe prodhimtarinë artistike për fëmijë që lëvrohet e prodhohet në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e në Diasporë. Dhe kështu niveli i kësaj letërsie njeh rritje, njeh maja të reja. Nuk thuhet tani, për shembull, se romani ynë për fëmijë zanafillën e ka në vitin 1964 me veprën "Shpella e piratëve" (nuk përmendej madje as "Debatiku" i Selman Vaqarit i vitit 1962, sepse ky autor qe dënuar e anatemuar nga partia në pushtet), por thuhet se rromani ynë për fëmijë e ka zanafillën në vitin 1959, me veprën *Lugjet e verdha* të autorit nga Kosova Rexhep Hoxha.

Veç edhe kjo periudhë tranzicioni ka dobësitë e mangësitë e veta. Kështu rënie ka gjinia e dramës për fëmijë. Këto dy dhjetëvjeçarë nuk kanë funksionuar teatrot për fëmijë dhe ata për kukulla për vogëlushët e kopshteve e shkollarët e ulët. Kjo gjendje ka sillë si pasojë që edhe krijuesit tanë të mos ulen e të krijojnë për skenën e këtyre moshave.

Në vitet e Demokracisë sidomos zhanri i romanit për fëmijë po njeh maja të reja. Përmendim romanin "*Katër fëmijë dhe Pogi i padukshëm*" të Rudolf Markut, "*Presidenti i planetit të kuq"* të Bedri Dedjes, Viktor Canosinajn me një seri romanesh me temë shoqërore ("*Ata kërkonin lumturinë", "Meriyll"* etj.), Astrit Bishqemin me romanin katërvëllimsh "*Klik, Rrapatushët*" apo Thanas Jorgjin tani së fundmi (2012) me serinë prej dymbëdhjetë romaneve me titull të përgjithshëm "*Unë jam Kronosi, mbreti i kohës"* etj. etj.

Letërsia jonë bashkëkohore për fëmijë ka dhënë edhe shumë autorë që janë shquar e profilizuar për trajtim temash, gjinish, a zhanre të veçantë. Kështu sot mund të përmendim:

Bedri Dedja – studiuesi e krijuesi shumëplanësh për fëmijë;
Odhise Grillo – humoristi, përrallëtari dhe rikrijuesi;
Petro Marko – romancieri evropian për fëmijë;
Adelina Mamaqi – poetja e moshës parashkollore dhe të ulët shkollore;
Xhevat Beqaraj – poeti i peizazhit akuarelist;
Gaqo Bushaka – përrallëtari i Çufos;
Skënder Hasko – novelisti për fëmijë;
Bardhyl Xhama – shkrimtari i detit;
Tasim Gjokutaj – mjeshtri i vargut humoristik;
Xhahid Bushati – liriku i fëmijëve;
Ferit Lamaj - fabulisti konçiz e tërë humor për fëmijë;
Viktor Canosinaj – një zë i veçantë në prozën për fëmijë e të rinj;
Vilhelme Vranari – idealizuesja e historisë së lashtë të popullit tonë;
Etj. etj...

Në këtë këndvështrim jemi munduar t'i paraqesim e t'i analizojmë edhe ne në këtë temë studimore.

BIBLIOGRAFI TEORIKE

- Aliu, Ali: Nga libri "*Katër romane të Petro Markos*", 1979- Kërkime, Tiranë, 1990.
- *Alfabetare e gjuhës shqipe*, Kostandinopojë 1879.
- Akademia e Shkencave e Republikës të Shqipërisë, "*Histori e letërsisë shqiptare"*, Tiranë, 1983

- Beka, Alfred. *Letërsi, ese, kritike, Nderohet Adelina Mamaqi*.

- Bishqemi, Astrit. *"Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë",* Tiranë, 2001
- Bishqemi, Astrit. *"Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë",* Elbasan, 2004.
- Bishqemi, Astrit." *Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë*" - SEJKO, Elb.2001; (e ripunuar: DY LINDJE DHE DY PERËNDIME, T.2008).
- Bishqemi, Astrit. " *Histori e letërsisë shqipe për fëmjë*", Elbasan, 2004.
- Bishqemi, Astrit. "*Vlera të anatemuara*...(Gjurmime e studime), Tiranë, 2005.
- Bishqemi, Astrit. "*Klik: Rrapatushët*", Tiranë, 2007.
- Bishqemi, Astrit. "*Autorë të letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj* 1886-2009, (lexikon), Tiranë, 2009.
- Bishqemi, Astrit. "*Tragave të letërsisë*...(Gjurmime e studime), Elbasan, 2011.

- Bojku, Fejzi. Në pasthënien e vëllimit "*Goni trazovaçi"*, Shkup, 2002.
- Bombaj, Iliaz. "*Veçoritë e përrallës, fabulës dhe gjëegjëzës"*, Gazeta Athina, Shkurt, 2011.
- Bubani, Dionis. (Odhise Grillo, *Tradhti në sarajet e Topias*- parathënie), Tiranë, 1996.
- Bulka , Nonda "*Naimi dhe fabulat"*, Nëntori Nr. 5, 1971.
- Bushati, Xhahid. "*Shkrimtari, personazhi, lexuesi i vogël – Marrëdhënie, raporte dhe aspekte të komunikimit artistik në poezinë për fëmijë të Adelina Mamaqit* (Studim), Revista OBELISK 134, f. 5
-

- Çadri, Ramazan. "*Letërsia për fëmjë midis vlerës dhe antivlerës"*, LETERSIA SI E TILLE. Tiranë, 1996.
- Çadri, Ramazan. *"Letërsia shqipe për fëmijë",* Tiranë, 2001.

- Dado, Floresha. " *A. Z. Çajupi – Jeta dhe vepra*", Tiranë, 1983.
- Dedja, Bedri. "*Probleme të historisë së letërsisë shqiptare për fëmijë"*, MESUESI, 15.12.1999
- Dedja, Bedri. "*Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë"*, Tiranë, 1971.
- Dedja, Bedri: *Fillimet e letërsisë moderne shqiptare për fëmijë* – Gazeta MËSUESI, 26 qershor 2000

- Dedja, Pandora: *Novela e parë shqipe për fëmijë "I vogli Donat Argjendi" e P.K. Negovanit* – PROBLEME TË TRADITËS DHE TË AKTUALITETIT NË LETËRSINË TONË PËR FËMIJË, "N. Frashëri", T. 1976.

- *Dule,* Miranda*: Roli i gjëagjëzave në zhvillimin mendor të fëmijëve* – "Probleme të traditës dhe të aktualitetit në letërsinë për fëmijë", Tiranë, 1976.

- Frashëri, Kristo. "*Tre vëllezër pishtarë*" (Abdyl Frashëri, Naim Frashëri, Sami Frashëri), Tiranë, 1078.

- Fullani, Dhimitër. " *Papa Kristo Negovani"* [parathënie e librit "Prishja e Hormovës"]. Tiranë, 1960.

- Gaçe, Bardhosh. "*Letërsia shqipe për fëmijë"*, Vlorë, 2006.
- Grillo, Odhise. Gazeta "*Drita*", 16 korrik 1995.
- Grillo, Odhise. *Panoramë letrare* – 3 (Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë), Botimet Toena, Tiranë, 2000.
- Grillo, Odhise. "*Panoramë letrare",* Tiranë, 1986.

- Gjokutaj, Tasim. *Letërsia shqipe për fëmijë ka nevojë më tepër për vlerësim* – "LETËRSIA SI E TILLË". Tiranë, 1996.

- Hamiti, Sabri. " *Letërsia moderne shqiptare",* Albas, 2000.
- Harka, Sejdo. Gazeta "*Ballkan*", Korrik, 2010.
- Historia e Shqipërisë – *Zhvillimi i ideologjisë dhe i kulturës së Rilindjes Kombëtare (vitet 80 të shekullit XIX – 1912*) , Kreu IX:

- Jorgaqi, Nasho. *Paraqitje* [parathënie e librit "Faik Konica – Vepra", Tiranë, 1993].
- Jorgaqi, Nasho. "*Traditë e re, vepër e re"* – DRITA, 3 prill 1988.

- *"Kalliri i plotë"* Shënime bio-bibliografike dhe shkrime të tjera për Odhise Grillon, Vështrim kritik nga Faik Shkodra, Gjilan, 2004.
- Krasniqi, Mark"*Mbeshtetje shkencore*…" , f.279; cituar sipas Anton Nikë Berishës, "Poezia…".
- Kristoforidhi, Kostandin. *"Gjahu i malësorëve" (Hieja e Tomorrit)*, Tiranë, 1950, në shënimin hyrës nga Ziaudin Kodra.
- Kodra, Klara; "Romani fantastiko-shkencor i shkrimtarit Bedri Dedja "*President i Planetit të Kuq*", shkrim në gazetën "Zëri i shqiptarëve", 13 Prill 2013.
- Kuteli, Mitrush. "*Vepra letrare 5"*, Tiranë, 1990.
- Kulla, Jerida. "*E dashuruar pas "Eseninit",* Shtator, 2011.

- Lamaj, Ferit."*Dhelpra e Trojës*", parathënia e Dritëro Agollit, Tiranë, 1996.

- Nelaj, Milaim. Gazeta "*Telegraf*", Prill, 2010.
- Nelaj, Milaim. "*Profile letrare"* - STUDIME, Tiranë, 2008.

- Prifti, Naum. "*Një mjeshtër i tregimit*" – NËNTORI, nr. 3/1990.

- Qosja, Rexhep. "*Porosia e madhe"*, Tiranë, 1989.
- Qosja, Rexhep. "*Historia e letërsisë shqip – Romantizmi II"*, Tiranë, 2000.
- Qosja, Rexhep. "*Asdreni- Jeta dhe vepra e tij*" (monografi), Tiranë, 2002.
- Quku, Mentor. "*Mjeda- 3*" libri i parë Alfabeti (1899-1912).

- Rama, Shukrije. "*Shpirti plor rubinë"* (studime), Prishtinë, 2007.

- Sadrija, Jahë. "*Andon Zako Çajupi – Jeta dhe vepra"* (1886-1930), Zemra shqiptare, Mars 2011.
- Syla, Xhevat. "*Kuvendim poetik*", Prishtinë, 2010.

- Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i gjuhësisë. *"Histori e letërsisë shqiptare"*, Vëllim i parë, Tiranë, 1959.

- Velo, Pëllumb. "*Fabulisti dhe gjallesat 1*", në parathënien e përmbledhjes me fabula, Vlorë, 2008.
- Veliu, Veli. "*Fabula shqiptare e periudhës së Rilindjes*", Shkup, 1993.
- Xholi, Zija, "*Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare*", Tiranë, 1987.

- Zheji, Gjergj. "*Hyrje në folklor*" Tiranë, 1994.

BIBLIOGRAFI E LIBRAVE TË MARRË NË ANALIZË

- Asdreni, "*Psallme murgu",* (Vjersha të tjera, Përkthime), Tiranë, 1980.

- Beqaraj, Xhevat. "*Kam një harmonikë*", Tiranë, 1965.
- Beqaraj, Xhevat. "*Rrugica ime*", Tiranë, 1966.
- Beqaraj, Xhevat. "*Shtëpia e bubit*", Tiranë, 1972.
- Beqaraj, Xhevat. "*Letrat e vjeshtës*", Tiranë, 1989.
- Beqaraj, Xhevat. "*Nuk qeshin të gjithë*", Tiranë, 2000.
- Beqaraj, Xhevat. "*Rruazat e vesës*", Tiranë, 2006.
- Bishqemi, Astrit. "*Gjoksshkëmbi*", Tiranë, 1972.
- Bishqemi, Astrit. "*Përtej oborrit diellor*", Tiranë, 1978.
- Bishqemi, Astrit. "*Kallëzimet e kokërave të breshërit*", Tiranë, 1978.
- Bishqemi, Astrit. "*Udhëtim i jashtëzakonshëm*", Tiranë, 1987.
- Bishqemi, Astrit. "*Thesi i gjallë*", Tiranë, 1998.
- Bishqemi, Astrit. "*Zemër, o bir*!", Tiranë, 2000.

- Bushaka, Gaqo. "*Zogu në kaushin e akullores*", Tiranë, 2004.

- Canosinaj, Viktor. "*Biri i erës"*, Tiranë, 2006.
- Canosinaj, Viktor. "*Meriyll"*, Tiranë, 2006.
- Canosinaj, Viktor. "*Monstrat e Rrugës së Mimozave*", Tiranë, 2006.

- Çakërri, Ferhat. "*E fshehta e kalasë*", Tiranë, 1984.

- Çakërri, Ferhat. "*Pula klloçkë bën vizita*", Tiranë, 1986, 1997.
- Çakërri, Ferhat. "*Ku ta gjej pranverën*", Tiranë, 2007.
- Çakërri, Ferhat. "*Arlini dhe e Bukura e Dheut*", Tiranë, 2001.

- Dedja, Bedri."*Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit*", Tiranë, 1954.
- Dedja, Bedri. "*Shkolla e pyllit", Tiranë*, 1967.

- Dedja, Bedri. "*Artan borizani dhe çeta e tij*", Tiranë, 1970, 1977.
- Dedja, Bedri. "*Kalamajtë e pallatit tim*", Tiranë, 1972, 1979
- Dedja, Bedri. "*Përralla njëmbëdhjtëkatëshe*", Tiranë, 1996
- Dedja, Bedri. "*Presidenti i Planetit të Kuq*", Tiranë, 2006 (pas vdekjes).

- Frashëri, Naim. " *E këndimit çunavet Këndonjëtoreja"*, copë e dytë, shtypurë prej Shoqërise Drita, Bukuresht, 1886.
- Frashëri, Naim.*" Vepra të zgjedhura 2",* Prishtinë, 1978.
- Frashëri, Sami. "*Dheu është flori*", Tiranë, 2000.
- Frashëri, Naim. "*Histori e Skënderbeut"*, Tiranë, 2003.

- Gaçe, Bardhosh. "*Lumi im s'fle*", Tiranë, 2005.
- Gaçe, Bardhosh . "*Pranvera i shkruan letër Baba Dimrit*", Tiranë, 2006.
- Gaçe, Bardhosh . "*Gugatin pëllumbat mbi Prishtinë*", Tiranë, 1997.
- Gaçe, Bardhosh . "*Pranvera i shkruan letër Baba Dimrit*", Tiranë, 2006.
- Gaçe, Bardhosh. "*Në kopshtin e ëndrrave*", Vlorë, 2009.
- Gurakuqi, Luigj. "*Vjersha*", Bari, 1940.
- Grillo, Odhise. "*Pse ashtu e pse kështu*", vjersha, poema humoristike, fabula e përralla në vargje, Tiranë, 1998.
- Odhise K. Grillo, "*Pse ashtu e pse kështu*", vjersha, poema humoristike, fabula e përralla në vargje, Tiranë, 1998, (*3 Përralla në vargje*), *Kush e ka kapuçin*, fq. 70, përralla është e shkruar në vitin 1957.
- Gjokutaj, Tasim. "*Kush e hëngri akulloren*", Tiranë 1997.

- Hasko, Skënder ."*Maçoku i katrahurës"*, Tiranë, 2000.

- Kristoforidhi, Kostandin. *"Gjahu i malësorëve"- (Hieja e Tomorrit)*, Tiranë, 1950.
- Kristoforidhi, Kostandin. "*Ylli i vogël lart në qiell"*, Tiranë, 2007.
- Kuteli, Mitrush."*Tregime të moçme shqiptare"*, Tiranë, 2005.

- Lamaj, Ferit. "*Dhelpra e Trojës*", UEGEN, 2005.
- Lamaj, Ferit. "*Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi*", Tiranë, 2010.
- Lamaj, Ferit. "*Mikrofabula*", Tiranë, 2003.
- Lamaj, Ferit. "*Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi*", Tiranë, 2010.

- Mamaqi, Adelina. "*Fluturo, kërce e rend"*, Tiranë, 1998.
- Mamaqi, Adelina. "*Si thoni Ju*?" Tiranë, 1976.
- Mamaqi, Adelina. "*Fluturo, kërce dhe rend"*, Tiranë, 1998.
- Mamaqi, Adelina. "*Goni trazovaçi"*, Tiranë, 1976.
- Mamaqi, Adelina. "*Si e gjete folenë moj dallëndyshe"*, Tiranë, 2007.
- Mamaqi, Adelina. "*Orizi i milingonave"*, Tiranë, 1978.
- Mamaqi, Adelina. "*Piguini Ping Ping Pi",* Tiranë, 2007.

- Mamaqi, Adelina. "*Xhoi- Toi", Tirane*, 2005.
- Mamaqi, Adelina. "*Ëndrra vashërije"* , Prishtinë, 1968.
- Marko, Petro. "*Griva"*, Tiranë 1999.
- Marko, Petro. "*Shpella e Piratëve*", Tiranë, 1998.
- Migjeni, "*Novelat e Qytetit të Veriut*", Tiranë, 1999.
- Mitko Thimi – "*Vepra*", Tiranë, 1981.
- Mjeda, Ndre. " *Poezi",* Tiranë 1978.
- Mjeda, Ndre. "*Dimri dhe plaku"*, Tiranë, 2002.

- Negovani , Papa Kristo. " *Prishja e Hormovës"*, Tiranë, 1960.
- Negovani, Papa Kristo. "*I vogëli Donat Argjendi* prej P.H.H.N. [Papa Harallamb Hristo Negovani – shënimi ynë, A.B., R. A.] Sofje. Ndë shtypshkronjet *Mbrodhësia*, Kristo P. Luarasi. 1904"
- Negovani, Papa Kristo. *Prishja e Hormovës* – N. Sh. Botimeve "Naim Frashëri", Tiranë, 1960.
- Negovani, Papa Kristo. "*.I vogli Donat Argjendi*" Përshtatur nga Bedri Dedja – Tiranë, 2002
- Petromilo, Andrea."*Kush e gjen*? Gjëza, Tiranë, 1998.
- Petromilo, Andrea. "*Qielli i murrëtyer i së dielës"*, Tiranë, 2000.
- Poetë të Rilindjes, Tiranë, 1973.

- Velo, Pëllumb."*Dhelpra dhe gjahtari*", Vlorë, 2006.
- Velo, Pëllumb. "*Kunadhja zyrtare" Vlorë,* 2007.
- Velo, Pëllumb. "*Skilja e lagunës*", Vlore, 2008.
- Vern, Zhyl. "*Dy vjet pushime*", UEGEN, 2004.
- Vranari, Vilhelme. "*Amanti i Arbërisë*", Tiranë, 2003.
- Vranari. Vilhelme. "Kuçedra dhe Dragoi", Tiranë, 2010.
- Vranari, Vilhelme. "Gjigandi dhe xhuxhi", Tiranë, 2011.

- Xhama, Bardhyl. "*Zhytësit e vegjël të thellësive*", Tiranë, 1977.
- Xhama, Bardhyl. "*Ekspedita e kaltër*", Tiranë, 1980.
- Xhama, Bardhyl, "*Zjarrfikësi i pyllitt*", Tiranë, 1987.
- Xhama, Bardhyl. "Tërfili me katër fletë", Tiranë, 1989.
- Xhama, Bardhyl. "*Pse qau delfini*", Tiranë, 1996.
- Xhama, Bardhyl. "*Në kthetrat e piratit*", Tiranë, 2001.

LETËRSIA PËR FËMIJË
(NGA RILINDJA DERI NË KOHËT E SOTME)

Abstrakt

Në kuadër të studimeve në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë, tema "*Letërsia për fëmijë"* synon të paraqesë atë krijimtari letrare që u dedikohet posaçërisht fëmijëve e të rinjve dhe që ndikon fuqishëm në formimin e shprehisë së leximit, si dhe zgjimin dhe thellimin e dashurisë së tyre për artin letrar.

Janë bërë përpjekje të trajtohen portrete shkrimtarësh, përfaqësues të letërsisë së sotme për fëmijë e të rinj të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në gjini të ndryshme letrare për lexuesit e moshave të njoma, duke theksuar më shumë anën estetike të krijimeve letrare dhe njohjen e veçorive psikologjike të fëmijëve.

Studimi është një përpjekje modeste për t'u dhënë studentëve, mësuesve dhe lexuesve të tjerë një panoramë të lindjes dhe zhvillimit të letërsisë për fëmijë e të rinj. Luigi Santucci letërsinë për fëmijë e quan letërsi e magjisë dhe letërsi e mrekullisë, që nxit përfytyrimin, kënaqësinë, fisnikërinë dhe pasurimin shpirtëror. Në këtë kuadër, themi që edhe punimi ynë ka meritën se i kushtohet një dege të rëndësishme të letërsisë sonë, një dege disi të lënë pas dore dhe jo të vlerësuar siç duhet tek ne edhe në ditët e sotme.

Fjalët kyçe: Letërsia për fëmijë, magjike, moderne, bashkëkohore, individualitete krijuese.

Abstract

In light of the studies in the field of Albanian literature for children, the thesis "*Literature for children"* aims to introduce the literature dedicated specifically to children and youth, which has a strong influence on the development of reading habits and the awakening and deepening of their love for literary art.

Efforts have been made to portrait writers, representativeof modern literature for children and young people, who have given their contribution in various literary genres for readers of young age, giving more emphasis to the aesthetic aspect of literary creations and recognition of children's psychological features.

The study is a modest attempt to give students, teachers and other readers an overview of the genesis and development of literature for children and youth. Luigi Santucci considers children's literature as the literature of magic and miracle that encourages imagination, pleasure, nobleness and spiritual enrichment. In this context, we say that our thesis has the advantage of being dedicated to an important branch of our literature, a branch neglected to some extent and not properly assessed nowadays.

Key words: literature for children, magic, modern, contemporary, creative individualities.